



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**Nr.344, datë 02/02/2015**

**“Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Eduart	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02 /02/2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të monitorimit në “Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d, dhe neni 42.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Raportit të Monitorimit të Sektorit të Analizës dhe Studimit mbi “Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”,

**VËREN SE:**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ka monitoruar tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve nisur nga rritja e ndjeshmërisë së konsumatorëve dhe indiciet nga media, në të cilat evidentohet rritja e fortë rreth 30% dhe e menjëhershme e çmimit të shitjes së vezëve.
2. Në tregun përkatës të prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, janë të regjistruar rreth 14 stabilimente të vezëve në rang kombëtar, nga të cilat 6 ndërmarrje operojnë në qytetin e Durrësit, 2 ndërmarrje në Vlorë, 2 ndërmarrje në Shkodër, 1 në Korçë, 1 në Kukës, 1 në Dibër dhe 1 në Berat.
3. Por, nga monitorimi i tregut rezultoi se numri i ndërmarrjeve aktive në prodhimin e vezëve është më i vogël dhe se ndërmarrjet me status aktiv në tregun e prodhimit të

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

vezëve janë 8, nga të cilat përqëndrimi më i madh është në zonën gjeografike të rrethit të Durrësit.

4. Të dhënat e monitorimit treguan se gjatë gjysmës së dytë të muajit nëntor, çmimi i vezëve u rrit me rreth 30 % dhe në vijim çmimi i shitjes së vezëve ka mbetur i pandryshuar në vlerën 17lekë-18 lekë/kokrra ( në varësi të ambalazhit).
5. Për sa më lart, rritja e fortë dhe e njëkohëshme e çmimit të vezëve mund të jenë shenja të caktimit të çmimeve si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 3 pika 4, nenin 4, nenin 24 gërma f, dhe nenin 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

**VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve.
- II. Periudha hetimore do përfshijë gjithë vitin 2014, ndërkohë që procedura e hetimit paraprak do të përfundojë jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM

nr.345, datë 12/02/2015

“Për

mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregimit me shumicë të karburanteve, ndaj ndërmarrjeve “Kastrati” SH.A, “Kaspetrol” SH.A, “Europetrol Durrës Albania” SH.A, “Porto Romano Oil” SH.A, “Bolv Oil” SH.A, “Genklaudis” SH.A, “Everest Oil” SH.A, “Taci Oil” SH.A. dhe “Armo” SH.A. dhe disa rekomandime për mirëfunksionimin e këtij tregu”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.02.2015 dhe 12.02.2015 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.

**Baza ligjore:** Neni 4, neni 8, neni 9, pika 1 dhe pika 2, germa (a); neni 24, shkronja d; dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar); ( këtu e më poshtë Ligji)

Ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”

**Ndërmarrjet nën hetim:**

1. “**Kastrati**” SH.A me nr NIPT K43823006A dhe adresë: Lagjia nr.14, Rruga Tiranë-Durrës, Shkozet;
2. “**Kaspetrol**” SH.A me nr. NIPT J91823501N dhe adresë: Shkozet, Durrës;
3. “**Europetrol Durrës Albania**” SH.A, me nr NIPT K24010212N dhe adresë: Lagjia “Hoxhe”, nr.12, Krujë
4. “**Portoromano Oil**” SH.A me nr. NIPT K61330501I dhe adresë: “Katundi i Ri”, Rruga Porto Romano, Durres;
5. “**Bolv Oil**” SH.A, me nr. NIPT K32528408H dhe adresë: Grize, Patos, Fier

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

6. **“Genklaudis” SH.A**, me nr. NIPT K76911001E dhe adresë: Berdice Beltoje, Shkoder;
7. **“Everest Oil” SH.A** me nr. NIPT L21829002Q dhe adresë: Rruga: “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Pallati 1/1, Kati II, Tiranë;
8. **“Taçi Oil International Trading & Supply” SH.A** me nr. NIPT K31902009J dhe adresë: Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, P.Sky Toëer, Kati IV, Tiranë;
9. **“Armo” SH.A** me nr. NIPT K82916498D dhe adresë: Rruga Papa Gjon Pali II, pallati nr 12, ABA Business Center, kati 8, Tiranë.

**Periudha e hetimit:** Periudha objekt hetimi e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr. 315, datë 13.05.2014, është 1 Janar 2010- 30 Prill 2014.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të :**

- Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Pretendimeve të paraqitura me shkrim dhe në mënyrë verbale nga ndërmarrjet nën hetim në seancat dëgjimore të datave 26 dhe 29 dhjetor 2014 si dhe ato të depozituara në datat 9 dhe 12 Janar 2015

**KONSTATOI :**

**I. PROCEDURA E NDJEKUR:**

1. Bazuar në shqetësimin publik të përcjellë nga mediat, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 292, datë 16.09.2013, të Komisionit të Konkurrencës vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”.
2. Për vlerësimin e pasojave të ndryshimeve strukturore dhe reflektimin në treg nga ndërmarrjet të efekteve të paketës fiskale të vitit 2014, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr.304, datë 27.01.2014 “Për një ndryshim në Vendimin nr.292, datë 16.09.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”, vendosi zgjatjen e periudhës së hetimit deri në 31 Janar 2014.
3. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, u konstatua rritje e shkallës së përqëndrimit të tregut si dhe dy modele të ndryshme biznesi në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të hidrokarbureve, mos reflektimi i ndryshimit të çmimit ndërkombëtar të hidrokarbureve në tregun e brendshëm. Në bazë të neneve 24, shkronja d), dhe 43, pika 1 të Ligjit, nenit 5, pika 3 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 315, datë 13.05.2014 vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve”, ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg dhe konkretisht: “Kastrati” SH.A, “Kastpetrol SH.A, “Europetrol Durrës Albania” SH.A, “Portoromano Oil” SH.A, “Bolv Oil SH.A, “Genklaudis” SH.A, “Everest Oil” SH.A, “Taci Oil International & Supply” SH.A dhe “Armo” SH.A për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 9 të Ligjit.

4. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur “Raportin e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve në Komisionin e Konkurrencës. Ky raport në zbatim të nenit 47 të Kodit të Procedurave Administrative i është vënë në dispozicion ndërmarrjeve objekt hetimi.
6. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit ndërmarrjet nën hetim “Kastrati” SH.A, “Kastpetrol SH.A, “Europetrol Durrës Albania” SH.A, “Portoromano Oil” SH.A, “Bolv Oil SH.A, “Genklaudis” SH.A paraqitën pretendimet e tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale në seancat dëgjimore të organizuara nga Komisioni i Konkurrencës në datat 26 dhe 29 dhjetor 2014.
7. Autoriteti ka administruar pretendimet e palëve "Kastrati" Sha dhe "Kastpetrol" Sha, me shkresën Nr 3/1 Prot, datë 08.01.2015, ndërmarrja "Genkaludis" Sha, me shkresën nr 3/2 Prot, datë 12.01.2015, ndërmarrja "Europetrol Durrës Albania" Sha, me shkresën nr 3/3 Prot, datë 12.01.2015 dhe ndërmarrja "Bolv Oil" Sha, me shkresën nr 3/4 Prot, datë 12.01.2015.

## **II. TREGU PËRKATËS**

8. Tregu përkatës është përcaktuar në nenin 3 pika 7 e Ligjit si dhe në Udhëzimin nr 76, datë 07.06.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione: **Tregun e produkteve dhe Tregun gjeografik**

### **II.1. Tregu përkatës i produkteve**

9. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.315, datë 13.05.2014 “ Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” tregu përkatës i produktit përfshin tregun e importimit, prodhimit dhe shitjes me shumicë për dy nëntregjet: nëntregu i produktit eurodiesel dhe nëntregu i produktit benzinë.
10. **Eurodielezi** është karburant i cilësisë së lartë që plotëson të gjithë parametrat apo standardet EN 590 të Bashkimit Europian, me squfur < 0.05%. Ky produkt sigurohet në tregun shqiptar nëpërmjet importit dhe prodhimit vendas.
11. **Benzina** është produkt importi, me tregues/parametra në përputhje me standardin shqiptar S SH EN 228 i destinuar për automjete, "pa plumb" (Pb<=0,013g/l), me

- oktan më të madh ose të barabartë me 95, por më të vogël se 98, i siguruan në tregun shqiptar nëpërmjet importit.
12. Tregu i rrjedhës së sipërme përbëhet nga shoqëritë importuese të karburanteve dhe kompania “Armo” SH.A., e vetmja shoqëri që përpunon naftën bruto dhe tregton nënproduktet e përpunimit.
  13. Tregu i importit përbëhet nga dy nëntregje: tregu i importit (ose ndryshe importi 7) i organizuar në magazinat e lira doganore, në të cilën ndërmarrja importuese blen dhe shet produktin e përjashtuar nga sistemi i taksave dhe detyrimeve doganore në vend, ndërsa pagesa e detyrimeve (zhdoganimi i produktit) realizohet nga ana e ndërmarrjes e cila blen mallin në magazinë të lirë doganore dhe e zhdoganon atë me drejtim tregun vendas, dhe; tregu i importit (ose ndryshe import 4) në të cilin ndërmarrja importuese e sjell produktin në magazinat e lira doganore dhe një pjesë e shesin në regjimin e lirë doganor ndërsa pjesën tjetër e zhdoganojnë vetë duke vazhduar zinxhirin e tregëtimit të produktit deri tek konsumatori fundor.
  14. Duke qenë se për produktin naftë dhe benzinë që përdoret në industrinë prodhuese, nxjerrëse, dhe përpunuese ndiqen politika të tjera tregtare në Republikën e Shqipërisë, ky produkt nuk është i zëvendësueshëm me produktin naftë dhe benzinë që tregtohet për automjetet në rrugë, për shkak të çmimit, i cili është i ndryshëm si pasojë e barrës fiskale. Prandaj, kjo kategori produkti nuk është përfshirë në tregun përkatës.
  15. Praktikrat më të mira të evidentuara nga OECD-ja provojnë se analiza e konkurrencës në tregun e karburanteve mund të vërtetohet në tregun e pakicës, gjë e cila në kushtet në të cilat operon tregu shqiptar i karburanteve, ka qenë e pamundur që të vlerësohet për shkak të veprimit të Udhëzimit 17/2008 të Ministrit të Financave, i cili është trajtuar në mënyrë më të detajuar në seksionin e vlerësimit të ndikimit të akteve ligjore dhe nënligjore në konkurrencën në tregun përkatës.
  16. Për këtë arsye analiza e kryer gjatë hetimit të thelluar është përqëndruar në tregun e rrjedhës së sipërme import, prodhim dhe tregtimi me shumicë i eurodiezelit dhe benzinës.

## **II.2. Tregu Gjeografik**

17. Ndërmarrjet nën hetim e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pra treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm i Republikës së Shqipërisë. Edhe zona e lirë doganore<sup>1</sup> është pjesë e territorit të Republikës së Shqipërisë dhe si e tillë përfshin të gjithë ndërmarrjet që kryejnë aktivitetet në të. Karburantet në territorin shqiptar mund të blihen dhe të shitën në zonën e lirë doganore, ose pasi ato janë të ndikuara nga politika tregtare, pra janë zhdoganuar.

---

<sup>1</sup> Referuar Ligjit nr.8449, date 27.01.1999 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 3 citohet, “Territori doganor përfshin territorin tokësor, ujrat territoriale, ujrat e brendshme dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë”. Neni 183 Zonat e lira dhe magazinat e lira janë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose ambiente të vendosura në këtë territor dhe të ndara nga pjesa tjetër e tij.

### III. KARAKTERISTIKAT E TREGUT OBJEKT HETIM

#### III.1. Struktura e tregut

18. Për vlerësimin e tregut të karburanteve dhe sjelljen e ndërmarrjeve pjesë e këtij tregu, analiza do të bëhet sipas nëntregjeve të mëposhtme:


#### Tregu i prodhimit - Rafineria (prodhimi vendas)

19. Gjatë periudhës objekt hetimi, Janar 2010 – Prill 2014, rafineria e vetme e naftës në vend ka prodhuar dhe hedhur në tregun vendas të karburanteve me destinacion automjetet në rrugë, produktin naftë, sipas standarteve të përcaktuara në ligj. Prodhimi i kësaj rafinerie, gjatë kësaj periudhe për këtë produkt dhe shitja në total në tregun vendas ka zënë në vitin 2011 17.5% të tregut (sasia më e lartë) dhe ka ardhur duke u ulur në 4.1% të tregut në vitin 2013 (sasia më e ulët). Për shkak të kësaj pjese të vogël të tregut analiza në këtë nëntreg nuk është realizuar.

#### Tregu i importit

#### III.2.1 Modelet e tregut

20. Tregu i importit të karburanteve është i strukturuar sipas dy modeleve, të cilat janë aplikuar në dy porte të ndryshme, përkatësisht modeli i organizimit dhe i funksionimit të Portit Romano, Durrës (Modeli A) dhe modeli i funksionimit në “Portin Vlora 1” (Modeli B). Këto dy modele janë paraqitur në Grafikon nr 1., “Skema A e funksionimit të tregut të karburanteve” si më poshtë:



<sup>1</sup> Shënim 1- Sasia e karburanteve të shitura brenda grupit Kastrati brenda zones së lire doganore në raport me sasinë totale të karburantit të importuar, në këtë nivel tregu për vitin 2013. Pjesa tjetër i shitet ndërmarrjeve të tjera.

<sup>2</sup> Sasia e karburantit të shitur nga ndërmarrja SHA drejt Agjencit të vet SHPK, në raport me sasinë totale të importuar për vitin 2013.

21. Sikurse vihet re në grafikun e mësipërm, në Modelin A importuesit e karburanteve e sjellin produktin në magazinat e lira doganore përkatëse, të cilat janë vendosur në portin “Romano port” dhe një pjesë të sasisë së importuar e shesin në regjimin



<sup>3</sup> Ndermarrja Everest Oil operon vetem ne kete nivel tregu, dhe klientet kryesore te saj jane paraqitur ne nivelin e shumices (Tea Oil, Aft, etj).

- e lirë doganor, ndërsa pjesën tjetër e zhdoganojnë<sup>2</sup> vetë, duke vazhduar zinxhirin e tregtimit të produktit deri tek konsumatori përfundimtar. Pjesa respektive kundrejt importit të destinuar për tregun vëndas që zhdoganojnë për të tregtuar nga vetë ndërmarrjet që operojnë në zonën e lirë doganore, paraqitet nëpërmjet shifrave që shoqërojnë shigjetat vertikale. Kështu p.sh. ndërmarrja “Kastrati” SH.A, 74% të naftës së importuar ia shet në zonën e lirë doganore ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.
22. Në modelin A të dhënat janë për vitin 2013. Për vitet paraadhëse 2011-2012 si në segmentin e importit (magazinat doganore) dhe në segmentin e shitjes me shumicë një nga aksionerët e shoqërisë “Kastrati” Sh.A zotëron “Kastpetrol” Sh.A pjesët e të tregut të së cilës janë 0 për vitin 2013.
23. Modeli B i organizimit të tregut të importit të karburanteve paraqitet në grafikun e mëposhtëm, sipas të cilit ndërmarrja “Everest Oil” SH.A vepron në zonën e lirë doganore të “Portit Vlora 1” dhe rezulton se nuk ka një rrjet të vetin në hallkat e tjera të shitjes së karburanteve.
24. Bazuar në të dhënat e administruara nga QKR-ja rezulton se njëri nga aksionerët e ndërmarrjes “Everest Oil” SH.A, “Surperba” Srl është pjesë e grupit PIR (La Petrolifera Italo-Rumena), i cili zotëron 94% të aksioneve të “La Petrolifera Italo-Albanese” SH.A. Për këtë fakt është vënë në dijeni Ministria e Industrisë dhe Energjitikës.
25. Pra, ndërmarrja Everest Oil SH.A blen dhe shet produktin e përjashtuar nga sistemi i taksave dhe detyrimeve doganore në vend, ndërsa pagesa e detyrimeve



- (zhdoganimi i produktit) realizohet nga ana e ndërmarrjes e cila blen mallin në magazinë të lirë doganore dhe e zhdoganon atë me drejtim tregun vendas.
26. Në momentin e zhdoganimit llogaritja e barrës fiskale mbi karburantet është e lidhur me çmimet ditore të bursës Platz. Në rastin kur çmimi i faturës së blerjes është nën çmimin Platz në ditën e zhdoganimit, atëherë për referencë merret çmimi Platz+30 USD ndërkohë që kur çmimi i faturës është më i lartë se Platz, barra fiskale llogaritet mbi çmimin e faturës.
  27. Pasi produkti zhdoganohet nga shitësit me shumicë, transaksioni i radhës është shitja drejt shoqërive të shitjes me pakicë, të cilat kanë nën pronësi të tyre dhe stacionet e shitjes për konsumatorët fundor. Çmim në faturë (në pompë) që u shitet shitësve me pakicë është ai fundor, pra çmimi që merr klienti fundor.
  28. Në këto kushte, tregu vendas ka një lidhje direkte me çmimin ditor të bursës PLATZ për sa i përket burimit të furnizimit, sjellje të cilën nuk e reflekton në çmimet fundore me pakicë të cilat janë të prekura nga fenomeni i ngurtësimit, duke mos reflektuar kostot e blerjes.

### **III.2.2 Struktura e tregut të importit sipas dy produkteve**

29. Në raportin e hetimit të thelluar janë paraqitur të dhëna të detajuara për ndërmarrjet dhe pjesët e tregut përkatës të përlllogaritur mbi bazën e sasisë së naftës dhe benzinës të shitur në magazinë të lirë doganore, si dhe ajo e prodhuar në tregun shqiptar për periudhën Janar 2010-Prill 2014 (duke përjashtuar sasinë e eksportuar të karburanteve nga ana e këtyre ndërmarrjeve drejt vendeve të tjera).
30. Nga vlerësimi i pjesëve të tregut konstatohet se ndërmarrja Kastrati SH.A ka ardhur duke e rritur pjesën e tregut në import, nga 38% në vitin 2010 (së bashku më kastpetrol sh.a) në 46,3% në vitin 2013, në tregun e importit të eurodieselit dhe rreth 36.8% të tregut të importit për benzinën. Konkurenti i tij më i afërt është Everest Oil SH.A, i cili shfaqet në 2012 me 4.5% të tregut të importit të eurodiesel dhe 15.9% të tregut të importit të benzinës dhe në 2013 ka arritur përkatësisht në 23.8% dhe 38.4%. Ndërsa ndërmarrja Europetrol SH.A. ka ardhur duke humbur pjesë tregu nga 34.8% në vitin 2010 në 16.6% në 2013 për tregun eurodiesel dhe nga 37.7% në vitin 2010 në 23.5% në vitin 2013 për tregun e benzinës. Ndërmarrja Taci Oil SH.A. paraqitet në vitin 2012 me 31.5% në vitin 2012 dhe 8% në vitin 2013 për tregun e eurodieselit dhe në tregun e benzinës pjesët e tregut kanë qënë 24.6% në 2012 dhe 1.3% në vitin 2013.
31. Ndërmarrja Kastrati SH.A rezulton se pjesën kryesore të karburantit e shet në zonën e lirë doganore edhe për periudhën Janar – Prill 2014 ku pozicioni i saj në treg është rritur ndjeshëm. Kështu, nga të dhënat e sjella nga vetë ndërmarrja, pjesa e karburantit naftë që shitet nga kjo ndërmarrje në zonën e lirë doganore është rreth 74% e sasisë totale të importuar dhe 80% të produktit benzinë të importuar.

32. Ndërmarrja prodhuese vendase ARMO SH.A, gjatë periudhës objekt hetimi, ka zënë pjesë të moderuara në tregun vendës të tregtimit me shumicë të karburanteve, duke patur si vit më të mirë 2011-ën me 17.5% të tregut vendës.
33. Gjatë periudhës hetimore konstatohet se treguesit e përqendrimit CR3,CR4,CR5 kanë ardhur në rritje gjatëperiudhes objekt hetimi duke treguar një shkallë shumë të lartë të përqëndrimit në tregun e importit duke përfshirë dhe rafinerinë vendase. Kështu në tregun e importit të eurodieselit për vitin 2013 treguesit e përqendrimit paraqiten: CR3-86.7% dhe CR4-97.4%; ndërsa për tregun e produktit të benzinës paraqiten akoma dhe më shumë i përqëndruar, CR3-98.7%.
34. Nga të dhënat e paraqitura konkludohet se pjesët e tregut të ndërmarrjeve kanë patur dinamikë të ndryshme duke sjellë rritjen e përqendrimit në këtë segment të tregut objekt hetimi.

### **III.2.3 Struktura e tregu të shitjes me shumicë.**

35. Në tregun e shitjes me shumicë operojnë ato ndërmarrje të cilat e importojnë vetë produktin, ose ndërmarrje të cilat nuk importojnë vetë, por e blejnë këtë produkt në magazinat e lira doganore. Duke qenë se këto ndërmarrje realizojnë procesin e blerjes së produktit në zonën e lirë doganore, akciza dhe taksat e tjera si edhe TVSH-ja, paguhen gjatë këtij transaksioni nga këto të fundit.
36. Bazuar në të dhënat e paraqitura në raportin e hetimit të thelluar konstatohet se numri i ndërmarrjeve aktive që operojnë në tregun e shitjes me shumicë është në rritje, nëse e krahasojmë me nivelin e sipërm, ku numri i ndërmarrjeve që importojnë nga tregjet e huaja dhe tregtojnë në zonën e lirë doganore është i ulët.
37. Nga të dhënat rezulon se shkalla e përqendrimit në tregun e shitjes me shumicë të eurodieselit është mesatarisht e përqëndruar. Kështu treguesi i përqendrimit në vitin 2010 treguesi i CR3 ishte 54% dhe në vitin 2013 CR3-61%. Gjithashtu edhe në tregun e shitjes me shumicë të benzinës vihet re e njëjti nivel përqëndrimi ku në vitin 2010 CR3 ishte 51% dhe në vitin 2013 treguesi CR3 ishte 61%.
38. Gjatë periudhës objekt hetimi janë evidentuar krahas ndërmarrjeve Kastrati SH.A, Europetrol SH.A dhe Genklaudis SH.A të cilat përbëjnë CR3 disa ndërmarrje të tjera që kanë ardhur duke rritur pjesët e tregut si Tea Construction&Petrol SH.A me 9% në 2013 apo 2A&2E Total SH.A me 9.2% gjatë periudhës Janar-Prill 2014; apo hyrës të rinjë treg si AFT- SHA me 6% në 2013. Gjithashtu janë venë re ndërmarrje që shfaqen me nje rritje te dukshme vetëm një vit të caktuar si Taci Oil SHA me 14.9% dhe Tot-Trading in oil&transport me 8.3% në vitin 2012.
39. Gjithashtu një pjesë e ndërmarrjeve të cilat kanë pjesë të vogla tregu janë blerës vetëm në zonën e lirë doganore. Për periudhën Janar – Prill 2014 vërehen dhe 2 ndërmarrje të cilat kanë realizuar import, por ky import është realizuar si blerje e përbashkët me ndërmarrjet me fuqi më të madhe në treg. Konkretisht ndërmarrjet Genkaludis SH.A dhe Portoromano Oil SH.A, kanë realizuar importe për produktet naftë dhe benzinë me të njëjtën anije me ndërmarrjet Kastrati SH.A dhe Europetrol Durrës SH.A<sup>3</sup>.

<sup>3</sup> Burimi: Shkresa nr 259/2 Prot, datë 11.06.2014, derguar nga porti Romano Port Sha

40. Strukturat e ngritura në tregun e karburanteve kanë evidentuar edhe një kategori ndërmarrjesh të cilat mund të kategorizohen si shitës me shumicë. Këto ndërmarrje pjesën dërrmuese të aktivitetit të tyre e realizojnë duke blerë dhe shitur karburante me shumicë, duke mos qënë vetë importues<sup>4</sup>. Kështu, ndërmarrja Everest Oil SH.A blen karburantet nga ndërmarrja ENI S.P.A dhe ia shet këtë karburant ndërmarrjeve të tjera të shitjes me shumicë në zonën e lirë doganore (pra i gjithë transaksioni ndodh në zonë të lirë doganore). Ndërkohë edhe ndërmarrjet Genkludis SH.A dhe Portoromano Oil SH.A në pjesën dërrmuese të aktivitetit të tyre kanë blerë në zonën e lirë doganore dhe kanë shitur drejt ndërmarrjeve të tjera të pakicës, kryesisht drejt ndërmarrjeve të tyre të shitjes me pakicë, pasi këto ndërmarrje janë të integruar vertikalisht në treg.
41. Shitësit me shumicë në portin “Romano Port” SH.A, kryesisht blejnë karburant nga importuesit ku përfshihen Kastrati SH.A, Europetrol SH.A, si edhe nga shitësi me shumicë që operon në zonën e lirë doganore në Portin “Vlora 1”, ndërmarrja Everest Oil SH.A.

### **III.2.4 Tregu i shitjes me pakicë**

42. Tregu i shitjes me pakicë i produkteve eurodizel dhe benzinë përbëhet nga stacionet e shitjes me pakicë të karburanteve (pikat e bardha), të cilat gjatë periudhës objekt hetimi janë rreth 1260, nga të cilat rreth 960 janë stacione të palidhura nga pikëpamja e pronësisë me ndërmarrjet që operojnë në tregun e shumicës dhe 300 stacione janë të integruar vertikalisht me ndërmarrjet e shitjes me shumicë të karburanteve.
43. Ndërmarrjet Kastrat SH.A, Europetrol Durrës SH.A, Bolv Oil SH.A, Genkludis SH.A janë të integruara vertikalisht me ndërmarrje të shitjes me pakicë, të cilat kanë një numër stacionesh në vend përkatësisht: ndërmarrja Europetrol SH.A e integruar vertikalisht me “Skenderi G” Sh.p.k, ka rreth 48 stacione të shitjes me pakicë; Kastrati SH.A e integruar vertikalisht me Kastrati Sh.p.k ka rreth 70 stacione të shitjes me pakicë; ndërmarrja Bolv Oil SH.A e integruar vertikalisht me ndërmarrjen Olsi Sh.p.k ka rreth 48 stacione të shitjes me pakicë; ndërmarrja Genkludis SH.A e integruar vertikalisht me ndërmarrjen Gega Center sh.p.k ka rreth 7 stacione të shitjes me pakicë.
44. Nga të dhënat konstatohet se ndërmarrja Kastrati SH.A shet drejt ndërmarrjes së integruar me të vertikalisht Kastrati Sh.p.k që operon në tregun me pakicë, rreth 26% të sasisë së naftës së zhdoganuar dhe 29% të benzinës. Pjesa tjetër e karburantit të zhdoganuar u shitet pikave të bardha. Ndërmarrja Europetrol SH.A 66% të produktit naftë dhe 48% benzinës të zhdoganuar ia shet ndërmarrjes së integruar vertikalisht Skenderi G. Pjesa tjetër e produktit shkon drejt pikave të bardha, të cilat e shesin këtë produkt drejt konsumatorit fundor. Ndërmarrja Genkludis SH.A shet drejt ndërmarrjes së integruar vertikalisht 8% të produktit naftë dhe 9% të produktit benzinë për vitin 2013. Pjesa dërrmuese e produktit

<sup>4</sup> Përfshihen ndërmarrjet Kastrati Sha, Europetrol Sha, Everest Oil Sha, Taçi Oil Sha për vitin 2013 ndërmarrjet e tjera e kanë blerë produktin naftë dhe benzinë në zonën e lirë doganore, pra në territorin shqiptar nga katër ndërmarrjet që renditen sa më sipër.

- shitet drejt pikave të bardha. Ndërmarrja Bolv Oil SH.A tregton rreth 40% të naftës dhe 50% të benzinës drejt ndërmarrjes së integruar vertikalisht Olsi Sh.p.k.
45. Pra, nga analiza e strukturës së nëntregjeve që janë objekt hetimi konstatohet se operatorët kryesorë në treg gjatë periudhës objekt hetimi Kastrati SH.A, Europetrol Durrës SH.A, Genklaudis SH.A, Bolv Oil SH.A dhe Porto Romano Oil SH.A, Taçi Oil SH.A janë të integruar në të gjitha nivelet e tregtimit të karburantit. Megjithatë shumicën e produktit të tregut përkatës e tregëtojnë nëpërmjet pikave të bardha të tregtimit të karburanteve.
46. Nga vlerësimi ligjor i ndikimit të akteve në konkurrencë rezultoi se stacionet e shitjes me pakicë (“Pikat e bardha”), të cilat tregëtojnë shumicën e produktit përkatës drejt konsumatorit fundor, gjatë periudhës hetimore nuk mund të ushtronin fuqinë kundërvepruese të klientit në tregun e shitjes me shumicë si rrjedhojë e efekteve të Udhëzimit 17/2018 të Ministrisë së Financave. Komisionet e aplikuara ndryshonin sipas zonave, por nuk mundësuan analizën e plotë të çmimit fundor.

### **III.3. VLERËSIMI LIGJOR MBI KUFIZIMET E MUNDSHME TË KONKURENCËS:**

47. Gjatë procedurës hetimore janë identifikuar efektet e Udhëzimit nr 17, datë 15. 05. 2008 të Ministrisë së Financave “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i cili përcaktonte se shoqëria e tregtimit me pakicë ishte në rolin e agjentit dhe të përfaqësuesit në shitjen e mallit me pakicë për llogari të shoqërisë së tregtimit me shumicë, si dhe nuk e konsideronte shoqërinë e tregtimit me pakicë si zotëruese të mallit edhe pasi e blen atë nga shoqëria e tregtimit me shumicë.
48. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr.118, datë 29.05.2009 “Për disa rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në nivelin e shitjes me shumicë të karburanteve”, ka propozuar ndryshimin e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, pasi ky akt që përcaktonte çmimin final të rishitjes (“Resale Price Maintenance (RPM)”) është një praktikë që kufizon konkurrencën veçanërisht në mënyrë vertikale, pasi për qëllimet e administrimit fiskal (mbledhja e TVSH-së tek furnizuesi kryesor) eliminohet efekti konkurrues në rrjedhën e poshtme të tregut (tregu i pakicës dhe blerësi fundor)
49. Ministri i Financave në datën 30.01.2015 ka nxjerrë Udhëzimin nr 6 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, udhëzim i cili është bazuar në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
50. Gjatë periudhës hetimore u evidentua se nga zbatimi jo korrekt i Udhëzimit 17 nuk u mundësua konkurrenca midis logove respektive të pretenduara nga tregtarët e shumicës. Gjithashtu u evidentua që komisionet e aplikuara nga ndërmarrjet e shumicës për ato të pakicës ju krijonte këtyre të fundit që të vazhdonin aktivitetin e tyre edhe në kushtet e mungësës së efciencës.

**III.4. Barrierat ligjore dhe ekonomike**

51. Në legjislacionin shqiptar nuk ka asnjë kufizim përsa i përket themelimit të një ndërmarrje e cila të operojë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, pra nuk ka ndonjë kufizim apo barrierë administrative të parashikuar nga legjislacioni shqiptar për hyrjen në treg të operatorëve të rinj. Duke qenë se Shqipëria nuk është e lidhur në ndonjë rrjet tubacioni të transportit të karburanteve, thuajse gjithë importimi i karburanteve realizohet nëpërmjet rrugëve detare, duke qenë edhe një transport me avantazhe të ndjeshme në kosto, krahasuar me transportin rrugor. Kërkesat për mbajtjen e rezervave ligjore të karburantit si edhe kapacitetet minimale të stokimit, janë barrierë të krijuara me ligj për hyrjet e reja në treg.
52. Investimet e konsiderueshme në sistemin e magazinimit dhe transportit të produktit kërkojnë gjithashtu kapitale të konsiderueshme të cilat vështirësojnë hyrjet e reja në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve. Operatorët e vegjël që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve përballen me investime të rëndësishme me të cilat duhet të përshtaten. Ndërmarrjet, për të realizuar importe nëpërmjet këtyre porteve, kërkojnë që të kenë investuar në depozita në pronësi të tyre ose të marra me qira në portin “Romano Port”, ose të marra me qera nga porti, në rastin e portit “Vlora 1”
53. Realizimi në disa raste i blerjeve të përbashkëta nga ndërmarrjet objekt hetimi në tregun e importit tregon përpjekjet e tyre për të arritur ekonominë e shkallës në kushtet e një ekonomie të vogël. Blerjet e përbashkëta konsiderohen si një mundësi komunikimi që mund të përbejë gjurme për sjellje të koordinuara ndërmjet konkurrentëve. Sjellja e koordinuar mund të konsiderohet shkelje e konkurrencës së lire dhe efektive, nëse vërtetohen evidencat direkte apo indirekte.
54. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e shitjes me shumicë nuk mund të ushtrorjnë aktivitetin e tyre në tregëtimin me pakicë, por duhet të ndërtojnë ndërmarrje të tjera me përgjegjësi të kufizuar. Ky përbën një kufizim ligjor, i cili krijon shumë hallka që nuk sjellin vlerë të shtuar nga momenti i importit deri në momentin e shitjes së produktit tek konsumatori fundor.

**VI. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE OBJEKT HETIMI**

55. Bazuar në Vendimin nr. 315, datë 13.05.2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” procedurat hetimore janë zhvilluar në të dyja pistat që parashikon Ligji: Ekzistenca e mundshme e një marrëveshje të ndaluar (neni 4) ose abuzimi me pozitën dominuese (neni 9).
56. Gjatë procedurave hetimore u kryen inspektime në të njëjtën ditë dhe orë në ndërmarrjet objekt hetimi për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë provë apo evidencë direkte.

57. Duke qënë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte të komunikimit mes konkurrenëve, bazuar në metodologjinë e OECD<sup>5</sup>-së, janë kryer analiza ekonomike me qëllim evidentimin e sjelljes së mundshme të bashkërenduar mes konkurrentëve, parashikuar sipas nenit 3, pika 4 e Ligjit e cila mund të shfaqet në formën e dominancës kolektive të ndërmarrjeve objekt hetimi me efekt kufizimin e mundshëm të konkurrencës.
58. Gjatë inspektimeve dhe nëpërmjet kërkesave për informacion janë administruar të dhëna dhe informacione të nevojshme për hetimin për të bërë të mundur analizën nëpërmjet evidencave ekonomike të dominancës kolektive të ndërmarrjeve objekt hetimi në nëntregjet përkatëse.
59. Për të provuar dominancën kolektive e drejta europiane ka gjykuar rast pas rasti dhe në të gjitha rastet e shqyrtuara theksohet se për vërtetimin i pozitës dominante kolektive duhet të plotësohen 3 kushte të nevojshme: (i) pjesë tregu të krahasueshme midis ndërmarrjeve të tregut përkatës gjatë gjithë periudhës objekt hetimi; (ii) qëndrueshmëria në pjesët e tregut respektive dhe pengesat për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg dhe; (iii) transparenca e tregut dhe ekzistenca e mekanizimit të “hakmarrjes” mes konkurrenteve.
60. Referuar të dhënave mbi pjesët e tregut të pasqyruara në raportin e hetimit të thelluar, dhe të përshkruara në paragrafët 29,36 dhe 37 gjatë periudhës hetimore ndërmarrjet objekt hetimi paraqesin pjesë tregu jo të krahasueshme me njëra-tjetrën për të dy nëntregjet: import dhe tregëtimi me shumicë për të dy produktet.
61. Referuar të dhënave të disponuara nga hetimi i thelluar vihet re se ndërmarrjet paraqesin një tablo dinamike të ndryshme të pjesëve të tregut respektive në periudhën objekt hetimi si dhe në nëntregjet janë identifikuar hyrje dhe dalje nga tregu përkatës.
62. Referuar të dhënave në lidhje me çmimet e tregëtimit me shumicë, përkatësisht produktin euro diesel dhe produktin benzinë, vihen re lëvizje paralele të çmimit të ofruar nga ndërmarrjet objekt hetimi. Gjatë periudhës objekt hetimi, në vitin 2013, është provuar se në këto treg ekzistojnë struktura oligopol (me disa shitës me shumicë) dhe analiza e sjelljes është kryer sipas teorive të sjelljes së firmës në këto lloj strukture
63. Nga përcaktimi tregut përkatës karburantet për mjetet e transportit janë produkte homogjene me mundësi të pakta për inovacion dhe vlerë të shtuar nga ana e ndërmarrjeve për rritjen e cilësisë së produktit apo shërbimit të ofruar klientëve në stacionet fundore. Kjo ndodh për faktin që produkti nuk pëson ndryshime teknologjike, por tregtohet nga një hallkë e tregut në hallkën tjetër. Në këto kushte, kriter ku ndërmarrjet mund të konkurrojnë apo të koordinojnë sjelljet e tyre është jo vetëm çmimi fundor i shitjeve me pakicë por edhe logot përkatëse të tyre. Gjithashtu, siç është shpjeguar edhe më lart, për shkak të shkallës së lartë të transparencës së tregut, ndërmarrjet objekt hetimi kanë patur mundësi të ndjekin tendencat e lëvizjeve të çmimeve të njëri – tjetrit, duke mos patur nevojë që të

---

<sup>5</sup> [www.oecd.org/competition/CompetitionInRoadFuel.pdf](http://www.oecd.org/competition/CompetitionInRoadFuel.pdf)

përdorin mekanizimin e ndëshkimit për ndërmarrjen që devijojnë nga anëtarët e oligopolit.

60. Nga krahasimi i çmimeve mujore të blerjes CIF të karburantit pa taksa me çmimin e shitjes pa taksa të pakicës së ndërmarrjeve objekt hetimi për vitin 2013, si dhe të marzheve bruto respektive për të dy produktet, evidentohen ndryshime të vogla në çmimet e aplikuara në nivelin e pakicës, sikurse ndryshime të vogla edhe në nivelin i çmimit CIF të karburantit të blerë duke rezultuar në këtë mënyrë në vlera jo të njëjta përsa i përket marzheve bruto të këtyre ndërmarrjeve. Gjithashtu vihet re një elasticitet mesatar i ulet i çmimit të shitjes me pakicë ndaj ndryshimeve të çmimit të blerjes CIF në doganë, kryesisht kur ky i fundit ka pësuar ulje.
61. Gjatë periudhës objekt hetimi është evidentuar një ngurtësim i tregut të shitjes me pakicë. Ky është një kufizim vertikal i konkurrencës që është rrjedhojë e Udhëzimit nr. 17/2008, i cili përcaktonte se shitësi me shumicë (kryesori) i cakton çmimet shitësit me pakicë (agjenti). Për këtë arsye nuk ka qënë e mundur matja e efekteve të cdo segmenti, përkatesisht importi, shitja me shumicë dhe shitja me pakicë në çmimin final të produkteve eurodizel dhe benzinë që i ofrohen konsumatorit fundor.
62. Të dhënat e administrara të analizuara, tregojnë që ndërmarrjet objekt hetimi kanë një strukturë mjaft të përqëndruar në tregun e importit dhe në tregun e shitjes me shumicë, me bariera në hyrje për shkak të fuqisë financiare që duhet të disponohet nga hyrësit e rinj në treg.
63. Diferencat e mëdha mes pjesëve të tregut dhe strukturat e tregut jo të krahasueshme midis ndërmarrjeve, hyrjet dhe daljet nga tregu gjatë periudhës objekt-hetimi janar 2010 - prill 2014, si dhe ekzistenca e dy modeleve të tregut të importit, në të cilat operojnë ndërmarrje të ndryshme konkurrencte me njëra-tjetrën, nuk përbëjnë evidenca të mjaftueshme për të argumentuar dominancën e përbashkët të disa ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës gjatë periudhës së hetimit.
64. Blerjet e përbashkëta, të realizuara gjatë periudhës objekt hetimi, janë transaksione të ndërsjellta me qëllim furnizimin me karburant dhe përdorimin i llogjistikës së njëjtë nga ana e konkurentëve, sjellje e cila është objekt i nenit 5 të Ligjit. Referuar këtij neni këto janë marrëveshje që mund të përjashtohen dhe duhet të njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës për të përfutuar përjashtimin.

**Në konkluzion:**

65. Pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar, pretendimeve të palëve në seancat dëgjimore rezultoi se gjatë periudhës objekt hetimi, nuk u gjetën evidenca që të provonin marrëveshje të ndaluara apo abuzimi me dominancën kolektive midis ndërmarrjeve objekt hetimi. Megjithatë konkurrenca në tregun e importit dhe tregëtimit me shumicë të karburanteve nuk është mjaftueshëm efektive për shkak të strukturave të tregut dhe rregullimit ligjor (ligji “Për hidrokarburet”) dhe atij nënligjor (udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe asaj të Energjetikës) të këtij tregu.

66. Hetimi i realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës, në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve evidentoi faktin se ekzistojnë hallka të tepërta në strukturat e tregut që nuk justifikojnë vlerën e shtuar që nga importi, zonat e lira doganore, shitjet me shumicë, shitjet me pakicë, deri tek konsumatori fundor, duke shkaktuar rritjen artificiale të kostove dhe një elasticitet të çmimit mesatarisht të ulët .
67. Shkalla e lartë e përqëndrimit të tregut dhe tendecat për rritjen e këtij përqëndrimi kryesisht në tregun e importit, kërkon përmirësime strukturore të tregut dhe ndërthurjen e instrumentave përtej atyre të Autoritetit të Konkurrencës, për të ndihmuar në kontrollin e abuzimit dhe ndalimin e ndërmarrjeve që kanë fuqi tregu të aplikojnë praktika abuzive duke dëmtuar konsumatorin fundor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d dhe f, neni 61, nenin 70 pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar):

### **VENDOSI:**

- I. T’i rekomandojë Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes:
- 1) Të rishikojë Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999<sup>6</sup> ”Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, duke i krijuar mundësi ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të eurodieselit dhe benzinës:
- a) të realizojnë edhe shitjen me pakicë, duke eliminuar në këtë mënyrë hallkat e tepërta në zinxhirin e tregtimit, për të mundësuar uljen e kostove të pajustificuara ekonomike në krahasim me vlerën e shtuar të produktit;
  - b) të ruajnë identitetin e produktit dhe të konkurrojnë nëpërmjet logos respektive tek shitësit me pakicë, për të mundësuar nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg.
- 2) Të krijojë bazën ligjore dhe infrastrukturën administrative të nevojshme, për një njësi të transparencës së çmimit të hidrokarbureve<sup>7</sup>, në të cilën ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburateve duhet të njoftojnë në kohë reale brenda 5-15 minuta këtë njësi dhe Autoritetin e Konkurrencës për çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë.
- 3) Vlerësimin e zbatimit të marrëveshjes koncesionare në portin “Vlora 1” për respektimin e detyrimit të mospërfshirjes së koncensionarit në tregtimin e karburantit si dhe transferimin e së drejtës ekskluzive në tregjet e lidhura.

<sup>6</sup> Ligji është përditësuar me: Ligjin nr. 9128, datë 08. 04. 2004, Ligjin nr. 9574, datë 03. 05. 2006, Ligjin nr. 9595, datë 27. 07.2006

<sup>7</sup> Ky rekomandim bazohet në praktikat më të mira në tregun e karburanteve, rasti i rekomandimeve të rregullimit të tregut në Gjermani (2013).



**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

- 4) Ndërtimin e instrumentave për të kontrolluar hyrjet dhe daljet e shpeshta brenda vitit financiar të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të karburanteve, të cilët gjenerojnë konkurrencë të pandershme.
- II. Ndërmarrjet që operojnë në tregun e hidrokarbureve të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës për vlerësim, marrëveshjet që ato lidhin për realizimin e importeve të përbashkëta apo përdorimin e logjistikës, për të përfituar përjashtimin individual të tyre në bazë të nenit 5 të Ligjit.
- III. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, ndaj ndërmarrjeve: Kastrati SH.A, Kaspetro SH.A, Europetro Durrës Albania SH.A, Porto Romano Oil SH.A, Bolv Oil SH.A, Genklaudis SH.A, Everest Oil SH.A, Taçi Oil SH.A dhe Armo SH.A
- IV. Në bazë të nenit 28 të Ligjit, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ngarkohet me monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe analizën e vazhdueshme të efekteve të akteve ligjore dhe nënligjore që ndikojnë në zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg.
- V. Sipas nenit 40 të Ligjit, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimim në Gjykatën e Tiranës brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

nr.346, datë 16.02.2015

**“Për**

**hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.02.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm.

**Baza ligjore:** Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” si dhe neni 5 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

## VËREN SE:

### I. Procedura e ndjekur

Autoriteti i Konkurrencës, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit, është njoftuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit se “nga auditimi i ushtruar nga KLSH në Autoritetin Rrugor Shqiptar, është konstatuar se në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, është konstatuar se të njëjtët operatorë ekonomikë të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kritere të vendosura në DST për seicilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta në oferte është e papërfillshme. Kjo mënyrë konkurrimi sjell si pasojë, që një grup i vogël operatorësh ekonomikë të kontrollojnë një pjesë të gjërë të tregut., duke hyrë në marrëveshje të fshehtë mes tyre dhe monopolizuar tregun”.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr 333, datë 21/10/2014 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg, për vitin 2013.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoriteti Kontraktor për procedurën e prokurimit nën hetim.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 139, datë 20.03.2013 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg.

### II. NDËRMARRJET NËN HETIM

Në procedurën e hetimit të thelluar do të jenë nën hetim të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse dhe bashkimet e përkohshme të ndërmarrjeve në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”.

- **Shoqëria “Gener 2” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 30145, dt. 03.09.2003, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K58615301M, me seli në: Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesë Nr. 12 ABA Business Center, Kati i 5, Tiranë;

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

- **Shoqëria “Albavia” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr 19077, datë 19.03.1998, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT: J81527001Q, me seli në: Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19, Tiranë;
- **Shoqëria “Gjikuria” Sh.p.k**, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 9293, date 28.02.1995, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J62903456H, me seli në: Rruga Brigada VIII, pallati Teknoprojekt, hyrja 1, kati 10, Tiranë;
- **Shoqëria “Gjoka Konstruksion” Sh.a** regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3306, dt. 01.04.1994, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me aksione 100% private, me NIPT J91815014U; Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center Kati 13, Tiranë;
- **Shoqëria “Favina” Sh.p.k** regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 34163, dt. 17-10-2005, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J64104078V, me seli në: Lagjja 7, Rruga Ismail Qemali, Nr. 13, Korçë;
- **Shoqëria “Alpin” S.r.l**, e regjistruar në Itali, ne dhomën e tregtisë së Benvenuto, me kod fiskal dhe numer regjistrimi 01293400626, datë 23.05.2003, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në : Rruga “Rivolta”, 82030 Torrecuso (BN), Itali, me administrator Antonello Sauchella, e përfaqësuar me prokurë nga Z. Bajram Dalipaj,
- **Bashkimi i përkohshëm i shoqërive Albavia&Favina&Alpin Srl (JV)**, të cilat më datë 17.04.2014 kanë lidhur një kontratë me objekt “ Bashkimi i përkohshëm i palëve për zbatimin e kontratës me emërtim objekti: “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme në Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 2
- **Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Gjoka Konstruksion& Gjikuria”**, të cilat kanë lidhur një kontratë me objekt “ Bashkimi i përkohshëm i palëve për zbatimin e kontratës me emërtim objekti: “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme në Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3.

### III. ANALIZA E KONKURENCËS

#### A. Tregu Përkatës i Produktit:

Në rastin e prokurimit publik analiza e konkurrencës i referohet sjelljes së ndërmarrjeve ofertuese në tregun përkatës të prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut –

Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” të cilat janë ndërmarrjet dhe bashkimet e përkohshme të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në këto procedura prokurimi.

### ***B. Tregu përkatës gjeografik***

Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, Tregu Përkatës Gjeografik do të konsiderohet “***Tregu i prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit)”***”.

## **IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE**

Vlerësimi i Sjelljes së Ndërmarrjeve, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike” si dhe është shqyrtuar i të gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet në të tre lotet e procedurës, pra: të gjitha dokumentat e plotësuar nga ndërmarrjet sipas Dokumentave Standarte të Tenderit, të cilat hartohen nga Autoriteti Kontraktor; Dokumentacioni i administruar në fazën e inspektimit si dhe dokumentacioni i administruar nga Autoriteti Kontraktor ARRSH gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës.

Prania e faktorëve si ofertat në rotacion dhe afërsia e ofertës fituese me fondin limit janë shenja mbi egzistencën e marrëveshjeve në oferta në rastin e prokurimit të realizuar në vitin 2013, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3.

### **A. Ofertat në rotacion.**

*Në lotin e I-rë*, me fond limit 1 955 797 770 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës në procedurë 3 operatorë me oferta, ku operatori fitues është Gener 2 ndërkohë që kanë paraqitur oferta më të larta bashkimi operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria (si Joint venture) dhe shoqëria Albia.

*Në lotin e II-të*, me fond limit 1 942 441 074 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës të njëjtët operatorë si në lotin e I-re, ku në këtë rast operatori fitues është bashkimi i operatorëve Albia & Favina & Alpin ndërkohë që oferta kanë paraqitur Gjoka Konstruksion&Gjiguria dhe Gener 2.

*Në lotin e III – të*, me fond limit 1 933 742 407 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës vetëm 2 operatorë, të njëjtët si në lotet I dhe II, ku fitues rezulton bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion - Gjiguria ndërkohë që ofertë si operator i vetëm ka paraqitur vetëm Albia.

### **B. Afërsia me fondin limit**

*Në lotin e I-rë*, fitues Gener 2 me 99.82 % të fondit limit ndërkohë që dy operatorët janë bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion me 99.91 % të

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

fondit limit dhe Gjiguria (si Joint venture) dhe shoqëria Albavia 99.96 % të fondit limit. Në lotin e II-të, fitues është bashkimi i operatorëve Albavia & Favina & Alpin, me ofertë rreth 99.9% e fondit limit ndërkohë që oferta kanë paraqitur Gjoka Konstruksion&Gjiguria me 99.98 % dhe Gener 2 me 99.99 % të fondit .

Në lotin e III – të, fitues rezulton bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria me vlerë oferte fituese 99.9% e fondit limit ndërkohë që ofertë si operator i vetëm ka paraqitur vetëm Albavia me 99.95 % të fondit limit.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

**V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” ndaj ndërmarrjeve: “Gener 2” Sh.p.k; “Albavia” Sh.p.k; “Gjoka Konstruksion” Sh.a; bashkimit të shoqërive Albavia, Favina dhe Alpin Srl (JV) si dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gjoka Konstruksion& Gjiguria” dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Albavia&Favina&Alpin Srl (JV)”.
- II. Periudha hetimore përfshin vitet 2013-2014.
- III. Afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Antar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 347, datë 16.02.2015**

“Për zgjedhjen e Zëvendeskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard Ypi Anëtar

Në mbledhjen e tij të dates 16.02.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Zgjedhja e Zëvendeskryetarit të Komisionit të Konkurrencës

**Baza ligjore:** Nenit 21, pika 1 të Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (I ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës:

**VENDOSI**

1. Znj. Servete GRUDA zgjidhet Zëvendeskryetare e Komisionit të Konkurrencës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( )  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

( )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

( )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr.348, datë 16.02.2015**

**Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014 dhe synimet kryesore për vitin 2015”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita MILO (LATI) | Kryetar    |
| ▪ Znj. Servete GRUDA       | Zv/Kryetar |
| ▪ Z. Koço BROKA            | Anëtar     |
| ▪ Znj. Iva ZAJMI           | Anëtar     |
| ▪ Z. Eduard YPI            | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 16.02.2015, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm, të titulluar “Raporti vjetor 2014 dhe synimet kryesore për vitin 2015”.

Bazuar në nenet 24, gërma e, dhe 29, gërma ç, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014 dhe synimet kryesore për vitin 2015” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr.349, datë 19/02/2015**

**“Për**  
**masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar**  
**detar të udhëtarëve dhe automjeteve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.01.2015 dhe 19.02.2015 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.  
Ligji nr. 8485 datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

**KONSTATOI:**

**IV. PROCEDURA E NDJEKUR:**

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 316, datë 23.05.2014 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.

2. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin e mësipërm është Janar 2013-Gusht 2014.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, autoritetet portuale, Qendra Kombëtare e Licencimit dhe ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në treg.
4. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 245, datë 26.05.2014 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në treg, ku u mbajtën dhe procesverbali “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, si dhe procesverbal “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.

## V. ANALIZA E KONKURRENCËS

5. Shërbimi i transportit të automjeteve dhe udhëtarëve në Republikën e Shqipërisë realizohet nëpërmjet 3 Porteve, përkatësisht, Porti i Durrësit, Porti i Vlorës dhe Porti i Sarandës.

### II.1 Tregu Përkatës

6. Shërbimi i transportit detar të udhëtarëve me ose pa automjete, i cili bën linja të rregullta dhe frekvente, paraqet karakteristika specifike si rregullësia e shërbimit, oraret dhe tarifat e paracaktuara, të cilat bëjnë një treg përkatës të ndarë nga ai i transportit detar të mallrave.
7. Ky shërbim realizohet nga territori i Republikës së Shqipërisë drejt territorit të Italisë, Porteve të Barit, Brindisit, Ankonës dhe Triestes, si dhe Greqisë, Portit të Korfuzit dhe anasjelltas.
8. **Treg përkatës produkti do të konsiderohet shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve që realizohet nga Porti i Durrësit, Vlorës dhe Sarandës në Republikën e Shqipërisë, drejt porteve të Italisë dhe Greqisë.**
9. Duke pasur parasysh destinacionin e linjave të trageteve dhe zëvendësueshmërinë e tyre nga ana e kërkesës dhe ofertës, tregu përkatës ndahet sipas nëntregjeve të mëposhtme:
  - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit në drejtim të Portit të Barit, Itali dhe anasjelltas;
  - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit dhe Vlorës në drejtim të Portit të Brindisit, Itali dhe anasjelltas;

- Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit në drejtim të Portit të Ankonës, Itali dhe anasjelltas;
  - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Durrësit në drejtim të Portit të Triestes, Itali dhe anasjelltas;
  - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe udhëtarëve nga Porti i Sarandës në drejtim të Portit të Korfuzit, Greqi dhe anasjelltas.
10. **Tregu përkatës gjeografik janë portet e Republikës së Shqipërisë ku kryhet transport detar i mallrave dhe udhëtarëve.**

## **II.2 Struktura e tregut**

11. Në tregun përkatës, pra në tregun e shërbimit të transportit detar të udhëtarëve dhe automjeteve, operojnë 7 kompani të trageteve, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në tre portet e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet agjencive detare përfaqësuese.
12. Nëntregu i shërbimit të transportit detar të pasagjerëve nga Porti i Durrësit drejt Portit të Barit, i cili përbën dhe nëntregun më të rëndësishëm, zotërohet nga 3 operatorë kryesorë për vitin 2013 dhe me një hyrje të re për vitin 2014. Nga analizimi i pjesëve të tregut, në këtë nëntreg, operatori kryesor AFH S.p.a, e përfaqësuar nga agjenti detar Adria Ferries zotëron pjesën prej 47-48% të totalit të pasagjerëve dhe automjeteve, e ndjekur nga ndërmarrja Nobel Maritime, e përfaqësuar nga agjenti detar “Duni Port Agency” Shpk. Siç konstatohet edhe nga treguesit e përqendrimit, ky nëntreg është shumë i përqendruar.
13. Nëntregu i shërbimit të transportit detar të pasagjerëve nga Porti i Durrësit drejt Portit të Ankonës-Triestes, zotërohet vetëm nga një operator i vetëm, i cili ka 100% të tregut sipas totalit të pasagjerëve dhe automjeteve, përkatësisht operatori AFH S.p.a, e përfaqësuar nga agjenti detar Adria Ferries.
14. Nëntregu i shërbimit të transportit detar të pasagjerëve nga Porti i Durrësit dhe Porti i Vlorës drejt Portit të Brindisit, zotërohet vetëm nga një operator, i cili ka 100% të tregut sipas totalit të pasagjerëve dhe automjeteve, në secilën nga linjat, përkatësisht operatori Northbay Lda me agjent detar ndërmarrjen “Gerverni Travel” shpk në Portin e Vlorës dhe agjentin detar “Euroferries” shpk në Portin e Durrësit.
15. Nëntregu i shërbimit të transportit detar të pasagjerëve nga Porti i Sarandës drejt Portit të Korfuzit, zotërohet nga tre operatore, ku Fly Dolphyns/Iva shpk me rreth 32% të tregut të pasagjerëve dhe 57% të tregut të automjeteve. Operatori Marina Maritime/Iva Shpk ka rreth 44% të tregut të udhëtarëve, ndërsa operatori i ri , ndërmarrja Rena S/Pirro 77 ka rreth 24% të totalit të pasagjerëve dhe 43% të totalit të automjeteve, për periudhën Janar – Gusht 2014.
16. Në periudhën Janar – Gusht 2014, vërehet një rritje e numrit të operatorëve të cilët ofrojnë shërbim në tregun përkatës. Në linjën Durrës – Bari, ka filluar aktivitetin e saj që prej muajit qershor të vitit 2014 shoqëria **Ena Shipping**, e përfaqësuar nga

Agjensia Detare **Altea Shpk.** Gjithashtu edhe në linjën Sarandë – Korfuz, që prej muajit prill 2014, ka filluar aktivitetin e tij operatori **“Rena S”** i përfaqësuar nga Agjensia Detare **“Pirro 77”** Shpk.

17. Referuar sa më sipër, gjatë vitit 2014 vërehet rritje e numrit të operatorëve që ofrojnë shërbimin në nëntregjet Durrës – Bari – Durrës dhe Sarandë – Korfuz – Sarandë. Ndërsa në nëntregjet Durrës/Vlorë - Trieste dhe Durrës-Ankona-Trieste, në të cilat ofrojnë shërbimin një operator i vetëm vihet re se nuk ka hyrës të rinj. Pra këto nëntregje kanë strukturë të ngurtësuar.

## **VI. RREGULLIMI I TREGUT**

18. Referuar nenit 8 të Ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, transporti detar i njerëzve dhe i mallrave konsiderohet si veprimtari detare. Kodi detar i Republikës së Shqipërisë ka si objekt rregullimin e marrëdhënieve juridike, ekonomike dhe shoqërore në fushën e detarisë, duke vendosur rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ushtrojnë veprimtari detare dhe kanë përgjegjësi ligjore mbi hapësirën detare.
19. Referuar VKM-së nr. 421, datë 15.5.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve jepen nëpërmjet QKL-së, por pasi ka paraqitur një akt kontrolli dhe vlerësimi paraprak të dokumentacionit teknik të anijes kryer nga Drejtoria e Përgjithshme Detare si dhe listën me dokumentacionin e anijes.
20. Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, duke synuar rregullimin, disiplinimin, monitorimin dhe lehtësimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat juridikë në fushën e transportit detar, si edhe integrimin e plotë të tyre në tregun europian të transportit detar, ka nxjerrë Udhëzimin nr. 10, datë 23.06.2008 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, i ndryshuar.
21. Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e lejeve të veprimtarisë dhe lejeve të operimit, subjekteve juridike që kërkojnë të kryejnë veprimtari në fushat e transportit detar dhe është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjitha subjektet juridike që kryejnë veprimtari në fushën e transportit detar.
22. Gjatë vitit 2013 licencat për ushtrimin e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve janë lëshuar nga MPTT, ku ndërmarrjet përveç dokumenteve të tjera paraqisnin edhe një listë të çmimeve që do të aplikonin për shërbimet që ofronin, të ndara sipas kategorive të udhëtimit për udhëtarët dhe në bazë të përmasave për automjetet. Gjithashtu këto tarifa ishin të ndara sipas sezoneve (i lartë/i ulët), si dhe kishin të përcaktuar itinerarin e lëvizjes, orarin e nisjes dhe ditët e udhëtimit.

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

23. Për vitin 2014, pas ndryshimeve të legjislacionit, lejet për ushtrimin e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve janë lëshuar nga QKL dhe ndërmarrjet kanë aplikuar pranë këtij institucioni. Referuar dokumentacionit të kërkuar nga QKL-ja për leje, rezulton se ndërmarrjeve nuk ju kërkohej të deklaroheshin paraprakisht tarifatat që do të aplikoheshin gjatë vitit 2014 për shërbimin që ofronin në ndryshim nga viti 2013 ku këto tarifa miratoheshin nga MPTT dhe ishin bashkëngjitur licencës.
24. Mospërcaktimi i tarifave që do të aplikohen gjatë vitit, vështirëson kontrollin dhe mbikëqyrjen e tarifave të aplikuara nga ndërmarrjet për shërbimin që ofrojnë, duke pasur parasysh që biletat për transportin detar të udhëtarëve dhe automjeteve tregtohen nga agjencitë në të gjithë Shqipërinë si dhe jashtë saj, duke mos përjashtuar dhe shitjen on-line të tyre.
25. Duke pasur parasysh mënyrën e tregtimi të biletave dhe të operimit të ndërmarrjeve në treg, të cilat nuk janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, megjithëse ushtrojnë veprimtari në territorin e RSH, vështirësohet mbikëqyrja e tyre lidhur me tarifatat që aplikojnë për udhëtarët dhe automjetet që transportojnë nga/drejt Republikës së Shqipërisë.
26. Kjo vështirësi në sigurimin e informacionit u ndesh edhe gjatë këtij hetimi, pasi referuar shkresave të ndërmarrjeve, ato nuk mund të aksesonin tarifatat e aplikuara ditore për vite të shkuara, pasi programet që ato përdornin për prerjen e biletave nuk e mundësonin këtë informacion. Në disa prej ndërmarrjeve informacioni për tarifatat e aplikuara kishte vetëm vlerën e biletës, duke mos paraqitur kategorinë e udhëtimit apo gjatësinë e automjeteve, duke e bërë të pamundur vlerësimin e tarifave të aplikuara.
27. Informacioni i administruar në lidhje me formën e mbajtjes së të dhënave nga ana e subjekteve të licencuara, nuk mundëson në shkallën e duhur qartësinë mbi politikën e vendosjes së tarifave për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg. Gjithashtu ky informacion nuk mundëson vlerësimin për respektimin ligjor të tarifave maksimale të vendosura nga Ministria e Transporteve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 45 dhe nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe në nenin 4, pika 9, gërma a, të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

Ti rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:

1. Të detyrojë ndërmarrjet që operojnë në treg të mbajnë të dhënat ditore për tarifatat e aplikuara të çdo biletë të shitur si dhe të mbajnë rekorde të shitjeve të biletave për një periudhë të paktën 3 (tre) vjeçare.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

2. Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në çdo kohë nga institucionet licensuese dhe mbikëqyrëse të tregut.
3. Gjatë procesit të licencimit të ndërmarrjeve të miratohen nivelet e tarifës maksimale që do të aplikohen për çdo kategori udhëtimi sipas sezoneve.
4. Të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të aplikuara nga ndërmarrjet krahasuar me tarifatat maksimale të miratuara.
5. Hartimin e nje metodologjie bazuar në kostot reale për përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve.
6. Mbylljen e procedurave të hetimit paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve.
7. Ngarkohet Sekretariati për monitorimin e tregut sipas parashikimeve të këtij vendimi dhe masave të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.
8. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**Nr.350, datë 19/02/2015**

**“Mbi**

**vlerësimin e kërkesën së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita MILO (LATI)	Kryetar
Servete GRUDA	Zv/Kryetar
Koço BROKA	Anëtar
Iva ZAJMI	Anëtar
Eduard YPI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.02.2015 shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e kërkesën së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 2, gërma c, neni 24, germa d, dhe neni 46

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të

- Kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”;
- Relacionit të Sekretariatit të Pergjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë;

**VËREN SE:**

1. Më datë 03.02.2015, pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një kërkesë nga ndërmarrja SICPA” për revokim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”;
2. Autoriteti i Konkurrencës e ka nisur procedurën e vlerësimit ex-post të kontratës koncensionare në zbatim të nenit 2/1/c dhe 69/2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) si dhe bazuar në shqetësimet e komunitetit të biznesit të bëra prezent në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet medieve mbi rritjen e çmimit të pullave fiskale.
3. Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave” është një vendim për disa rekomandime drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, bazuar në nenin 69, pika 1/b dhe 69/2 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).
4. Para lidhjes së marrëveshjes së koncesionit nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), dhe konkretisht nuk është respektuar neni 69 i Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” sipas të cilit duhet të ishte marrë vlerësimi i Autoritetit. Autoriteti i Konkurrencës ka detyrimin ligjor për vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta të dhëna në territorin e Republikës së Shqipërisë referuar nenit 2 pika c e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe detyrimeve në kuadër të respektimit të marrëveshjes së Stabilizim Associmit (Autoriteti i Konkurrencës është lider dhe koordinator i kapitullit 8-Konkurrenca dhe Liberalizimi dhe ka detyrimin për të raportuar në Komisionin Evropian mbi të drejtat e veçanta dhe ekskluzive në territorin e Shqipërisë).
5. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 21.3.2-14, në asnjë pikë nuk citohet se Ministria e Financave nuk duhet të merte mendimin e Autoritetit të Konkurrencës pasi një detyrim i tillë ligjor parashikohet në nenet 69-70 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
6. Në lidhje me pretendimin se vendimi është marrë në kundërshtim me vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, Vendimi i gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 21.03.2014, në asnjë pikë të tij nuk parashikon se Ministria e Financave nuk duhet të merrte mendimin e Autoritetit të Konkurrencës, pasi një detyrim i tillë ligjor parashikohet në nenet 69, pika 1, gërma 1 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
7. Konkensionarit, shoqërisë SICPA i është kërkuar informacion i detajuar mbi koston, investimet dhe informacionin përkatës që lidhet me procesin e marrjes së



koncesionit me shkresën nr 372, datë 10.09.2014. Koncesionari me anë të shkresës 372/3, datë 8.10.2014, ka dërguar kontratën koncensionare dhe pasqyrat financiare, por jo argumenta dhe analizën shoqëruese mbi justifikimin ekonomik të marrëveshjes koncensionare.

8. Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Në kuptim të nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes “Sicpa” nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.
9. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave” dhe i argumenteve të dhëna nga këto ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve për revokimin e vendimit.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave” si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes “SICPA” dhe Ministrisë së Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtare**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

**KRYETAR**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**nr. 351 , datë 03/03/2015**

**“Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike lidhur me brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.03.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për disa rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike lidhur me brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), nenet, 2 pika c), 24 pika d), 69 dhe 70.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga ndërmarrja “Plus Communication” SH.A mbi tenderin me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”,

**VËREN SE:**

1. Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 29/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ndërmarrja “Plus Communication” SH.A mbi tenderin me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.
2. Autoriteti i Konkurrencës ka administruar informacionin e ardhur me anë të: shkresave të “Plus Communication” me nr. 155 prot, dt. 13.02.2015, si dhe nr. 196 prot, dt. 20.02.2015, drejtuar nga kjo e fundit njëkohësisht edhe: Ministrin

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

për Inovacionin dhe Administratën Publike, AKEP-it, si dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, lidhur me tenderin me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”.

3. Ndermarrja “Plus Communication” pretendon se: Kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”, përbëjnë pengesë/barrierë për hyrjen e operatorëve të vegjël në një treg përkatës si gjenerata 4G.
4. Sipas ankimesit “duke qenë se spektri i frekuencave në këtë brez është një burim natyror i kufizuar, pamundësia e ofrimit të këtij spektri tek të gjithë operatorët, për shkak të mënyrës së organizimit të këtij procesi, është një barrierë hyrëse teknike dhe administrative”.
5. Ndermarrja “Plus Communication” pretendon se “kushtet e vendosura favorizojnë vetëm operatorët me pozitë dominuese dhe fuqi financiare duke u dhënë atyre mundësinë të marrin të gjithë resurset natyrore të tenderuara, të cilat janë burim i fundëm frekuencash, duke lënë operatorët e vegjël si Plus pa mundësinë teknike për të ofruar shërbime 4G dhe rrjedhimisht duke lënë pajtimtarët e këtyre operatorëve pa mundësinë teknike për të përdorur shërbime 4G. Kjo përbën pengesë hyrëse ekonomike për operatorët e vegjël në këtë treg”.
6. Nga ankesa “mosdhënia e aksesit të barabartë dhe pa diskriminim për çdo operator, shkel parimet bazë të dhënies së spektrit, sipas legjislacionit të BE dhe praktikave më të mira Europiane, të cilat kanë në themel të tyre promovimin e një tregu konkurrent dhe shmangien e përqëndrimeve të pabazuara të pronësisë së spektrit”.
7. Për sa më lart Plus kërkon:
  - 1) Ndërmarrjen e masave të menjëhershme për anulimin e tenderit me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”;
  - 2) Rihapjen e procedurës së tenderit me kushte të ndryshme, me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe konkurrencës në treg, për dhënien e aksesit të barabartë dhe mosdiskriminimin e të gjithë operatorëve në frekuencat e tenderuara.

### I. **Baza ligjore dhe procedura e dhënies së autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave**

8. Sipas Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (Kreu VII “Spektri i frekuencave”) spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Për një përdorim të frytshëm dhe efektiv të tyre, AKEP jep autorizime individuale për përdorimin e frekuencave, bazuar në parimin e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit.

9. Kur AKEP, në referencë të nenit 68 të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se kërkesat për caktim të frekuencave në një brez janë më të mëdha se frekuencat disponibël për t’u caktuar në këtë brez, atëherë për dhënien e së drejtës për përdorimin e këtij brezi frekuencash AKEP zbaton procedurat e tenderit publik, në përputhje me “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, miratuar me VKM nr. 1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” (të ndryshuar), legjislacionin në fuqi për prokurimet publike, Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Planin Kombëtar të Frekuencave. Procedura duhet të jetë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.
10. Në bazë të nenit 5 pika 10 dhe nenit 68, pika 7, të Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, është kompetencë e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (Ministri) të miratojë kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave dhe procedurat përkatëse të tenderimit për dhënien e tyre, bazuar në propozimet e AKEP-it.
11. Referuar Ligjit 9918, AKEP, pasi ka zhvilluar konsultimin publik ka bërë miratimin përfundimtar të këshillimit publik “Mbi përdorimin e brezave të frekuencave GSM 900/1800” dhe propozimit për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX” (miratuar me VKD të AKEP nr.2495, datë 14.08.2014).
12. Në vazhdim të procedurave, pas marrjes së miratimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike mbi numrin e autorizimeve individuale, kriterin e vlerësimit, çmimin minimal për dhënien e tyre dhe procedurën e prokurimit, AKEP ka filluar procedurën e konkurrimit publik me anë të VKD nr.2527, datë 12.11.2014 “Për miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX” dhe njoftimin për tender publik”.
13. Ndërmarrja “Plus Communication” S.H.A i është drejtuar AKEP me një kërkesë për sqarim mbi tenderin me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”. Në përgjigje të kësaj kërkesë AKEP i është drejtuar Plus me sqarimet përkatëse (Shkresat e AKEP: nr. 423/2 prot, dt. 17.02.2015 “Përgjigje kërkesës për sqarim përcjellë me shkresën nr. 154 prot, dt. 13.02.2015” dhe nr. 423/7 prot, dt. 18.02.2015) ku shprehet se: dokumenti i tenderit nuk vendos asnjë kufizim për të bërë të mundur ngushtimin e hapësirave të pjesëmarrjes në tender, pasi është i bazuar në aktet ligjore përkatëse.
14. AKEP me Vendimin nr.2540, datë 28.02.2015 “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore të Plus Communication S.H.A. “Për anulimin e tenderit me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për

sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX" të miratuar me Vendimin e AKEP Nr.2527, datë 12.11.2014, si të pabazuar në ligj dhe rihapjen e procedurës së tenderit bazuar në legjislacionin në fuqi”, ka vendur rrëzimin e kërkesës ankimore të Plus Communication.

15. Në këtë vendim AKEP, pasi ka shqyrtuar pretendimet e Plus, ka konstatuar se: Parashikimet ligjore për përcaktimin e procedurës dhe hapat e njëpasnjëshëm janë ndjekur tërësisht dhe brenda afateve ligjore; Në asnjë dokument AKEP nuk është shprehur se ky spektër është i destinuar vetëm për katër operatorët përdorues aktual të tij. Procedura ka parashikuar edhe pjesëmarrje në garë të interesuar të tjerë vendas dhe të huaj; interesi për këtë brez varet shumë edhe në shfrytëzimin aktual të spektrit të dhënë në përdorim operatorëve. Plus, bazuar në të dhënat e raportuara e përdor shumë pak ose aspak spektrin e alokuar në brezin 1800 MHz; spektri është një burim i fundëm dhe si i tillë ka edhe një vlerë ekonomike të caktuar e cila është një element bazë në vlerësimin e tij.

## **II. Kushtet e vendosura në dokumentet e tenderit**

16. Sipas dokumenteve të tenderit publik, miratuar me VKD të AKEP nr. Nr.2527, datë 12.11.2014, procedura e tenderit publik “Procedurë e hapur” me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”, zhvillohet për të dhënë 6 (gjashtë) Autorizime në brezat e frekuencave përkatëse për përdorim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
17. Autorizimi individual do të jetë i vlefshëm për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) vjeçare, me mundësi rinovimi në fund të përfundimit të periudhës së vlefshmërisë.
18. Një ofertuesi i jepet mundësia që të marrë deri në 4 (katër) të drejta përdorimi në total, në përfundim të vlerësimit, nga 6 (gjashtë) të drejta përdorimi që janë gjithsej.
19. Kriter vlerësimi është “Çmimi i ofertës”, e cila do të vlerësohet nga 0 - 100 pikë. Oferta e vlerësuar me më pak se 60 pikë skualifikohet.
20. Çmimi minimal i pranueshëm për ofertuesit, për secilën nga të drejtat e përdorimit është 3.100.000 (tre milion e njëqind mijë) Euro. Ofertat me çmim më të vogël se çmimi minimal i caktuar skualifikohen.
21. Vlerësimi i ofertave do të jete i përshkallëzuar, me disa runde vlerësimi. Numri i maksimal i rundeve të vlerësimit do të jete 5. Ky numër është subjekt i ndryshueshëm (nga 1 deri në 5) në varësi të numrit të ofertave fituese për çdo rund.
22. AKEP, shpall fitues në çdo rund vlerësimi, ofertuesit me ofertën e vlefshme që kanë grumbulluar numrin më të lartë të pikëve sipas renditjes për atë rund. Numri i fituesve nuk e kalon numrin e të drejtave të përdorimit.

23. Në tender kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë ofertuesit të cilët plotësojnë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **III. Vlerësimi ligjor**

24. Duke qene se spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë, për një përdorim të frytshëm dhe efektiv të tyre AKEP, si organi rregullator përkatës, jep autorizime individuale për përdorimin e tyre, bazuar në parimin e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit.
25. Kur AKEP arrin në përfundimin se kërkesat për caktim të frekuencave në një brez janë më të mëdha se frekuencat disponibël për t’u caktuar në këtë brez, atëherë për dhënien e së drejtës për përdorimin e këtij brezi frekuencash AKEP zbaton procedurat e tenderit publik, në përputhje me “Rregullat e zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, miratuar me VKM nr. 1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” (të ndryshuar), legjislacionin në fuqi për prokurimet publike, Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Planin Kombëtar të Frekuencave. Procedura duhet të jetë objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale.
26. Kriteri ekonomik i çmimit minimal mund të përbëjë barrierë financiare për hyrësit e rinj në treg dhe për këtë arsye rekomandohet vendosja e të 4 operatorëve të licensuar në kushte të barabarta dhe një ndarje e frekuencave mbi parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve në treg.
27. Bazuar në nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), dhënia e së drejtës së përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX duhet t’u mundësohet të gjithë operatorëve celularë duke i vendosur ata në kushte të barabarta konkurrence në treg.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me propozim te Sekretariatit:

### **VENDOSI:**

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që t’u mundësohet të gjithë operatorëve celularë e drejta e përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, duke i vendosur ata në kushte të barabarta konkurrence në treg.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**

(          )  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(          )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(          )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(          )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 352, datë 3.03.2015**

**PËR**  
**MIRATIMIN E UDHËZIMIT**

**“MBI VLERËSIMIN E KUFIZIMEVE VERTIKALE ”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |                       |            |
|-----------------------|------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar    |
| • Servete GRUDA       | Zv/Kryetar |
| • Koço BROKA          | Anëtar     |
| • Iva ZAJMI           | Anëtar     |
| • Eduard YPI          | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 03.03.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Udhëzimit “Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( I ndryshuar);

**Baza ligjore:** Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 4, dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt - Udhëzimit “Mbi Vlerësimin e Kufizimeve vertikale” dhe Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

**VËREN SE:**

1. Në përmbushje të objektivit për të plotësuar kuadrin ligjor sekondar dhe për të përditësuar e reflektuar të gjithë eksperiencën dhe praktikat më të mira të së drejtës europiane, Sekretariati ka paraqitur kërkesën për shfuqizimin e Vendimit nr 145, datë 15.04.2010 të Komisionit të Konkurrencës mbi udhëzimit “Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale” dhe miratimin e draftit të ripunuar të Udhëzimit të ri “Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale”.
2. Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë parimet e vlerësimit të marrëveshjeve vertikale bazuar në nenin 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003



**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

“Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), si dhe të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”;

3. Ky Udhëzim është hartuar, duke përshtatur dhe përfaruar Udhëzimin e BE-së; “Njoftimi i Komisionit “Udhëzues mbi kufizimet vertikale” (52010SC0411)/2010/C 130/01);

**VENDOSI:**

1. Udhëzimi “Mbi vlerësimin e marrëveshjeve vertikale” miratuar me Vendimin nr 145, datë 15.04.2010 të Komisionit të Konkurrencës, shfuqizohet.
2. Të miratojë Udhëzimin “Mbi Vlerësimin e Kufizimeve Vertikale”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCES**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO(LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**nr.353 , datë 05.03.2015**

**“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara”.**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Eduard YPI Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.03.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Servete GRUDA Zv/Kryetar, Znj. Iva ZAJMI Anëtar, Z. Koço BROKA Anëtar, Z. Eduard YPI Anëtar, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara.

**Baza ligjore:** Neni 24, shkronja d, neni 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

**I. PROCEDURA**

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të monitorimit, të realizuar nga sektori i analizës dhe monitorimit të tregjeve, në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara, në zbatim të nenit 24, shkronja (d), nenit 26 dhe 42, pika 1, të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e më poshtë Ligji), vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e

importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara (Vendimi Nr. 342, datë 27.11.2014), për të vlerësuar nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është 1 Janar 2014 – 31 Dhjetor 2014.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit, Vendimit dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 510 Prot., datë 01.12.2014, grupi i inspektimit realizoi inspektimet pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg.

## II. NDËRMARRJET NËN HETIM

Bazuar në Vendimin nr. 342, si edhe informacionin e administruar gjatë inspektimeve, ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të duhanit janë:

1. **AGNA Group**, me seli në Gjirokastër Vrisera. Shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e paketave të saj kjo ndërmarrjes e realizon nëpërmjet shoqërisë ALFA. Shoqëria ALFA ka selinë në Gjirokastër Vrisera.
2. **British American Tobacco (BAT)**, me seli në Tiranë, Rruga e Kavajës, zotërohet 100% nga British American Tobacco International Holdings. BAT ushtron aktivitetin në Shqipëri prej 21 vitesh. BAT operon në Shqipëri si importuese dhe shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e paketave deri te shitësi me pakicë e realizon nëpërmjet Tabacco Holding Group (THG).
3. **Japan Tobacco International** Tirana, me seli në Tiranë, Rruga Milto Tutulani zotërohet 100% nga Japan Tobacco International Holding ushtron aktivitetin në tregun shqiptar që nga janari i vitit 2011. JTI importon paketat e mësipërme dhe realizon shitjen me shumicë dhe distribucionin nëpërmjet Marketing & Distribution.
4. **Imperial Tobacco** është e vetmja kompani në tregun e duhanit e cila operon në Shqipëri me statusin e përfaqësisë. Kjo shoqëri ka selinë në Tiranë Rruga Brigada e 8. Të gjithë aktivitetin e saj e kryen shoqëria Marketing & Distribution.
5. **Marketing & Distribution**, me seli në Tiranë Kashar. M&D importon, shet me shumicë dhe shpërndan paketat e Imperial Tobacco.
6. **Philip Morris** Albania, me seli në Tiranë, Rruga Murat Toptani, ka për objekt të veprimtarisë së saj blerjen, shitjen eksport importin e prokteve të duhanit. Kjo shoqëri zotërohet 100% nga Philip Morris S.A. Shitjen me shumicë dhe

shpërndarjen e paketave të shoqërisë Philip Morris e realizon shoqëria Inter Distribution Services.

### **III. STRUKTURA E TREGUT**

Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

*a. Tregu i produktit*

*b. Tregu gjeografik*

Tregu përkatës i produktit është: cigaret e prodhuara nëpërmjet makinerive. Cigaret e prodhuara nëpërmjet makinerive kanë karakteristika të ndryshme përsa i përket paketimit, formës së tyre, elementëve të brendshëm si nikotina, aroma, niveli i katranit, shija etj. Duke qenë se në tregun e cigareve ka 90 lloje të ndryshme paketash në analizë kemi marrë ato paketa të cilat zënë peshën më të madhe në importet dhe shitjet e një ndërmarrjeje.

#### **I.1.1**

#### **I.1.2 III.1. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe ofertës**

Në tregun e cigareve kemi zëvendësueshmëri si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ana e ofertës. Përsa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës themi se duhan pirësit kanë mundësi zgjedhje duke qenë se ekzistojnë 90 lloje të ndryshme paketash në treg. Pavarësisht faktit që çmimi i cigareve ndryshon shumë nga lloji në lloj, brenda të njejtës kategori çmimi, ka një shumëllojshmëri të madhe paketash.

#### **I.1.3**

#### **I.1.4 III.2. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës**

Në tregun e cigareve janë 11 ndërmarrje importuese duhani dhe cigaresh. Nga analiza e tregut, rezulton se disa prej ndërmarrjeve importuese operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe shpërndarjes së cigareve. Nga ana e ofertës themi se kemi zëvendësueshmëri duke qenë se ka disa ndërmarrje të cilat importojnë, tregtojnë me shumicë dhe shpërndajnë produktin.

Tregu gjeografik përfshin të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë sepse ky produkt tregtohet në të gjithë tregun e brendshëm.

***Tregu përkatës është prodhimi, importi, tregtimi me shumicë, shpërndarja dhe shitja me pakicë e cigareve në tregun e brendshëm.***

### **IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE**

#### ***IV.1. Vlerësimi i pozitës dominuese***

Vlerësimi i pozitës dominuese të një ndërmarrjeje dhe i fuqisë së tregut që ajo zotëron është hapi i parë, që përcaktohet nga neni 8 i Ligjit dhe për të vazhduar më pas me analizën e nenit 9 të Ligjit, për sjellje të mundshme antikonkurrese dhe abuzive me pozitën dominuese në treg.

Për vlerësimin e pozitës dominuese të ndërmarrjeve objekt hetimi janë marrë në shqyrtim:

a. **Pjesët e tregut**

Pjesët e tregut mbeten kriteri i parë për nisjen e vlerësimit të pozitës dominuese në një treg. Komisioni Europian fillon vlerësimin e një ndërmarrje nëse ka pozitë dominuese individuale për pjesë tregu mbi XX %. Ndërmarrja Philip Morris Albania, referuar figurës së mëposhtme, zotëron XX % të pjesës së tregut të shitjes me shumicë të cigareve për vitin 2014. Ndërmarrja e dytë Agna SHA rezulton me një pjesë tregu prej XX % për vitin 2014. Ndërmarrja British American Tobacco dhe Japan Tobacco International zotërojnë nga XX % të tregut, ndërsa ndërmarrja Marketing & Distribution XX % të tregut. Për të parë nëse një ndërmarrje gëzon statusin e pozitës dominuese individuale edhe në rastin e pjesëve të tregu ajo duhet të ketë një qëndrueshmëri në vite të këtij treguesi.

*Figura 1. Pjesët e tregut të ndërmarrjeve në tregun e shitjes me shumicë<sup>8</sup>*

Bazuar në grafikun e mësipërm rezulton se të dy ndërmarrjet Philip Morris Albania dhe Agna Group nuk kanë pozitë dominuese individuale duke qenë më pjesë të përafërta tregu.

b. **Barrierat ligjore**

Në legjislacionin shqiptar nuk ka asnjë kufizim për sa i përket themelimit të një ndërmarrje, e cila të operojë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve, pra nuk ka ndonjë kufizim apo barrierë administrative të parashikuar nga legjislacioni shqiptar për hyrjen në treg të operatorëve të rinj. Në këto kushte mund të themi se tregu është i hapur për hyrje të reja të operatorëve.

c. **Barrierat ekonomike**

Për sa i përket fuqisë ekonomike, ndërmarrjet Philip Morris Albania, Agna SHA, JTI, M&D dhe BAT kanë angazhuar kapitale të rëndësishme financiare si edhe realizojnë një xhiro të konsiderueshme në tregun përkatës. Pozita e konsoliduar e ndërmarrjeve në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite, përbëjnë barrierë hyrëse. Mund të jetë e vështirë të hysh në këtë treg ku eksperiencia apo reputacioni janë të nevojshme për të konkurruar efektivisht.

d. **Konkurrenca potenciale**

Në tregun e importit ndërmarrjet që operojnë gjatë periudhës 2012-2014 kanë mbetur të pandryshuara, duke qenë të kufizuara në numër dhe duke ruajtur përgjithësisht edhe pjesët e tregut. Shkak për këtë qëndrueshmëri në vite si të pjesëve të tregut edhe të ndërmarrjeve, janë markat të cilat përbëjnë një barrierë për hyrje të reja. Në Shqipëri aktualisht janë prezentë markat kryesore të cigareve që importohen nga 5 ndërmarrjet kryesore në këtë treg.

e. **Fuqia kundërvepruese e blerësve**

Për të analizuar fuqinë kundërvepruese të blerësve analiza konvergon në dy kategori: ndërmjetësit/shitësit me pakicë dhe konsumatorët finalë. Për sa i përket ndërmjetësve dhe shitësve me pakicë për shkak të Udhëzimit nr. 17, datë 15.05.2008 i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, mundësia për të negociuar e tyre mbetet e vogël. Kjo për shkak se çmimi final përcaktohet nga ana e importuesit që në hapin e parë të shitjes.

Ndikimi i drejtpërdrejtë në konkurrencë nga Udhëzimi nr. 17, datë 15.05.2008 i Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është mbi pikat me pakicë, të

<sup>8</sup> Burimi: Të dhënat e ndërmarrjeve dhe përpunimet e SAS

cilat nuk mund të ndryshojnë çmimin e përcaktuar nga ana e ndërmarrjes së shitjes me shumicë.

f. **Qëndrueshmëria e kërkesës**

Kërkesa për cigare të importuara në vend ka ardhur në rënie. Kështu gjatë vitit 2014 rezultoi se kemi një import prej 2,830,361 fije, në vitin 2013 kjo sasi është 3,512,366 fije dhe në vitin 2012 cigaret e importuara janë 3,471,679 fije. Rënia në importe është e konsiderueshme për vitin 2014 krahasuar me 2013, por bazë për këtë rënie mund të jenë edhe sasi të mëdha të importuara në fundin e vitit paraardhës, të cilat mbarten si stoqe në vitin pasardhës.

g. **Homogjeniteti i produktit, transparenca e tregut**

Duhani është produkt i zëvendësueshëm, pra ka një zëvendësueshmëri nga ana e kërkesës, por duhet të theksojmë se markat në këtë treg kanë ruajtur një rol të rëndësishëm. Pra, investimet në marketing dhe në cilësi, kanë bërë që markat e ndryshme të kenë fuqi të ndryshme mbi çmimin dhe pjesën e tregut.

Në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë të cigareve nuk ka asimetri informacioni. Si firmat ashtu dhe konsumatorët kanë informacion të plotë përse i përket karakteristikave të produktit dhe ndryshimit të çmimit, duke qenë se firmat, bazuar në Udhëzimit nr.17, janë të detyruara të publikojnë çmimet e shitjes me pakicë të cigareve në website-in e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si edhe në gazetatat kryesore në vend.

Për sa më sipër, bazuar në Nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ndërmarrjet Philip Morris Albania SH.A, AGNA SH.A, JTI, M&D Sha dhe BAT nuk kanë pozitë dominuese individuale në tregun e importit dhe tregimit me shumicë të cigareve.

***IV.2. Ekzistenca ose jo e marrëveshjeve të ndaluara***

Duke qenë se nuk u gjetën evidencat direkte të bashkëpunimit, si dhe nga analiza e tregut përkatës rezultoi një shkallë e lartë përqendrimi, grupi i punës ka analizuar, nëse kjo fuqi tregu vjen si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun përkatës nëpërmjet evidencave indirekte ekonomike dhe/ose të komunikimit.

Më datë 02.12.2014 u realizuan inspektimet në mënyrë të njëkohshme në ndërmarrjet “Philip Morris Albania”, “British American Tobacco”(BAT) dhe në datën 06.12.2014 në ndërmarrjen Alfa SH.A/ AGNA Group”. Gjatë inspektimeve në ndërmarrje nuk u gjetën evidencat direkte, të cilat mund të përbënin provë për një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim.

Referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 17 është përcaktuar që furnizuesit kryesorë janë të detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore nacionale dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketing çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të publikojë çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve në çdo formë tjetër publikimi.

Duke marrë në konsideratë këtë fakt janë analizuar datat e ndryshimit të cmimit të paketave të cilat zënë peshën më të madhe brenda një shoqërie që janë paketat: Winston, Imperial, Karelia Slims, Malboro, Philip Morris, Rothman Leggera dhe Kent.

Nga analiza e bërë konstatohet se pesë ndërmarrjet e importimit dhe shitjes me shumicë të cigareve, të cilat zënë rreth 91% të tregut të importit dhe gjithë tregun e shitjes me shumicë për vitin 2014, nuk kanë patur sjellje të njëjtë për sa i përket çmimeve në treg. Kështu, ndërmarrja Philip Morris SH.A, e cila është edhe ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut të shitjes me shumicë ka patur një rritje çmimi në periudhë të ndryshme nga ndërmarrja me pjesë tregu më të afërt me të.

Rritja e çmimit të ndërmarrjes Philip Morris është në një periudhë të ndryshme nga ndërmarrja Agna SH.A, por edhe nga ndërmarrjet e tjera Marketing & Distribution dhe ndërmarrja JT International Tirana Shpk. Rritja e çmimeve nga këto ndërmarrje për vitin 2014 është në periudha të ndryshme kohore dhe nuk mund të vlerësohen si çmime paralele dhe si të tilla nuk përbëjnë evidenca ekonomike që mund të përdoren për të provuar një praktikë të bashkënduar me evidenca indirekte. Gjithashtu, këto ndërmarrje reflektojnë rritjen e barrës fiskale që ka ndodhur në fund të muajit Tetor 2014.

Ndërmarrja Philip Morris dhe ndërmarrje BAT kanë rritur çmimet në një diferencë thuajse të njëjtë prej 30 lekë për paketë në datat 27 dhe 30 Tetor 2014, pas rritjes së barrës fiskale me 24 lekë për paketë. Ndërmarrjet Philip Morris dhe BAT kanë pjesë asimetrike tregu (XX% Philip Morris dhe XX% BAT). Për ndërmarrjen Agna SHA mund të themi se referuar edhe periudhës së futjes në fuqi të akcizës së rritur për cigaret, vendimi për rritjen e çmimit të cigareve është me një vonesë prej një muaj nga kjo ndërmarrje.

Për sa më sipër, vlerësojmë se ndërmarrjet AGNA SH.A, Marketing & Distribution dhe JT International Tirana Shpk kanë rritur çmimin e paketave në momente të ndryshme nga njëra-tjetra, gjë që është vërtetuar dhe nga analiza që i është bërë faturave të shitjes të ardhura nga firmat. Ndërmarrjet Philip Morris dhe BAT kanë rritur çmimet në një diferencë prej tre ditësh, si edhe mungesa e evidencave shtesë të nevojshme (komunikimi apo direkte), bën që të mos ketë indicio të forta për një marrëveshje të mundshme apo një praktikë të bashkënduar midis tyre.

Si konkluzion mund të themi se nuk konstatohen shkelje të nenit 4 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe të nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

**V E N D O S I:**

- I. Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikua, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 9 dhe 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
( )  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**  
( )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
( )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
( )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 354, datë 19.03.2015**

“Mbi

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të pjesshëm të shoqërisë Archer Daniles Midland nga shoqëria Olam International Limited”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar      |

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të pjesshëm të shoqërisë Archer Daniles Midland nga shoqëria Olam International Limited.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Archer Daniles Midland / Olam International Limited,

**V Ë R E N S E:**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Përqendrimi realizohet me anë “Marrëveshjeve Blerje Master” të datës 15 Dhjetor 2014<sup>9</sup>, e lidhur ndërmjet palëve shoqëria Archer Daniels Midland (në cilësinë e shitësit) dhe shoqërisë Olam International Limited (në cilësinë e blerësit), me objekt

---

<sup>9</sup> Transaksioni I përqendrimit është parashikuar të mbyllet vetëm me miratimet e tij nga Komisioni Europian, Maroku, Korea e Jugut, Tajvan, Turqi dhe Ukrainë. Transaksioni përqendrimit pritet të përfundojë në Qershor 2015.

përftimi i kontrollit të asetëve që i përkasin aktivitetit të biznesit të kakaos të zotëruara nga Archer-Daniels-Midland, nga Olam International Limited.

Përqendrimi i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit nga shoqëria Olam International Limited mbi një pjesë të shoqërisë ADM dhe përkatësisht të asetëve që përbëjnë biznesin e kakaos. Biznesi i kakaos së ADM-së përfshin të gjitha asetet përkatëse, interesat e pasurisë dhe ndërmarrjet e biznesit që përbëjnë biznesin global të kakaos së ADM-së.

Transaksioni i cili realizohet në formën e përftimit të kontrollit të pjesshëm mbi një ndërmarrje (Archer Daniels Midland) sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

## **2. Palët në transaksion**

- ❖ **Olam International Limited (“Olam”)**, në cilësinë e **Blerësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Singaporit, me seli në adresën: 9 Temasek Boulevard 11-02 Suntec, Singapor. Ajo kryen veprimtari në agrobiznes, duke përfshirë prodhimin e dhe tregtimin e mallrave bujqësorë dhe përbërësve të ushqimit. Aktiviteti kryesor i shoqërisë përfshin prodhimin, përpunimin fillestar, paketimin dhe marketingun e produkteve dhe lëndëve të para industriale. Shoqëria është e listuar në Bursën e Singaporit.
- ❖ **Archer Daniels Midland (“ADM”)**, në cilësinë e **Shitësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit USA, me seli në adresën: Chicago, Illinois 60601, USA. Shoqëria vepron në aktivitetin e prokurimit, transportit, magazinimit, përpunimit dhe tregimit të mallrave bujqësore dhe produkteve të tyre. Veprimtaritë e ADM janë të organizuara, menaxhuara dhe të klasifikuara në tre segmente biznesi: (i) përpunimi i farave vajore; (ii) përpunimi i drithërave; (iii) shërbime agrikulture.
- ❖ **Biznesi i kakaos së ADM-së**, i cili është dhe **Targeti** i këtij transaksioni është pjesë e biznesit më të madh sipas pikës (i) më sipër: përpunimit të farave vajore.

## **3. Xhiro për vitin 2013**

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX Lekë:
  - Olam International Limited : XXX \$ = XXX Lekë

- Archer Daniel Midlands : XXX \$ = XXX Lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXX Lekë:
- Olam International Limited XXXSGD<sup>10</sup> = XXX Lekë
- Archer Daniel Midlands : XXX \$ = XXXX Lekë

#### 4. ANALIZA E KONKURENCËS

##### Tregu Përkatës:

###### A. Tregu përkatës i produktit:

Palët janë përgjithësisht aktive në aspekte të ndryshme të prokurimit dhe shitjes së kakaos, si dhe prodhimit dhe shitjes së produkteve gjysmë të gatshme të kakaos (pije me kakao, gjalpë kakao dhe pluhur kakao).

Referuar Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i prokurimit dhe tregtimit të kokrrave të kakaos, si dhe tregu i prodhimit dhe shitjes së produkteve gjysmë të gatshme të kakaos si pijes së kakaos, gjalpë të kakaos dhe pluhurit të kakaos.

###### B. Tregu përkatës gjeografik:

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar Republika e Shqipërisë.

#### 5. Vlerësimi i përqendrimit

Duke u nisur nga tregu përkatës, objekt i këtij përqendrimi mund të themi se:

Olam dhe ADM nuk kanë mbivendosje në aspektin horizontal në Shqipëri në fushën e prokurimit dhe shitjes të kokrrave të kakaos, meqenëse asnjëra prej tyre nuk prokuron dhe as i tregton ato në Shqipëri.

Palët nuk kanë mbivendosje në aspektin horizontal të ndonjë produkti gjysmë të gatshëm në Shqipëri meqenëse as Olam dhe as ADM nuk shesin pije të kakaos dhe gjalpë kakao në Shqipëri.

Olam nuk ka shitur pluhur kakao në Shqipëri as në vitin 2013 dhe as në vitin 2014, ndërsa përsa i pëket ADM-së, kjo ka realizuar shitje nepermjet distributoreve në vlerën 2 799 727 Lekë, pra më pak se 0.005% e shitjeve totale të pluhurit të kakaos të ADM-së në mbarë botën.

---

<sup>10</sup> SGD (dollarë singapori), 1 SGD = 88.9 Lekë

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese. dhe për këto arsye duhet te autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

**VENDOSI:**

2. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të pjesëshëm të shoqërisë Archer Daniles Midland nga shoqëria Olam International Limited.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**nr.355, datë 20/03/2015**

**“Për  
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë  
elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv.kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e tregtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”;  
Pretendimet e palëve OSHEE dhe Gen-I në seancat dëgjimore të datës 05.02.2015.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e tregtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, si dhe pas seancave dëgjimore me ndërmarrjen ankimuese dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në datë 5.02.2015,

**KONSTATOI:**

**VII. PROCEDURA E NDJEKUR:**

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja (d), neni 26 dhe 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Vendimit nr. 326, datë 08.09.2014 vendosi “Për hapjen

e procedurës së hetimit paraparak në tregun e tregtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është Janar-Shtator 2014.

2. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 374, datë 11.09.2014 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime pranë ndërmarrjeve GSA dhe EFT AL, ku u mbajtën dhe procesverbalet “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, si dhe procesverbal “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës kërkoi të dhëna dhe informacion nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), GSA dhe EFT AL.

## **VIII. ANALIZA E KONKURRENCËS**

### **II.1 Tregu Përkatës**

4. Tregu përkatës i produktit është tregu i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, nga OSHEE (ish CEZ shpërndarje), i cili operon me tarifa jo të rregulluara nga ERE, si i tillë mund dhe duhet të operojë në kushtet e konkurrencës efektive, me qëllim kosto të ulët dhe përfitime për konsumatorin përfundimtar. Tregu përkatës është përkufizuar bazuar në kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”.
5. Tregu gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë. Të gjitha transaksionet për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **II.2 Karakteristikat e tregut**

6. Gjatë periudhës objekt hetimi, Kompania CEZ Shpërndarje/OSHEE ka kryer blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve bazuar në rregullat dhe procedurat e parashikuara në rregulloren për blerjen e energjisë elektrike nga ana e CEZ Shpërndarje Sh.A për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.
7. Bazuar nga ankesat e tregëtarve të energjisë elektrike, dhe bazuar në vlerësimin e bazës rregullatore, Komisioni i Konkurrencës u shpreh në datën 03.12.2013, për hartimin e një rregulloreje të veçantë për procedurat mujore të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve. ERE me anë të Vendimit nr 9, datë 06.02.2014 përcaktoi se procedurat e blerjes mujore të energjisë elektrike nga CEZ Shpërndarje SH.A për mbulimin e humbjeve do të bëhen sipas rregullores së procedurave të blerjes nga KESH SH.A (KESH Gen/FPSH) të energjisë elektrike,

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

nga tregtarët vendas dhe të huaj, të miratuar me vendimin e ERE nr. 30, datë 23.03.2011.

8. Nga vlerësimi i procedurës së ndjekur gjatë blerjeve mujore të energjisë elektrike nga OSHEE-ja si dhe kufizimeve që sjell rregullorja e mësipërme e miratuar me Vendimin e ERE nr. 9, datë 06.02.2014, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr. 334, datë 31.10.2014, “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”.
9. Nga informacioni i grumbulluar u analizuan pjesët e tregut për kompanitë pjesëmarrëse dhe fituese të tenderave sipas muajve, gjatë periudhës objekt hetimi, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1- Pjesët e tregut sipas ofertës së shpallur fituese në sasi (MW) për çdo muaj

	<b>Ndërmarrjet</b>	<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>	<b>Prill</b>	<b>Maj</b>	<b>Qershor</b>	<b>Korrik</b>	<b>Gusht</b>	<b>Shtator</b>
1	GSA	14%	30%	31%	23%	7%	16%	17%	30%	20%
2	EFT*AG	63%	46%	68%	37%	52%	84%	60%	42%	80%
3	GEN-I* Serbia	23%						15%	7%	
4	GEN-I-AL		23%	1%	38%	41%		8%	19%	
5	AXPO		1%		2%				2%	
	Total (%)	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Burimi: të dhënat e OSHEE për procedurat e tenderimit

10. Të dhënat e mësipërme paraqesin në mënyrë të detajuar ndërmarrjet që kanë marrë pjesë dhe që kanë fituar në procedurat e tenderimit për blerjen e energjisë elektrike nga operatori shpërndarës. Treguesit shprehin peshën specifike sipas fuqisë së tregëtuar nga secila ndërmarrje për çdo muaj të periudhës hetimore, pasi procedurat e kryerjes së tenderimit janë procedura mujore.

### II.3 Vlerësimi i sjelljes të ndërmarrjeve në treg

11. Referuar ankesës së shoqërisë GEN-I Tirana sh.p.k, pretendohet për një marrëveshje të mundshme midis ndërmarrjeve OSHEE SH.A, EFT dhe GSA të cilat kanë për pasojë kufizimin e konkurrencës.
12. Për të vlerësuar sjelljen e të gjithë ndërmarrjeve që marrin pjesë në këto procedura prokurimi, janë kryer inspektime të befasishme pranë ofertuesve të energjisë që marrin pjesë në procedurat e shitjes së energjisë elektrike për OSHEE-në si dhe është marrë në analizë i gjithë dokumentacioni i depozituar nga ofertuesit në këto procedura prokurimi si dhe dokumentacioni i mbajtur nga OSHEE për zhvillimin e këtyre procedurave. Duke qenë se OSHEE e organizon blerjen e energjisë mbi baza mujore, janë marrë në analizë të gjithë procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën objekt hetimi, Janar-Shtator 2014.

**Prokurimi i muajit Janar 2014.**

13. Kërkesa e CEZ Shpërndarje/OSHEE për muajin Janar 2014 ka qenë për 500 MW, por në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 349 MW, pra nuk është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Janar që janë GSA, për sasinë 55MW me çmimin 64.57Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 294MW me çmimin 69.75Euro/MWh. Në këtë procedurë, ndërmarrja GEN-I Tirana sh.p.k, është përjashtuar për shkak të mos heqjes së kushteve të kërkuara në ftesën për ofertë dhe kontratës përkatëse.

**Prokurimi i muajit Shkurt 2014.**

14. Kërkesa e CEZ Shpërndarje/OSHEE për muajin Shkurt 2014 ka qenë për 480 MW, por në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 445 MW, pra nuk është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Shkurt 2014 janë: GEN-I Tirana SH.P.K për sasinë 100MW me çmimin 66.50Euro/MWh; GSA për sasinë 95 MW me çmimin 63.75Euro/MWh, si dhe për sasinë 40 MW me çmimin 67.75Euro/MWh; AXPO për sasinë 5MW me çmimin 64.99Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 205MW me çmimin 70.50Euro/MWh.

**Prokurimi i muajit Mars 2014.**

15. Kërkesa e CEZ Shpërndarje/OSHEE për muajin Mars 2014 ka qenë për 385 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 385 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Mars 2014 që janë: GEN-I Tirana sh.p.k për sasinë 5 MW me çmimin 55.90Euro/MWh; GSA për sasinë 120 MW me çmimin 55.80Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 260 MW me çmimin 55.85Euro/MWh. Ofertat e të 3 (tre) ndërmarrjeve fituese ndryshojnë nga njëri tjetri me vetëm 0.05 Euro dhe shoqërisë GEN-I Tirana i janë blerë vetëm 5 MW nga sasia prej 100 MW të ofruar, duke qenë se rezultoi se është operatori me çmimin më të lartë të ofruar.

**Prokurimi i muajit Prill 2014.**

16. Kërkesa e OSHEE për muajin Prill 2014 ka qenë për 260 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 260 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Prill 2014 janë si vijon: GEN-I Tirana sh.p.k për sasinë 100 MW me çmimin 46.68Euro/MWh; GSA për sasinë 60 MW me çmimin 49.95Euro/MWh; AXPO për sasinë 5 MW me çmimin 49.64Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 95 MW me çmimin 50Euro/MWh.

**Prokurimi i muajit Maj 2014.**

17. Kërkesa e OSHEE për muajin Maj 2014 ka qenë për 220 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 220 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Maj 2014 janë, si vijon: GEN-I Tirana SH.P.K për sasinë 90 MW me çmimin 47.92Euro/MWh; GSA për sasinë 15 MW me çmimin 49.95Euro/MWh; dhe EFT AG për sasinë 115 MW me çmimin 49.85Euro/MWh.



**Prokurimi i muajit Qershor 2014.**

18. Kërkesa e OSHEE për muajin Qershor 2014 ka qenë për 250 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 250 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Komisioni i shpalli fituesit e muajit Qershor 2014 dhe u nënshkruan kontratat me kompanitë fituese, si vijon: GSA për sasinë 40 MW me çmimin 48.25Euro/MWh; dhe EFT AG për sasinë 210 MW me çmimin 48.29Euro/MWh.

**Prokurimi i muajit Korrik 2014.**

19. Kërkesa e OSHEE për muajin Korrik 2014 ka qenë për 260 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 260 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Korrik 2014 janë, si vijon: GSA për sasinë 45 MW me çmimin 52Euro/MWh; GEN-I Tirana SH.P.K për sasinë 20 MW me çmimin 48.13Euro/MWh; GEN-I Beograd për sasinë 40 MW me çmimin 48.93Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 155 MW me çmimin 52.5Euro/MWh.

**Prokurimi i muajit Gusht 2014.**

20. Kërkesa e OSHEE për muajin gusht 2014 ka qenë për 270 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 270 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit gusht 2014 janë si vijon: GSA për sasinë 80 MW me çmimin 50.50Euro/MWh; GEN-I Tirana SH.P.K për sasinë 50 MW me çmimin 47.39Euro/MWh; GEN-I Beograd për sasinë 20 MW me çmimin 49.05Euro/MWh; EFT AG për sasinë 114 MW me çmimin 50.75Euro/MWh dhe AXPO për sasinë 6 MW me çmimin 47.65Euro/MWh.

**Prokurimi i muajit Shtator 2014.**

21. Kërkesa e OSHEE për muajin Shtator 2014 ka qenë për 225 MW dhe në përfundim të procesit kontratat me fituesit janë nënshkruar për 225 MW, pra është arritur të sigurohet e gjithë sasia e energjisë së kërkuar. Fituesit e muajit Gusht 2014 janë, si vijon: GSA për sasinë 45 MW me çmimin 47.50Euro/MWh; dhe EFT AG për sasinë 180 MW me çmimin 47.40Euro/MWh.
22. Referuar ofertave fituese për çdo muaj, vihet re se çmimet përfundimtare të ndërmarrjes EFT dhe GSA për muajin Qershor 2014 ndryshojnë me vetëm 0.04 Euro/MW, për muajin Korrik 2014 ndryshojnë me vetëm 0.5 Euro, kurse për këtë muaj oferta midis ndërmarrjeve GEN-I ndryshon me 0.8 Euro, për muajin gusht 2014 ndryshojnë me vetëm 0.25 Euro, kurse oferta midis ndërmarrjeve GEN-I ndryshojnë me 1.66 Euro, për muajin Shtator 2014 ndryshojnë me vetëm 0.10 Euro. Gjithashtu oferta përfundimtare midis ndërmarrjes GEN-I Tirana dhe GSA ndryshon me 0.22 Euro.
23. Gjithashtu, referuara ofertave të paraqitura, rezulton se në procedurat e blerjes së energjisë elektrike për muajt qershor, korrik dhe gusht 2014 kanë marrë pjesë dhe ndërmarrjet e grupit GEN-I, nëpërmjet ndërmarrjeve GEN-I Tirana sh.p.k dhe

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

GEN-I Beograd, ofertat e të cilave janë të nënshkruara nga i njëjti person. Këto ndërmarrje paraqiten si dy operatorë për të zënë vendet në pesë kompanitë pjesëmarrëse në negociim.

24. Vihet re, se në muajt në të cilat kërkesa për blerje energjia nga OSHEE është më e vogël se oferta e ndërmarrjeve, çmimi me të cilin është lidhur kontrata përfundimtare është më i ulët. Në ato muaj kur kërkesa është më e vogël se oferta ndodh fenomeni që ndërmarrjet hyjnë me sasi më të vogël në ofertat fillestare dhe përfundojnë me sasi të përafërt me sasinë e kërkuar nga ndërmarrja OSHEE SH.A dhe çmimi përfundimtar është shumë i afërt midis ndërmarrjeve fituese.
25. Procedurat e tenderimit gjatë procesit të negociimit, pas marrjes së ofertave fillestare, nuk janë transparente dhe kryerja e disa fazave të negociimit (në përgjithësi katër faza) e bëjnë procesin dyshues për shkak të mundësisë së asimetrisë së informacionit mes palëve duke i vendosur ndërmarrjet në një “teori loje” mes sasisë së ofruar dhe negociimit të çmimit.
26. Referuar sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Këto ndërmarrje me anë të sjelljes së tyre mund të kenë kufizuar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në formën e marrëveshje të ndaluara horizontale apo vertikale, sjellje e cila kthehet në kosto të rritura për ndërmarrjen blerëse (OSHEE) dhe humbje për konsumatorin fundor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d), nenet 26, 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 5 pika 3 e Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ndaj ndërmarrjeve:
  - 1- GSA sh.p.k
  - 2- EFT sh.p.k
  - 3- GEN-I Tirana sh.p.k dhe GEN-I Beograd
  - 4- OSHEE SH.A
- II. Periudha objekt hetimi është Janar – Dhjetor 2014
- III. Procedura e hetimit të thelluar duhet të përfundojë jo më vonë se katër muaj nga marrja e këtij vendimi.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

IV. Ndërmarrjet objekt hetimi mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështrimin e tyre brenda 30 ditëve nga bëra me dije e ketij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

( \_\_\_\_\_ )

**Zv/Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**nr. 356, datë 31.03.2015**

**“Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes VODAFONE  
ALBANIA SHA, në tregun e telefonisë celulare me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪ <b>Lindita</b>	<b>MILO (LATI)</b>	<b>Kryetare</b>
▪ <b>Servete</b>	<b>GRUDA</b>	<b>Zv/Kryetare</b>
▪ <b>Koço</b>	<b>BROKA</b>	<b>Anëtar</b>
▪ <b>Iva</b>	<b>ZAJMI</b>	<b>Anëtare</b>
▪ <b>Eduard</b>	<b>YPI</b>	<b>Anëtar</b>

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2015 dhe 30.03.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtim i raportit të hetimit paraprak dhe propozimi për marrje të masave të përkohshme ndaj shoqërisë Vodafone Albania Sh.A në tregun e telefonisë celulare me pakicë

**Baza ligjore:** Nenet 9, pika 1, 24, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 9121, neni 61, shkronja d), datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ketu dhe me poshte Ligji.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e telefonisë celulare ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

**VËREN SE :**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një ankesë nga Shoqëria “Plus Communication” SHA (këtu e në vijim Plus) kundër ndërmarrjes Vodafone Albania SHA (këtu e në vijim Vodafone) për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri. Ankuesi pretendon se duke u mbështetur në provat e mbledhura nga Plus, Autoriteti i Konkurrencës mund të konstatojë se Vodafone ka operuar duke abuzuar me pozitën dominuese në treg në periudhën 01.01.2013-31.12.2013, nëpërmjet një sjellje përjashtuese agresive me objektiv të qartë

eliminimin e operatorëve të vegjël nga tregu, duke penguar në mënyrë indirekte e të pakthyeshme zhvillimin e konkurrencës në sektorin e telefonisë celulare dhe, në veçanti, në tregun e pakicës dhe, si rrjedhim, duke cënuar konsumatorët shqiptarë në një perspektivë afatgjatë.

2. Sipas ankimesit, rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës në Vendimin nr. 303, datë 16.01.2014 nuk janë zbatuar si nga AKEP ashtu edhe nga ndërmarrja nën hetim Vodafone, pavarësisht angazhimit publik të saj për zbatimin e këtyre rekomandimeve.
3. Bazuar në vlerësimin e ankesës nga Sekretariati, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 336, datë 11.11.2014, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone Albania SHA”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
4. Në përgjigje të kërkesës për informacion, ndërmarrja Vodafone Albania SHA, dërgoi informacionin e kërkuar me anë të shkresës nr. 497/1 prot., datë 03.12.2014. Gjithashtu, Shoqëria “Vodafone Albania SH.A me anë të shkresës së saj, me referencë LRD/0010/OX datë 29.01.2015, (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. prot. 65/1, datë 29.01.2015), ka paraqitur një shkresë “*Në vijim të hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë*”. Në të ajo përditëson me informacion zhvillimet më të fundit në tregun e telefonisë celulare, sepse gjykon se mund të ndihmojë Autoritetin e Konkurrencës në vendimmarrjen e pritshme.
5. Nga vlerësimi i nenit 8 të Ligjit: nisur nga pjesët e tregut, qëndrueshmërinë e pjesëve të tregut në vite, shkallën e përqendrimit në të gjithë treguesit, pengesat e hyrjes në treg; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por dhe nga praktikat më të mira të së drejtës europiane të konkurrencës, ndërmarrja Vodafone Albania ka pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë për periudhën 2013 - 6 mujori I- rë 2014.
6. Nga vlerësimi i sjelljes se ndërmarrjes Vodafone Albania rezultoi se:
  - i. Ndërmarrja Vodafone, e cila zotëron 100 % të tregut të shitjes me shumicë (terminimit, i cili është një input i domosdoshëm për të kryer thirrje në rrjetin Vodafone) si dhe pozitë dominuese në tregun e pakicës sipas Vendimit nr. 303/2014 të Komisionit të Konkurrencës. Pjesët e tregut të Vodafone Albania në tregun e pakicës (sipas të ardhurave) janë më të mëdha se pjesët e tregut të 3 (tre) konkurrentëve të saj të marrë së bashku.
  - ii. Vodafone Albania ka aplikuar (për periudhën nën hetim 2013-gjysma e parë e vitit 2014) çmime shumë të ulta për thirrjet brenda rrjetit (nën tarifën e terminimit), për të cilet ndërmarrjet konkurrenca nuk mund ta konkurrojnë në mënyrë fitimprurëse, pasi do ti duhet që të paguajnë inputin e domosdoshëm për të kryer një thirrje drejt rrjetit Vodafone, tarifën e terminimit.

- iii. Raporti i trafikut brenda rrjetit krahasuar me atë jashtë rrjetit është shumë i lartë. Shtrembërimi i fluksit të trafikut të thirrjeve on-net/off-net shkaktuar nga diferencimi i çmimeve me pakicë on-net/off-net ka rezultuar në përkeqsimin e bilancit të operatorëve të tjerë, i cili sjell efektin e rritjes së shpenzimeve dhe dobëson pozitën e tyre në treg. Devijimi i trafikut drejt on-net (ku Vodafone 95% të thirrjeve të tij i ka brenda rrjetit) është rezultat i zbatimit të diferencimit të tarifave midis praktikave për thirrjet on-net dhe off-net. Shtrembërimi i fluksit të trafikut on-net (Vodafone zotëron 52% të thirrjeve on-net/totalin e thirrjeve on-net të gjithë operatorëve) ka prirje për të zvogëluar pjesët e tregut të operatorëve më të vegjël. Struktura e thirrjeve është e tillë që rrjetet ndërmjet tyre kanë një ndërveprim shumë të ulët dhe të papërfillshëm në krahasim me trafikun total të hyrjeve ndonëse sipas të dhënave të AKEP gjatë vitit 2014 ky tregues është në rënie, në sajë të masave që ka marrë AKEP për uljen e tarifave të terminimit në zbatim të Vendimit nr. 303 të Komisionit të Konkurrencës.
  - iv. Vodafone gjatë periudhës nën hetim ka ofruar paketa në përbërje të të cilave ka thirrje zanore në numër shumë të madh (me dhjetra herë) minutash brenda club/ rrjetit dhe të kufizuara jashtë rrjetit; SMS dhe internet. Këto paketa ofrohen në mënyrë ofertash për të dy planet tarifore me parapagesë, Vodafone Card dhe Vodafone Club.
  - v. Strategjia diferencuese shfaqet më e theksuar në ofertat dhe paketat e hedhura për planin tarifor Vodafone Club, duke ju ofruar abonentëve të saj një numër shumë të madh thirrjesh (Minutash), SMS, MMS dhe Internet brenda rrjetit dhe më të kufizuara jashtë rrjetit. Ofertat e planit tarifor Vodafone Club janë më të shumta në numër, me bazë ditore, javore, mujore. Nëpërmjet ofertave Vodafone Club, i shtyn abonentët e vet që të kalojnë apo të zgjedhin këtë plan tarifor, pasi ofron një sasi shumë të madhe minutash, SMS, MMS dhe Internet brenda tij. Kalimi i abonentëve në planin tarifor Vodafone Club ka përfitime për komunikimin brenda këtij plani tarifor për shkak të njësive të shumta të ofruara në raport me çmimin e paguar. Ky diskriminim/diferencim të tarifave midis thirrjeve on-net dhe off-net, ka çuar në fenomenin e “club effect”.
  - vi. Strategjia e aplikuar nga Vodafone lidhur me “portabilitetin për klientët në segmentin parapagesë” Vodafone Club, Vodafone Card ka qëllim të nxisë tërheqjen e klientëve tek Vodafone (kryesisht Vodafone Club), duke rritur bazën e numrit të abonentëve të saj kryesisht me forcimin e efektit “Club”; të ofrojë tarifa për klientët e rinj më të ulët sesa cmimet që u aplikohen klientëve aktualë të Vodafone; duke kushtëzuar sjelljen e konsumatorit shqiptar.
7. Si konkluzion, tregu është në kushtet e pozitës dominuese individuale të shoqërisë Vodafone Albania në tregun përkatës dhe ekziston rreziku për të shkaktuar një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit,

**PËR KËTO ARSYE:**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 8, 9, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, neni 61, shkronja d, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**V E N D O S I:**

- I. Marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjen Vodafone në tregun e telefonisë celulare me pakicë për rivendosjen e kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg:
- 1) Vodafone Albania SH.A ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:
    - a) Sasia e minutave brenda rrjetit Vodafone Albania të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;
    - b) Përcaktimet e pikës 1.a më sipër aplikohet për të gjitha ofertat, shportat, opsionet dhe skontot e ofruara për abonentët;
- II. Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme, i cituar në pikën 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë:
- a. periodike ditore jo më shumë se 5 % të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës sipas nenit 76 pika b), në mënyrë që ndërmarrja të veprojë në përputhje me vendimin për marrjen e masave të përkohshme sipas nenit 44 të këtij Ligji
  - b. deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit.
- III. Masat e përkohshme duhet të zbatohen brenda 30 ditëve që nga momenti i marrjes dijeni të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjeve.
- IV. Brenda një periudhe 10 ditore nga dalja e këtij vendimi shoqëria Vodafone Albania duhet të paraqesë këndvështrimet e saj lidhur me masat e përkohshme
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA  
YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetare**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtare**

**Eduard**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 357, datë 02.04.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Credins Bank SH.A të 76% të kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sicred SH.A, të zotëruara nga shoqëria Sicred SH.A”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Zv. Kryetar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar
- Z. Eduard Ypi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 02.04.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar përfutimit të kontrollit nga shoqëria Credins Bank SH.A të 76% të kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sicred SH.A, të zotëruara nga shoqëria Sicred SH.A.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16 dhe 17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Credins Bank SH.A / Sicred SH.A / Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sicred SH.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**V Ë R E N S E:**

**2. Transaksioni dhe përqendrimi**

Transaksioni i përqendrimit realizohet në bazë të “Kontratës për Shitjen e Aksioneve” e nënshkruar ndërmjet ndërmarrjeve Banka Credins SH.A (Blerësi) dhe Sicred SH.A



(Shitësi), me objekt transferimin e pjesës prej 76% të kapitalit aksionar të ndërmarrjes Shoqëria e Administrimit të Fondit të Pensioneve Sicred SH.A nga shitësi tek blerësi, më datë 22 Dhjetor 2014.

Transaksioni cili realizohet në formën e përfutimit të kontrollit maxhoritar mbi një ndërmarrjen Shoqëria e Administrimit të Fondit të Pensioneve Sicred SH.A nga ndërmarrja Credins Bank SH.A, i cili sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në këtë të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit përbën një përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

## 2. Palët në transaksion

- ❖ **Banka Credins SH.A:** në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar, Ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me seli në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, nr. 4, Tiranë. Objekti i shoqërisë është veprimtaritë bankare dhe financiare: a) të gjitha format e kredi dhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore; b) faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare; c) qiranë financiare; d) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit, çeqet bankare dhe kartat e pagesës, etj.
- ❖ **Sicred SH.A** në cilësinë e **Shitësit**, është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në baze të legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Rruga “Brigata e VIII-të” Vila nr. 3/1, Tiranë. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është sigurimi i jetës.
- ❖ **Shoqëria e Administrimit të Fondit të Pensionit Sicred SH.A**, në cilësinë e **Targetit të përqendrimit** është një shoqëri e cila është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: “Rruga Brigata VIII-të”, vila nr.3/1, Tiranë. Qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë është: (i) mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10197, datë 10. 12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikim), për ofrimin e përfutimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit; (ii) kryerja e pagesave të pensionit, për arritjen e këtij qëllimi shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridik dhe fizikë brenda dhe jashtë vendit të cilët kanë të njëjtin qëllim.

### 3. Xhiro për vitin 2013

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XX Lekë:**
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është **XXX Lekë:**
  - **Banka Credins** : XXX Lekë
  - **Grupi SiCred** : XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndyshuar.

#### **4. Analiza e konkurrencës**

##### **- Tregu përkatës**

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndyshuar), si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I). tregu përkatës i produktit, dhe
- II). tregu përkatës gjeografik.
  - **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i pensioneve private vullnetare.

- **Tregu përkatës gjeografik:**

Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet **tregu i brendshëm** pra territori i Republikës së Shqipërisë.

#### **Struktura e Tregut**

Gjatë vitit 2013 numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri të ndryshme administruese, përkatësisht Raiffeisen Invest SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen, Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, si dhe SiCRED SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar SiCRED.

#### **4.1 Konkurrentët në tregun kombëtar**

Gjatë vitit 2013 dhe 9 mujorit të vitit 2014, në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri të ndryshme administruese, përkatësisht Raiffeisen Invest SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen, Sigal Life Uniqa Group Austria SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar Sigal, si dhe SiCRED SH.A., e cila administron Fondin e Pensionit Vullnetar SiCRED.

#### **5. Vlerësimi i konkurrencës.**

Nga vlerësimi i përqendrimit të njoftuar rezulton se përqendrimi nuk do të sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri pasi ndryshon vetëm kontrolli nga SiCred SHA te Credins Bank.

Nga kendveshtrimi i autoriteteve rregullatore të tregut, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, me shkresën nr 434/1 prot., të datës 09.03.2015, në përgjigje të shkresës së Autoritetit të Konkurrencës,(nr.131 prot., datë 03.03.2015) është shprehur se :

- Referuar nenit 20 të Ligjit nr.10197, datë 10.12.2009, ku parashikohet se “Te pakten 51% e aksioneve të shoqërisë administruese të Fondit të Pensionit

Vullnetar duhet te zoterohen nga banka dhe institucione financiare”, rezulton se transaksioni ploteson kriterin e parashikuar ne kete nen.

Banka e Shqiperise ne shkresen nr.1067/1 prot., date 18.03.2015, eshte sqaruar se “Investimi i Bankes Credins ne kapitalin e institucionit financiar nuk tejkalon 15% te kapitalit te saj rregullator pasi perben 0.502% te kapitalit rregullator te Bankes Credins”. Si autoritet mbikqyres i subjekteve bankare, Banka e Shqiperise vlereson se niveli i rreziqeve potenciale qe lidhen me zoterimin e aksioneve te shoqerise administruese nga Banka Credins eshte plotesisht i menaxhueshem nga kjo e fundit. Shoqeria administruese eshte nje entitet i veçante nga Banka dhe kapitali minimal i kerkuar i shoqerise administruese eshte 15,6 mln lek dhe duhet te rritet paralelisht me rritjen e aseteteve neto te fondit po ne nje raport 1:5000”.

**Nga vleresimi i konkurrences, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve te nenit 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.**

#### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

#### **VENDOSI:**

4. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Credins Bank SH.A të 76% të kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sicred SH.A, të zotëruara nga shoqëria Sicred SH.A.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr.358 , datë 16.04.2015**

**“Për**  
**mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me**  
**objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore**  
**(Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” dhe disa**  
**rekomandime për Autoritetin Rrugor Shqiptar.**

Komisioni i Konkurrencës, i përbërë nga:

- |                       |             |
|-----------------------|-------------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetare    |
| • Servete GRUDA       | Zv/Kryetare |
| • Koço BROKA          | Anëtar      |
| • Iva ZAJMI           | Anëtare     |
| • Eduard YPI          | Anëtar      |

dhe me pjesëmarrjen e Servete GRUDA, Koço BROKA, Iva ZAJMI dhe Eduard YPI, në mbledhjen e tij të datës 16.04.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të hetimit thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”

**Baza ligjore:** Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e më poshtë Ligji), neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 5 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

**VËREN SE:**

**PROCEDURA E NDJEKUR**

Autoriteti i Konkurrencës, mori shkas nga njoftimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit “që në procedurat e prokurimit publik për vitin 2013 me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3, është konstatuar se të njëjtët operatorë ekonomikë të cilët kanë konkurruar për lotin e 1 dhe që janë skualifikuar, rezultojnë të dalin fitues mbi bazë rotacioni në lotet 2 dhe 3, duke konkurruar për të njëjtat kriteret të vendosura në DST për secilin lot, ku dhe diferenca në vlerë nga oferta në oferte është e papërfillshme. Kjo mënyrë konkurimi sjell si pasojë që një grup i vogël operatorësh ekonomikë të kontrollojnë një pjesë të gjërë të tregut., duke hyrë në marrëveshje të fshehtë mes tyre dhe monopolizuar tregun”.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 346, datë 16.02.2015 , “Për hapjen e procedurës së hetimit thelluar në tregun e prokurimit me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”, vendosi hapjen e kësaj procedure.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga Autoriteti Kontraktor për procedurën e prokurimit nën hetim.

Në bazë të neneve 35 dhe 36 të Ligjit dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës, u kryen inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

**NDËRMARRJET NËN HETIM**

Në procedurën e hetimit të thelluar do të jenë nën hetim të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse dhe bashkimet e përkohshme të ndërmarrjeve në procedurat e prokurimit me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”.

- Shoqëria “Gener 2” Sh.p.k,
- Shoqëria “Albavia” Sh.p.k,
- Shoqëria “Gjikuria” Sh.p.k,
- Shoqëria “Gjoka Konstruksion” Sh.a,
- Shoqëria “Favina” Sh.p.k,
- Shoqëria “Alpin” S.r.l,
- Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Gjoka Konstruksion& Gjikuria”,
- Bashkimi i përkohshëm i shoqërive Albavia&Favina&Alpin Srl (JV),

Gjatë procedurës së hetimit paraprak u kryen inspektime të njëkohshme pranë të gjitha ndërmarrjeve nën hetim ku u mbajtën proces-verbalet përkatëse të inspektimit dhe të marrejs së shpjegimeve. Gjithashtu gjatë hetimit të thelluar, u kryen inspektime

në bashkëpunim me ARRSH-në, në vendin ku po kryente punime secila prej ndërmarrjeve.

**Në përfundim të procedurave të inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte që të provonin ekzistencën e bashkëpunimit ose marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve nën hetim.**

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin u kërkuar informacion nga ndërmarrjet nën hetim si edhe nga ARRSH, i cili u depozitua pranë Autoritetit të Konkurrencës.

## **ANALIZA E KONKURRENCËS**

### ***C. Tregu përkatës i produktit:***

Operatorët ekonomikë që të jenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duhet të përmbushin të gjitha ato kritere që vlerësohen të nevojshme nga autoriteti kontraktor dhe që kanë të bëjnë me kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndjen ekonomike e financiare, kapacitetet ligjore, si dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Këto kritere duhet të jenë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Ato duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, tregu përkatës i produktit është *tregu i prokurimit publik me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3.*

### ***D. Tregu përkatës gjeografik***

Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet *“Tregu i prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit)”.*

## **VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE**

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik të ndërtimit të rrugës me objektin e mësipërm u vlerësuan të dhënat e siguruar nga Autoriteti Kontraktor, meqënëse gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi nuk u gjet asnjë evidencë që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike” si dhe është shqyrtuar i të gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet në të tre lotet e procedurës, pra: të gjitha dokumentat e plotësuar nga ndërmarrjet sipas Dokumentave Standarte të Tenderit, të cilat hartohen nga Autoriteti Kontraktor;

Dokumentacioni i administruar në fazën e inspektimit si dhe dokumentacioni i administruar nga Autoriteti Kontraktor ARRSH gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës.

Prania e faktorëve si ofertat në rotacion dhe afërsia e ofertës fituese me fondin limit janë shenja mbi ekzistencën e marrëveshjeve në oferta në rastin e prokurimit të realizuar në vitin 2013, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, me objekt “Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3.

**A. Ofertat në rotacion.**

*Në lotin e I-rë*, me fond limit 1 955 797 770 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës në procedurë 3 operatorë me oferta, ku operatori fitues është Gener 2 ndërkohë që kanë paraqitur oferta më të larta bashkimi operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria (si Joint venture) dhe shoqëria Albavia.

*Në lotin e II-të*, me fond limit 1 942 441 074 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës të njëjtët operatorë si në lotin e I-re, ku në këtë rast operatori fitues është bashkimi i operatorëve Albavia & Favina & Alpin ndërkohë që oferta kanë paraqitur Gjoka Konstruksion&Gjiguria dhe Gener 2.

*Në lotin e III – të*, me fond limit 1 933 742 407 lekë pa TVSH, janë pjesëmarrës vetëm 2 operatorë, të njëjtët si në lotet I dhe II, ku fitues rezulton bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria ndërkohë që ofertë si operator i vetëm ka paraqitur vetëm Albavia.

**B. Afërsia me fondin limit**

*Në lotin e I-rë*, fitues Gener 2 me 99.82 % të fondit limit ndërkohë që dy operatorët janë bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion me 99.91 % të fondit limit dhe Gjiguria (si Joint venture) dhe shoqëria Albavia 99.96 % të fondit limit.

*Në lotin e II-të*, fitues është bashkimi i operatorëve Albavia & Favina & Alpin , me ofertë rreth 99.9% e fondit limit ndërkohë që oferta kanë paraqitur Gjoka Konstruksion&Gjiguria me 99.98 % dhe Gener 2 me 99.99 % të fondit .

*Në lotin e III – të*, fitues rezulton bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria me vlerë oferte fituese 99.9% e fondit limit ndërkohë që ofertë si operator i vetëm ka paraqitur vetëm Albavia me 99.95 % të fondit limit.

**IV.1. Analizë e thelluar për secilin lot, bazuar në informacionet e grumbulluara në inspektimet në terren**

Nga hetimi i kryer për çdo fazë të vlerësimit të ofertave të paraqitura nga palet, analiza u përqendrua në:

- 1 Analizën dokumentave të kerkuara nga ARRSH, dokumentave të dorezuar, ato të munguara, duke e krahasuar me dokumentacionin faktit të paraqitur për lotin përkatës për secilin lot.

- 2 Analizën e dokumentave për të vlerësuar nëse kompanitë fituese kanë qene nënkontraktore, dhe nëse po, cilët janë nënkontraktorët.

LOTI 1 përfshin Rotondon e ndertuar ne aksin e autostrades Tirane – Elbasan ne zonen prane “Natyrës së Qetë” dhe përfundon në Pr. 208 , - km 4.14, gjatesi 4140 m – fitues “GENER 2” shpk, me vlerën 1 952 308 394 lekë.

IV.2. Analiza dokumentave te kerkuara, dokumentave te dorezuar, ato te munguara, duke e krahasuar me dokumentacionin e faktit te paraqitur për lotin përkatës.

Nga krahasimi i dokumenteve të siguruar në formë elektronike për lotin e parë, me proces verbalet përkatëse të ARRSH, mbajtur gjatë procedurave të kryerjes së secilës fazë të tenderimit dhe dokumentet e paraqitur, konstatojmë se dokumentacioni i paraqitur dhe krahasuar me dokumentacionin e përshkruar në procesverbalet përkatëse është i njejte.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur vlerësimi nëse kompanitë për kryerjen e punimeve sipas kontratave, janë bazuar në kapacitetet teknike te veta apo kanë nënkontraktuar kompani për punime të ndryshme, në përfundim rezultoi se nuk kanë kompani nënkontraktuese.

Nga analiza e elementëve perkatës të matricës dhe përshkrimit sipas proces-verbaleve, vihen re se elementet e pershkruar ne proces-verbale, dhe dokumentet e dorëzuar nga kompanite pjesëmarrëse janë të njejta. Gjithashtu nga dokumentacioni faktit nuk rezulton të ketë nënkontraktor për punime të ndryshme qe duhen kryer.

LOTI 2 (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), – Hyrja e repartit te helikoptereve, ndjek shtratin e perroit te Shkalles, Pr. 208 – Pr. 314 Km 4,14 –Km. 6,34. FITUESI – “ALBAVIA SHPK & FAVINA SHPK & ALPIN SRL” me vlerën 1 939 904 984 lekë.

Analiza dokumentave te kerkuara, dokumentave te dorezuar, ato te munguara, duke e krahasuar me dokumentacionin faktit te paraqitur për lotin përkatës.

Nga krahasimi i dokumenteve të siguruar në formë elektronike për lotin e dytë, me proces verbalet përkatëse të ARRSH, mbajtur gjatë procedurave të kryerjes së secilës fazë të tenderimit dhe dokumentet e paraqitur, konstatojmë se dokumentacioni i paraqitur dhe krahasuar me dokumentacionin e përshkruar në proces-verbalete përkatëse është i njejte.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur vlerësua nëse kompanitë, për kryerjen e punimeve sipas kontratave, janë bazuar në kapacitetet teknike te veta apo kanë nënkontraktuar kompani për punime të ndryshme. Dhe në përfundim rezultoi se bazuar në dokumentacionet faktike nuk kanë kompani nënkontraktuese.

Nga krahasimi i dokumenteve të siguruar në formë elektronike për lotin e dytë, me proces verbalet përkatëse të ARRSH, mbajtur gjatë procedurave të kryerjes së secilës fazë të tenderimit dhe dokumentet e paraqitur, konstatojmë se dokumentacioni i paraqitur dhe krahasuar me dokumentacionin e përshkruar në proces-verbalete përkatëse është i njejte.



LOTI 3 (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3. Përbehët nga Segmenti I Pr. 314 – Pr. 388, Km 6,34 – Km 7.85; Segmenti II (sistemimi I Lanes dhe rruget paralele) ne pk. 00 – 79, km 0.00 – km 1.57).

Kompania fituese është “Gjoka Konstruksion shpk & Gjiguria shpk ” me vlerën 1 931 953 307 lekë.

IV.3. Analiza dokumentave te kerkuara, dokumentave te dorezuar, ato te munguara, duke e krahasuar me dokumentacionin faktit te paraqitur për lotin përkatës.

Analiza e lotit te tretë, bazohet në informacionin mbi kriteteret e përgjithshme, të vecanta dhe teknike të pranimit dhe kualifikimit, kritere ligjore, financiar dhe ekonomik, dokumentet e paraqitur dhe dokumentet e munguar nga cdo kompani pjesëmarrëse, dhe vleren e ofertave te paraqitura prej tyre. Fitues i lotit të tretë është kompania – Gjoka konstruktion shpk & Gjiguria shpk

Nga krahasimi i dokumenteve të siguruar në formë elektronike për lotin e tretë, me proces verbalet përkatëse të ARRSH, mbajtur gjatë procedurave të kryerjes së secilës fazë të tenderimit dhe dokumentet e paraqitur, konstatojmë se dokumentacioni i paraqitur dhe krahasuar me dokumentacionin e përshkruar në proces-verbalet përkatëse është i njejte.

Sipas proces-verbaleve kompania JV ALBAVIA, nuk ka paraqitur të plota dokumentet e tenderit. Në fund të procedurës komisioni shpali fitues bashkimin e operatorëve “Gjoka Konstruksion shpk & Gjiguria shpk” me vlerë 1 931 953 307 lekë.

Për lotin e tretë, bazuar në folderin e dokumentave që disponohen, shfaqet nje *file* me emrin e kompanisë VICTORIA INVEST, por që nuk ekziston informacioni i kërkuar dhe dokumentacioni përkatës i tenderit për këtë lot. Në këtë *file* ndodhet vetem dokumenti i “Njehsimit të licensës”. Ndërsa në pocesverbalet përkatëse të ARRSH nuk ndodhet asnje informacion më shumë dhe nuk është përshkruar asgje në lidhje me VICTORIA INVEST.

Në dokumentet faktike të folderit përkatës, nuk gjendet informacion në lidhje me: (a) vertetimin e xhiros per 3 vitet pasardhese te Gjiguria shpk dhe (b) pasqyrat financiare te vitit 2009 të Gjiguria shpk.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur vlerësua nëse kompanitë, për kryerjen e punimeve sipas kontratave, janë bazuar në kapacitetet teknike te veta apo kanë nënkontraktuar kompani për punime të ndryshme. Dhe në përfundim rrezulton, bazuar në dokumentacionet faktike, nuk kanë kompani nënkontraktuese. Gjatë hetimit të thelluar, u kryen inspektime nga ana e Grupit të Punës në bashkëpunim me ARRSH-në, në vendin ku po kryente punime secila prej ndërmarrjeve, në të 3 (tre) lotet nën hetim si më poshtë vijon:

Më datë 01.04.2015, u krye inspektim në kantierin e ndërtimit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gener 2” SHPK, në prezencë edhe të përfaqësuesit të ARRSH-së. Gjatë inspektimit u mbajt procesverbal i datës 01.04.2015 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.

Më datë 01.04.2015, u krye inspektim në kantierin e ndërtimit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gjoka Konstruksion” SH.A dhe “Gjiguria” shpk, në prezencë edhe të përfaqësuesit të ARRSH-së. Gjatë inspektimit u mbajt procesverbal i datës 01.04.2015 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.

Gjithashtu, më datë 01.04.2015, nga Grupi i Punës u krye inspektim në kantierin e ndërtimit të bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Albavia& Favina dhe Alpin SRL (JV)”, por në kantier nuk gjendej asnjë prej përfaqësuesve të ndërmarrjeve.

Nga inspektimet në terren dhe analiza e dokumentacionit të paraqitur vlerësua nëse kompanitë, për kryerjen e punimeve sipas kontratave, janë bazuar në kapacitetet teknike të veta apo kanë nënkontraktuar kompani për punime të ndryshme. Dhe në përfundim rrezultoi se bazuar në dokumentacionet faktike nuk kanë kompani nënkontraktuese.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara nga ndërmarrjet ofertuese në procedurën e prokurimit nën hetim nuk konstatohen evidenca indirekte të komunikimit si: gabime të njëjta në hartimin e ofertës, preventive të njëjta të ofertës, numra serial/protokolli të njëjtë ose të njëpasnjëshëm etj. Por, konstatohet se Autoriteti Rrugor Shqiptar me mënyrën se si ka prokuruar apo ndare fondin limit për cdo lot, ka ndarë tregun gjeografik të prokurimit, si edhe ka përcaktuar paradhenien për kompanitë fituese ka krijuar kushte për kufizim të konkurrencës.

Si rezultat i analizave të kryera dhe evidencave të paraqitura Komisioni arrin në përfundimin se pavarësisht shenjave rotacionit dhe afërsisë së ofertave fituese me fondin limit, nga inspektimet shqyrtimi i dokumentacionit dhe inspektimet e kryera nuk gjenden elementë të cilët vërtetojnë marrëveshjen ndërmjet kompanive fituese dhe konkurrese në zbatim të praktikave dhe të eksperiencave për zbulimin marrëveshjeve midis ndërmarrjeve të përfshira në prokurimet publike të aplikuar edhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

Por për vlerësimin e sjelljes sipas metodologjisë së OECD për marrëveshjet në oferta dhe eksperiencat më të mira përveç shenjave të rotacionit të fituesve dhe afërsisë me fondin limit janë vlerësuar faktorët shtesë si të domosdoshëm për provimin e koordinimit të sjelljes në manipulimin e ofertave si shenjat e komunikimit mes ndërmarrjeve dhe nënkontraktimeve të shoqërive të shpallura fituese të njëjtat shoqëri apo të shoqëri të lidhura.

Procesi i hartimit, harmonizimit dhe bashkëveprimit të procedurave të prokurimit publik mes autoritetit kontraktor dhe ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedura është kombinim i shumë faktorve të cilat jo të gjitha janë objekt dhe mund të trajtohen nga Ligji i konkurrencës, si dhe Autoriteti i Konkurrencës. Procesi i prokurimeve publike

mund të ketë patur si pasojë deformime në formën e konkurrencës së padrejtë, e cila mund të shkaktohet edhe nga sjelljet njerëzore që tejkalon parashikimet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” por që rregullohet nga legjislacioni i prokurimeve publike dhe zbatimi me korrektesë i legjislacionit në draftimin e kritereve dhe pranimin e dokumentacionit nga autoriteti prokurues dhe sjelljes njerëzore të personave zyrtarë të ngarkuar me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e prokurimeve.

Për këto arsye KLSH ka bërë kallëzim penal ndaj personave të ngarkuara me procedurat e prokurimit publik të këtij rasti. Me qëllim, që të siguroheshim për evidenca të cilat mund të vërtetojnë sjelljen ndërmjet operatoreve pjesëmarrës në tender, nga ana Autoritetit të Konkurrencës është kërkuar informacion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me anë të shkresës nr. 1285/6, datë 31.03.2015, për të cilën afati për përgjigje është data 20 Prill 2015.

Gjithashtu nga verifikimet e Autoritetit të Konkurrencës për lotin e tretë konstatojmë që ARRSH nuk ka kërkuar dokumentacionin ekonomik dhe financiar për të dy operatorët e bashkimit Gjoka shpk & Gjiguria shpk si dhe mungon informacioni në lidhje me xhiron e tre viteve të fundit për Gjiguria shpk, si edhe pasqyrat financiare të viti 2009 për Gjiguria shpk megjithëse janë nënshkruar kontratat nga ARRSH.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe inspektimet e kryera gjatë procedurave të hetimit paraprak në mënyrë të njëkohshme dhe të befasishme të gjitha ndërmarrjet nën hetim si dhe nga verifikimet në terren në procedurën e hetimit të thelluar nuk gjenden elementë të cilët vërtetojnë marrëveshjen ndërmjet kompanive fituese dhe konkurruese, por është sjellja e Autoritetit Kontraktor ajo që e ka bërë procesin dyshues për manipulime të mundshme të procedurave të prokurimit, dyshime për të cilat ka nisur procedimi nga prokuroria e rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

#### **V E N D O S I:**

- V. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” ndaj ndërmarrjeve: “Gener 2” Sh.p.k; “Albavia” Sh.p.k; “Gjoka Konstruksion” SH.A; bashkimit të shoqërive Albavia, Favina dhe Alpin Srl (JV) si dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gjoka Konstruksion& Gjiguria” dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Albavia&Favina&Alpin Srl (JV)”.

- VI. T’i rekomandojë Autoritetit Rrugor Shqiptar:
- a- në ndarjen e loteve të mos krijohet mundësi për ndarje tregu sipas vëllimit të punimeve ndërmjet konkurrentëve dhe ndarje tregu gjeografik;
  - b- Të kryhet vlerësimi i plotë i kriterëve ekonomike dhe financiare për të gjithë pjesëmarrësit apo bashkimet e kompanive pjesëmarrëse me qëllim që të sigurohet trajtim i barabartë dhe jodiskriminues ndërmjet pjesëmarrësve në procedura;
  - c- Të shmangen format e paradhënies dhe vlerësimit preferencial ndaj ndërmarrjeve të ndryshme të cilat kufizojnë konkurrencën.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**

### **Mendimi i pakicës- Argumentimi i Votës Kundër**

Qendrimi ndaj Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt:”Ndërtim I Rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, Pjesa verilindore(segmenti kthesa e Saukut-Bregu I Lumit) Loti 1, Loti2, Loti 3 dhe Draf Vendimi “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg”.

Si në Raport ashtu dhe në draft Vendim thuhet se ky prokurim publik është karakterizuar midis të tjerash nga dy elementë, afërsia e ofertës fituese me fondin limit dhe Ofertat me Rotacion:

#### **1) Afërsia me fondin limit:**

Në Lotin e I-rë fitues Gener me 99.82 % të fondit limit

Në Lotin e II-të fitues bashkimi i operatorve Albavia & Favina & Alpin, me ofertë fituese 99.87 % e fondit limit

Në Lotin e III-të fitues bashkimi i operatorve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria me vlerë oferte fituese 99.91 % e fondit limit

II-Ofertat me Rotacion -shih faqe 5 të draft Vendimit dhe Raportin.

Në fakt këto dy elementë janë pjesë të zbardhura të shkresës së Kontrollit të Shtetit datë 01.08.2014 drejtuar Autoritetit të Konkurrencës.

Pra nga AK nuk ka vlerë të shtuar por vetëm se këto elementë konfirmohen dhe nga Sekretariati apo grupi hetimor, që ka hartuar Raportin.

- 2) Se dyti Jam dakort dhe ndaj të njëjtin qëndrim lidhur me Metodën baze të hetimit nga ana e Grupit të punës, pra me Udhëzimin”Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurime Publike”pra Metodologjinë që aplikon OECD apo Banka Botërore.
- 3) Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me hartuesit e draft Vendimit në faqen 6-7 dhe për rrjedhojë dhe në pjesën Vendosi. Pra nuk ndaj të njëjtim qëndrim dhe nuk jam dakort me veprimtarinë e grupit të punës për zbulimin e asaj se në se gjatë këtij prokurimi kemi manipulim në oferta- shmangie të konkurrencën në këtë tender, në këtë prokurim publik apo jo ? Lexova me kujdes hartuesit e Raportit por dhe vleresimet nga Sekretariati lidhur me këtë veprimtari dhe konkluzion të grupit të punës. E pashë që kemi konkluzione të ndryshme. Iu riktheva edhe disa here Raportit por megjithatë nuk ndaj të njëjtin qëndrim për arsyet e mëposhtme:

Metodologjia e Manipulimit në Oferta, në Prokurimet Publike e OECD dhe Bankës Botërore është e qartë. Ajo thotë se mekanizmi për të shmangur konkurrencën, në këto tregje, pra mekanizmi për të arritur një afërsi sa më të madhe gati të njëjtë me fondin Limit , pra afërsia me fondin limit konsiston në këto element

Së pari **Rotacionin në Oferta.** (kjo ishte dhe është e gjithë pranuar nga të gjithë, para dhe pas hetimit)

Së dyti :**Shuarje e ofertës.** Një ose më shumë konkurrues janë dakort të shmangen të tërhiqen, më parë se të shpallet tenderi kështu që kompania tjetër mund të fitojë tenderin.

Së treti **Ofertat Plotësuese** Kompanitë konkurruese janë dakort me atë se kush mund ta fitojë tenderin dhe për rrjedhojë nënshkruan një Ofertë Artificaliale për të krijuar aparancën e një konkurrence të fortë.

Cfarë ka ndodhur dhe cfarë nuk ka analizuar grupi i punës në përputhje me kërkesat e kësaj metodologjie ?

Në Tenderin për Lotin e Parë kemi pjesëmarrjen e tre ndërmarrjeve në tender, a) të Gener, b) të bashkimi i operatorve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria c) Ndërmarrjes Albavia.

Kjo e fundit nuk plotësonte kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të Dokumentave Standarte për Proçedurën e Prokurimit Publik-me gjithatë ka marrë pjesë në tender për të krijuar përshtypjen se këtu kemi konkurrence të fortë. Nuk ka rëndesi se skualifikohej ose jo , ajo në çdo rast ishte e vetedijshme se nuk plotësonte kushtet e Tenderit. (Grupi i punës dhe draft vendimi duhej ta evidentonin dhe evidentojnë këtë fakt)

E njehta gjë ndodh në tenderitn e Lotit III. Në fakt marrin pjesë në tender vetëm dy operatorë. Operatori Fitues bashkimi i operatorve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria dhe ndërmarrjes Albavia. E cila dhe në këtë rast skualifikohej dhe e dinte se skualifikohej.

Pra ëer gjykimin tim ndërmarrja Albavia ka zbatuar mekanizmin e manipulimit në oferta, duke krijuar, dukjenartificaliale sikur në këtë treg ka konkurrencë. Por si në rastin e Lotit të parë dhe të Lotit të tretë ka marrë pjesë artificialisht në këtë tender për të krijuar përshtypjen se në këtë treg ka konkurrencë...

Po kështu në tenderin e lotit të dytë, ndërmarrja Gener ka zbatuar mekanizmin e Shuarjes së ofertës. Ajo duke fituar tenderit në Lotin e Parë ishte në dijeni të kushteve që duhet të plotësonte gjatë pjesëmarrjes ne Tender . Sipas proçesverbaleve është skualifikuar se nuk ka plotësuar të gjitha kushtet e sigurimit të ofertes në masën 2 % të fondit limit etj.

Po kështu realizimi i kerkeses se mjeteve me qira ose në pronesi. Vetëm evidentimi i saktë se kush e I ka në pronesi(cilat mjete) dhe cilat me qira) ? Ky ndryshim ka efekte në preventive jne masë shumë më të madhe se sa ndryshimi ne ofertat ose nga fondi limit maksimumi prej 19 mijë për mijë.

Pra në këtë treg, gjatë zhvillimit të tenderit të prokurimit publik, nuk janë zbatuar rregullat e konkurrences në tender, si rezultat i zbatimit të mekanizmave të

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

mirënjohur të manipulimit në oferta. Është shmatur konkurrenca si rezultat i veprimtarive të ndërmarrjeve të mësipërme (Albavia dhe Gener )

Për rrjedhojë unë nuk jam dakort as me Raportin, as me draft vendimin e prezantuar dhe e jap votën kundër

Komisioner

Koço Broka datë 16.04.2015



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 359 , datë 04.05.2015**

**“Për disa rekomandime në lidhje me marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve “**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

• Lindita MILO (LATI)	Kryetar
• Servete GRUDA	Anëtar
• Koço BROKA	Anëtar
• Iva ZAJMI	Anëtar
• Eduart YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.05.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka dhe Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të monitorimit për marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G; në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( i ndryshuar);

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), si dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit për marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G, si dhe relacionin shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

**VËREN SE:**

1. Koncesionari Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G. ka paraqitur më



- 07.12.2010 një propozim të pa-kërkuar në lidhje me koncesionin e shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve;
2. Me Vendim nr. 609, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore për dhënien me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë është Ministria e Financave. Gjithashtu po me këtë vendim, është miratuar dhënia e bonusit prej 6 % të pikëve për rezultatin, teknik e financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pa-kërkuar), shoqërisë “Global Fluids International”, SA (GFI), për dhënien me koncesion të këtij shërbimi;
  3. Me Vendimin nr. 200, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G., është miratuar kontrata e koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve.
  4. Kohëzgjatja e Koncesionit është 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga data efektive.
  5. Para nënshkrimit të marrëveshjes koncensionare apo gjatë procedurës për dhënien e koncesionit, nuk është respektuar nga Ministria e Financave detyrimi që përcaktohet në nenin 2/1c dhe 69/1/b të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për të marrë vlerësimin e Autoritetit në rastet kur vendosen të drejta ekskluzive apo të veçanta.
  6. Çështja është shqyrtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, pas ankesës së depozituar nga Shoqata e Shoqërive të Hidrokarbureve, me objekt: “Shfuqizimi si i papajftueshëm me Kushtetutën i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.03.2013, *“Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G.* Gjykata Kushtetuese ka vendosur rrëzimin e kërkesës së depozituar;
  7. Nga vlerësimi i marrëveshjes koncensionare është arritur në konkluzionet e mëposhtme:
    - a) Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) në nenin 2, pika 1 germa c, zbatohet edhe *“për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta”*. Neni 69 i Ligjit parashikon *“detyrimet për organet qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt që ka të bëjë ndër të tjera me (a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin dhe*

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

*(b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara”.*

Ministria e Financave nuk ka kërkuar paraprakisht mendimin e Autoritetit për këtë kontratë koncesionare, për kryerjen e vlerësimit *ex-ante* të saj në respektim të detyrimit ligjor (neni 69).

- b) Kontrata përmban klauzolë ekskluziviteti, dhe konkretisht në nenin 7, pika 7.1, (iv) “*Të drejtat e Konçesionit do të jenë ekskluzive dhe Konçesionari do të ketë të drejtën e vetme dhe ekskluzive të ushtrijë të drejtat e Konçesionit të dhëna sipas kësaj Kontrate*”.
- c) Sipas Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, palët e interesit, Shoqata e Hidrokarbureve, ndër të tjera është ankuar se është cenuar konkurrenca nëpërmjet vendosjes së një situatë monopol në treg, është cenuar liria ekonomike, si dhe janë shkelur marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Autoriteti i Konkurrencës në këtë proces është shprehur se nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke mos marrë mendimin e Autoritetit para dhënies së kësaj të drejte ekskluzive, si dhe se Autoriteti i Konkurrencës do të kryejë hetime *ex-post* në rastet kur vihen re shkelje të mundshme me pozitën dominuese në tregun në fjalë.
- d) Nga vlerësimi *ex-post* rezulton që ky shërbim është me vlerë të shtuar. Bazuar në dokumentacionin<sup>11</sup> e depozituar nga koncesionari konstatohet se nga kontrolli i 1250 pikave të shitjes së karburantit, 12% e pikave tregëtonin karburante të përzierja (deri në 100% përzierje).

### PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### VENDOSI:

- I. T’i rekomandohet Autoritetit Kontraktor:
  - a. Të kërkojë zbatimin me përpikmëri të marrëveshjes koncesionare për markimin dhe monitorimin e karburantit të importuar dhe prodhimit vëndas, si dhe të naftës bruto.
  - b. Brenda një kohe të përshtatshme të realizojë analizën e plotë *ex-post* të rezultateve gjatë fazës së parë të monitorimit deri në fund të vitit 2014.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe njoftimin e vendimit Ministrisë së Financave.

<sup>11</sup> Shkresën nr 10/01/1, datë 29.01.2015 të Shoqërisë GFI Albania për Autoritetin të Konkurrencës; Shkresa e datës 13.10.2014, me nr prot 122/10 e GFI Albania drejtuar Ministrisë së Financave dhe për dijeni Kryeministrit si dhe Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes “Monitorimi i tregut të karburanteve në Shqipëri: Parandalimi i humbjes së miliona dollarëve” me

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

**Iva Zajmi**

**Eduart Ypi**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**nr. 360, datë 04 .05.2015**

**“Për  
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me  
shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës”**

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e :

- |   |         |             |         |
|---|---------|-------------|---------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Servete | GRUDA       | Anëtar  |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar  |
| • | Iva     | ZAJMI       | Anëtar  |
| • | Eduard  | YPI         | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 04.05.2015, pjesëmarrjen eZnj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Monitorimi i tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës (GLN)

**Baza ligjore:** Nenet 24, (shkronja d), 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit të Grupit të Punës mbi monitorimin e tregut të importit dhe tregut të shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

**VËREN SE :**

8. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar(këtu e në vijim Ligji), ka realizuar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të GLN-së dhe në tregjet e lidhur me të, disa procedura hetimore ku përmendim: hetimin e thelluar në bazë të Vendimit nr. 147, datë 23.06.2010 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të GLN-së”, Vendimit nr. 201,

datë 20.09.2011 dhe vendimit nr. 277, datë 03.04.2013, në të njëjtin treg përkatës. Referuar problematikave të hasura në këtë treg gjatë realizimit të procedurave hetimore në periudhën 2010-2013 dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka monitoruar dhe analizuar kushtet e tregut të importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

9. Tregu përkatës i produktit është **tregu i importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së** dhe analiza e konkurrencës është fokusuar në përcaktimin e strukturës së tregut të importit e shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së dhe sjelljen ndaj çmimit, sipas ndërmarrjeve importuese, atyre të shitjes me shumicë dhe pakicë që operojnë në Republikën e Shqipërisë.
10. Në përfundim të përpunimit të të dhënave të administruara nga ndërmarrjet, monitorimit në terren, evidentimin dhe vlerësimin e shqetësimeve të tregut gjatë periudhës 2012-2014, u arrit në përfundimin se tregu i importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së paraqet karakteristikat e një tregu me përqendrim të lartë, ku ndërmarrja A&V Gas SH.A zotëron rreth 58% të tregut për vitin 2014 dhe ndërmarrja më e afërt me të, Kevin Gas SH.A, ka rreth 18% të tij. Ndërmarrja A&V Gas SH.A ka një pozitë dominuese të konsoliduar për një periudhë kohe prej 4 vitesh në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së.
11. Nga monitorimi rezulton se mund të jemi përballë kufizimeve të konkurrencës, ku është konstatuar që ndërmarrja me pozitë dominuese ka shitur në dy periudha afatshkurtra me çmime më të ulëta se kosto mesatare totale (ATC), si edhe dy ndërmarrjet Prima Gas SHA dhe Mare Oil SHA konkurrense të ndërmarrjes me pozitë dominuese kanë dalë nga tregu i importit dhe shitjes me shumicë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

#### **V E N D O S I:**

- I.** Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë e pakicë të GLN-së.
- II.** Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore 2012-Prill 2015;
- III.** Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij Vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtare**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtare**

**Eduard YPI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 362 , datë 14.05.2015**

**Për**  
**mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.05.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.  
Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve” dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

**I. PROCEDURA**

1. Bazuar në konkluzionet e monitorimit të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 3, pika 4, neni 4, neni 24, si dhe neni 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (të ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me VKK nr. 344, datë 02.02.2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes

me shumicë të vezëve”, miratoi hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga 01 Janar – 31 Dhjetor 2014.

2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës, si dhe ka zhvilluar takime me përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave (MBZHRAU) dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
3. Në bazë të nenit 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 8/1, datë 02.02.2015 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

## **II. NDËRMARRJET NËN HETIM**

4. Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 344, datë 02.02.2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”, ndërmarrjet nën hetim të cilat operojnë në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve janë:
  - Ndërmarrja “REA’S” sh.p.k, me NIPT K21501503T, me seli në: Xhafzotaj, Durrës.
  - Ndërmarrja “A.I.B.A. KOMPANI” SH.A, me NIPT J61818528J, me seli në: Shkozet, Durrës, Lagja 14, Rr. Tirana.
  - Ndërmarrja “OVVITAL” sh.p.k, me NIPT K02023501G, me seli në: Durrës, Fshati Kulle, Sukth.
  - Ndërmarrja “PULARI KORÇA” sh.p.k, me NIPT K74118005U, me seli në: Korçë, Rruga: Korçë - Drenovë, KM I.
  - Ndërmarrja “VEZA E MËNGJESIT” sh.p.k me NIPT K02701023J, me seli në: Berat - Otlak, në Rrugën Nacionale.
  - Ndërmarrja “BEATA” sh.p.k, me NIPT L41617003G, me seli në: Shkodër-Koplik, Lagjja “Bregu i Liqenit”, Rruga: “Përroi i Thate”.
  - Ndërmarrja “ALBA-Company” sh.p.k , me NIPT K57524701H, me seli në: Shkodër, Kastrat BAJZE, Rruga Nacionale Shkodër-Hani Hotit, km 25, zona kadastrale 1010, nr. pasurie 850/2, Alijaj, Bajze, Koplik Malësi e Madhe.
  - Ndërmarrja “ATLIU-FARM” sh.p.k, me NIPT L26318702V, me seli në: Tomin, Pilafe, Kuben, Dibër.
  - Ndërmarrja “OVOFARM” sh.p.k, me NIPT L42423016R, me seli në: Tiranë-Kashar-YZBERISH, Ndërtesë njëkatëshe tek ish Pularia Yzberisht.
  - Ndërmarrja “ALBZOO” sh.p.k, me NIPT L31715502U, me seli në: Durrës, Lagjja 14, Shkozet.
  - Ndërmarrja “HAJG” sh.p.k, me NIPT K01501501B, me seli në: Durrës, Komuna Xhafzotaj, Fshati Salmone.



- Ndërmarrja “A – K – KANINA” sh.p.k, me NIPT L06509202T, me seli në: Vlorë, Qendër - Vlorë, Kaninë, Godinë private, Fushë Kaninë.

### **III. TREGU PËRKATËS**

*Treg përkatës të produktit do të konsiderohen tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve të prodhuara në pularitë në vend. Treg Gjeografik do të konsiderohet Territori i Republikës së Shqipërisë.*

### **IV. VLERËSIMI I KUFIZIMEVE TË MUNDSHME NË TREG**

#### **IV.1. Inspektimet për ekzistencën e mundshme të një marrveshje të ndaluar**

5. Për te vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve ne tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve janë realizuar inspektimeve të befasishme të tipit “Dawn Raids” në ndërmarrjet kryesore që operojnë në këtë treg.
6. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte mes konkurrenteve, janë kryer analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjelljeje të mundshme të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes së produktit.

#### **IV.2. Analiza e strukturës së tregut përkatës në këndvështrimin e konkurrencës**

7. Tregu i prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve përbëhet nga rreth 20 ndërmarrje prodhuese të produktit vezë të cilët janë të vendosur në zona të ndryshme gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë.
8. Kosto më e madhe me të cilën përballen prodhuesit e vezëve është ushqimi i zogjve. Kjo përfaqëson rreth 60% të kostos së prodhimit në kushte normale.
  - Produkti nuk mund t’i përgjigjet lëvizjeve në ofertë për shkak të ndryshimeve të çmimit, pasi produkti karakterizohet nga një cikël prodhimi që zgjat rreth 4-5 muaj.
  - Produkti është delikat me një gjatësi të limituar për të marrë vlerat ushqyese, pra jetëgjatësia optimale e produktit është rreth 21 ditë.
  - Përfitimet nga prodhimi janë shumë të ndjeshme ndaj luhatjeve të çmimit të ushqimit, pasi zë rreth 60% të kostos së prodhimit në kushte normale.
9. Ndërmarrjet e prodhimit dhe shitjes me shumice të vezëve janë të lokalizuara në qytetet Durrës, ku është dhe pjesa më e madhe e tyre, në Shkodër, në Berat, Korçë, Dibër dhe Vlorë. Nga verifikimi i faturave të shitjes si dhe nga sa u konstatua dhe u pohua gjatë inspektimeve në ndërmarrje, ndërmarrjet konkurrojnë midis tyre në gjithë zonën gjeografike.
10. Në fillim të vitit, gjatë muajve janar – maj 2014, pularia më e madhe në vend (Floryhen) shpalli falimentimin duke krijuar një mungesë të konsiderueshme të produktit në treg. Gjithashtu po në këtë periudhë kishte pushuar së prodhuari edhe një prej ndërmarrjeve me fuqi të konsiderueshme në treg Elvisi Shpk ( e cila

ndryshoi aksionere dhe u fut në treg në muajin korrik 2014 si ndërmarrja Beata Shpk).

11. Për këtë arsye, gjatë muajve qershor – dhjetor 2014, në tregun e prodhimit të vezëve nga pularitë vendase u konstatua një mungesë e ndjeshme në sasinë e prodhuar. Kjo mungesë u reflektua në treg në mënyrë të menjehershme, pasi produkti vezë është specifik dhe nuk i përgjigjet dot kërkesës së tregut ne afatshkurtër . Kjo pasi ndërmarrjet prodhuese nuk kishin parashikuar një mungesë të tillë në prodhim. Gjatë kësaj periudhe të dyja ndërmarrjet rezultojnë të kenë aplikuar çmime të shitjes së produktit brenda vendit me vlerë më të vogël ose të barabartë me çmimin e eksportit.
12. Referuar indeksit të përqendrimit HHI, rezulton se ky treg ka një përqëndrim të lartë, megjithatë treguesit në lidhje me peshën e tre dhe katër (CR3 ;CR4) ndërmarrjeve prodhuese më të mëdha në treg shënojnë një vlerë mesatare për vitin 2014 ku tregohet se pesha e tre ose katër ndërmarrjeve të mëdha është rreth 65% të tregut. Megjithatë ky treg përbëhet nga një numër i madh ndërmarrjesh, por me peshë të vogël në treg.
13. Analiza e sjelljes se ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë gjatë periudhës objekt hetimi Janar –Dhjetor 2014. Në vlerësimin e trendit të ndryshimit të çmimit mesatar të shitjes me shumicë është marrë në konsideratë krahasimi i çmimit mesatar mujor të shitjes me shumicë të vezëve që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave të sjella nga ndërmarrjet.
14. Nga analizimi i çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet për sejcilën kategori produkti vërehet se këto ndërmarrje aplikojnë çmime të ndryshme nga njëra tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes
15. Gjithashtu nga analizimi i çmimeve mesatare ditore të ndërmarrjeve më të mëdha për periudhën Nëntor – Dhjetor 2014, vërehet se ritmet e rritjes dhe ndryshimit të çmimit nuk kanë trende të njëjta. Gjithashtu dhe çmimi i aplikuar nga ndërmarrjet për të njëjtën kategori produkti është i ndryshëm për periudha të njëjta.
16. Nga kjo analizë konkludohet se nuk ka asnjë sjellje të koordinuar të ndërmarrjeve në lidhje me caktimin e çmimit. Rritja e çmimit të produktit vezë ka ardhur si pasojë e mungesës së këtij produkti, si pasojë e daljes nga tregu e një prej ndërmarrjeve më të mëdha dhe më me peshë në treg sikurse ishte Floryhen ( pasi kjo ndërmarrje deri në muajin Qershor ishte aktive në treg duke përfunduar të gjithë ciklimin e zogjve të mbetur). Gjithashtu nga ana tjetër po në këtë periudhë kishte pushuar së prodhuari edhe Elvisi Shpk (e cila ndryshoi aksionere), si një prej ndërmarrjeve me ndikim të konsiderueshme në treg. Kësaj mungese të mallit iu shtua dhe vonesa e importit të zogjve, gjë që u evidentua dhe gjatë takimit me AKU, nga pohimet e kësaj të fundit, duke shtyrë në kohë ciklimin e zogjve, dhe duke krijuar automatikisht një vonesë në daljen e produktit përfundimtar.

17. Si konkluzion, nga inspektimet nuk rezultuan shenja të bashkëpunimit mes ndërmarrjeve nën hetim si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve dhe analizat ekonomike të çmimeve dhe ofertës nuk rezulton kufizim i mundshëm i konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**V E N D O S I:**

- I. Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, për periudhën nën hetim.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

**Iva Zajmi**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv.Kryetar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr.363, datë 14/05/2015**

**Mbi**

**refuzimin e kërkesës së ndërmarrjes “GEN-I Tirana” shpk për revokimin e Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/ Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.05.2015 me pjesëmarrjen e Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Kërkesa e ndërmarrjes “GEN-I Tirana” shpk për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 355, datë 20.03.2015, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, (gërma d), dhe neni 46.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “GEN-I Tirana” shpk për ndryshimin/revokimin e Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015, të Komisionit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

1.Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 355, datë 20.03.2015, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, ndaj ndërmarrjeve “GSA” SHPK, “EFT” shpk “Gen-I Tirana” shpk, “Gen-I Beograd” dhe “OSHEE” SHA.

2.Lidhur me këtë Vendim, pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka paraqitur kërkesë për ndryshimin/revokimin e tij, ndërmarrja “Gen-I Tirana” shpk, me anë të shkresës nr.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

238 prot., datë 07.05.2015, duke kërkuar mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar për ndërmarrjet GEN-I Tirana shpk dhe GEN-I d.o.o. Beograd dhe vazhdimin e këtij hetimi ndaj ndërmarrjeve OSHEE, EFT dhe GSA.

3.Kërkesa e ndërmarrjes “Gen-I Tirana” shpk, për ndryshimin/revokimin e Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015, nuk përmbush kriteret e parashikuara nga neni 46, “Revokimi i vendimeve”, i Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d, nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Refuzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Gen-I Tirana” shpk, për ndryshimin/revokimin e Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015, të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015, të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi shoqërisë “Gen-I Tirana” shpk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

( \_\_\_\_\_ )

**Zv/Kryetar**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 364, datë 27.05.2015**

**“Mbi**

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur JV nga ndërmarrjet Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |           |
|----------------------------|-----------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar   |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv/Kyetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar    |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar    |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar    |

Në mbledhjen e tij të datës 27.05.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur JV nga ndërmarrjet Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit “Magyar Telekom Nyrt / Met Holding AG”,

**V Ë R E N S E:**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes së aksionerëve” të datës 11 mars 2015 , e lidhur ndërmjet palëve: Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG (në cilësinë e ndërmarrjeve mëma), me objekt krijimin e një shoqërie të përbashkët të pavarur në formën e Joint Venture *full function*(JV).

Sipas marrëveshjes së aksionerëve, palët kanë rënë dakord që të themelojnë një ndërmarrje të përbashkët si një entitet me personalitet juridik të veçantë, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Më themelimin e shoqërisë së përbashkët JV, aksionet e saj do të zotërohen në mënyrë të barabartë nga mëmat.

Ky transaksion, i cili realizohet në formën e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët të pavarur nga ndërmarrjet mëma (Magyar Telekom dhe MET Holding) në kuptim të nenit 10, pika 3) të Ligjit, përbën një përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

## 2. Palët në transaksion

**Magyar Telekom Nyrt (“Magyar Telekom”)**, në cilësinë e shoqërisë **Mëmë** të **JV** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit hungarez, me seli në adresën: 1013 Budapest, Kristzina krt.55, Hungari. Ajo është një shoqëri lider në fushën e shërbimeve të telekomunikacioneve, e cila është e zotëruar në masën 59% nga Deutsche Telekom dhe pjesa tjetër e aksioneve tregtohet në Bursën e Budapestit. Magyar Telekom ofron shërbime të komunikimeve me linja fikse dhe mobile për klientët rezidencialë dhe klientët, biznese të vogla dhe të mesme, nën markën Telekom, si dhe shërbimeve kooperative për klientët që janë korporata nën markën T-Systems..

Shoqëria është pjesë e grupit të Deutsche Telekom dhe zotërohet 59% nga kjo e fundit. Deutsche Telekom është gjithashtu ndërmarrja mëmë e shoqërisë shqiptare AMC SH.A, me anë të së cilës ka realizuar xhiro në tregun shqiptar.

**MET Holding AG (“MET Holding”)**, në cilësinë e shoqërisë **Mëmë** të **JV**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Zvicerian, me seli në adresën: Baarestrasse 141, 6300 Zug., Switzerland. Shoqëria është aktive në disa tregje europiane në tregtimin, shitjen me shumicë dhe pakicë të gazit natyror, elektricitetit, naftës dhe produkteve të saj.

## 3. Xhiro për vitin 2014

**Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2014 është XXXX Lekë:**

- Xhiro e Deutsche Telekom Group<sup>12</sup> = XXX milionë Euro  $\approx$  XXXX Lekë<sup>13</sup>.
- Xhiro e MET Holding Group AG dhe degëve të tij = XXX Euro<sup>14</sup> = XXXX Lekë.

<sup>12</sup> Magyar Telekom është pjesë e Deutsche Telekom Group. Kursi mesatar për vitin 2014; 1 Euro = 139.97 ALL. Burimi Banka e Shqipërisë, (Raporti Statistikor, Janar 2015).

<sup>13</sup> INFORMACION KONFIDENCIAL.

<sup>14</sup> Burimi: Referuar pasqyrave financiare të MET Holding AG and Subsidiaries. Kursi mesatar vjetor për 2014 referuar Bankës së Shqipërisë (Raporti Statistikor, Janar 2015): 1 Euro = 139.97 ALL.  
INFORMACIONI NE LIDHJE ME XHIRON KLASIFIKOHET SI KONFIDENCIAL INFORMACIONI NE LIDHJE ME XHIRON KLASIFIKOHET SI KONFIDENCIAL.

Në Shqipëri, grupi Deutsche Telekom është prezent nëpërmjet filialit të saj *Albanian Mobile Communication Sha (AMC)*. Ndërkohë, grupi MET Holding nuk është prezent në tregun e brendshëm.

Për vitin 2014, xhiro e Albanian Mobile Communication Sha (AMC) në Shqipëri është XXX Lekë<sup>15</sup>.

Pra, xhiro e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun e brendshëm për vitin 2014, përbëhet vetëm nga xhiro e AMC dhe është XXXX Lekë.

#### **4. ANALIZA E KONKURENCËS**

##### **Tregu Përkatës:**

##### *A. Tregu përkatës i produktit:*

Referuar veprimtarisë ekonomike të palëve të përfshira në transaksion si dhe në përputhje me praktikën e përcaktimit të tregut të aplikuar nga KE, treg përkatës produkti do të konsideronim:

- Shpërndarjen (furnizimin) me pakicë dhe shumicë të gazit natyror;
- Shitjen me pakicë dhe shumicë të energjisë elektrike si dhe gjenerimin e energjisë elektrike.

##### *B. Tregu përkatës gjeografik:*

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar tregu i brendshëm.

#### **5. Vlerësimi i përqendrimit**

Ky përqendrim nuk sjell asnjë efekt në tregun shqiptar, pasi asnjë prej palëve pjesëmarrëse në këtë transaksion nuk është aktiv me aktivitetin e tyre ekonomik në tregun e brendshëm dhe për pasojë ky përqendrim nuk shkakton mbivendosje të aktivitetit të palëve në Shqipëri.

Duke pasur parasysh se në tregun e brendshëm, ndërmarrja Albanian Mobile Communication/ AMC (e cila është pjesë e grupit Deutsche Telekom, ku bën pjesë dhe Magyar Telekom), ushtron aktivitetin e saj në një tjetër treg përkatës produkti (tregun e telekomunikacionit), ky transaksion nuk pritet të sjellë asnjë efekt në tregun shqiptar.

**Nga vlerësimi i konkurrencës ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56/1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.**

---

<sup>15</sup> INFORMACIONI NE LIDHJE ME XHIRON E AMC NE TREGUN E BRENDSEM KLASIFIKOHET SI KONFIDENCIAL NGA PALA NJOFTUESE.



**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur JV nga ndërmarrjet Magyar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 365 , datë 4.06.2015**

**“Mbi**

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tranzit Sh.p.k të 100% të kapitalit aksionar të “Credit Agricole Albania Bank” SH.A, të zotëruara nga shoqëria “IUB Holding”**

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar;     |

Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Tranzit Sh.p.k të 100% të kapitalit aksionar të “Credit Agricole Albania Bank” Sh.a, të zotëruara nga shoqëria IUB Holding.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet, 10-12, dhe neni 16 dhe 17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Tranzit Sh.p.k / Credit Agricole Albania Bank SH.A / IUB Holding dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**V Ë R E N S E:**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Transaksioni i përqendrimit realizohet në bazë të “Marrëveshje për blerje aksionesh” e nënshkruar ndërmjet ndërmarrjeve Tranzit Sh.p.k (Blerësi) dhe IUB Holding (Shitësi), me objekt transferimin e pjesës prej 100% të kapitalit aksionar të ndërmarrjes Credit Agricole Albania Bank SH.A nga Shitësi tek Blerësi, më datë 12 Maj 2015.

Shitësi i shet me vullnet të lirë dhe të plotë Blerësit 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë. Në bazë të këtij transaksioni, Blerësi bëhet pronar i ligjshëm dhe me të drejta të plota mbi shoqërinë target “Credit Agricole Albania Bank” Sh.a.

Transaksioni, i cili realizohet në formën e përfimit të kontrollit të plotë dhe të vetëm ekskluziv, nga ndërmarrja Tranzit Sh.p.k mbi ndërmarrjen Credit Agricole Albania Bank SH.A, i cili sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në këtë të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit përbën një përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

## 2. Palët në transaksion

- ❖ **Tranzit Sh.p.k (“Tranzit”)**: në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Sky Tower, No. 7/2, Rr. Ibrahim Rugova, Tiranë. Objekti i shoqërisë është t’ju ofrojë kredi personave fizikë dhe juridikë; faktoringu, qiraja financiare (leasing), këshillimi dhe shërbime ndërmjetësimi. Veç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të lidhur drejtpërdrejtë ose indirekt, që vjen si pasojë ose që është e lidhur me veprimtarinë e mësipërme. Për të arritur qëllimet e mësipërme shoqëria mund të kryejë çdo transaksion si psh. tregtar, financiar, shërbime të mbledhjes së huave me vonesë, të pagesave në vonesë dhe /ose detyrimeve të tjera në vonesë të institucioneve të tjera me qëllim vlerësimin e vizibilitetit të portofoleve për t’u blerë nga shoqëria.
- ❖ **IUB Holding**: në cilësinë e **Shitësit**, është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në baze të legjislacionit francez, me seli në adresën: 12 place des Etats-Unis, 92127, Montrouge, Francë. Ajo është e zotëruar tërësisht nga Credit Agricole SA.
- ❖ **Credit Agricole Albania Bank SH.A**: në cilësinë e shoqërisë **Target** është një shoqëri e cila është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me seli në adresën: “Rr. Kavajës”, Nd. 27, H.1, Njësia Bashkiake Nr. 10, Kodi postar 1001, Tiranë. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: (i) të pranojë depozita të çdo lloji me ose pa interes; (ii) të ushtrojë aktivitetin kreditues duke përfshirë kredinë e konsumit, kredinë hipotekore, financimin e bizneseve dhe transaksioneve të ndryshme tregtare; (iii) të marrë hua, të blejë e të shesë për llogari të saj dhe

të klientëve instrumenta të tregut të parasë; (iv) të kryejë të gjitha format e pagesave në favor të klientëve sipas standardeve ndërkombëtare; (v) të emetojë letra me vlerë të çdo lloji dhe të kryejë të gjitha llojet e veprimeve me to.

### 3. Xhiro për vitin 2014

- a. Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar**<sup>16</sup> është XXXX Lekë:
- o **Credit Agricole Group** : XXX € = XXX Lekë
  - o **New Century Holding XI L.P** : XXX \$ = XXX Lekë
  - o **NCH Balkans Fund L.P**: XXX \$ = XXX Lekë

3.2 Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX Lekë:

- o **Credit Agricole Albania SH.A.** : XXXX Lekë
- o **Tranzit sh.p.k** : XXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin 12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

### 4. Analiza e konkurrencës

#### a. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- III). tregu përkatës i produktit, dhe
- IV). tregu përkatës gjeografik.

- **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet ofrimi i shërbimeve bankare për individë (retail banking) dhe korporata (corporate banking).

- **Tregu përkatës gjeografik:**

Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet **tregu i brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

#### 4.2 Struktura e tregut.

Spektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital të gjithin privat, dhe me mbizotërim të bankave të huaja me qendra në vendet e Bashkimit Europian.

<sup>16</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014, 1 euro=140 lek dhe 1\$=106 lek.

## 5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri. Shoqëria target dhe shoqëria blerëse ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregje të ndryshëm. “Tranzit” shpk është licencuar nga Banka e Shqipërisë si subjekt financiar jo-bankë (SFJB), ndërsa Credit Agricole Albania është licencuar si subjekt që operon në tregun bankar.

I vetmi segment i tregut financiar ku veprojnë si shoqëria “Tranzit” shpk ashtu dhe “Credit Agricole Albania” është kredidhënia. Për të parë peshën që do të ketë shoqëria Credit Agricole pas realizimit të këtij përqendrimit është analizuar si nëntregu i kredidhënies në vend ashtu edhe ai i aktiveve.

Referuar të dhënave të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013, totali i aktiveve për tregun financiar (tregun bankar dhe subjektet financiare jobanka) rezulton të jetë XXX Lekë. Shoqëria target zë XX të totalit të aktiveve në këtë treg, ndërsa shoqëria “Tranzit” ka zënë vetëm XX të tyre. Në total të dy shoqëritë përbëjnë vetëm XXX të aktiveve në tregun financiar vendas.

Në nëntregun e kredidhënies, për vitin 2013, totali i kredisë për tregun financiar në tërësi është XXX Lekë, nga të cilat Credit Agricole Albania përbën vetëm XXX të kësaj vlere dhe “Tranzit” shpk XXX të saj. Në total, këto dy subjekte kanë zënë vetëm XXX të kredisë së dhënë.

Sa më sipër, pesha e “Tranzit” shpk, referuar aktiveve dhe kredidhënies, zë një peshë të vogël në gjithë sistemin financiar në vendin tonë, duke ndikuar në mënyrë të papërfillshme tek fuqia që do të ketë Credit Agricole Albania në treg pas realizimit të këtij përqendrimit.

Për produktet e tjera të tregut përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

### VENDOSI:

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga shoqëria Tranzit Sh.p.k të 100% të kapitalit aksionar të “Credit Agricole Albania Bank” Sh.a të zotëruara nga shoqëria “IUB Holding”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(\_\_\_\_\_  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(\_\_\_\_\_  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(\_\_\_\_\_  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**  
**nr. 366, datë 4.06.2015**

**“Për**  
**detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për**  
**barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”**

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e

▪ <b>Lindita</b>	<b>MILO (LATI)</b>	<b>Kryetar</b>
▪ <b>Servete</b>	<b>GRUDA</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
▪ <b>Koço</b>	<b>BROKA</b>	<b>Anëtar</b>
▪ <b>Iva</b>	<b>ZAJMI</b>	<b>Anëtar</b>
▪ <b>Eduard</b>	<b>YPI</b>	<b>Anëtar</b>

Në mbledhjen e tij të datës 4.06.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare dhe Vendimit nr. 356, datë 31.03.2015 “Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

**Baza ligjore:** Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e telefonisë celulare ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionet e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për procedurë hetimore: nr. 26/3 prot., datë 03.03.2015, nr. 75/1 datë 11.5.2015, nr. 80 datë 15.05.2015, nr 82 prot datë 15.5.2015 dhe nr. 84 datë 19.05.2015.
- Këndvështrimet e ndërmarrjes Vodafone Albania lidhur me Vendimin nr. 356 datë 31.03.2015 dhe me “Raportin e hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”;
- Ankesën e shoqërisë Altelecom ndaj Vodafone me anë të shkresës Nr. 2440 Prot., (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 208 Prot., datë 20.04.2015);

- Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me vleresimin e ankeses se Albtelekom nr 91 prot, date 01.06.2015;

## **VËREN SE :**

### **I. ÇËSHTJA NË SHQYRTIM**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një ankesë nga Shoqëria “Plus Communication” SHA (këtu e në vijim Plus) kundër ndërmarrjes Vodafone Albania për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri. Ankimuesi pretendon se duke u mbështetur në provat e mbledhura nga Plus, Autoriteti i Konkurrencës mund të konstatojë se Vodafone ka operuar duke abuzuar me pozitën dominuese në treg edhe në periudhën 01.01.2013-31.12.2013, nëpërmjet një sjellje përjashtuese agresive me objektiv të qartë eliminimit e operatorëve të vegjël nga tregu, duke penguar në mënyrë indirekte e të pakthyeshme zhvillimin e konkurrencës në sektorin e telefonisë celulare dhe në veçanti, në tregun e pakicës. Si rrjedhim janë cënuar konsumatorët shqiptarë në një perspektivë afatgjatë.
2. Sipas ankesës, rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës në Vendimin nr. 303, datë 16.01.2014 nuk janë zbatuar si nga AKEP ashtu edhe nga ndërmarrja nën hetim Vodafone, pavarësisht angazhimit publik të saj për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Plus i kërkon AK të hetojë sjelljen e Vodafone, pasi konsideron se Vodafone ka shfrytëzuar pozitën e tij dominuese në treg, pra pjesën e tij të tregut, për të aplikuar strategjinë diferencuese të çmimeve brenda dhe jashtë rritit, e cila është një sjellje abuzuese me qëllimin e vetëm dëmtimin e operatorëve më të vegjël, në veçanti Plus, duke rezultuar për pasojë në një sjellje abuzive sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.
3. Gjithashtu, Shoqëria “Albtelecom” SH.A (Eagle Mobile për segmentin pjesën e ofrimit të shërbimit celular) ka paraqitur ankim kundër ndërmarrjes Vodafone Albania për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri. Sipas ndërmarrjes Albtelecom, bazuar në faktet dhe argumentimet ligjore të parashtruara, praktikat e ndjekura nga Vodafone Albania janë antikonkurrense dhe kanë si pasojë bllokimin e tregut të shërbimeve celulare në favor të Vodafone dhe si rrjedhim, Eagle Mobile nuk ka mundur dot të rrisë pjesën e tij të tregut dhe rrezikon të përjashtohet tërësisht nga ky treg.

### **II. PROCEDURA E NDJEKUR**

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 336, datë 11.11.2014, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone Albania SHA”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të



konkurrencës. Periudha e hetimit e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në vendimin e mësipërm është nga 01.01.2013 deri në 30.06.2014.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, Vendimit nr. 336, datë 11.11.2014 të Komisionit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit nr. 76, datë 17.11.2014 “Për ngritjen e grupit të punës për hetimin paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA”, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja nën hetim, Vodafone Albania SHA, me anë të shkresës nr. 497 prot., datë 18.11.2014 dhe nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Ndërmarrja Vodafone Albania SHA, dërgoi informacionin e kërkuar me anë të shkresës nr. 497/1 prot., datë 03.12.2014. Gjithashtu, shoqëria “Vodafone Albania SH.A me anë të shkresës së saj, me referencë LRD/0010/OX datë 29.01.2015, (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. prot. 65/1, datë 29.01.2015), ka paraqitur një shkresë “*Në vijim të hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë*”. Në të ajo përditëson minformacion zhvillimet më të fundit në tregun e telefonisë celulare, sepse gjykon se mund të ndihmojë Autoritetin e Konkurrencës në vendimmarrjen e pritshme.

4. Në përfundim ndërmarrja Vodafone Albania SHA, kërkon që në vijim të argumenteve dhe informacionit të paraqitur nëpërmjet shkresës së datës 3 Dhjetor 2014, si dhe informacionit të mësipërm, të veprohet nga ana e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të mbylljes së hetimit të filluar ndaj Vodafone Albania SHA.
5. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 14 të Rregullores së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës, sipas kërkesës së ndërmarrjes Plus Communication nr. 216/2 datë 15.05.2015, zhvilloi një seancë dëgjimore me ankimuesin Plus Communication në datën 02/06/2015. Përfaqësuesit e Plus u shprehen për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar dhe marrjen e vendimit të Komisionit për moszbatimin e Vendimit nr. 356 ‘Për masat e përkohshme ndaj shoqërisë Vodafone’.
6. Gjithashtu në drejtim të ndërmarrjes Vodafone ka ardhur një ankesë nga ana e shoqërisë Altelecom (Eagle Mobile për segmentin pjesën e ofrimit të shërbimit celular) me anë të shkresës nr. 2440 prot., (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 208 prot., datë 20.04.2015) për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri.
7. Sekretariati me autorizimin e Komisionit ka zhvilluar një seancë dëgjimore me datë 15.05.2015 me ankimuesin Altelecom dhe përfaqësuesit e Ankimuesit ju

përmbajtën pretendimeve të paraqitura me shkrim me anë të shkresës nr. 208 prot., datë 20.04.2015.

8. Me datë 19.05.2015, në ambientet e AKEP u zhvillua takimi me Drejtorin e Drejtorisë së Tregjeve pranë AKEP dhe specialistët e AKEP lidhur me problematikat e shfaqura në këtë treg e në mënyrë të posaçme ankesën ndaj Vodafone. Për këtë takim është mbajtur dhe procesverbali përkatës depozituar me nr. 89 prot të datës 29.05.2015
9. Meqënëse Autoriteti i Konkurrencës ishte në një procedure hetimore ndaj ndërmarrjes Vodafon Albania SHA, në zbatim të nenit 14 të Rregullores së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës, sipas kërkesës së ndërmarrjes Albtelecom nr. 208/3 datë 01.06.2015, Komisioni i Konkurrencës zhvilloi një seancë dëgjimore me ankimuesin Albtelekom në datën 03/06/2015.

### III. TREGU PËRKATËS

1. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit, tregu përkatës përbëhet nga “*produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionimit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese*”.
2. Në zbatim të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 76, datë 07.04.2008, ka miratuar Udhëzimin “Për tregun përkatës”, sipas të cilit tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik. Përcaktimi i tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, bëhet me qëllim që të identifikohen konkurrentët aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturën e tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg.

#### III.1 Tregu përkatës i produktit

3. *Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruar nga kompanitë celulare në tregun e shitjes me pakicë.*

#### III.2 Tregu përkatës gjeografik

4. *Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Zona gjeografike e shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive celulare me pakicë është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat këto kompani operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

### IV. VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

5. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në Nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës të

ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; barrierat e hyrjes në tregun përkatës; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; varësia ekonomike e furnizuesve dhe blerësve; fuqia kundërvepruese e blerësve konsumatorëve; zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve; lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera; karakteristika të tjera të tregut përkatës.


#### IV.1 Pjesët e tregut përkatës të konkurrentëve dhe shkalla e përqëndrimit

##### IV.1.1 Pjesët e tregut

6. Një nga kriteret bazë, nga e cila fillon analiza e pozitës dominuese është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Praktikantët më të mira të vendeve të Bashkimit Europian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrja zotëron një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit<sup>17</sup>. Pjesët e tregut përkatës janë llogaritur bazuar në disa tregues: sipas të ardhurave (të ardhurat e gjeneruara në tregun me pakicë; të ardhura në total) dhe sipas volumit (numri i pajtimtarëve sipas pajtimtarëve aktiv dhe Karta SIM, thirrje dalëse, SMS).

##### IV.1.1.1 Pjesët e tregut sipas të ardhurave retail

7. Sipas Udhëzimit të Tregut Përkatës, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07.04.2008, parashikohet se niveli i të ardhurave është kriteri bazë për llogaritjen e pjesëve të tregut. Llogaritja e pjesëve të tregut për nga të ardhurat e realizuara është tregues më i saktë dhe i rëndësishëm për një reflektim më të mirë të pozicionit dhe të fuqisë së çdo ndërmarrje në treg. Këto të ardhura në tregun përkatës, realizohen nga thirrjet dalëse, SMS, MMS dhe të ardhura të tjera të cilat pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm:



Grafiku 1. Mbi të ardhurat e realizuara në retail nga ndërmarrjet për vitet 2012-2013<sup>18</sup>

8. Sipas grafikut të mësipërm rezultojnë se ndërmarrja më e madhe e tregut për nga të ardhurat e realizuara në tregun përkatës është Vodafone me 51% të tregut në vitin 2013 dhe 50% në vitin 2012. Konkurrenti i përafërt me Vodafone, AMC rezultojnë me 32% pjesë tregu në vitin 2013 duke ulur pjesën e tregut në krahasim me vitin 2012 me 1%. Dy ndërmarrjet së bashku përfaqësojnë 83% në


<sup>17</sup> Komunikim nga Komisioni Udhëzimit mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant

<sup>18</sup> Burimi AKEP: Analiza Tregut telefonise Nentor 2014 fq 36 (vlere absolute) përpunuar nga AK (vlere relative)

vitin 2013 dhe 2 operatorët e vegjël së bashku janë në të njëjtën pjesë tregu krahasuar me vitin 2012 (Eagle është ulur dhe Plus është rritur në % të vogël).

#### IV.1.1.2 Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale të telefonisë celulare

9. Duke vlerësuar treguesit e të ardhurave të kompanive për periudhën 2013 - 6 muajori 1-rë 2014, rezulton se të ardhurat totale të telefonisë celulare në vitin 2013 janë ulur me 12% në krahasim me vitin 2012. Uljen më të madhe në vlerë relative e ka ndërmarrja Vodafone me 21,28%. Ndërmarrja Plus ka rritur të ardhurat me 18% në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012. Ndërmarrja AMC ka ulur të ardhurat krahasuar me vitin 2012 me 2% dhe ndërmarrja Eagle Mobile ka ulur të ardhurat me 3%.
  
10. Kompania me pjesë më të madhe tregu për vitin 2013 është Vodafone Albania me 50% e cila ka ulur pjesën e tregut krahasuar me vitin 2012 me 6% (në vitin 2012 ishte 55,98% në 50%<sup>19</sup> në vitin 2013). Ndërmarrja më e afërt është AMC<sup>20</sup> e cila ka rritur pjesën e tregut krahasuar me vitin 2012 me 3% duke shkuar në 33% në vitin 2013. Ndërmarrja Eagle Mobile dhe Plus kanë rritur lehtësisht pjesën e tregut krahasuar me vitin 2012, por përsëri të dyja së bashku përfaqsojnë 17%. Dinamika e pjesëve të tregut sipas të ardhurave në komunikimet elektronike paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Grafiku 2. Pjesët e tregut për nga të ardhurat totale për periudhën 2012-2013 për ndërmarrjet e telefonisë celulare<sup>21</sup>

#### IV.1.2 Pjesët e tregut sipas volumit

##### IV.1.2.1 Pjesët e tregut sipas thirrjeve dalëse


11. Duke vlerësuar kriterin sipas *thirrjeve dalëse* në tregun përkatës rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për 6 muajorin e parë të vitit 2014

<sup>19</sup> In Case C-62/86, AZKO Chemie BV vs. Commission (1991), the European Court of Justice considered that a market share of 50% could be considered to be very large such that, absent exceptional circumstances, an undertaking with such a market share should be presumed dominant.

<sup>20</sup> Burimi: AKEP Analiza Tregut Telefonise Nentor 2014 fq 40... Sipas AKEP ... [Në lidhje me të ardhurat, vlen të theksohet se pjesa e tregut e AMC në të ardhura totale dhe retail ka pasur rënie të ndjeshme në 3 vitet e fundit, për shkak të rënies së ndjeshme të të ardhurave nga komunikimet elektronike.

<sup>21</sup> Burimi: AKEP Analiza Tregut Telefonise, Nentor 2014 fq 36 (vlera absolute), përpunuar nga AK (vlera relative).


dhe vitin 2013 është **Vodafone me 50%**, me një ulje të pjesës së tregut krahasuar me vitin 2013 me 1%. Vodafone shfaq qëndrueshmëri të pjesëve të tregut që nga viti 2011. Ndërmarrja e dytë në treg është AMC me pjesë tregu 36% në 6 mujorin e parë të vitit 2014, e cila ul pjesën e tregut me 3% më pak krahasuar me vitin 2013 që ishte 39%. Ndërmarrja Albtelecom/Eagle ka pjesë tregu 10% në 6 mujorin e parë të vitit 2014, e cila ka rritur me 3% pjesën e tregut në krahasim me vitin paraardhës. Ndërmarrja Plus Communication zë 4% të pjesës së tregut nga thirrjet dalëse, në 6 mujorin e parë të vitit 2014, duke u rritur me 1%, sipas grafikut të mëposhtëm:



Grafiku 3. Pjesët e tregut nga thirrje dalese për periudhën 2013 - 6 mujori parë 2014<sup>22</sup>

#### IV.1.2.2 Pjesët e tregut sipas SMS

12. Duke vlerësuar kriterin sipas **SMS**<sup>23</sup> rezulton se: për periudhën 2013-6 mujori 1<sup>te</sup> 2014, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut është **Vodafone (viti 2014 - 72%, viti 2013 - 73%)**, pasuar nga shoqëria AMC me 22%, Eagle Mobile me 5% dhe Plus Communication me 1%.



Grafiku 4. Pjesët e tregut nga SMS në tregun përkatës 2013-6 mujori I<sup>te</sup> 2014

#### IV.1.2.3 Pjesët e tregut sipas numrit të përdoruesve

13. Sipas AKEP numri i përdoruesve celularë matet dhe raportohet në dy mënyra: sipas numrit të përdoruesve sipas kartave “SIM aktive” që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive në rrjetin celular në fund të periudhës së raportimit; dhe numrit të “përdoruesve aktivë” që janë përdorues të kartave SIM që kanë

<sup>22</sup> Burimi AKEP: Analiza Tregut telefonise Nentor 2014 fq 36 (vlere absolute) përpunuar nga AK (vlere relative)

<sup>23</sup> Burimi AKEP: Analiza Tregut t telefonise Nentor 2014 fq 36 (vlere absolute) përpunuar nga AK (vlere relative)

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit.

14. Nga tabela e mëposhtme në bazë të vlerësimit të pjesëve të tregut sipas kriterit të numrit të pajtimtarëve të “Sim aktive” dhe “përdoruesve aktiv” rezulton se:

*Tabela 1. Pjesët e tregut të operatoreve sipas kartave “SIM aktive”, dhe “përdoruesve aktivë” për vitet 2012- 6 mujori i 2014<sup>24</sup>*

Ecuria e numrit te pajtimtareve celulare 2010-6 mujori pare 2014													
N/r	Ndermarrjet	2012		M SH 2012		2013		M SH 2013		6/1 2014		M SH 6m 1 2014	
		Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive	Karta SIM	Aktive
1	VODAFONE	2,019,655	1,491,126	35.94%	42.15%	2,239,610	1,659,690	42.40%	45.03%	1,947,690	1,633,410	39.71%	47.03%
2	AMC	1,874,220	1,407,811	33.35%	39.80%	2,058,400	1,380,960	38.97%	37.47%	2,065,570	1,214,270	42.12%	34.96%
3	Eagle mobile	1,423,420	435,922	25.33%	12.32%	676,679	424,237	12.81%	11.51%	617,490	416,498	12.59%	11.99%
4	Plus	302,310	202,426	5.38%	5.72%	307,652	221,086	5.82%	6.00%	273,471	209,183	5.58%	6.02%
	<b>Totali</b>	<b>5,619,605</b>	<b>3,537,285</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>5,282,341</b>	<b>3,685,973</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>4,904,221</b>	<b>3,473,361</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>

15. **Numri i përdoruesve për kartat** “Sim aktive” në total është ulur nga 5,619,605 në vitin 2012, në 5,282,341 në vitin 2013 me një ulje 6%, ku Vodafone pësoi një rritje të numrit të përdoruesve të kartave SIM me 10,89% në vitin 2013 në krahasim me vitin 2012. Bazuar në numrin e pajtimtarëve për kartat SIM për vitin 2013, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu është Vodafone me 42.4%. Gjatë 6 mujorit të parë 2014, ndërmarrja Vodafone ka ulur pjesën e tregut me 6.3% krahasuar me vitin 2013 duke arritur në 39,71%. Ndërmarrja e dytë për vitin 2013 është AMC me 38.97% e cila ka rritur pjesën e tregut në krahasim me vitin 2012 me 9,8%. Edhe gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2014, AMC ka rritur pjesën e tregut me 8,1% duke shkuar në 42,12%. Rënie të numrit te pajtimtarëve (SIM), por dhe në pjesë tregu (krahasuar me vitin 2012 dhe vitin 2013) ka ndërmarrja Eagle Mobile.

16. **Numri i “përdoruesve aktivë”** në total për vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 është rritur me 4,2%. Rritjen më të madhe në këtë tregues e ka patur Vodafone me 11,3% dhe Plus me 9,2%, ndërsa AMC dhe Eagle kanë ulje të numrit të “përdoruesve aktivë”. Edhe në 6 mujorin e parë të vitit 2014 ndërmarrja Vodafone ka rritje të numrit të “përdoruesve aktivë” me 4,4%, ndërsa konkurrenti më i afërt AMC ka ulje në të njëjtën %. *Bazuar në numrin e pajtimtarëve aktivë për vitin 2013, ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu është Vodafone me 45%. Konkurrenti më i afërt për vitin 2013 është AMC me 37%. Për 6 mujorin e parë të vitit 2014, Vodafone zotëron 47% dhe AMC me 35%, ndërsa dy konkurrentët e vegjël përfaqsojnë 18% të tregut.*

17. Po të krahasojmë pjesët e tregut në bazë të të ardhurave me pjesët e tregut në bazë të numrit të përdoruesve rezulton sipas tabelës së mëposhtme:

<sup>24</sup>Burimi: AKEP Analiza Tregut Telefonise Nentor 2014 fq 29, përpunuar nga AK.

Tabela 2. Pjesa e tregut në bazë të ardhurave, përdoruesve dhe diferenca midis tyre për periudhën 2013-6 mujori I<sup>re</sup> 2014<sup>25</sup>

Kompanite	Pjesa tregut ne baze te ardhurave retail		Pjesa tregut ne baze te ardhurave totale		Pjesa tregut ne baze te perd aktive		Dif midis pjeses se tregut perd dhe te ardh		Dif midis pjeses se tregut perd dhe te ardh tot neto	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013	2012	2013
VODAFONE	50.00%	51.49%	55.98%	50.09%	42.15%	45.03%	-7.85%	-6.46%	-13.83%	-5.06%
AMC	32.80%	31.66%	29.31%	32.69%	39.80%	37.47%	7.00%	5.81%	10.49%	4.77%
Eagle mobile	12.34%	11.34%	10.34%	11.36%	12.32%	11.51%	-0.02%	0.17%	1.99%	0.15%
Plus comm	4.85%	5.51%	4.37%	5.86%	5.72%	6.00%	0.87%	0.49%	1.35%	0.14%

18. Tabela e mësipërme tregon një diferencë ndërmjet pjesës së tregut të të ardhurave në raport me pjesën e tregut të përcaktuar në bazë të përdoruesve aktivë, që tregon se duhet vlerësuar kriteri i pjesëve të tregut nga të ardhurat.

#### IV.2. Vlerësimi i fuqisë së tregut

19. Fuqia e tregut është fuqia për të patur ndikim mbi parametrat e konkurrencës në treg. Matës specifik i përqendrimit të tregut, domethënë i shkallës në të cilën një numër i vogël i firmave zënë një përqindje të madhe të tregut të produktit është Indeksi Herfindahl-Hirschman, (HHI-ja) i cili përdoret si një tregues i mundshëm i fuqisë së tregut ose i konkurrencës midis firmave<sup>26</sup>.

20. Vlerat e indeksit HHI për periudhën 2012-2013, i bazuar në pjesët e tregut për numrin e përdoruesve SIM dhe aktiv dhe të ardhurat në tregun përkatës dhe të ardhurat totale në tregun e telefonisë celulare, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3. Vlera e HHI për periudhën 2012- 2013<sup>27</sup>

Kompanite	HHI 2012					HHI 2013				
	AMC	Vodafone	Eagle	Plus	totali	AMC	Vodafone	Eagle	Plus	totali
ardhura tregu pakice	1,076	2,500	152	24	3,752	1,002	2,651	129	30	3,812
perdorues SIM	1,112	1,292	642	29	3,074	1,518	1,798	164	34	3,514
perdorues aktive	1,584	1,777	152	33	3,546	1,404	2,027	132	36	3,600
ardhura totale	859	3,134	107	19	4,119	1,069	2,509	129	34	3,741

21. Nga të dhënat e tabelës nga krahasimi i të dhënave të vitit 2013 me vitin 2012, vihet re një vlerë shumë e lartë e indeksit HHI ku: sipas të ardhurave të gjeneruara në tregun me pakicë është 3,812, duke u rritur lehtësisht krahasuar me vitin 2012 (3,752) dhe për numrin “përdoruesve aktivë” është 3,600, duke u rritur lehtësisht krahasuar me vitin 2012 (3,546). Edhe për përdoruesit e kartave ”Sim aktive” ky tregues është rritur nga 3074 në vitin 2012 në 3514 në vitin 2013. Operatori Vodafone e rrit shkallën e përqendrimit sipas tre treguesve duke plotësuar vetë ky operator shkallën e lartë të përqendrimit<sup>28</sup>, sipas treguesit të të

<sup>25</sup> Burimi: AKEP përpunuar nga AK

<sup>26</sup> Indeksi Herfindahl-Hirschmann (IHH) Ky indeks mat përqendrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e tregut në katror të të gjitha firmave të industries. Sa më i lartë të jetë IHH-ja për një treg të caktuar, aq më shumë është i përqendruar produkti i atij tregu në një numër të vogël firmash. Me fjalë më të përgjithshme, kur një IHH është më i vogël se 1 000, atëherë përqendrimi i tregut mund të konsiderohet si i ulët, kur është midis 1 000 dhe 1 800 mund të konsiderohet mesatarisht i përqendruar, ndërsa nëse është më i madh se 1 800 mund të konsiderohet si i lartë.

<sup>27</sup> Burimi: AKEP, përpunuar nga AK sipas pjesëve të tregut.

<sup>28</sup> 1800.

ardhurave në tregun me pakicë nga 2500 në 2651, sipas kartave ”Sim aktive” nga 1292 në 1798, sipas përdoruesve aktivë nga 1777 në 2027.

22. Treguesi i përqëndrimit nga të ardhurat totale ka rënë si rezultat i uljes së pjesës së tregut të Vodafone, (nga 56% në 50%), megjithatë edhe ky tregues është shumë i lartë, perseri kjo për faktin e rënies së të ardhurave nga shërbimi intekoneksionit ndërkombëtar. Në këtë shkallë përqëndrimi fuqia e dy operatorëve me të rinj, Eagle dhe Plus, është e pakonsiderueshme.
23. Vlerat e HHI për tregun me shumicë janë të njëjta me vlerat e HHI për tregun me pakicë të shërbimeve celulare si rezultat i mospjesëmarrjes së ofruesve të pavarur të shërbimeve nga MVNO, pasi rezultojnë të mos ketë të tilla, ndonëse me ligj mund të operohet në këtë treg. Në vendet e tjera përfshirja e MVNO ka çuar në zbutjen e këtij indeksi.
24. Përgjithësisht, në tregun e telefonisë celulare HHI është më e lartë se në tregjet e tjera, pasi në këtë lloj tregu operojnë një numër i kufizuar operatorësh. Në kushtet e madhësisë së tregut shqiptar, ku operojnë 4 ndërmarrje, ky tregues duhej të ishte shumë më i ulët.

### **IV.3 Pengesat në hyrjen në tregun përkatës**

25. Tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është i rregulluar. Institucioni i ngarkuar për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë është AKEP.
26. Me gjithë ndryshimet në legjislacion, aktualisht në tregun celular me pakicë nuk ka ende ofrues të pavarur shërbimesh apo MVNO. Ky fakt përben një tregues se tregu celular me pakicë vazhdon të ketë pengesa për hyrjen në treg të ofruesve të shërbimeve.
27. Pengesat në hyrje mund të jenë administrative, teknike dhe ekonomike.

#### **IV.3.1 Pengesat administrative dhe teknike**

28. Në Republikën e Shqipërisë numri i licencave për të ushtruar veprimtari në tregun e telefonisë celulare është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat. Aktualisht në treg janë dhënë të 4 (katër) licencat dhe nuk ka licenca të tjera në dispozicion. Kjo shpreh mjaft qartë faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barrierat hyrëse administrative.
29. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar, ndërkohë që Plani Kombëtar i Radiofrekuencave, ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave. Edhe me hapjen e plotë për konkurrencë të tregut të telekomunikacioneve që ndodhi më herët, disa shërbime do vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori ku numri i licencave është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat. Kjo shpreh mjaft qartë faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barrierat hyrëse teknike.



30. Fakti që Shqipërisë i është lënë një kuotë e caktuar bandash në kategori të ndryshme frekuencash nga ITU (International Telecommunication Union), të cilat e lejojnë në maksimumin e tyre licensimin e vetëm 4 ndërmarrjeve të telefonisë mobile, tregon se kemi të bëjmë me pengesa (barriera) teknike, të vendosura si rezultat i burimeve natyrore të kufizuara.

#### IV.3.2 Pengesat ekonomike

31. Së pari, kostot për hyrjen dhe daljen e një operatori në tregun e telefonisë së lëvizshme janë të konsiderueshme, sidomos ajo që konsiderohet kosto e pakthyeshme;
32. Së dyti, investimet fillestare për ndërtimin e rrjeteve të telefonisë celulare të operatorve që hyjnë në këtë treg, janë mjaft të mëdha. Për hyrësit e rinj siç janë Eagle Mobile dhe Plus Communication, këto investime për të hyrë fuqishëm në këtë treg janë më shumë të kushtueshme, pasi ato nuk mund të arrijnë në mënyrë të shpejtë shitjet dhe numrin e mjaftueshëm të pajtimtarëve;
33. Së treti, këto kosto janë të pakthyeshme, pasi pajisjet e përdorura për ndërtimin e rrjetjeve nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Kostot e pakthyeshme përbëjnë një kufizim për konkurruesit, dhe janë një barrierë e konsiderueshme ekonomike nëse ndërmarrja del nga tregu.
34. Ekonomitë e shkallës<sup>14</sup> mund t'i japin ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës avantazh mbi konkurrentët e vegjël. Kur një kompani celulare bën investime të mëdha për ndërtimin e rrjetit, si: stacionet; antenat; pas përfundimit të ndërtimit të të gjithë rrjetit, shtimi i çdo klienti të ri, çon në reduktimin e kostove mesatare të kësaj kompanie. Operatorët e rinj në këto tregje nuk mund të kenë një trafik të madh në krahasim me operatorët ekzistues, si rrjedhojë ata nuk perfitojnë nga ekonomitë e shkallës`
35. Në tregjet që janë mjaftueshëmrisht fitimprurëse ka prirje për të pasur hyrës të rinj në treg. Në këtë mënyrë, për vlerësimin e konkurrencës potenciale duhet të merren në konsideratë faktorë të tillë si barrierat e hyrjes, reagimet e mundshme të ndërmarrjes më të madhe në treg dhe konkurrentëve të tjerë, si dhe riskun dhe koston e falimentimit.
36. Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP kanë ndërhyrë për rritjen e konkurrencës në treg nëpërmjet zbatimit të ligjit të konkurrencës dhe nxjerrjes së akteve rregulluese të këtij tregu, megjithatë tregu përsëri ka një shkallë shumë të lartë përqëndrimi, sikurse është evidentuar më lart. Për arritjen e një niveli të pranueshëm konkurrence, operatorët e mëdhenj, por edhe operatorët e vegjël ekzistues, duhet të kërkojnë klientët e tyre, midis atyre që tashmë janë klientë të operatorëve të tjerë. Duke marrë në konsideratë indeksin e penetrimit<sup>29</sup> që është 187 %, sipas përdoruesve të kartave SIM, shifër kjo më e lartë se shumë vende të tjera, ky fenomen sjell vështirësi për operatorët e vegjël për të tërhequr klientë në rrjetet e tyre.

<sup>29</sup> Burimi: AKEP Analiza Telefonisë Celulare 2014 fq 29.....Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në 2013 ishte 130% sipas përdoruesve aktivë dhe 187% sipas kartave SIM. Norma e penetrimit në Shqipëri sipas përdoruesve aktive është sa niveli mesatar në vendet e BE në 2012.

37. Operatorët e vegjël për të qënë konkurrues duhet të përdorin çmime më të favorshme në krahasim me operatorët e mëdhenj të pranishëm në treg. Por, tërheqja e pajtimtarëve kryesisht ndër klientët ekzistues të operatorëve të tjerë, paraqet një pengesë për rritjen e aktorëve të pranishëm në treg.

#### IV.5 Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve

38. Kompanitë celulare rezultojnë kompani me xhiron vjetore më të lartë në Shqipëri. Te ardhurat e gjeneruara në telefoninë celulare për vitin 2013 janë 36.9 miliardë lekë, nga 42 miliarde leke në vitin 2012.
39. Bazuar në të dhënat mbi të ardhurat e çdo kompanie rezulton se të ardhurat për kompanitë celulare për vitin 2013, krahasuar me vitin 2012 janë ulur me 12%. Kompania Vodafone rezulton të ketë ulur të ardhurat në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 me 21,28%. Kompania Vodafone është kompania më e madhe në krahasim me tre konkurrentët e tjerë të marrë së bashku. Konkurrenti më i afërt i ndërmarrjes Vodafone, ndërmarrja AMC<sup>30</sup>, ka ulur të ardhurat në vite (40% në vitin 2010 në 33% në vitin 2013) dhe të ardhurat e Vodafone për vitin 2013 rezultojnë 1,5 herë më të larta se të AMC. Konkurrenti i tretë Eagle ka ulur të ardhurat në vite (që nga viti 2010 në rënie nga 5166 në vitin 2010 në 4199 në vitin 2013). Ndërmarrja Plus ka rritur të ardhurat, por përsëri ngelet në pjesë tregu të vogël për tu marrë në konsideratë (4,3% në vitin 2013).

Tabela 4. Të ardhurat e realizuara për vitin 2010-2013 (milionë lekë)<sup>31</sup>

Ndermarrjet	Te Ardhurat				Market Share			
	2010	2011	2012	2013	2010	2011	2012	2013
VODAFONE	20,165	20,347	23,520	18,515	48.13%	52.06%	55.98%	50.09%
AMC	16,552	13,124	12,315	12,086	39.51%	33.58%	29.31%	32.69%
Albtelecom mobile (EM)	5,166	4,865	4,342	4,199	12.33%	12.45%	10.34%	11.36%
Plus communication	10	751	1,835	2,167	0.02%	1.92%	4.37%	5.86%
<b>Totali</b>	<b>41,893</b>	<b>39,087</b>	<b>42,012</b>	<b>36,967</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>	<b>100.00%</b>
Ndermarrjet	Fitimi Neto				Fitim neto/te ardhura (%)			
	2010	2011	2012	2013	2010	2011	2012	2013
VODAFONE	5,877	4,199	5,019	3,293	29%	21%	21%	18%
AMC	6,250	4,069	3,047	4,124	38%	31%	25%	34%
Albtelecom mobile (EM)	-393	-1,043	-1,045	-1,048	-8%	-21%	-24%	-25%
Plus communication	-913	-2,079	-1,969	-1,263	-8%	-40%	-39%	-25%
<b>Totali</b>	<b>10,821</b>	<b>5,146</b>	<b>5,052</b>	<b>5,106</b>	<b>51%</b>	<b>-10%</b>	<b>-17%</b>	<b>2%</b>

40. Kompania Vodafone rezulton të ketë ulur rezultatin financiar në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 nga 21% në vitin 2012 në 18% në vitin 2013, ndërsa AMC për vitet 2010-2012 ka qënë në rënie, ndërsa për vitin 2013 rezulton të ketë rritur rezultatin financiar nga 25% në vitin 2012 në 34% në vitin 2013. Eagle dhe Plus janë me rezultat financiar negativ të konsiderueshëm 25%. Kompania Plus ndonëse ka rritje të të ardhurave në vite përsëri rezulton me fitim negativ të theksuar.

<sup>30</sup> Sipas AKEP, Analiza Tregut Telefonise, Nentor 2014 fq 37 ..[Treguesit e të ardhurave për AMC reflektojnë rënie të vazhdueshme periodike....ndërsa për Vodafone kemi rritje të të ardhurave totale nga 2010-2012 dhe rënie të ardhurave për 2013.... Ndersa treguesit financiar per dy operatorët e vegjël Albtelecom (EM) dhe Plus per periudhen kohore 2010-2013, pasqyrojne nje renie te vazhdueshme te te ardhurave totale per Albtelecom sh.a (EM) **duke u shoqeruar me fitim neto negativ, ndersa ne rastin e Plus edhe pse ka rritje te te ardhurave totale per secilin nga vitet, ne bilancin e kesaj kompanie shoqerohet me fitim neto negativ te konsiderueshem**].

<sup>31</sup> Burimi: AKEP Analiza Tregut telefonise Nentor 2014 fq 38, përpunuar nga AK.

#### IV.6 Fuqia kundërvepruese e konsumatorëve dhe blerësve (konkurrentëve)

41. Vetë struktura e tregut të Telefonisë Celulare me pakicë është e tillë, që përdoruesit që blejnë sasira të konsiderueshme shërbimi celular janë mjaft të pakët në numër. Vodafone me numrin më të madh të përdoruesve celularë zotëron përdorues me parapagesë<sup>32</sup> 93-95% të numrit të përgjithshëm të përdoruesve. Pjesa tjetër prej 5-7%, abonentët me kontratë, përdorin sasi më të mëdha të shërbimit të telefonisë celulare (me kontratë). Abonentët e shërbimit me parapagim gjithsesi janë përdorues të vegjël dhe nuk kanë fuqi kundërvepruese, ndërsa pjesa tjetër e abonentëve përbëjnë një numër të vogël (megjithatë pjesa më e madhe e këtyre të fundit janë persona fizikë). Në këto kushte është e qartë, që përdoruesit në tregun e telefonisë celulare me pakicë, nuk zotërojnë ndonjë fuqi kundërvepruese për t’u marrë në konsideratë.
42. Ndërmarrja Vodafone ka krijuar avantazhe në tregun e telefonisë celulare, nëpërmjet krijimit të rrjeteve të veta, klientëve përkatës (abonentët), eksperiencës në menaxhimin e tregut, emër nëpërmjet marketingut, si dhe fuqi të konsiderueshme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte, operatorëve të rinj do t’u duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme, për t’u bërë pjesë efektive e këtij tregu. Numri i abonentëve potencialë të mbetur në treg është relativisht i kufizuar.
43. Një tjetër përparësi për ndërmarrjet ekzistuese përbën edhe fakti që operatorët “Eagle” dhe “Plus” janë më të rinj dhe nuk kanë fuqi të madhe kundërvepruese. Gjithashtu, karakteristikë e rrjeteve të telekomunikacionit është se operatorët janë të integruar vertikalisht në tregjet e shumicës dhe të pakicës. Ky integrim përbën avantazh për operatorët ekzistues në krahasim me hyrësit e rinj.
44. Sa më sipër evidentohet që fuqia e tyre kundërvepruese e konkurrentëve të vegjël si Eagle dhe Plus është e pandjeshme.
45. Ndërmarrja Vodafone ka aktualisht një rrjet prej 139 pika shitje<sup>33</sup> në të gjithë vendin, të cilat ofrojnë shërbim çdo ditë të javës. Dyqanet Vodafone ofrojnë produkte dhe shërbime të kompanisë Vodafone, telefona celularë dhe aksesorë, si dhe asistencë teknike. Shërbimi i Kujdesit për Klientin i Vodafone Albania i përgjigjet nevojave të klientëve në 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

#### IV.7 Karakteristika të tjera të tregut përkatës

46. Vodafone Albania<sup>34</sup> SH.A. është pjesë e Vodafone Group Plc - kompani lider në botë në fushën e komunikimeve elektronike. Marka Vodafone renditet si marka e shtatë më e vlerësuar në botë. Vodafone është i pranishëm në më shumë se 30 vende të botës dhe është partner me rrjete të tjera në mbi 40 vende. Kjo ndërmarrje ka akses në tregjet e kapitalit dhe burimet financiare, për arsye se është pjesë e grupit ndërkombëtar lider në fushën e telekomunikacioneve. Vodafone është operatori i parë që prezantoi shërbimet e teknologjisë 3G në Shqipëri në Janar 2011. Tashmë Vodafone mbulon 99 % të popullsisë me sinjalin e rrjetit 3G.

<sup>32</sup> AKEP Analiza Tregut telefonise Nentor 2014, fq 30.

<sup>33</sup> Burimi: faqja internetit [http://ëëë.vodafone.al/vodafone/Vodafone\\_Albania\\_202\\_1.php](http://ëëë.vodafone.al/vodafone/Vodafone_Albania_202_1.php)

<sup>34</sup> Burimi: [http://ëëë.vodafone.al/vodafone/Vodafone\\_Albania\\_202\\_1.php](http://ëëë.vodafone.al/vodafone/Vodafone_Albania_202_1.php).

47. Vodafone ju ofron mbi 2 milion klientëve të saj në Shqipëri një gamë të gjerë shërbimesh komunikimi të një cilësie të lartë, duke përfshirë komunikimin zanor dhe të të dhënave duke siguruar që klientët të përdorin rrjetin më të mirë të komunikimeve elektronike dhe të përfitojnë nga shërbime novatore dhe cilësore.
48. *Nisur nga pjesët e tregut<sup>35</sup>, qëndrueshmërinë e pjesëve të tregut në vite, shkallën e përqëndrimit në të gjithë treguesit, pengesat e hyrjes në treg; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por dhe nga praktikat me të mira të së drejtës evropiane të konkurrencës, ndërmarrja Vodafone Albania ka pozitë dominuese në tregun e telefonisë celulare me pakicë për periudhën 2013 - 6 mujori I<sup>ri</sup> 2014.*

## V. ANALIZA E KONKURENCËS NË TREGUN PËRKATËS

49. Gjatë vitit 2013 Autoriteti i Konkurrencës realizoi një hetim të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA, si me pozitë dominuese, duke analizuar edhe kushtet e tregut për periudhën 01.01.2011 deri në 31.12.2012. Në përfundim të procedurës hetimore, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 303, datë 16.01.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA dhe rekomandime për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, vendosi t’i rekomandojë këtij të fundit sa vijon:
- 1) *Të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut, për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti:*
    - i. *Të modifikojë modelin BULRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës;*
    - ii. *Të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave off-net/on-net brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese.*
  - 2) *Të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për*

<sup>35</sup> Sipas të Drejtës së Konkurrencës të Bashkimit Evropian: zotërimi nga ndërmarrjet i pjesëve të konsiderueshme të tregut të produktit për një farë kohe, ka shumë të ngjarë që të jetë tregues i pozitës së tyre dominuese në treg, por vetëm ky tregues nuk mund ta provojë këtë pozitë. Rasti i vetëm, kur ky tregues konsiderohet i mjaftueshëm është kur ndërmarrjet zotërojnë 50% apo më shumë të tregut të produktit. Ky vlerësim, konfirmohet edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në Luksenburg (GJED) në çështjen nr. 85/76, datë 13.02.1979 Hofmann-La Roche, (paragrafi 39, 41): “Ekzistenca e Pozitës Dominuese mund të rrjedhë nga disa faktorë, të cilët, të marrë veç e veç, nuk janë domosdoshmërisht vendimmarrës, por ndërmjet këtyre faktorëve ekzistenca e një pjese të lartë të tregut është shumë e rëndësishme.

“... megjithëse madhësia e pjesëve të tregut ndryshon nga tregu në treg, me të vërtete mund të thuhet që pjesë të mëdha të tregut përbejnë në vetvete, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, prove të ekzistencës së një pozite dominuese. Ky interpretim i dhënë nga gjykata shërbeu si bazë edhe për përcaktimin e përqindjes së mjaftueshme së pjesës së tregut të një ndërmarrjeje për vlerësimin e pozitës dominuese të saj vetëm mbi bazën e këtij kriteri. Konkretisht në çështjen AKZO shprehimisht të trajtuar prej po kësaj gjykate (GJED), thuhet: “Në rast të zotërimit të një pjese tregu prej të paktën 50%, Pozita Dominuese mund të prezumohet. Në këtë rast barra e provës do të kalojë mbi ndërmarrjen që zotëron mbi 50% të tregut, e cila duhet të japë argumente për mohimin e prezumimit (që nuk zotëron 50% të tregut – shënimi ynë)”

*reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifat jashtë rrjetit të operatorit Vodafone.*

- 3) *Në rolin e rregullatorit të vëzhgojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fix, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimit real të kësaj difference jo vetëm në tarifat nominale (off-net, on-net), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore).*
50. AKEP me Vendimin nr. 2412, datë 16.01.2014, miratoi nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”. Periudha e këshillimit publik u zhvillua për një muaj më 16.01.2014-16.02.2014.
51. Nga dokumenti i analizës së kryer nga AKEP, rezulton se janë krahasuar tarifat mesatare të terminimit të 27 vendeve të BE, tarifat e BEREC, si dhe tarifat mesatare të terminimit të 13 vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër, ku ka rezultuar:
  - i. *Tarifa mesatare e 27 vendeve anëtare të BE në 1 Janar 2013 është 2.33 eurocent/minutë, ndërsa në 34 vendet e referuara nga BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit) tarifa mesatare e ponderuar është 1.90 eurocent/minutë;*
  - ii. *Tarifa mesatare e ponderuar në 34 vendet e referuara nga BEREC më 1.07.2013 është 1.46 eurocent/minutë apo 2.04 lek/minutë.*
  - iii. *Tarifat mesatare në 27 vendet e BE dhe 34 vendet e referuara nga BEREC kanë pasur ulje të konsiderueshme në 2013 në raport me 2012, dhe kjo për shkak të rritjes së numrit të vendeve me LRIC të pastër.*
  - iv. *Tarifa mesatare e terminimit e 13 vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër deri në fund të vitit 2013 është 1.055 eurocent/minutë, apo 1.48 lek/minute.*
52. Referuar analizës, AKEP-i gjykoi se mënyra më efikase dhe më e mirë do të ishte rishikimi i nivelit të tarifave të terminimit, duke iu referuar nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet që kanë aplikuar LRIC të pastër (vende anëtare të BE dhe të rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pika 2.
53. Në përcaktimin e tarifave për secilin operator, AKEP gjykon se është e nevojshme që krahas nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar tashmë LRIC të pastër, të marrë në konsideratë edhe kushtet aktuale dhe pritshmërinë për zhvillimin e tregut celular në Shqipëri, me qëllim realizimin e objektivave rregullatore për rritjen e konkurrencës efektive në këtë treg dhe realizimin e objektivit final të maksimizimit të përfitimeve të përdoruesve fundorë nga shërbimet celulare në Shqipëri.
54. Në përfundim të analizës, AKEP-i ka vendosur që:
  - i. *Tarifat e terminimit në rrjetet e të katër operatorëve të reduktohen gradualisht, duke aplikuar 2 faza të ndërmjetme 1.04.2014-31.03.2015 dhe 1.04.2015-31.12.2015, dhe një asimetri midis dy operatorëve të mëdhenj dhe dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj) deri më 31.12.2015.*

- ii. *Tarifat e terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë më 1.01.2016 të jenë në nivelin 1.48 lek/minutë, të njëjtë me mesataren në vendet e BE dhe rajonit që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013 (1.06 eurocent/minutë);*
55. Sipas AKEP-it, reduktimet e propozuara të tarifave të terminimit do të japin një impuls pozitiv në rritjen e mëtejshme të konkurrencës në tregun celular me pakicë në Shqipëri dhe eliminimin/reduktimin e stimujve për tarifa shumë të ulëta on-net, dhe rritjen e stimujve për paketa tariforesh me minuta kombëtare (drejt të gjitha rrjeteve celulare). Politika të tilla tariforesh pritet të kenë efekt pozitiv në treg dhe zgjedhja e përdoruesve të këtyre paketave do të zvogëlojë stimujt për paketat me tarifa shumë të ulëta brenda grupeve. Kjo mund të çojë edhe në reduktim të kartave SIM aktive në treg, pasi një pjesë e madhe e përdoruesve celularë kanë më shumë se një kartë SIM për të shfrytëzuar oferta me tarifa shumë të ulëta on-net (brenda grupeve). Rregullimet e propozuara pritet të kenë efekt në rritje të trafikut off-net duke zvogëluar proporcionin shumë të madh aktual të trafikut on-net.
56. Në analizën e AKEP-it, janë marrë në shqyrtim dhe rekomandimet e AK-së, si dhe tregu i pakicës së telefonisë celulare, duke arritur në përfundimin se:
- 1) *Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare për orientim në kostot LRIC të pastër, është një kusht i nevojshëm që duhet ndërmarrë, sic është parashikuar dhe planifikuar nga AKEP që në Analizë tregu celular 2012, dhe është në vijim të statusit me FNT të secilit operator celular për terminimin e thirrjeve në rrjetin e vet.*
  - 2) *Çdo lloj mase nga AKEP për rregullim të tarifave celulare në nivel me pakicë, për një operator sipas rekomandimit të AK, apo për më shumë operatorë, do të jetë objekt i një analize më të detajuar nga AKEP, siç është analiza e tregut celular, pasi bazuar në Ligjin Nr. 9918 dhe direktivat/rekomandimet e KE/BEREC rregullimi i tarifave në nivel me pakicë është masa e fundit rregullatore që vendoset për FNT në treg me pakicë dhe kur gjykohet se masat e tjera rregullatore në nivel me shumicë nuk pritet të kenë efektin e duhur në konkurrencën afat-gjatë midis operatorëve në treg.*
57. Si përfundim, AKEP-i, pas procedurës së konsultimit publik, me Vendimin nr. 2431, datë 13.03.2014 Për “Miratimin e dokumentacionit përfundimtar për “Rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare”, miratoi dokumentin e rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke miratuar gjithashtu me anë të vendimeve nr. 2432, nr. 2433, nr. 2434 dhe nr. 2435, datë 13.03.2014, tarifat e terminimit për të gjithë operatorët e telefonisë celulare.
58. Gjithashtu, pas periudhës nën hetim, AKEP-i, në zbatim të detyrimit për të kryer analizën e tregut të telefonisë celulare jo më pak se një herë në dy vjet, me Vendimin nr. 2492, datë 23.07.2014, miratoi dhe nxori për këshillim publik dokumentin: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, e cila më pas u miratua me Vendimin e AKEP-it nr. 2522, datë 06.11.2014 “Për miratimin dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu

me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme-Dokumenti përfundimtar”.

59. Referuar analizës së AKEP-it, janë marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës dhe në përfundim të analizës, me anë të Vendimeve të AKEP nr. 2523-2526, datë 06.11.2014, ndaj të gjitha ndërmarrjeve FNT (Vodafone, AMC, Albtelecom dhe Plus) në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, si dhe janë vendosur detyrimet përkatëse, të cilat janë detyruese për ato, ku ndër të tjera veçojmë:

*“Sipërmarrësit me status me FNT për terminimin e thirrjeve, bazuar në detyrimin e mosdiskriminimit (neni 39 i ligjit 9918 dhe pika 3.1 më sipër), si dhe në bazë të nenit 51 të Ligjit nr. 9918 ka edhe detyrimet e mëposhtme:*

1. *Sipërmarrësit me FNT ndalohen të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:*

- (1) tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit të sipërmarrësit me FNT;*
- (2) Sasia e minutave brenda rrjetit të sipërmarrësit FNT të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
- (3) Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarde, ofertat, shportat, optionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;*

2. *Sipërmarrësit me FNT për paketat tarifore standarde dhe ofertat/promocionet apo skontot e përkohshme në tërësi të ofruara për pajtimtarët e shërbimit celular ka detyrim:*

- (4) në muajin Janar të çdo viti të paraqesë në AKEP tarifat e planeve standarde dhe ndryshimet e kryera në vitin paraardhës;*
- (5) Ofertat/promocionet apo skontot e përkohshme në tërësi:*
  - a) duhet të kenë afat vlefshmërie të përcaktuar qartë që në fillim të aplikimit dhe jo më të gjatë se 3 muaj.*
  - b) që zgjasin më shumë se 3 muaj duhet të përfshihen në paketat/tarifat standarde;*
  - c) nuk duhet të ri-hidhen në treg me emër të ndryshuar kur elementët kryesorë të tyre janë thelbësisht të pandryshuar apo të ngjashëm;”.*

60. Afati i përcaktuar nga AKEP-i në vendimet e tij, për realizimin e detyrimeve të mësipërme nga të gjitha ndërmarrjet FNT, është data 01.01.2015.

61. Pas analizës së pretendimeve të operatorëve, AKEP-i ka vendosur që të bëjë ndryshime në Vendimet nr. 2523-2526, datë 06.11.2014, si më poshtë:

Të përcaktojë një glide-path (reduktim të përshkallëzuar) në kohë të tarifës së terminimit të Plus sipas tabelës së mëposhtme:

Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (rishikim)

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
Vodafone/AMC	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
Albtelecom (EM)	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
Plus	6.52	<b>6.52</b>	<b>4.00</b>	<b>2.66</b>	<b>1.48</b>

Shënim: vlerat në lekë/minutë pa TVSH

Tarifat e mësipërme të Plus janë të njëjta me tarifat përcaktuara nga AKEP më 13.03.2014, duke përfshirë dhe një fazë reduktimi të ndërmjetëm nga niveli 4.00 në 2.66 lek/minutë në Korrik 2015;

Të përcaktojë si afat të fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifrat on-net/off-net, afatet e mëposhtme:

data 1.07.2015: për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj datë;

data 1.01.2016: për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).

Afatet e mësipërme nënkuptojnë që:

Duke filluar nga data 1.07.2015 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net për përdoruesit me parapagim, përdoruesit e rinj me kontratë dhe përdoruesit aktualë me kontratë që kryejnë rinovim të kontratës pas datës 1.07.2015;

Duke filluar nga data 1.01.2016 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net edhe për përdoruesit me kontrata specifike si dhe përdoruesit aktualë me kontratë; Dy afatet e mësipërme janë të lidhura me datat e reduktimit të tarifës së terminimit në rrjetin Plus.

Secili operator celular ka kohën e mjaftueshme për të kryer ndryshimet e nevojshme dhe njoftuar përdoruesit për ndryshimet në tarifa, përfshirë përdoruesit me kontratë.

AKEP do të monitorojë nga afër zhvillimet në tregun celular, tarifrat me pakicë si dhe efektet në trafikun on-net/off-net dhe pagesat neto midis operatorëve, dhe konkurrencën në tregun me pakicë, për të gjykuar mbi nevojën e rishikimit të masave të mësipërme.

## **VI. ANALIZA E SJELLJES SË VODAFONE ALBANIA NË TREGUN PËRKATËS**

62. Pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare dhe kushteve të tregut, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 356, datë 31.03.2015 vendosi marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë, të cilat duhet të



zbatoheshin brenda një periudhe 30 ditore nga momenti i njoftimit të Vendimit. Gjithashtu në Vendim i është përcaktuar ndërmarrjes Vodafone dhe e drejta që brenda 10 ditëve të paraqiste këndvështrimet e saj në lidhje me masat e përkohshme.

63. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 356, datë 31.03.2015, vendosi marrjen e masave të përkohshme për ndërmarrjen Vodafone në tregun e telefonisë celulare me pakicë për rivendosjen e kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg:
- 2) *Vodafone Albania Sh.a ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare:*
- 1. Sasia e minutave brenda rrjetit Vodafone Albania të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
  - 2. Përcaktimet e pikës 1.a më sipër aplikohet për të gjitha ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për abonentët;*
64. Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 356, datë 31.03.2015, masat e përkohshme duhet të zbatohen brenda 30 ditëve që nga momenti i marrjes dijeni të këtij vendimi nga ana e ndërmarrjes Vodafone Albania.
65. Vendimi i mësipërm ju njoftua ndërmarrjes Vodafone me anë të shkresës nr. 178 prot., datë 31.03.2015, duke e ftuar që të paraqiste kundërshtimet e saj në seancë dëgjimore përpara Komisionit të Konkurrencës. Ndërmarrja Vodafone i paraqiti këndvështrimet e saj në lidhje me masat e përkohshme përpara Komisionit të Konkurrencës në seancën e datës 08.04.2015.
66. Në bazë të këtij Vendimi, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës është ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi. Për këtë arsye Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës më datë 08.05.2015 monitoruan tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke u paraqitur pranë pikës së shitjes së ndërmarrjes Vodafone, për të monitoruar tarifat dhe ofertat që aplikon kjo ndërmarrje në këtë treg, pas marrjes së masave të përkohshme nga Autoriteti i Konkurrencës.
67. Gjithashtu, Shoqëria “Vodafone Albania” SHA (Vodafone) me anë të shkresës së saj LRD//OX datë 23.04.2015, (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 219 prot., datë 24.04.2015), shprehet mbi qëndrimin proaktiv të Vodafone Albania për të adresuar shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës, heqjen e masës së ndërmjetme dhe mbylljen e hetimit.
68. Sipas ndërmarrjes Vodafone, nisur nga përfundimet e Vendimit nr. 303, datës 16.01.2014 Vodafone Albania (VA) në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarrë nisma në tregun e telefonisë celulare në mënyrë pro aktive për të adresuar shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës. Për rrjedhojë VA gjykon se sjellja e tyre bashkëpunuese së bashku me mbështetjen dhe orientimin e organeve rregullatore ndihmon thelbësisht për të arritur qëllimin e përbashkët për garantimin e konkurrencës eficientë dhe të ndershme që siguron përfitime për përdoruesit fundorë pa qene nevoja për ndërhyrje dhe hetime të përsëritura.
69. Njëpërmjet kësaj shkrese Vodafone bën me dije se duke filluar nga data 8 Maj 2015 hedh në treg një tjetër pakete të re tarifore konkurruese që përmban numër

te barabarte minutash brenda dhe jashtë rrjetit (për thirrjet drejt rrjeteve kombëtare celulare dhe fiks). Ashtu si edhe iniciativat e mëparshme kjo pakete synon të kënaqë nevojat e pajtimtarëve, rritjen e volumit të thirrjeve jashtë rrjetit në mënyre të krahasueshme me thirrjet brenda tij duke nxitur kështu gjenerimin e trafikut dalës e për rrjedhojë balancimin e tij dhe rritjen e te ardhurave të operatoreve të tjerë celulare nëpërmjet përfitimit të tarifës së terminimit për minutat drejt rrjeteve përkatës.

70. Sipas VA kjo paketë e re në treg, së bashku me produktet konkurruese ekzistuese, kënaq nevojat e pajtimtarëve për komunikim sipas preferencës së tyre brenda dhe jashtë rrjetit dhe njëkohësisht adreson shqetësimin e AK në lidhje me barazinë e tarifave dhe nxitjen e mëtejshme të trafikut dalës jashtë rrjetit dhe balancimin e tij.
71. Referuar shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës nr. 75/1, datë 11.05.2015, “Mbi monitorimin e zbatimit të Vendimit nr. 356, datë 31.03.2015 të Komisionit të Konkurrencë”, nga monitorimi i realizuar nga AK rezultoi se kjo pakete është hedhur në treg dhe është e vlefshme deri më 31 Maj.
72. Shoqëria “Vodafone Albania” SHA (Vodafone) me anë të shkresës së saj LRD/0083/OX datë 25.05.2015, (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me nr. 255 prot., datë 26.05.2015), *shprehet për të dytën herë mbi qëndrimin proaktiv të Vodafone Albania për të adresuar shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës, në tregun e telefonisë celulare si më poshtë:*
  - 1) Duke filluar nga data 27 Maj 2015 VA përditëson njërën nga paketat tarifore mujore (Vodafone Club Superior) e cila do të përmbajë këtë e tutje numër të barabarte minutash brenda dhe jashtë rrjetit (për thirrjet drejt rrjeteve kombëtare celulare dhe fiks).
  - 2) Duke filluar nga data 3 Qershor 2015 VA përditëson paketën tarifore ditore (Vodafone Day Pass) e cila do të përmbajë këtë e tutje numër të barabarte minutash brenda dhe jashtë rrjetit (për thirrjet drejt rrjeteve kombëtare celulare dhe fiks).
  - 3) Duke filluar nga data 12 Maj 2015 VA ka përditësuar edhe me tej një tjetër pakete tarifore mujore (Vodafone Club Inter/national) e cila përmban 2 here me shume minuta kombëtare (kjo pakete ka përfshirë që nga fillimi numër të barabarte minutash brenda dhe jashtë rrjetit).
73. Gjithashtu sipas VA, këto paketa të reja (versionet e tyre të mëparshme do të hiqen nga tregu) së bashku me produktet konkurruese ekzistuese adresojnë me së miri shqetësimin e AK në lidhje me barazinë e tarifave dhe nxitjen e mëtejshme të trafikut dalës jashtë rrjetit dhe balancimin e tij. Ato i shtohen nismave të VA në tregun e telefonisë celulare, e cila vijon që në mënyre pro aktive të shfaqë sjellje bashkëpunuese për të garantuar konkurrence eficiente dhe të ndershme.
74. Gjithashtu nga monitorimi rezultoi se VA përveç ofertave të mësipërme mujore, në të cilën kishim barazim të minutave brenda rrjetit me ato jashtë rrjetit, ofronte dhe oferta të tjera mujore, si vijon: 1- Club Mix; 2- Club Extra; Club me minuta, si dhe oferta ditore (që sipas VA do të ndryshojë më datë 3 Qershor 2015) dhe javore etj., ku rezulton se sasia e minutave brenda rrjetit është më e lartë se sasia e minutave jashtë rrjetit.

75. Gjithashtu sipas VA, duke filluar prej datës 1 Maj 2015 ka njehsuar planet tarifore me para-pagese Vodafone Card dhe Vodafone Club, në një plan tarifor të vetëm. Nëpërmjet kësaj iniciative thjeshtohet informacioni për pajtimtarët, rritet edhe më tej transparenca e kushteve dhe çmimeve të ofrimit të shërbimit dhe njëkohësisht adresohet shqetësimi i Komisionit të Konkurrencës (ngritur dhe gjate takimit më të fundit) në lidhje me tarifën e diferencuara për thirrjet brenda rrjetit dhe brenda grupit (ndërmjet pajtimtarëve të Vodafone Club dhe Vodafone Card).
76. Si përfundim, referuar analizës së mësipërme, rezulton se pas rekomandimeve të dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës me anë të VKK nr. 303, të cilat janë marrë në konsideratë nga AKEP në analizën e tij, kanë sjellë reduktim të ndjeshëm të tarifës së terminimit midis operatorëve celularë, duke sjellë dhe rritje të sasisë së minutave të terminuara jashtë rrjetit. Detyrimet e vendosura nga AKEP-i, ndaj të gjithë operatorëve celularë, për mosdiskriminim të thirrjeve brenda rrjetit me ato jashtë rrjetit, do të hyjnë në fuqi për të gjithë pajtimtarët me parapagesë më datë 01.07.2015.
77. Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 356, ndërmarrja Vodafone Albania ka zbatuar pjesërisht vendimin pasi ka hedhur në treg një ofertë të re në të cilën ka barazuar sasinë e minutave të ofruara brenda rrjetit me ato jashtë rrjetit si dhe që nga muaji nëntor 2013 ka barazuar tarifën për thirrjet standarte, por gjithësesi vazhdon të ketë në treg oferta me më shumë minuta brenda rrjetit sesa jashtë rrjetit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d), nenin 43.5, pika 5 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe në nenin 4, pika 9, gërma a, të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

#### **V E N D O S I:**

- I.** Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e Vendimit nr. 356 të Komisionit të Konkurrencës të datës 31.03.2015, për marrjen e masave detyruese që të ndalojë të aplikojë tarifa në nivel pakice që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, për të gjitha ofertat e hedhura në treg për periudhën nga njoftimi i këtij vendimi deri në 01.07.2016 si vijon:
- Barazimi i tarifave brenda me jashtë rrjetit me jashtë rrjetit (“on net” dhe “of net”) do të jetë për të gjitha ofertat, opsionet dhe tarifën e thirrjeve standarteve për të gjitha paketat dhe shërbimet e telefonisë celulare të shoqërisë Vodafone Albania SH.A:
  - Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në ofertat/pagesë fikse të paketave tarifore nuk mund të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;
  - Gjatë procesit të ndryshimit të planeve tarifore dhe ofertave të njoftojë abonentët mbi ndryshimet në planet tarifore të thirrjeve standarteve dhe ofertave.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

- II.** Moszbatimi i Vendimit ndëshkohet me gjobë për shkelje të rënda deri në 10 % të xhiros së vitit financiar paraadhës, sipas parashikimeve të nenit 74, pika 1 gërma b të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.
- III.** Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA, në tregun e telefonisë celulare dhe përfundimin e procedimit administrativ të ankesave të shoqërive Plus Communication SH.A dhe Albtelekom SH.A ndaj Vodafone Albania.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin dhe monitorimin e këtij vendimi, si dhe njoftimin e këtij vendimi për palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv/Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**nr. 367 , datë 04.06.2015**

**“Për**

**përfshirë**  
**tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në**  
**rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”**

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e:

Lindita MILO (LATI)	Kryetare
Servete GRUDA	Zv/Kryetare

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Përjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”

**Baza ligjore:** Ligji nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 5, pika 2, neni 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50 pika 1.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të :

Raportit i “Përjashtimi nga ndalimi të Marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH SH.A. dhe OSHEE per tepricat e energjise elektrike, perfshire tepricat ne kushtet e prurjeve te medha, me qellim plotesimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per vitin 2015“ si dhe relacionit të Sekretares së Përgjithshme

### VËREN SE :

#### I. Procedura e ndjekur

Pranë Autortitetit të Konkurrencës, me shkresën nr 150 prot, datë 16.03.2015, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike ( AAES ) ka paraqitur një ankesë lidhur me paligjshmërinë e nënshkrimit të marrëveshjes së shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH – OSHEE, e miratuar nga ERE me vendimin nr 12, datë 06.02.2015.

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike pretendon se marrëveshja dypalëshe e lidhur ndërmjet KESH dhe OSHEE, e cila kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen në tregtimin e energjisë elektrike të kompanive të licencuara nga ERE, duhet të konsiderohet si marrëveshje në kundërshtim me politikat e qeverisë Shqiptare, politika të cilat synojnë liberalizimin e tregut.

Autoriteti i Konkurrencës, pas marrjes së ankesës së shoqatës AAES, me shkresën nr 150/1 prot, datë 23.03.2015, i është drejtuar KESH, OSHEE dhe për dijeni Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në lidhje me marrëveshjen e lidhur ndërmjet KESH dhe OSHEE, ku i bën me dije se kjo marrëveshje, nëse plotëson kushtet per

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

perjashtim, mund të jetë objekt përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të nenit 5 dhe 49 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Konstatojmë se kjo marrëveshje e nënshkruar nga palët KESH Sh.a dhe OSHEE Sh.a dhe e miratuar nga ERE, më datë 06.02.2015 nuk është sjellë për vlerësim pranë Autoritetit të Konkurrencës bazuar në nenin 69 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Në vijim të procedurave, me shkresën nr 150/2 prot, datë 02.04.2015, është njoftuar Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike për fillimin e procedurave të vlerësimit të marrëveshjes sipas parashikimeve të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Enti Rregullator i Energjisë, me shkresën nr 150/3 prot, datë 10.04.2015, ka paraqitur pranë Autoritetit “Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, per tepricat e energjise elektrike, perfshire tepricat ne kushtet e prurjeve te medha, me qellim plotesimin e humbjeve ne rrjetin e shperndarjes per vitin 2015“ si dhe Vendimin Nr 12, datë 06.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE, për miratimin e kësaj marrëveshje.

Gjithashtu, OSHEE SH.A dhe KESH SH.A, përkatësisht me shkresat nr 150/5 dhe 150/6, datë 14.05.2015, kanë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës Formularin e Plotësuar të Njoftimit të Marrëveshjes.

### **II. Palët në marrëveshje**

Palët e përfshira në këtë marrëveshje janë:

- Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, KESH Sha, është kompani publike, e regjistruar si person juridik me vendimin Nr 12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përfaqësuar nga Z, Agron Hetoja, Administrator.
- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSHEE Sha, kompani publike, i regjistruar si person juridik me vendimin Nr 38587, datë 19.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të përfaqësuar nga Z. Adrian Cela, Administrator

### **III. Përshkrimi i marrëveshjes**

KESH dhe OSHEE, në datën 6 shkurt të vitit 2015, kanë nënshkruar një marrëveshje “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, per tepricat e energjise elektrike përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”.

Marrëveshja ka si objekt shit-blerjen/furnizimin e tepricave të energjisë elektrike, për mbulimin e pjesshëm ose të plotë të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, sipas përkufizimeve të dhëna në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, Rregullat e Shitjes së Energjisë Elektrike dhe Rregulloren e Shkarkimit të Plotave dhe atë të Sigurisë së Digave.

Marrëveshja pavarësisht se përfshin periudhën kohore që i korrespondon vitit 2015, në fakt është një marrëveshje e cila mund të jetë efektive vetëm për një periudhë të shkurtër të këtij viti, për faktin se ajo është e kushtëzuar me shitjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes vetëm në situatën e tepricave të energjisë elektrike, përfshirë dhe ato në kushtet e prurjeve të mëdha, kur KESH sh.a-së do ti duhet të shmangë derdhjen e ujit pa prodhim të energjisë elektrike.

### *Qëllimi i marrëveshjes*

Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet KESH dhe OSHEE përcakton procedurat dhe modalitetet e komunikimit dhe përcaktimit të kërkesës nga ana e OSHEE për KESH për energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, përpara fillimit nga ana e saj të procedurës së marrjes së ofertave nga ana e tregtarëve.

## **IV. Tregu përkatës**

### **III.1. Tregu përkatës i produktit**

Tregu përkatës i produktit është tregu i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, nga OSHEE (ish CEZ shpërndarje) dhe tregu i shitjes së energjisë elektrike nga KESH sha, të sasive të tepërta të energjisë në rast të prurjeve të mëdha.

Bazuar në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike dhe në Deklaratën Rregullatore<sup>36</sup> blerja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, kryhet nga OSHEE. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është i vetmi operator, me pozicion monopol natyror, në dy segmente të tregut të energjisë elektrike. Ai vepron i vetëm në segmentin e tregut të shpërndarjes dhe në segmentin e furnizimit me pakicë të publikut.

Për shkak të humbjeve teknike dhe jo teknike të rrjetit të shpërndarjes, dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, është vetëm OSHEE operatori që kryen blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Pra në këtë segment tregu OSHEE vepron i vetëm. Si rrjedhim, tregu është inelastik dhe i pazëvendësueshëm nga ana e kërkesës.

Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, në këtë treg janë të licensuar 66 operatorë për tregtim të energjisë elektrike. Pra, tregu nga ana e ofertës mund të jetë elastik, por realisht nga të dhënat që disponohen lidhur me këtë treg, operatorë pjesëmarrës aktivë në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga ana e OSHEE janë vetëm 5 ose 6 operatorë.

**Operatori KESH SH.A** është shoqëri aksionere dhe vepron si një shoqëri e vetme, që në përbërje ka dy segmente tregu të energjisë elektrike përkatësisht operatorin KESH GEN dhe operatorin Furnizuesi Publik me Shumicë. KESH sh.a ka pozicion monopol natyror në dy segmente tregu në tregun e prodhimit/gjenerimit të energjisë elektrike dhe në tregun e furnizimit publik me shumicë.

KESH Gen është operatori publik i cili është i licencuar për prodhimin e energjisë

<sup>36</sup> Pika 4.5, Deklaratës Rregullatore

elektrike. KESH Gen është prodhuesi publik i energjisë elektrike me zotërim të 100% të aksioneve nga shteti.

Furnizuesi Publik me Shumicë(FPSH) zotërohet 100% të aksioneve nga shteti. FPSH ka përgjegjësi për blerjen e energjisë elektrike dhe shitjen te furnizuesi publik me pakicë FPP për furnizimin pa ndërprerje të klientëve tariforë. Ky operator zotëron licencë për blerjen e energjisë elektrike nga KESH Gen-i, PPE-te, PVE-te, apo tregtuesit, me qëllim shitjen tek Furnizuesi Publik me Pakice. Furnizuesi publik me shumice lidh kontrata vjetore me OSHEE me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike të klientëve tarifor.

### **Tregu përkatës gjeografik**

Tregu gjeografik, përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë. Pasi, energjia elektrike që blihet për mbulimin e humbjeve në rrjet, dhe ajo që shitet nga KESH sh.a për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, përdoret për sigurinë e rrjetit të brendshëm me energji elektrike të vazhdueshme. Të gjitha transaksionet për blerjen e energjisë elektrike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **V. Analiza e Konkurrencës**

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri funksionon në bazë të Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.338, datë 09.03.2008.

KESH SH.A/FPSH i shet OSHEE sha/FPP energji elektrike sipas kërkesave dhe nevojave vjetore, me çmim të miratuar nga ERE. Shitja bëhet sipas marrëveshjeve vjetore ose periudha të tjera të miratuara nga ERE, gjithashtu KESH sh.a shet energji të tepërt në tregun vendas ose atë të eksportit në përputhje me rregullat dhe procedurat e shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga ERE.

OSHEE - ja është përgjegjëse për blerjen e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes, ajo mund ta blejë këtë energji nga cdo pjesëmarrës me çmime tregu. Gjatë vitit 2014, humbjet në rrjetin e shpërndarjes arritën në 37.81% ndërsa në vitin 2013 ishin 45.04%<sup>37</sup>. Ky nivel i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes ndikon në tarifën përfundimtare të energjisë elektrike që llogaritet<sup>38</sup> dhe miratohet në vitin pasardhës.

Bazuar në procedurat hetimore të realizuara nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me tregun e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, rezultoi se në këtë segment tregu nuk ka konkurrencë dhe shkak kryesor është baza ligjore rregullatore që përdoret nga operatori OSHEE, për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve.

OSHEE do të blejë energji elektrike për mbulimin e humbjeve nga KESH sha, që është ndërmarrje publike, ndërsa ky i fundit do të shesë energjinë elektrike në rastet e

<sup>37</sup> Burimi, publikimi në faqen zyrtare të OSHEE.

<sup>38</sup> Në bazë të metodologjisë për llogaritjen së tarifave, reflektohet në kostot për llogaritjen e tarifave të energjisë elektrike, si kosto e energjisë së blerë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.



prurjeve të mëdha me çmim burse HUPX. Në çdo rast transaksionet do të jenë në përfitim të interesit publik dhe eficeses.

Deri në këtë periudhë që zbatohet kjo marrëveshje, problematikë për tregun është fakti që ligji i ri për Sektorin e Energjisë, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë datë 30.04.2015, ende nuk e ka përcaktuar modelin e tregut të energjisë elektrike, i cili duhet të përcaktojë qartë funksionet dhe rolin e sejcilit operator të tregut.

## VII. Kushtet dhe detyrimet

Bazuar në marrëveshjen për shitblerjen e energjisë ndërmjet KESH sha dhe OSHEE sha për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015 miratuar me datë 06.02.2015 vëmë re se pikat e mëposhtme përfaqësojnë detyrimet e palëve.

- **OSHEE SH.A.**, përpara çeljes së procedurës mujore për blerjen në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të njoftojë KESH sh.a. për sasinë e energjisë elektrike që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar me këtë rast KESH sh .a. përcaktimin e sasisë së energjisë elektrike që kjo e fundit mund ti shesë për mbulimin e tyre, sasi e cila mund të mbulojë pjesërisht apo plotësisht kërkesën për mbulimin e humbjeve.
- **KESH SH.A.**, përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha apo dhe tepricave, *pasi ka garantuar plotësimin e kërkesës me energji elektrike për furnizimin e konsumatorëve tarifore*, do ti komunikojë shoqërisë OSHEE sh.a mundësinë e furnizimit me energji elektrike për "mbulimin e humbjeve" në rrjetin e shpërndarjes, ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

Nëse të dyja palët bien dakord për furnizimin, lëvrimin e plote apo të pjesshëm të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, atëherë programimet, nominimet, konfirmimet, lëvrimi dhe matja do të bazohen në Rregullat në fuqi të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim.

*Çmimi për lëvrimin e energjisë elektrike sipas kësaj kontrate do të jete çmimi mesatar mujor i bursës hungareze HUPX për periudhën në të cilën kryhet lëvrimi i energjisë elektrike, për produktin/profilin në bande, Siç publikohet nga bursa e Hungarisë HUPX (ne faqen e internetit: [www.hupx.hu](http://www.hupx.hu)).*

***Marrëveshja potencialisht mund të përbëjë kufizim të konkurrencës për ofruesit e tjerë të furnizimit me energji elektrike (tregtarët, PPE dhe PVE), të cilët hyjnë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të kryera nga OSHEE.***

**Arsyet e përjashtimit nga ndalimi**

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

- 1) Marrëveshja kontribuon në sigurinë kombëtare dhe problemet sociale që lindin në rastet e shkarkimeve dhe përmbytjet në zonat përkatëse.
- 2) Marrëveshja kontribuon në shfrytëzimin maksimal dhe optimizimin e prodhimit dhe të shitjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a., si shoqëria përgjegjëse dhe administruese e Kaskadës së Lumit Drin dhe HEC- eve prodhuese të saj, në kushtet e tepricave apo prurjeve të mëdha, raste emergjencash, kur edhe shitja në tregun e eksportit është e pamundur si rrjedhojë e kapaciteteve të limituara të interkoneksionit .
- 3) Marrëveshja siguron ulje të kostove për konsumatorët tarifore, pasi garanton furnizimin pjesërisht të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga energjia elektrike e prodhuar nga KESH sh.a. në kushtet e tepricës dhe prurjeve të mëdha, pasi ka plotësuar kërkesën e OSHEE, me çmim më të ulët sesa çmimi i importit të energjisë elektrike, bazuar në evidencat dhe të dhënat historike që disponojmë.
- 4) Sjell përfitime esenciale për konsumatorët tariforë, duke patur parasysh që kostot e sigurimit nëpërmjet blerjes, se energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, përfshihen në tarifatat e furnizimit me pakicë për konsumatorët tarifore.
- 5) Pra, kjo marrëveshje është në përfitim të interesit publik dhe efikasitetit të tregut, në rastin e prurjeve të mëdha.
- 6) *Marrëveshja do të aplikohet deri në fund të vitit 2015, në rastet e prurjeve të mëdha.*

### **PËR KËTO ARSYE :**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 5, nenit 49, 50, 69 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;

### **V E N D O S I:**

1. Të përjashtojë nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.
2. Afati i përjashtimit të kësaj marrëveshjeje është nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 31.12.2015.
3. Miratimi sa më shpejt të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me specifikat e tregut shqiptar.
4. Njoftimin e marrëveshjeve dhe ndryshimet e bëra në to në Autoritetin e Konkurrencës, për vlerësimin e përjashtimit individual të marrëveshjeve.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat e parashikuara në Rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete Gruda</b>	<b>Koço Broka</b>	<b>Iva Zajmi</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv.Kryetare</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtare</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**nr.368, datë 16/06/2015**

**Për**  
**ndreqje gabimi material në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”**

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- **Lindita MILO (LATI) Kryetare**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

▪ Servete	<b>GRUDA</b>	<b>Zv/Kryetare</b>
▪ Koço	<b>BROKA</b>	<b>Anëtar</b>
▪ Iva	<b>ZAJMI</b>	<b>Anëtare</b>
▪ Eduard	<b>YPI</b>	<b>Anëtar</b>

Në mbledhjen e datës 16.06.2015, me pjesëmarrjen e Znj.Lindita Milo (Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Për ndreqjen e një gabimi material në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”.

**Baza ligjore:** Neni 120 i Kodit të Procedurës Administrative;  
Neni 24, gërma (d) i Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës nr. 86 prot., datë 16.06.2015, për një ndreqje gabimi në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës;

**VËREN SE:**

Gjatë procesit të zbardhjes ka ndodhur një gabim material në lidhje me datën e shprehur në rrjeshtin 5, të pikës I të dispozitivit në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015 të Komisionit të Konkurrencës, e cila duhet të ishte 01.07.2015.

Referuar sa më sipër, propozimi për një ndreqje gabimi në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015, të Komisionit të Konkurrencës, është i bazuar në ligj.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në Neni 120 të Kodit të Procedurës Administrative dhe nenin 24, gërma (d) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Në pikën (I) të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 366, datë 04.06.2015, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”, data **“01.07.2016” zëvendësohet** me datën **“01.07.2015”**.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi për palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetare**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtare**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 369, datë 2.07.2015**

**“ Për**  
**disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në**  
**Portin e Vlorës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetare

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

- |                      |             |
|----------------------|-------------|
| ▪ Znj. Servete Gruda | Zv/Kryetare |
| ▪ Znj. Iva Zajmi     | Anëtare     |
| ▪ Z. Koço Broka      | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduart Ypi      | Anëtar;     |

Në mbledhjen e tij të datës 2.07.2015, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo, Znj.

Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Për disa rekomandime në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (ndryshuar), nenet: 24 pika d), 2, pika 1, germa c) dhe neni 9, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës dhe seancës dëgjimore me palët e prekura:

**V Ë R E N S E:**

**Procedura e ndjekur:**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja “Gerverni Travel” Shpk ka plotësuar Formularin e Ankesës, i cili është protokolluar me nr 169 prot, datë 24.03.2015, në të cilin paraqitet një ankim ndaj ndërmarrjes “Porti Vlorë” SHA.

Referuar kërkesës, ndërmarrja Gerverni Travel shpk ankohet se Porti Vlorë SHA kërkon të prishë kontratën ekzistuese midis tyre dhe grafikun e udhëtimit të tragetit të kësaj ndërmarrjeje në Linjën Vlorë – Brindisi, duke vendosur një grafik të ri, i cili e detyron tragetin të udhëtojë një ditë po dhe një ditë jo. Sipas ankuesit, kjo bëhet për të hapur rrugën e futjes së një trageti të ri në këtë linjë, duke i dhënë këtij të fundit automatikisht 50% të tregut.

Në rastin objekt-shqyrtimi (i kësaj vendimmarrjeje) paraprakisht evidentohet se ka patur një korrespondencë të vazhdueshme mes Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrjes Gerverni Travel shpk, dhe Ministrisë së Transporteve, reciprokisht me njëri-tjetrin, në lidhje me rastin.

Në vijim të vlerësimit të ankesës, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion nga Porti Vlorë SHA, në lidhje me arsyet e ndryshimit nga ana e Portit Vlorë të kontratës të tragetit nr.722 prot, datë 30.12.2014, me ndërmarrjen “Trintsea Shipping” LDA si dhe paralelisht ka vënë në dijeni Ministrinë e Transportit dhe të Infrastrukturës në lidhje me këtë ankesë.

Gjithashtu me shkresën nr.169/2 prot, datë 03.04.2015 është njoftuar ankimesi në lidhje me vazhdimin e procedurës së vlerësimit të ankesës nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe është ftuar ankimesi në seancë dëgjimore.

Nga takimet e realizuara në Portin e Vlorës, drejtori i Portit Vlora SHA, deklaroi se në muajin Mars në Portin e Vlorës ka patur një kërkesë nga një operator tjetër për të operuar në linjën Vlorë - Brindizi. Në zbatim të akteve ligjore, Porti i Vlorës ka lidhur me operatorin e interesuar një “Kontratë për Licencë” në mënyrë që të vazhdojë procedurat dhe hapat e mëtejshme për marrjen e licensës nga organet përkatëse.

Bazuar në nenin 4 të kontratës “Kushte të tjera të Kontratës” së lidhur, në 30.12.2014, me operatorin “Tintsea Shipping”, Porti i Vlorës i ka bërë një njoftim përfaqësuesit të operatorit ekzistues “Gerverni Travel” në lidhje me mundësinë e ndryshimit të grafikut të lëvizjeve të tragetit.

Nga shkresa e ndërmarrjes “Gerverni Travel” SHPK nr. 08/5 prot., datë 08.05.2015, rezultoi se Porti Detar Vlorë SHA me anë të shkresës së tij Nr.184/4 Prot., datë 06.05.2015, njoftoi ndërmarrjen “Gerverni Travel” SHPK se: *duke filluar nga data 10.05.2015, fillon zbatimin e grafikut të ri të përcaktuar nga Porti*, i cili ishte bashkëngjitur edhe asaj shkrese. Referuar grafikut, tragetet “Horizonti” dhe “Red Star” me përfaqësues agjencitë detare “Ruci Line” dhe “Gerverni Travel” do të operojnë një ditë njëri dhe një ditë tjetri. Ky grafik është kundërshtuar nga ndërmarrja “Gerverni Travel” SHPK, me anë të shkresës së saj datë 07.05.2015, drejtuar MTI dhe për dijeni Porti Detar Vlorë SHA dhe Drejtorisë së Përgjithshme Detare, me pretendimin se Porti Vlorë ka kapacitetet për punimi deri në 3 tragete në të njëjtën kohë.

Ky treg në vazhdimësi, ka qenë objekt monitorimi, hetimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Përkatësisht edhe me VKK nr.248, datë 11/10/2012 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”. Po kështu edhe me VKK nr.349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” Komisioni Konkurrencës.

### **Tregu Përkatës**

*-Tregu përkatës i produktit/shërbimit* është tregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në terminalin e Portit të Vlorës. Këto shërbime ofrohen vetëm nga ndërmarrja “Porti Vlora” SHA, i cili është i vetmi ofrues i këtij shërbimi, për ndërmarrjet që ofrojnë shërbimin e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, sipas kushteve licencuese që ato zotërojnë.

*-Tregu përkatës gjeografik është tregu i linjave detare në zonën gjeografike të Portit të Vlorës.*

### **Analiza e Konkurrencës**

Nga analiza e kushteve të ofrimit të shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në terminalin e Portit të Vlorës, rezulton se ndërmarrja “Porti Vlora” SHA është e vetmja ndërmarrje publike, e cila realizon shërbimet e saj vetëm ose dhe nëpërmjet të tretëve të licencuar nga MTI, ndër këto, edhe transportin e ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, në zonën gjeografike të ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare. Gjë e cila, e vendos atë në kushtet e pozitës dominuese në tregun përkatës të këtyre shërbimeve.

Nga evidencat e grumbulluara rezulton se grafiku i vendosur nga “Porti Vlora” SHA, duke alternuar në ditë të ndryshme vetëm me një operator të ndryshëm në treg, kushtëzon funksionimin në mënyrë konkurruese duke ndar tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve ndërmjet 2 (dy) operatorëve të licencuar, duke mos ua mundësuar konkurrimin midis tyre, brenda së njëjtës ditë.

Si pasojë e kësaj sjelljeje të ndërmarrjes me pozitë dominuese “Porti Vlora” SHA, kemi ulje të konkurrencës midis operatorëve brenda së njëjtës ditë, çka eliminon konkurrimin e çmimeve të shërbimeve, midis operatorëve ndaj konsumatorëve/përfituesve të shërbimeve, me njëri tjetrin, si dhe ndarje të tregut mes tyre, gjë e cila, gjithsesi çon në kufizim të konkurrencës në treg dhe automatikisht me pasoja për konkurrentët dhe përfituesit e shërbimeve.

Në vijim të vlerësimit të situatës së mësipërme, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 39 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me shkresat, përkatësisht: nr 169/7 prot. dhe nr 169/8 prot. datë 18.05.2015, ka ftuar për pjesëmarrje në seancë dëgjimore ndërmarrjen ankuese “Gerverni Travel” Shpk, ndërmarrjen “Porti Vlora” SHA, si dhe përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Në seancë dëgjimore u paraqitën vetëm përfaqësuesit e ndërmarrjes “Gerverni Travel” Shpk, si dhe përfaqësuesi i MTI. Përfaqësuesit e ndërmarrjes “Porti Vlora” SHA nuk u paraqitën në seancat dëgjimore të organizuara nga Komisioni i Konkurrencës.

Përfundimisht, nga deklaratimet e palëve në seancë dhe faktet e mësipërme, situata në lidhje me konkurrentët dhe përfituesit e shërbimeve vazhdon të jetë e pandryshuar, duke i vendosur konkurrentët në kushte të pabarabarta dhe në gjendje të pafavorshme konkurrence, si dhe duke u kushtëzuar ndarjen e tregut midis tyre, duke sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.

### **PËR KËTO ARSYE**



**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Në zbatim të nenit 24, germa d), dhe nenit 2, pika 1, germa c), si dhe në mbështetje edhe të nenit 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

**V E N D O S I :**

- 1- Ndalimin e ndarjes së tregut të shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve nga ndërmarrja “Porti Vlora” SHA;
- 2- Detyrimin e ndërmarrjes “Porti Vlorë” SHA të zbatojë dhe lejojë operimin në kushte të barabarta, të të gjithë operatorëve që operojnë në terminalin e Portit të Vlorës, duke i vendosur ato në gjëndje të favorshme konkurrence, për shërbimin e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, duke u mundësuar konkurrimin midis tyre brenda së njëjtës ditë.
- 3- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij Vendimi për palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete Gruda</b>	<b>Koço Broka</b>	<b>Iva Zajmi</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv.Kryetare</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtare</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 370, datë 21.07.2015**

**“Mbi**

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të vetëm të Alcatel-Lucent nga Nokia Corporation”**

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Zv. Kryetar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar
- Z. Eduard Ypi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 21.07.2015, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Alcatel-Lucent nga Nokia Corporation.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 16 dhe 17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Nokia Corporation / Alcatel - Lucent dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

### V Ë R E N S E:

#### 1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i propozuar synon përfutimin e kontrollit të vetëm të Alcatel-Lucent nga Nokia Corporation.

Transaksioni i përqendrimit do të realizohet me anë të një oferte publike në Francë dhe në Shtete e Bashkuara. Për këtë qëllim është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit nga palët Nokia Corporation dhe Alcatel Lucent, më datë 15 prill 2015. Sipas kushteve të Memorandumit të Bashkëpunimit, Nokia do të paraqesë ofertat publike brenda një kohe të shkurtër pas plotësimit ose heqjes dorë nga të gjitha kushtet për finalizimin e Marrëveshjes.

Transaksioni i cili realizon përfutimin e kontrollit të vetëm të Alcatel Lucent nga Nokia Corporation, sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në këtë të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit dhe përbën një përqendrim.

Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

#### 2. Palët në transaksion

- ❖ **Nokia Corporation (“Nokia”)**: në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri publike e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit finlandez me zyra qendrore në adresën: Espoo, Usiama, Finlandë. Aktiviteti i Nokia

është i strukturuar në tre njësi biznesi: (i) segmenti Nokia Networks; (ii) Segmenti HERE ; dhe (iii) Nokia Technologies, zhvillon mundësi të reja biznesi të ndërtuara nga inovacionet Nokia dhe marka Nokia.

Nokia është prezente në Shqipëri me anë të degës së saj Nokia Solutions and Networks Branch Operations Oy, me seli në adresën Blv., “Bajram Curri”, European Trade Center , kati 9, Tiranë. Dega është aktive dhe ka si qëllim të zhvillojë aktivitetin e saj në emër dhe për llogari të mëmës (shoqërisë Nokia Corporations).

- ❖ **Alcatel-Lucent (“Alcatel”)**: në cilësinë e shoqërisë **Target** është një shoqëri publike anonime e cila është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit francez , me seli në adresën: Boulogne- Billancourt, Francë. Alcatel është e listuar në bursat e Euronext dhe të New York-ut. Shoqëria nuk kontrollohet nga asnjë ndërmarrje tjetër dhe aksionet e saj janë të shpërndara gjerësisht. Aktiviteti i Alcatel është i organizuar kryesisht në njësitë operative: (i) Aksesi; dhe (ii) Rrjeti qendror (Core networking).

### 3. Xhiro për vitin 2014

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXX Lekë:
  - **Nokia Corporation** : XXX € = XXXX Lekë
  - **Alcatel Lucent** : XXXX € = XXXXX Lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është XXX Lekë:
  - **Nokia Solution & Networks Branch Operation O.Y – Dega Shqipëri** : XXXX Lekë
  - **Alcatel Lucent** : XXXX € = XXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

### 4. Analiza e konkurrencës

#### Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: (i) tregu përkatës i produktit, dhe (ii) tregu përkatës gjeografik.

- **Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i pajisjeve, pjesëve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe zgjidhjeve (solutions) / shërbimeve profesionale të lidhura me to.
- **Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

### 5. Vlerësimi i konkurrencës

Në tregun e brendshëm, shoqëria target dhe shoqëria blerëse ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregje të ndryshëm, duke mos sjellë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës. Nokia është aktive në shitjen e pajisjeve të infrastrukturës të rrjetit *wireless* (RAN ose Core) dhe shërbimeve të rrjetit wireless, ndërsa Alcatel Lucent në vendin tonë është i kufizuar në shitjen e një sistemi pagese online dhe pajisjeve për IP routing (rrugëzimi nëpërmjet protokollit të internetit), dhe IP transport (transportimit nëpërmjet teknologjisë IP).

Nokia është prezente në vendin tonë nëpërmjet degës së saj Nokia Solutions and Networks Branch Operations O.Y - Dega Shqipëri, ndërkohë Alcatel Lucent nuk është prezent në vendin tonë, por realizon shitje nëpërmjet Alcatel Lucent Rumani, e cila është furnizuesi i produkteve tek klientët në Shqipëri. Pjesa e tregut e Nokia-s apo pozicioni i saj në vendin tonë nuk pëson asnjë ndryshim.

Aktivitetet ekonomike të Nokia-s dhe Alcatel Lucent në Shqipëri nuk kanë mbivendosje, pasi veprojnë në tregje të ndryshëm produkti duke mos sjellë shqetësime në lidhje me konkurrencën në treg.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Alcatel-Lucent nga Nokia Corporation.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
Zv. Kryetar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr.371, Datë 04/09/2015**

**“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të  
hotelerisë”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

- Servete GRUDA                      Zv/Kryetare
- Eduard YPI                            Anëtar
- Koço BROKA                          Anëtar
- Iva ZAJMI                              Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka dhe Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Raportit të hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26; Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

### VËREN SE:

#### I. PROCEDURA

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar një ankesë, në të cilën pretendohet se nga disa hotele në Tiranë, Sarandë etj, janë kryer shkelje të Ligjit nr 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, duke përdorur pranë emrit të tyre emrin “Tirana Hotel”, e cila sipas ankimuesit përbën një kufizim të konkurrencës në tregun e hotelerisë. Gjithashtu, ankimuesi pretendon se është konstatuar edhe ofrim i shërbimeve me çmime të ngurtësuar dhe të fiksuara nga ana e tyre, si dhe praktika të bashkërenduara në caktimin e tyre dhe ndarjen e tregjeve të këtyre shërbimeve.
2. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit, me anë të Vendimit Nr. 361, datë 11.05.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë”, vendosi të miratojë hapjen e hetimit në këtë treg, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës për periudhën objekt hetimi.
3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 240, datë 11.05.2015 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

#### II. NDËRMARRJET OBJEKT HETIMI

4. Bazuar në Vendimin Nr.361, datë 11.05.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë”, ndërmarrjet objekt hetimi janë:

- Shoqëria “Grand Hotel” Sh.p.k, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.26013, datë 21.06.2001, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT: K11414001L, me seli në: Rr. “Ismail Qemali”, Tiranë.
- Shoqëria “Golden Eagle” Sh.p.k, (ROGNER Hotel) regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J61806015D, me seli në: Tirane, Blv: Dëshmorët e Kombit.
- Shoqëria “Mak Albania” Sh.p.k, (SHERATON Hotel) e regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 4453, dt. 24.05.1994, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J61821059A, me seli në: Rr. Perlat Rexhepi”, Tirane.
- Shoqëria “Diplomat H Y” Sh.p.k regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.6764, dt. 16.09.1993, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J61814106E me seli në: Rruga Sulejman Delvina, Tirane.
- Shoqëria “SKY HOTEL’S” Sh.p.k regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.CN-228874-10-13, dt. 23.10.2013, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT L32126014G me seli në: Rruga Ibrahim Rugova, Tirane.
- Shoqëria “Airport Hotel Tirana” Sh.p.k regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.CN-123120-02-08, dt. 28.08.2008, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K81422027F me seli në: Rruga Nikel, Durrës.
- Shoqëria “SAHHILBA” Sh.p.k (Iliria Hotel) regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.5695, dt. 20.07.1993, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT J91413001N me seli në: Rruga Elbasanit, Tiranë.
- Shoqëria “HCT Boutique” Sh.p.k (City Hotel) regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.CN-460714-05-14, dt. 08.05.2014, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT L41629007G me seli në: Rruga Ismail Qemali, Tiranë.
- Shoqëria “7 Seven Group ” Sh.p.k (Seven Hotel) regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.CN-112205-01-08, dt. 20.10.1994, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT L41629007G me seli në: Rruga e Kavajës, Tiranë.
- Shoqëria “Livia 2006” Sh.p.k (Livia Hotel) regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.37029, dt. 05.10.2006, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT K31809008K me seli në: Rruga Qemal Stafa, Tiranë.

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

- Hotel NOBEL, regjistruar si person fizik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nr CN-084196-06-15, datë 09.06.2015, me adresë Rr.Urani Pano, Tiranë.
- Hotel FIRENZE, regjistruar si person fizik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nr CN-542211-04-11, datë 22.04.2011, me adresë Bulevardi Zogu i Parë, Tiranë.
- Hotel EUROPA, regjistruar si person fizik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, nr CN-711932-11-14, datë 10.11.2014, me adresë Rr.Reshit Collaku, Tiranë.
- Hotel CAPITAL TIRANA, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane nr.CN-668415-01-12, datë 30.01.2012, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, me kapital 100% privat, me NIPT L12304018B me seli në: Rruga Qemal Stafa, Tiranë.

### III. STRUKTURA E TREGUT

5. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a. Tregu i produktit
- b. Tregu gjeografik

#### III.1. Tregu përkatës i produktit

6. Referuar parashikimeve në Ligjin Nr .9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin, neni 4, pika 8 parashikohet se: *"Hotel" është një ndërtesë, që ka jo më pak se 6 dhoma në dispozicion për akomodimin e përshtatshëm të udhëtarëve, ku ofrohet ushqim, pije dhe, nëse kërkohet, akomodim për çdo udhëtar, pa ndonjë kontratë të veçantë, që është i gatshëm të paguajë shumën e shpallur për shërbimet dhe mjediset. Mjediset duhet të përdoren për qëllime të ushtrimit të zanatit të hotelierit"*
7. Hotelet në Shqipëri janë të kategorizuara sipas “Yjeve”, gjithashtu dhe llojit të shërbimeve që mund të ofrojnë, duke përmendur salla konferencash, paketa shërbimi “Health & SPA”. Gjithashtu ndryshim cilësor përbën edhe qëllimi i qëndrimit të klientëve, të cilët frekuentojnë hotelet për qëllime pune ose turizmi.
8. Që nga vitit 2007 ligji “Për Turizmin”, nuk e parashikonte më kategorizimin dhe klasifikimin e strukturave akomoduese, duke sjellë një situatë kaotike në tregun e hotelerisë.
9. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *treg përkatës të produktit do të konsiderohen hotelet me 3 e më shumë yje.*

#### III.2. Tregu përkatës gjeografik

10. Për efekt të ankesës janë inspektuar dhe përfshirë në procedurë hetimore të gjitha hotelet e paraqitura nga ankimesi në territorin e Republikës së Shqipërisë



ndërkohë që treg përkatës sipas përcaktimeve të nenit 3 pika 7 si të zëvendësueshëm me hotel “Tirana” janë vetëm hotelet me 3 dhe më shumë yje në zonën gjeografike të Tiranës.

#### **IV. SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG**

11. Grupi i punës ka realizuar inspektime (Dawn Raids) në ndërmarrjet objekt hetimi për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të mundshme midis konkurrentëve për fiksime të çmimeve të shërbimit të hotelerisë. Grupet e punës kërkuan shenja (indicie) në lidhje me shkëmbimin e informacioneve dhe statistikave mbi numrin e dhomave të lira, numrin e klienteve apo dhe çmimin e ditës për dhomat e mbetura ose shpërndarjen e klientëve në hotelet në të njëjtën zonë gjeografike.
12. Gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë provë apo evidencë direkte apo indirekte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).
13. Në vijim të procedurës, grupi i punës ka kryer analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjellje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të ofrimit të shërbimit në tregun e hotelerisë.
14. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e ofrimit të shërbimit ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet e të njëjtës kategori, kanë aplikuar çmime të njëjta ofrimi të shërbimit gjatë periudhës objekt hetimi. Në vlerësimin e çmimeve të aplikuara nga ndërmarrjet për gjatë vitit 2014 është marrë në konsideratë çmimi i ofrimit të shërbimit që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave të administruara gjatë fazës së inspektimit.
15. Gjatë procedurës së hetimit janë monitoruar të gjitha domain-et (faqet zyrtare) të hoteleve nën hetim, pasi sipas ankimesit ndërmarrjet e përmendura përdorin në mënyrë abuzive dhe të paautorizur emrin tregtar dhe markën tregtare të regjistruar “Hotel Tirana”. Nga monitorimi rezulton se përveç hoteleve “Sky Hotel”, “Hotel Rogner” dhe “Hotel Diplomat”, të gjithë hotelet e tjera përdorin fjalën “tirana” si pjesë përbërëse të adresës së tyre të internetit, duke krijuar kështu konfuzion gjatë kërkimit në internet nga klientët për rezervimet online.
16. Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim si dhe nga analiza e sjelljes të këtyre ndërmarrjeve, rezulton se nuk janë gjetur evidencë direkte ose indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun objekt hetimi. Pra, nuk jemi në kushtet e shkeljes së mundshme të nenit 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 69 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

nenit 12 dhe nenit 21, pika 4 të Rregullores së “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

**V E N D O S I:**

- I. Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë, pasi nuk evidentohen shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. T’i rekomandojë AKEP diversifikimin e domaineve të hoteleve për të mundësuar një informacion simetrik për klientët që bëjnë rezervimin online dhe për të shmangur mbivendosjet që shkaktohen nga ngjashmëritë e domain-eve.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete Gruda**  
(                    )  
**Zv.Kryetar**

**Koço Broka**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**Nr. 372 Datë 04.09.2015**

**“Mbi**

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Raiffeisen Leasing Sh.a të portofolit të qirasë financiare të Tirana Leasing Sh.a”**

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare
- Servete GRUDA Zv/Kryetare
- Eduard YPI Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2015, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka dhe Z. Eduard Ypi, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Raiffeisen Leasing Sh.a të Portofolit të Qirasë Financiare të Tirana Leasing Sh.a.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet, 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Plotë “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Raiffeisen Leasing Sh.a/Tirana Leasing Sh.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

## **V Ë R E N S E:**

### **1. Transaksioni dhe përqendrimi**

“Marrëveshja për shitjen dhe transferimin e portofolit të qirasë financiare” është nënshkruar ndërmjet palëve Raiffeisen Leasing Sh.a në cilësinë e Blerësit dhe Tirana Leasing Sh.a në cilësinë e Shitësit, më datë 24 Qershor 2015.

Paraprakisht Shitësi ka krijuar një portofol qiraje financiare të përbërë nga marrëveshje qiraje financiare për makina private, kamionë dhe autobusë, furgonë të vegjël dhe pajisje të rënda .

Sipas Marrëveshjes, Shitësi dëshiron t’i shesë, transferojë dhe çedojë të gjithë portofolin dhe Blerësi dëshiron të blejë, t’i transferohet dhe t’i çedohet ky portofol, në kushtet ku ky portofol përbën njëkohësisht edhe të gjithë aktivitetin financiar të Shitësit. Pas realizimit të kësaj marrëveshjeje Raiffeisen Leasing Sh.a bëhet pronar i vetëm dhe i ligjshëm i portofolit të qirasë financiare me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin prej tij.

Operacioni i transferimit të portofolit të qirasë financiare, i cili përbën edhe të gjithë aktivitetin e Tirana Leasing Sh.a, tek Raiffeisen Leasing Sh.a, në formën e transferimit të aseteve përbën një përqendrim në bazë të nenit 10, pika 1, gërma b dhe nenit 10, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (këtu e në vijim Ligji).

## 2. Palët në transaksion

**Raiffeisen Leasing Sh.a (Raiffeisen Leasing):** në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit bankar shqiptar me seli në adresën: Blv “Bajram Curri” ETC, kati 10, Tiranë. Shoqëria është liçencuar si subjekt financiar jo-banke nga Banka e Shqipërisë me liçencë nr.13, datë 15.07.2009 për të ushtruar veprimtarinë e qirasë financiare. Objekti i shoqërisë është: (i) ushtrimi i veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme; (ii) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre; (iii) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare; (iv) të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajtshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna me qira financiare). Shoqëria ka të drejtën të themelojë filiale ose degë brenda vendit dhe të blejë pjesëmarrje në çfarëdolloj mënyre ligjore në shoqëri të tjera tregtare, si dhe të realizojë projekte tregtare së bashku me subjekte të tjera tregtare.

**Tirana Leasing Sh.a (Tirana Leasing):** në cilësinë e **Shitësit** është një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit bankar të RSh-së, me seli në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova” nr.1/1, Tiranë. Shoqëria është liçencuar nga Banka e Shqipërisë me Liçencë nr. 14, datë 11.12.2009 si subjekt financiar jo-bankë për të shtruar veprimtarinë e qirasë financiare. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është përfshirja dhe kryerja në Shqipëri dhe jashtë saj e të gjitha veprimtarive (transaksioneve) që janë të lejueshme konform ligjeve përkatëse dhe rregulloreve të autoriteteve përkatëse të rregullimit të veprimtarisë për liçensimin e subjekteve jo-banka. Aktiviteti është ushtrimi i qirasë financiare dhe për arritjen e këtij qëllimi shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose cilëndo tjetër, brenda ose jashtë vendit.

## 3. Xhiro për vitin 2014.

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXX Lekë**.
  - Raiffeisen International Group: XXX Euro = XXX Lekë;
  - Piraeus Bank Group: XXX Euro = XXX Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm** është **XXX Lekë**:
  - Raiffeisen Bank Sh.a : XXX Lekë;
  - Raiffeisen Leasing Sh.a XXX Lekë;
  - Tirana Bank Sh.a : XXX Lekë;
  - Tirana Leasing Sh.a: XXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit.

## 4 Analiza e konkurrencës

### 4.1 Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, si edhe Udhëzimit Nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- V). tregu përkatës i produktit, dhe
- VI). tregu përkatës gjeografik.

**Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘qiraja financiare/ leasing’.

**Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

#### 4.2 Struktura e Tregut

Portofoli i qirasë financiare ofrohet nga subjekte financiare banka dhe subjekte financiare jobanka.

Për vitin 2014, subjektet financiare jobanka kanë realizuar në tregun përkatës vlerën e 7 160 520 000 Lekë. Rezultati i subjekteve financiare jobanka përbën rreth 6.7% të rezultatit të sistemit bankar, gjë që tregon peshën e vogël që zënë këto subjekte në gjithë sistemin financiar në vendin tonë.

Përveç subjekteve financiare jobanka, aktivitetin e qirasë financiare për vitin 2014 e kanë ushtruar dhe 3 banka të nivelit të dytë, përkatësisht Banka e Parë e Investimeve, Credins Bank dhe Banka Societe Generale Albania<sup>39</sup>.

**Tabela 5.** Pjesët e tregut të subjekteve financiare të cilat ushtrjnë aktivitetin e qirasë financiare për vitin 2014.

Raiffeisen Leasing Sh.a. kryeson tregun me XX% të portofolit të qirasë financiare. Ky subjekt ndiqet nga Tirana Leasing e cila zë XX% të këtij portofoli. Në total, pjesa e kombinuar e tregut të këtyre dy subjekteve pas përqendrimit arrin në XX%.

Indeksit i përqendrimit HHI tregon se tregu i qirasë financiare është një treg shumë i përqendruar. Para transaksionit ky tregues shënonte një vlerë prej HHI = 2648, ndërsa pas transaksionit me pjesën e re të kombinuar të palëve ky indeks shënon vlerën prej HHI= 4447 me një  $\Delta = 1799$ , duke treguar një rritje të ndjeshme të fuqisë së tregut të Blerësit pas realizimit të tij.

Pjesa e tregut më e madhe se 50%, në vetvete përbën një provë të ekzistencës së një pozicioni dominant në treg. Megjithatë për vlerësimin e efekteve që sjell në tregun përkatës rritja e fuqisë së tregut të Blerësit, sipas udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, duhet të vlerësohet edhe reagimi i konkurrentëve më të vegjël të cilët veprojnë duke influencuar në kufizimin e ndjeshëm nëpërmjet aftësisë dhe nxitjes për të rritur ofertat e tyre<sup>40</sup>.

Duke patur parasysh: përqendrimin e produktit të qirasë financiare kryesisht tek mjetet e transportit për punë dhe personale – (të cilat zënë rreth 81% të qirasë financiare të dhënë ngasubjektet financiare jo bankare), si dhe; ekzistencën e një shkalle të lartë zëvendësueshmërie ndërmjet produkteve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim dhe atyre të ofruara nga aktorët e tjerë në këtë treg, atëherë Blerësi, pas realizimit të këtij transaksioni do të jetë i ndikuar nga ofertat e konkurrentëve të tij në tregun përkatës.

<sup>39</sup> Shkresa Nr. 334/8 Prot., dt 07.08.2015, Kthim përgjigje nga Banka e Shqipërisë.

<sup>40</sup> Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, pika 10.

Në tregun e qirasë financiare operojnë edhe banka të nivelit të dytë – pjesë e grupeve bankare me një shtrirje rajonale dhe më gjerë, të cilat në kushtet kur tregu do të hasëj me rritje të çmimeve nga ana e palëve pjesëmarrëse në përqendrim, këto të fundit i kanë kapacitetet e mjaftueshme të rrisin ofertën e tyre nëse do të shihnin me leverdi zgjerimin e aktivitetit në këtë treg. Pra, këta konkurrentë do të rrisnin kështu presionin konkurrencial ndaj ndërmarrjes së përqendruar.

Për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të kontratave të qirasë financiare, mund të thuhet se ky treg do të paraqitet sërish dinamik, pasi pjesa aktuale e kombinuar e tregut pas përqendrimit do të jetë e përkohshme deri në përfundimin e kontratave aktuale me klientët.

#### ***4.3 Konkurrenca potenciale, barrierat në hyrje***

Pavarsisht nivelit të lartë të përqendrimit, tregu i qirasë financiare përbën një treg të hapur me një numër të konsiderueshëm lojtarësh potencialë<sup>41</sup>.

Për vlerësimin e konkurrencës potenciale merren në konsideratë faktorë të tillë: si barrierat e hyrjes, reagimet e mundshme të ndërmarrjes më të madhe në treg dhe konkurrentëve të tjerë, si dhe risku dhe kosto e falimentimit.

Banka e Shqipërisë, bazuar në Ligjin 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ka autoritetin për të liçensuar dhe mbikqyrur bankat, subjektet financiare jobanka (të pranishme në tregun e qirasë financiare), shoqëritë e kursim kreditit e unionet e tyre, zyrat e këmbimit valutor dhe zyrat e përfaqësimit. Liçensimi i subjekteve financiare jobanka bazohet në rregulloren ‘Për liçensimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka’, miratuar me vendim nr. 01 datë 17.01.2013 të Këshillit të Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë. E drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë financiare lind vetëm pasi subjekti pajiset me liçensë ose merr miratimin përkatës nga Banka e Shqipërisë.

Referuar rregullores së sipërpërmendur shuma përkatëse e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për t’u liçensuar si subjekt financiar jobankë për qiranë financiare është 20,000,000 (njëzet milionë) lekë. Liçensa është e pakufizuar në kohë, e patjetërsueshme dhe e patjetërsueshme.

Përsa i takon afatit kohor brenda të cilit një subjekt mund të pajiset me liçensë për të ushtruar veprimtarinë e qirasë financiare, Banka e Shqipërisë jep ose refuzon dhënien e liçensës si subjekt financiar jobankë, si institucion mikrokredie ose si institucion i parasë elektronike, brenda 2 (dy) muajve nga data e pranimit të kërkesës për liçensë.

Përsa më sipër, mund të thuhet se ky treg nuk ka pengesa të konsiderueshme në hyrje për subjektet e reja të cilat duan të hyjnë në këtë treg, subjekte financiare banka, subjekte financiare jo banka apo qoftë për kompanitë importuese të automjeteve të cilat duan të zgjerojnë aktivitetin e tyre dhe në këtë treg, në vendin tonë.

Ky transaksion nuk e vendos ndërmarrjen e përqendruar në një pozicion të tillë, i cili i jep mundësi asaj të vështirësojë zgjerimin e ndërmarrjeve më të vogla dhe

---

<sup>41</sup> Shkresës Nr 334/10 Prot., datë 08.2015, të Bankës së Shqipërisë “Kthim përgjigje” të shkresës Nr 334/9 Prot. datë 10.08.2015.

konkurrentëve potencialë<sup>42</sup>, apo të kufizojë aftësinë e aktorëve të tjerë në treg për të konkurruar.

#### ***4.4 Fuqia kundërvepruese e aktorëve në treg***

Sipas Bankës së Shqipërisë<sup>43</sup>, bankat që operojnë në vend, në kushtet e tepricës së fondeve likuide me kosto më të ulët, evolimit dhe zhvillimit të tregut po përfshihen gjithnjë e më shumë në këtë aktivitet. Nga ana tjetër, subjektet financiare jobanka do të duhet të përdorin avantazhet e tyre konkurruese si institucione specifiku siç janë specializuara dhe të dedikuara në këtë aktivitet, apo lehtësitë rregullatore për të vijuar me zgjerimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti.

Vetë tregu i qirasë financiare mund të cilësohet si një treg i vogël (me portofol me më pak se 8 mld lekë) dhe ende në zhvillim në vendin tonë sidomos për blerjen e automjeteve, dhe për makineritë e pajisjet e bizneseve. Referuar totalit të portofolit të qirasë financiare dhe produkteve të ofruara në këtë treg mund të thuhet se blerësit janë të pakët në numër. Marrëdhënia ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit është e bazuar mbi bazën e një kontrate në të cilën janë përcaktuar elementë të rëndësishëm si pagesat dhe peridiociteti i tyre, kohëzgjatja, mbulimi i risqeve etj. Në këto kushte është e qartë, që si fuqia e qiradhënësit ashtu dhe ajo e qiramarrësit për të ndryshuar termat është e kufizuar nga përmbajtja e kontratës së lidhur mes tyre.

#### ***4.5 Përfitimet e konsumatorëve***

Konsumatorët do të përfitojnë drejtëpërdrejtë apo tërthorazi nga ky transaksion. Rrjeti i zgjeruar i Raiffeisen Leasing sh.a. dhe kanalet e tij të shpërndarjes dhe promovimit do të përmirësojnë gamën dhe cilësinë e shërbimeve në lidhje me kontratat e qirasë financiare. Konsumatorët do të kenë mundësi të përfitojnë nga niveli i shërbimeve që ofron Raiffeisen Leasing sh.a. si kompani lider me eksperiencë të gjatë.

Gjatë analizës së efekteve të këtij këtij transaksioni në tregun përkatës është marrë në konsideratë edhe ndikimi në stabilitetin financiar të këtij përqëndrimi. Për këtë arsye i kemi referuar edhe Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar<sup>44</sup>, sipas të cilit, ecuria dhe qëndrueshmëria financiare e bankave shqiptare me kapital grek është vendosur në fokus të veprimtarisë mbikqyrëse të Bankës së Shqipërisë. Fuqizimi i rezervave të likuiditetit dhe ulja e mëtejshme e peshës së bankave shqiptare me kapital grek në tregun shqiptar janë pjesë e strategjisë mbikqyrëse. Në vijim, mundësia e shitjes së një pjese të aseteve të këtyre bankave tek operatorët e tjerë të tregut financiar me kapital grek është vlerësuar si një instrument praktik që i shërben kësaj strategjie. Në fakt, vlerësohet që realizimi i shpejtë i këtij transaksioni është i rëndësishëm për ruajtjen e vlerës së aseteve që tregtohen, për qëndrueshmërinë e treguesve financiarë të palëve dhe në përgjithësi për mirëfunksionimin e tregut.

Banka e Shqipërisë vlerëson që përthithja e mundshme e Tirana Leasing sh.a nga Raiffeisen Leasing sh.a nuk do të ndikonte ndjeshëm konkurrencën në tregun e

<sup>42</sup> Referuar Bankës së Shqipërisë, Shkresa nr. Prot.334/10, datë 08.2015, aktualisht në Republikën e Shqipërisë janë licencuar për kryerjen e aktivitetit të qirasë financiare jo vetëm subjekte financiare jo banka, ekskluzivisht të përfshira në skemën e këtij aktiviteti por edhe të gjitha bankat tregtare të cilat operojnë në vend.

<sup>43</sup> Shkresa Nr. 334/10 Prot., datë 18.08.2015

<sup>44</sup> Njoftimi për shtyp i GKSF, datë 07.07.2015,

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

qiradhënies financiare si në aspektin e klientëve të synuar ashtu edhe në llojin e portofolit të qiradhënies të subjekteve pjesëmarrëse<sup>45</sup>.

Për sa mësipër, pavarësisht se transaksioni objekt shqyrtimi sjell rritje të nivelit të përqendrimit të Blerësit në tregun përkatës, analiza e konkurrencës tregon që ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun përkatës.

**PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar):

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga Raiffeisen Leasing Sh.a të Portofolit të Qirasë Financiare të Tirana Leasing Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetare**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**nr. 373 , datë 16.09.2015**

**“Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”**

<sup>45</sup> Sipas shkresës nr 334/10 prot., datë 18.08.2015, Banka e Shqipërisë



Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare
- Servete GRUDA Zv/Kryetare
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtare
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16. 09.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të monitorimit në tregut bankar.

**Baza ligjore:** Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 41 (pika1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 3 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të raportit të monitorimit në tregut bankar si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

#### **VËREN SE:**

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), ka realizuar një monitorim në tregun bankar.
2. Gjatë viteve të fundit tregu bankar paraqet karakteristikat e një tregu me norma relativisht të larta fitimi në kushtet e stanjacionit të kreditimit; interesa shumë të ulta të depozitave (deri në 0.55 % mbi bazë vjetore nën nivelin e inflacionit); diferenca (spread) relativisht të larta mes interesave të kredive dhe depozitave; tendencës në rritje të interesave të letrave me vlerë të qeverisë, kryesisht afatgjata (obligacione) në kushtet e një politike lehtësuese monetare dhe kur norma bazë e interesit të depozitave kanë tendencë në rënie; ka rritje të komisioneve për pagesat kryesisht brenda vendit etj.
3. Këto rrethana të bëjnë të mendosh që konkurrenca në sektorin bankar mund të jetë kufizuar ose shtrembëruar si rezultat dhe/ose pasojë e shkeljes së nenit 4 (marrëveshje të ndaluara) dhe/ose nenit 9 (abuzim me pozitën dominuese) të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), 26 dhe 41 (pika1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 3 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

**V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar për të vlerësuar nëse konkurrenca në këtë sektor është e kufizuar ose e shtrembëruar si pasojë e sjelljes së një ose disa bankave.
- II. Hetimi i përgjithshëm të përfshijë periudhën kohore: vitin 2014 dhe nëntëmujori 2015.
- III. Procedura e hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar dhe dorëzimi i raportit të hetimit të bëhet jo më vonë se 6 muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Autoriteti i Konkurrencës do të asistohet nga një ekspert i sektorit bankar në realizimin e hetimit të përgjithshëm në formën e një studimi tregu të orientuar nga vlerësimi i nivelit të konkurrencës sipas tregjeve përkatëse të produkteve/shërbimeve bankare.
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

**Iva Zajmi**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv.Kryetare**

**Anëtar**

**Anëtare**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**Nr. 374 , datë 8.10.2015**

**Për miratimin e udhëzimit**  
**“Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqëndrimeve”**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete GRUDA       | Anëtar  |
| • Koço BROKA          | Anëtar  |
| • Iva ZAJMI           | Anëtar  |
| • Eduard YPI          | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Projekt-Udhëzimit “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ( i ndryshuar);

**Baza ligjore:** Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja d), dh), neni 61 dhe Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt - Udhëzimit “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”, si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm te Autoritetit te Konkurrences,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Udhëzimin “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky Udhëzim është hartuar duke përshtatur dhe përfaruar Udhëzimin e BE-së; “Njoftimi i Komisionit mbi masat e pranueshme sipas rregullores së Këshillit nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit nr 802/2004” ((52008XC1022(01), OJ C 267, 22.10.2008, p.1-27)
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(                    )  
**Zv/Kryetar**

**Koço Broka**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard Ypi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

**K R Y E T A R**

## UDHËZIM

### **Për kushtet dhe detyrimet ne rastet e përqendrimeve<sup>46</sup>**

#### **I. Hyrje**

1. Bazuar në nenin 61 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ( i ndryshuar), janë parashikuar rastet e përqendrimeve me kushte dhe detyrime. Komisioni i Konkurrencës mund t’i bashkojë vendimit të tij masa, me qëllimin që të sigurojë se ndërmarrja në fjalë bie dakord me këto angazhime të rëna dakord *vis a vis* (përballë) me Komisionin e Konkurrencës (këtu e në vijim Komisioni) me synimin për realizuar përqendrimin.<sup>47</sup>
2. Qëllimi i këtij Udhëzimi, është përcaktimi i udhëzimeve mbi angazhimet që marrin përsipër ndërmarrjet që janë të interesuara për ndryshimin dhe autorizimin e përqendrimit. Të tilla ndryshime cilësohen si “masa (remedies)” derisa synimi i tyre është të eliminojnë shqetësimet/problemet mbi konkurrencën<sup>48</sup> të identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës.
3. Udhëzimi, përcakton:
  - a) parimet e përgjithshme që zbatohen për masat që pranohen nga Komisioni;
  - b) llojet kryesore të angazhimeve që mund të pranohen nga Komisioni;
  - c) kërkesat e veçanta për të cilat propozimet e angazhimeve nevojitet të përmbushin në të dy fazat e procedurës; si dhe
  - d) kërkesat kryesore për zbatimin e angazhimeve.

Në çdo rast, Autoriteti i Konkurrencës do të marrë në konsideratë rrethanat e veçanta rast pas rasti.

---

<sup>46</sup> 52008XC1022(01), Njoftimi i Komisionit mbi masat e pranueshme sipas rregullores së këshillit nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit nr 802/2004 (OJ C 267, 22.10.2008, p.1-27)

<sup>47</sup> Kur një ndërmarrje modifikon një përqendrim të njoftuar, në veçanti duke ofruar angazhime, Autoriteti duhet të jetë në gjendje që ta deklarojë përqendrimin si të ndryshuar. Angazhime të tilla duhet të jenë në proporcion me problemet e konkurrencës dhe ti eliminojnë tërësisht ato. Angazhimet duhet të pranohen para fillimit të procedurave kur problemet e konkurrencës janë të identifikueshme dhe mundet lehtësisht të rregullohen nëpërmjet kushteve dhe detyrimeve.

<sup>48</sup> Termi “shqetësimet të konkurrencës” sipas fazës dhe procedurave, lidhet me dyshime serioze ose gjetje paraprake që përqendrimi ka shumë të ngjarë të pengojë efektivisht konkurrencën në treg ose në një pjesë domethënëse të tij, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

## II. Parimet e përgjithshme

1. Autoriteti i Konkurrencës (këtu e vijim- Autoriteti) vlerëson pajtueshmërinë e përqendrimit të njoftuar me kushtet e tregut, dhe efektet që sjell mbi strukturën e konkurrencës në treg. Testi për pajtueshmërinë përcaktohet në nenin 5 të Rregullores “Për Zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” (këtu e vijim- “Rregullorja e Përqendrimeve”), nëse është një përqendrim, i cili rrezikon të pengojë në mënyrë domethënëse konkurrencën në treg, ose në një pjesë të rëndësishme të tij, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.
2. Kur një përqendrim, krijon shqetësime për konkurrencën në lidhje me faktin se mundet të pengojë në mënyrë domethënëse konkurrencën efektive, në veçanti si rezultat i krijimit (ose forcimit) të pozitës dominuese, palët mund të kërkojnë që të ndryshojnë/modifikojnë përqendrimin me qëllim që të zgjidhin shqetësimet e konkurrencës dhe kështu të përftojnë autorizimin për përqendrimin e tyre. Të tilla modifikime, mundet të jenë plotësisht të zbatueshme edhe para marrjes së vendimit të autorizimit. Megjithatë, është më tepër e zakonshme që palët të paraqesin angazhime me synimin për ta bërë këtë përqendrim të pajtueshëm me tregun dhe që këto angazhime të zbatohen duke ndjekur autorizimin e dhënë.
3. Sipas strukturës së “Rregullores së përqendrimeve”, Autoriteti vlerëson nëse një përqendrim pengon në mënyrë domethënëse konkurrencën.<sup>49</sup> Autoriteti i komunikon shqetësimet e tij palëve, për ti lejuar ato që të formulojnë propozimet për masat e duhura dhe që i korrespondojnë rastit.<sup>50</sup> Është kjo koha, për palët në përqendrim, të sjellin angazhimet e tyre. Autoriteti nuk vendos në mënyrë të njëanshme ndonjë kusht tek vendimi i autorizimit, por vetëm mbi baza të angazhimeve të propozuara të palëve.<sup>51</sup> Autoriteti informon palët në lidhje me vlerësimin e tij paraprak për propozimet për masa. Megjithatë, nëse palët nuk propozojnë masa të vlefshme, të përshtatshme për eliminimin e shqetësimeve/problemeve të konkurrencës, mundësia e vetme e Komisionit do të jetë mosdhënia e autorizimit të përqendrimit.<sup>52</sup>
4. Autoriteti vlerëson nëse masat e propozuara, pasi të zbatohen, eliminojnë shqetësimet e identifikuar të konkurrencës. Vetëm palët, japin informacionin përkatës të nevojshëm për një vlerësim të tillë, në veçanti për kryerjen e angazhimeve të propozuara. Sa më sipër, është përgjegjësia e palëve që të ofrojnë një informacion të tillë të vlefshëm, që është i nevojshëm për vlerësimin e propozimeve të masave. Rregullorja e Përqendrimeve detyron palët njoftuese që të ofrojnë informacion të detajuar për përmbajtjen e angazhimeve, kushtet për zbatimin e tyre si dhe të tregojnë përshtatshmërinë për të zhvendosur ndonjë pengesë domethënëse të konkurrencës efektive, ashtu siç përcaktohen në aneksin e rregullores zbatuese (‘Formulari). Për angazhimet që kanë të bëjnë me shitjen e një biznesi, palët duhet të

<sup>49</sup> Në fazën e parë dhe përpara dërgimit të Raportit të Hetimit) kjo korrespondon me dyshime serioze të tilla si pengimi domethënës i konkurrencës efektive.

<sup>50</sup> Rregullorja e përqendrimeve parashikon fazat formale ku palët informohen për shqetësimet e konkurrencës nga Autoriteti (Raporti i Hetimit). Në praktikë më të mira të DG COMPETITION, procedurat e kontrollit të përqendrimeve të Komisionit Evropian parashikon se takimet/mbledhjet që (*state of play*) zhvillohen normalisht do të bëhen në fazat kyçe të procedurës, kur Komisioni do të shpjegojë shqetësimet e tij me qëllim që ti lejojë palëve që të përgjigjen me propozime për kushte dhe detyrime. [2005] ECR II-3745, paragrafi 105. [1999] ECR II-753.

përshkruajnë në detaje, në veçanti se si biznesi që do të shitet, është duke operuar/ushtruar aktivitetin për momentin. Ky informacion, i mundëson Autoritetit që të vlerësojë përshtatshmërinë, konkurrueshmërinë dhe tregtinë e biznesit duke krahasuar veprimtarinë ekonomike të tanishme të tij, me qëllimin që kërkohet të arrihet sipas këtyre angazhimeve. Autoriteti kërkon informacion të saktë dhe diskuton paraprakisht me palët në lidhje me qëllimin e informacionit të kërkuar kur dorëzohet formulari i njoftimit.

5. Kur palët kanë për të propozuar angazhime, për të zhvendosur problemet e konkurrencës dhe dorëzojnë informacionin e nevojshëm për vlerësimin e tyre, Komisioni duhet të vendosë nëse një përqendrim, i modifikuar nga angazhimet e dorëzuara, duhet të deklarohet si i papajtueshëm me tregun, sepse ai çon, pavarësisht angazhimeve, në një pengesë domethënëse të konkurrencës efektive. Barra e provës për ndalimin ose autorizimin e një përqendrimi të modifikuar/ndryshuar nga angazhimet, është subjekt i të njëjtit kriter ashtu si dhe një përqendrim i cili nuk është modifikuar.

### ***Kushtet bazë për angazhime të pranueshme***

1. Vetëm Komisioni ka të drejtën që të pranojë angazhime të afta ta bëjnë një përqendrim të pajtueshëm me tregun, duke ndaluar kështu një pengesë domethënëse të konkurrencës efektive. Angazhimet, duhet të eliminojnë shqetësimet e konkurrencës tërësisht dhe duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe efektive. Për më tepër, angazhimet duhet të jenë në gjendje që të zbatohen plotësisht në mënyrë efektive brenda një kohe të shkurtër, duke qenë se kushtet e konkurrencës në treg nuk do të jenë në gjendje të qëndrojnë njësoj derisa angazhimet të jenë përmbushur.
2. Angazhimet strukturore, në veçanti shitjet e propozuara nga palët do të plotësojnë këto kushte vetëm për sa kohë Autoriteti do të jetë në gjendje që të arrijë në përfundimin e saktë se ato do të zbatohen dhe se ka të ngjarë që struktura e re e tregut që rezulton nga kjo, do të jetë mjaftueshmërisht operative dhe e qëndrueshme për të siguruar se është eliminuar pengesa domethënëse e konkurrencës.
3. Shkalla e kërkuar e sigurisë, për sa i përket zbatimit të angazhimeve të propozuara, mundet në veçanti të ndikohet nga rreziku në lidhje me transferimin e biznesit që do të shitet, të tilla si kushtet bashkëlidhur nga palët për shitje, të drejtat e palëve të treta në lidhje me biznesin ose rrezikun e gjetjes së blerësit të përshtatshëm, ashtu si dhe rreziku në lidhje me degradimin e asetëve derisa të kryhet shitja. Është një mbështetje për palët që të zhvendosin të tilla pasiguri për zbatimin e masave, kur i depozitojnë ato pranë Autoritetit.<sup>53</sup>
4. Në vlerësimin e kushtit të dytë, nëse angazhimet e propozuara do të eliminojnë shqetësimet e identifikuar të konkurrencës, Autoriteti merr në konsideratë faktorë të tjerë përkatës që lidhen me masat e propozuara, përfshirë ndër të tjera (*inter alia*), llojin, shkallën dhe qëllimin e masave të propozuara, gjykuar

<sup>53</sup> Në varësi të natyrës së riskut, një kujdes i veçantë mund të ketë për qëllim kompensimin nga to. P.sh. Risku që ngrihet nga të drejtat e palëve të treta në lidhje me asetet që do të shiten, mund të kompensohet nga propozimet e një shitjeje alternative.

nga struktura dhe në veçanti nga karakteristikat e tregut, për të cilat janë ngritur shqetësimet e konkurrencës, përfshirë edhe pozicionin e palëve dhe lojtarëve të tjerë në treg.

5. Me qëllim që angazhimet të përputhen me këto parime, duhet të ketë një zbatim efektiv dhe mundësi për të monitoruar këto angazhime. Pasi kryhet një shitje, nuk ka nevojë për masa të tjera monitoruese, ndërkohë që për lloje të tjera angazhimesh, kërkohet një monitorim efektiv të mekanizmave për arritjen e angazhimeve, me qëllim që të ofrohet siguria e mjaftueshme që efektet e këtyre angazhimeve nuk janë reduktuar apo eliminuar nga palët. Pra, angazhime të tilla duhet të konsiderohen si deklarata të thjeshta të palëve dhe nuk do të llogariten si detyruese, përderisa mungojnë mekanizmat efektiv monitorues.
6. Kur palët depozitojnë masa, të cilat janë kaq gjithëpërfshirëse dhe komplekse, duke bërë të pamundur që Komisioni të përcaktojë në një shkallë të kërkuar sigurie, në kohën e vendim-marrjes së tij, që ato do të zbatohen plotësisht dhe që do të ruhet konkurrenca efektive në treg, vendimi i autorizimit nuk mund të jepet. Komisioni mund të refuzojë masa të tilla në veçanti duke u bazuar në faktin se zbatimi i këtyre masave nuk mund të monitorohet efektivisht dhe që mungesa e monitorimit efektiv, zvogëlon ose edhe eliminon, efektin e angazhimeve të propozuara.

#### ***Përshtatshmëria e llojeve të ndryshme të masave***

1. Qëllimi kryesor i angazhimeve, është të sigurojë konkurrencë në strukturat e tregut. Angazhimet të cilat janë strukturore për sa i përket natyrës së tyre, të tilla si angazhimet për të shitur një njësi të biznesit, janë si rregull i përgjithshëm, më të preferuara, parë nga këndvështrimi i objektivave të rregullores së përqendrimeve duke qenë se angazhime të tilla parandalojnë, në kohë të zgjatur, shqetësimet e konkurrencës të cilat do të krijoheshin nga përqendrimi i njoftuar si i tillë, dhe nuk kërkojnë masa monitoruese në terma afatshkurtër apo afatgjatë. Pavarësisht, kjo nuk do të thotë se lloje të tjera angazhimesh nuk janë në gjendje që të eliminojnë shqetësimet e konkurrencës.
2. Komisioni përcakton llojet e masave të cilat janë të përshtatshme për të eliminuar shqetësimet e identifikuar të konkurrencës, rast pas rasti.
3. Një dallim i përgjithshëm mund të bëhet ndërmjet shitjeve, masave të tjera strukturore ( të tilla si dhënia e aksesit për infrastrukturën kryesore ose inputet në terma jo diskriminuese) dhe angazhimeve në lidhje me sjelljet e ardhshme të njësisë së përqendruar. Angazhimet e shitjeve, janë mënyra më e mirë për eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës që rezultojnë nga mbivendosja horizontale dhe mund të jenë mënyra më e mirë për të zgjidhur problemet e përqendrimeve vertikale ose konglomerate. Të tjera angazhime strukturore mund të jenë të përshtatshme për zgjidhjen e të gjitha shqetësimeve, nëse këto masa janë ekuivalente me masat e shitjeve për sa i përket efekteve të tyre. Angazhimet në lidhje me sjelljen e ardhshme të njësisë së përqendruar, mund të jenë të pranueshme, vetëm në rastet përjashtimore në rrethana shumë specifike veçanta. Angazhimet në formën e mos-rritjes së çmimeve, për reduktimin e linjave të produkteve ose për zhvendosjen e markave etj, në

përgjithësi nuk eliminojnë shqetësimet e konkurrencës që rezultojnë nga mbivendosja horizontale. Në çdo rast, këto lloje masash, pranoen vetëm nëse realizueshmëria e tyre sigurohet plotësisht nga zbatimi dhe monitorimi efektiv i tyre, dhe nëse ato nuk rrezikojnë të çojnë në efekte shtrembëruese/penguese për konkurrencën.<sup>54</sup>

### **Procedura**

1. Komisioni mund të pranojë angazhime në secilën fazë të procedurës. Megjithatë, duke pasur parasysh që hetimi i thelluar i tregut është ndërmarrë vetëm në fazën e dytë, angazhimet e depozituara pranë Autoritetit në fazën e parë mund të jenë të mjaftueshme për eliminimin e “shqetësimeve serioze”.<sup>55</sup> Komisioni merr vendim, sapo shqetësimet e konkurrencës janë eliminuar, si rezultat i angazhimeve të depozituara nga palët. Ky rregull zbatohet për angazhimet e propozuara në fazën e dytë të procedurave, para se Autoriteti të nxjerrë raportin e hetimit. Nëse Autoriteti arrin në përfundimin se, përqendrimi çon në një pengesë domethënëse të konkurrencës efektive dhe nxjerr raportin e hetimit, angazhimet duhet të jenë të mjaftueshme për të eliminuar një pengesë të tillë domethënëse të konkurrencës efektive.
2. Ndërsa angazhimet duhet të ofrohen nga palët, Autoriteti do të sigurojë zbatueshmërinë e angazhimeve duke e bërë autorizimin e përqendrimit subjekt të përputhshmërisë me angazhimet. Një dallim duhet të bëhet ndërmjet masave (kushteve dhe detyrimeve). Kusht mund të jetë arritja e ndryshimeve strukturore të tregut (p.sh shitja e një biznesi). Hapat zbatuese të cilat janë të nevojshme për arritjen e këtyre rezultateve janë zakonisht detyrime për palët p.sh të tilla si caktimi i një administratori (administrator i besueshëm-*trustee*) me një mandat të parevokueshëm për të shitur biznesin.
3. Kur ndërmarrjet në fjalë, nuk zbatojnë detyrimin e vendosur, (nuk e kryejnë detyrimin) Komisioni mund të revokojë vendimin e dhënë. Në rastin e moskryerjes së detyrimit, palët mund të jenë gjithashtu subjekt i gjobave dhe pagesave të sanksioneve. Kur sidoqoftë, një kusht nuk është përmbushur (është prishur) d.m.th një biznes nuk shitet brenda kohës së parashikuar në angazhimet e marra ose edhe pasi shitet biznesi ri-përftohet, vendimi i pajtueshmërisë me angazhime nuk është më i zbatueshëm. Komisioni mundet:

- *së pari*, të marrë masa të ndërmjetme të përshtatshme për të mbrojtur konkurrencën efektive;

- *së dyti*, mundet, të urdhërojë çdo masë të përshtatshme për të siguruar së ndërmarrja në fjalë do të shpërbëjë përqendrimin, (ose të marrë masa të tjera).

Palët mundet gjithashtu të jenë subjekt i gjobave në këto raste.

### **III. Llojet e ndryshme të masave (kushteve dhe detyrimeve)**

#### **1. Shitja e bizneseve tek një shitës i përshtatshëm**

<sup>54</sup> P.sh angazhimet në lidhje me disa çmime sjelljeje të tilla si çmime kapak/mburojë të cilat përmbajnë riskun që të çojnë në sjellje anti-konkurrese të çmimeve ndaj konkurrentëve.

<sup>55</sup> Angazhimet në fazën e parë mund të pranoen vetëm në disa raste situatash të veçanta, .



Kur një përqendrim i propozuar, kërcënon të pengojë në mënyrë domethënëse konkurrencën, mënyra më e mirë efektive për të mbrojtur konkurrencën efektive, përveç ndalimit të përqendrimit, është krijimi i kushteve për shfaqjen/daljen e një njësie të re konkurruese ose forcimin e konkurrentëve ekzistues nëpërmjet shitjes nga palët pjesëmarrëse në një përqendrim.

## 2. Shitja e bizneseve konkurrues dhe të suksesshëm

1. Veprimtaritë që shiten, duhet të jenë një biznes i suksesshëm, që nëse administrohen nga një blerës i përshtatshëm, mund të konkurrojnë efektivisht me njësinë e re të përqendruar mbi baza të qëndrueshme.<sup>56</sup> Për një biznes të jetë i suksesshëm, mundet gjithashtu të jetë e nevojshme që të përfshijë aktivitete të cilat lidhen me tregje, ku Autoriteti nuk ka identifikuar më parë shqetësime të konkurrencës, nëse kjo, është kërkuar me qëllim që të krijojë një konkurrent efektiv në tregjet e prekura.
2. Propozimi që të shitet një biznes i suksesshëm, duhet të marrë në konsideratë pasiguritë dhe rreziqet që lidhen me transferimin e biznesit tek një pronar i ri. Këto rreziqe mund të kufizojnë ndikimin konkurrues të biznesit të shitur dhe kështu mund të çojnë në një situatë tregu ku shqetësimet e identifikuara të konkurrencës nuk do të eliminohen.

## 3. Qëllimi i biznesit për tu shitur

1. Biznesi, duhet të përfshijë të gjitha asetet të cilat kontribuojnë në operimin/aktivitetin e tij aktual ose të cilat janë të nevojshme për të siguruar suksesshmërinë dhe konkurrueshmërinë e tij, dhe të gjithë personelin i cili është i punësuar aktualisht ose që janë të nevojshëm për të siguruar suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit.<sup>57</sup>
2. Personeli dhe asetet të cilat aktualisht janë ndarë ndërmjet biznesit që do të shitet dhe bizneseve të tjera të palëve, por që kontribuojnë për operimin/aktivitetin e biznesit ose që janë të nevojshme për të siguruar suksesin dhe konkurrueshmërinë e tij, duhet gjithashtu të jenë përfshirë. Në të kundërt, sukcesi dhe konkurrueshmëria e biznesit që do të shitet, do të ishte në rrezik. Prandaj, biznesi i shitur duhet të përmbajë personelin që siguron funksionet kryesore të tij të tilla si p.sh grupi i kërkim zhvillimit dhe stafi i teknologjisë së informacionit edhe kur një personel i tillë aktualisht është i punësuar nga një njësi biznesi tjetër i palëve (të paktën deri në momentin e duhur që nevojitet për vijueshmërinë e aktivitetit të biznesit që shitet). Në të njëjtën mënyrë, asetet e përbashkëta duhet të përfshihen edhe nëse këto asete zotërohen ose janë shpërndarë tek një njësi tjetër biznesi.
3. Me qëllim që Autoriteti, të jetë në gjendje të identifikojë qëllimin e biznesit që do të shitet, palët duhet të përfshijnë një përcaktim të saktë të qëllimit të biznesit që do të shitet në angazhimet e tyre. (përshkrimi i biznesit ). Përshkrimi

<sup>56</sup> Kjo përfshin, sipas disa kushteve, biznese që janë krijuar nga bizneset e palëve ose asete individuale,

<sup>57</sup> Palët që njoftojnë një përqendrim duhet të ndërmarrin në angazhimet e tyre faktin që biznesi i cili do të shitet përfshin të gjitha asetet dhe personelin. Kur përshkrimi i detajuar i biznesit, që do të ofrohet palëve, në një kohë të mëvonshme shfaqet si e paplotë në këtë këndvështrim dhe palët nuk plotësojnë biznesin me asetet e nevojshme shtesë ose personelin, komisioni mund të revokojë vendimin me kusht që ka dhënë.

i biznesit duhet të përshtatet rast p.sh. rasti dhe duhet të përmbajë të gjithë elementët që janë pjesë e biznesit që do të shitet: asetet e trupëzuara (p.sh. kërkim zhvillimi, prodhimi, shpërndarja, shitjet dhe aktivitetet e marketingut) dhe ato të patrupëzuara (të tilla si të drejtat e pronësisë intelektuale, *know-how* dhe emri i mirë); licencat, lejet dhe autorizimet nga organet qeveritare, të dhënat e biznesit, kontratat, qiratë dhe angazhimet (p.sh. marrëveshjet e rëna dakord me furnizuesit dhe klientët) për qëllime përfitimi të biznesit që do të shitet; klientët, dhe çdo të dhënë tjetër etj. Në përshkrimin e biznesit, palët duhet të përfshijnë personelin që do të transferohet në terma të përgjithshëm, përfshirë edhe stafin dytësor dhe të punësuarit e përkohshëm si dhe të shtojnë një listë të personelit kryesor, d.m.th. personelin kryesor përgjegjës për suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit.

4. Në përshkrimin e biznesit, palët gjithashtu duhet të vendosin në lidhje me marrëveshjet e furnizimit të produkteve dhe shërbimeve nga ana e tyre për biznesin që shitet ose nga biznesi që shitet tek ata. Marrëdhënie të tilla të biznesit që shitet mund të jenë të nevojshme për të ruajtur suksesin e plotë ekonomik dhe konkurrueshmërinë e biznesit që shitet në periudhën transitore. Autoriteti do të pranojë të tilla marrëveshje, vetëm nëse ato nuk ndikojnë në pavarësinë e biznesit që shitet nga palët.
5. Me qëllim që të shmanget çdo keqkuptim, duhet që të jetë shprehimisht e parashikuar nga palët në tekstin e angazhimeve çdo e dhënë lidhur me biznesin që do të shitet, asetet ose personelin e punësuar nga biznesi, por që (sipas palëve) nuk duhet, të transferohet bashkë me procesin e shitjes. Autoriteti i pranon këto përjashtime të aseteve ose personelit, vetëm nëse palët qartësisht tregojnë se kjo nuk ndikon suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit.
6. Biznesi që do të shitet duhet të jetë i suksesshëm. Burimet e një blerësi të mundshëm ose të prezumuar të ardhshëm nuk merren në konsideratë nga Autoriteti në fazën e vlerësimit të masave (kushteve dhe detyrimeve). Situata është e ndryshme nëse gjatë procedurës, një marrëveshjeje shitjeje ose blerjeje me një blerës të veçantë, tashmë ka përfunduar dhe burimet e të cilit mund të merren në konsideratë në kohën e vlerësimit të angazhimeve.
7. Pas miratimit të vendimit të autorizimit dhe identifikimit të blerësit, disa nga asetet ose personeli i përfshirë në biznesin e shitur mund të mos jenë të nevojshëm nga blerësi i propozuar. Në procesin e miratuar të blerjes, Komisioni mundet mbi bazën e një kërkesë nga palët, të miratojë shitjen e biznesit tek blerësi i propozuar pa një ose më shumë asete ose pjesë të personelit, nëse kjo nuk ndikon në suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit që do të shitet, duke marrë në konsideratë burimet e blerësit të propozuar.

#### **4. Bizneset që qëndrojnë vetë (me baza të forta) dhe kushtet për pranueshmërinë e alternativave**

1. Normalisht, një biznes i suksesshëm është një biznes i cili mund të ushtrojë aktivitet mbi baza të vet-qëndrueshme çka nënkupton në mënyrë të pavarur nga palët në përqendrim për sa i përket ofrimit të materialeve të lëndës së parë ose formave të tjera të bashkëpunimit të ndryshme nga ato përgjatë periudhës transitore.

2. Preferohen bizneset ekzistuese që vetë-qëndrojnë( *stand-alone business*). Kjo mund të jetë në formën e një ndërmarrjeje para-ekzistuese ose grupi ndërmarrjesh, ose e një pjese të biznesit, i cili me parë nuk ishte ligjërisht i trupëzuar si i tillë.
3. Kur shqetësimet e konkurrencës rezultojnë në një mbivendosje horizontale, palët mund të jenë në gjendje të zgjedhin ndërmjet dy bizneseve. Në rastet e një oferte të pafavorshme, angazhimi për shitjen e aktiviteteve të kompanisë në fjalë mundet, (në rrethana kur palët njoftuese disponojnë informacion të kufizuar për biznesin që do të shitet) të rrisë rrezikun që ky biznes të mos rezultojë (pas shitjes) në një konkurrent të suksesshëm, për të konkurruar në treg mbi baza afatgjata. Në këtë rast është e përshtatshme për palët, që të propozojnë që të shesin aktivitetet e ndërmarrjes përfutuese.

#### 5. *Carve-outs*<sup>58</sup>/*ndryshime/krijime*

1. Edhe pse është kërkuar shitja e një biznesi ekzistues të suksesshëm që ushtron aktivitet, duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit, Komisioni mundet të vendosë shitjen e biznesit i cili ka lidhje ekzistuese të forta ose që është pjesërisht i integruar me biznese të tjera, që ruhen nga palët dhe si i tillë duhet të ‘*ndryshohet*. Me qëllim që të reduktohet në minimum rreziku lidhur me suksesin dhe konkurrueshmërinë në këto rrethana, një opsion për palët është depozitimi i angazhimeve ku propozohen ndryshime të këtyre pjesëve të një biznesi ekzistues, biznes i cili jo domosdoshmërisht duhet të shitet.
2. Komisioni do të pranojë vetëm ato angazhime, të cilat kërkojnë ndryshim të një biznesi nëse është i sigurt se, (në kohën kur biznesi është transferuar tek blerësi) po shitet një biznes i suksesshëm që ushtron aktivitet dhe se është reduktuar në minimum rreziku lidhur me suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit pas këtyre ndryshimeve. Palët duhet të sigurojnë se ndryshimet e duhura kanë filluar në periudhën e ndërmjetme d.m.th periudhën ndërmjet miratimit të vendimit nga Komisioni dhe përfundimit të shitjes (duke nënkuptuar transferimin ligjor dhe faktik të biznesit tek blerësi). Njëkohësisht, në fund të kësaj periudhe, një biznes i suksesshëm që ushtron vetë aktivitet do të shitet. Nëse kjo nuk do të jetë e mundur ose nëse ndryshimet do të jenë veçanërisht të vështira, palët mund të ofrojnë një shkallë të kërkuar të sigurisë për Autoritetin duke propozuar një zgjidhje për blerësin e sipërm.

#### 6. *Shitja e asetëve, veçanërisht markat, patentat dhe licencat*

1. Shitja që konsiston në një kombinim të asetëve të caktuara, të cilat nuk përbëjnë një biznes njëtrajtshëm dhe të suksesshëm në të kaluarën, sjell rrezik lidhur me suksesin dhe konkurrueshmërisë të biznesit (që rezulton nga shitja). Ky është rasti kur asetet përfshihen nga më tepër se sa një palë. Një model i tillë mund të pranohet nga Autoriteti, vetëm nëse sukcesi i biznesit sigurohet pavarësisht faktit se asetet nuk përbënin një biznes uniform në të kaluarën. Ky

<sup>58</sup> Përkufizimi i ‘*Carve-Out*’ Shitja e pjesëshme e një njësie biznesi. Një ndërmarrje që ndërmerr një *carve-out* do të thotë se nuk e shet menjëherë biznesin por ndërkohë shet një pjesë të kapitalit të vet në këtë biznes

mund të jetë rasti kur asetet individuale konsiderohen si biznes i suksesshëm dhe konkurrues. Në mënyrë të ngjashme, vetëm në raste përjashtimore një paketë shitjesh që përfshin vetëm markat dhe produktet mbështetëse dhe/ose asetet e shpërndarjes mund të jetë e mjaftueshme për të krijuar kushtet për një konkurrencë efektive. Në këto rrethana, paketa që përbëhet nga markat dhe asetet duhet të jetë e mjaftueshme për ti lejuar Autoritetit që të arrijë në përfundimin se biznesi që rezulton nga shitja, do të jetë menjëherë i suksesshëm.

2. Preferohen shitjet e biznesit sesa shitjet që kanë të bëjnë me dhënien e licencave të drejtave të pronësisë intelektuale, duke qene së dhënia e licencave përfshin disa pasiguri, të cilat nuk i mundësojnë personit të pajisur me licencë që të konkurrojë menjëherë në treg, dhe kërkojnë një lidhje vijuese me palët, të cilat mund ti lejojnë licencuesit që të influencojë personin e pajisur me licencë në sjelljen e tij konkurruese dhe mund të krijojë konflikt ndërmjet licencuesit dhe të licencuarit për qëllimin, kushtet dhe detyrimet e licencës. Dhënia e një licence për më tepër përgjithësisht nuk konsiderohet si e përshtatshme kur shitja e një biznesi është e mundur. Kur shqetësimet e konkurrencës shfaqen nga pozicioni në treg si rrjedhojë e një teknologjie të tillë ose e të drejtës së pronësisë intelektuale, shitja e teknologjisë ose e të drejtave të pronësisë intelektuale është masa e preferuar duke qenë se shitja eliminon një lidhje zgjattë gjatë ndërmjet njësisë së përqendruar dhe konkurrentëve të tij. Megjithatë, Autoriteti mund të pranojë marrëveshje të licencës, si një alternativë të shitjes kur p.sh, një shitje mund të pengojë kërkimet vazhduesen vijueshmëri ose kur një shitje është e pamundur për shkak të natyrës së biznesit. Të tilla licenca duhet ti mundësojnë personit të pajisur me licencë, që të konkurrojë efektivisht me palët në të njëjtën mënyrë ashtu siç edhe ka ndodhur shitja. Ato normalisht janë licenca ekskluzive dhe nuk duhet të jenë të kufizuara në lidhje me ndonjë fushë veprimi apo kufizime gjeografike për personin e pajisur me licencë. Kur ka ndonjë pasiguri në lidhje me qëllimin e licencës për sa i përket përcaktimeve dhe kushteve të saj, palët duhet të shesin të drejtën e pronësisë intelektuale që ndodhet në të, por mund të marrin mbrapsht një licencë. Nëse ka pasiguri që licenca do të jepet tek një licencues i përshtatshëm, palët mund të propozojnë një person të pajisur me licencë të radhës së parë ose një zgjidhje të menjëhershme, me qëllim që të mundësojë Autoritetit arrijë në përfundime të sakta lidhur me zbatueshmërinë e kushteve dhe detyrimeve të dhëna.

## 7. *Re-branding(rimarkëzimi)*

1. Në raste të veçanta, Autoriteti ka pranuar angazhime për të dhënë një licencë ekskluzive, të kufizuar në kohë për një markë me qëllim që ti lejojë personit të pajisur me licencë që të ri-markëzojë produktin në periudhën e parashikuar. Pas fazës së parë të licencës të këtyre të ashtuquajturave angazhime të rimarkëzimit, palët angazhohen në një fazë të dytë të abstenojnë nga çdo përdorim i markës (faza e bllokimit/*blackout phase*). Qëllimi i këtyre angazhimeve është ti lejojnë personit të pajisur me licencë, që të transferojë klientët nga marka e licencës tek marka e tij me qëllim që të krijojë një konkurrent të suksesshëm, pa qenë e nevojshme shitja e përhershme e markës së licencuar.

2. Një masë e ri-markës, mban në vetvete rreziqe shumë të mëdha dhe domethënëse për rivendosjen e konkurrencës efektive sesa një shitje, përfshirë edhe shitjen e markës, duke qenë se konsiderohet e pasigurte nëse personi i pajisur me licencë do të jetë i suksesshëm të tregojë vetveten si një konkurrent aktiv në treg me produktin e ri-markëzuar. Një masë e ri-markës mund të jetë e pranueshme, në rrethanat kur një markë është përdorur gjerësisht dhe një pjesë e madhe e xhiros së tij është gjeneruar në tregje jashtë atyre në të cilat janë identifikuar shqetësimet e konkurrencës.<sup>59</sup> Në këto rrethana, një masë për ri-markëzim duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë, që të sigurojë që dhënia e licencës ruan konkurrencën efektive në treg mbi baza të qëndrueshme dhe që personi i pajisur me licencë do të jetë një konkurrent efektiv edhe pas ri-markëzimit të produkteve.
3. Duke qenë se suksesi i angazhimeve të ri-markëzimit lidhen domosdoshmërisht me suksesin e markës së licencuar, një numër parakushtesh duhet të plotësohen për dizenjimin e këtyre angazhimeve. Së pari, marka që do transferohet duhet të jetë e mirënjohur dhe një nga pikat e forta që garanton suksesin e menjëhershëm të markës së licencuar dhe mbijetesën ekonomike në periudhën e rimarkëzimit. Së dyti, pjesë e aseteve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve të shënuara nën markën e licencuar ose transferimin e know-how, mund të jetë e nevojshme për të siguruar suksesshmërinë e masave.<sup>60</sup> Së treti, licenca duhet të jetë ekskluzive d.m.th jo e kufizuar në një gamë të caktuar produktesh brenda një tregu të veçantë, dhe duhet të përfshijë të drejtat e pronësisë intelektuale për të siguruar që klientët kanë njohuri të mjaftueshme lidhur me familjaritetin e produkteve të ri-markëzuara. Palët nuk do lejohen të përdorin fjalë të ngjashme ose shenja duke qenë se kjo do të krijojë probleme për ri-markëzimin.<sup>61</sup> Së katërti, si licenca ashtu edhe periudha e bllokimit duhet të jenë të mjaftueshme për kohë të gjatë, dhe duhet të merren në konsideratë për veçantitë e rastit, në mënyrë që masat /kushtet dhe detyrimet e ri-markëzimit të kenë të njëjtin efekt ashtu si dhe shitja.<sup>62</sup>
4. Identiteti i personit potencial të pajisur me licencë është një element kyç për suksesin e angazhimeve. Nëse ka pasiguri në lidhje me numrin e disponueshëm të personave të përshtatshëm të pajisur me licencë, duke qenë në gjendje dhe duke pasur nxitës të fortë për të ndërmarrë procesin e ri-markëzimit, palët mund të propozojnë një zgjidhjeje të radhës së parë ose të menjëhershme.

<sup>59</sup> Megjithatë, edhe në këto kushte një shitje e markës mund të jetë më tepër e përshtatshme, veçanërisht nëse rezultati ndahet në pronësinë e markës që korrespondon praktikës së përbashkët në industri, shiko industrinë farmaceutike rasti COMP/M.3544 — Bayer Healthcare/Roche (OTC) e 19 Nëntor 2004, paragrafi 59 për sa i përket shitjeve të Desenex brand.

<sup>60</sup> COMP/M.3149 — Procter&Gamble/Wella paragrafi 60; IV/M.623 — Kimberly-Clark/Scott Paper e 16 Janar 1996, paragrafi 236(i). Kjo është veçanërisht e rëndësishme përgjatë fazës së licencës në të cilën personi i pajisur me licencë duhet të përgatitet për nxjerrjen e një marke të re konkurruese. Nxjerrja në treg e një marke të re duket se nuk është e mundur nëse blerësi duhet të shpenzojë burime të konsiderueshme në fazën e prodhimit, marketingut dhe shpërndarjes të markës së licencuar; COMP/M.2337 — Nestlé/Ralston Purina e 27 Korrik 2001, paragrafi 67 *et seq.*; COMP/M.2621—SEB/Moulinex e 8 Janar 2002, paragrafi 140.

<sup>61</sup> COMP/M.3149 — Procter&Gamble/Wella e 30 Korrik 2003, paragrafi 61; COMP/M.2337 — Nestlé/Ralston Purina e 27 Korrik 2001, paragrafi 68; COMP/M.2621 — SEB/Moulinex e 8 Janar 2002, paragrafi 141; IV/M.623 — Kimberly-Clark/Scott Paper e 16 Janar 1996, paragrafi 236(ii).

<sup>62</sup> P.sh duke marrë në konsideratë ciklin e jetës së produktit, c.f. COMP/M.2621 — SEB/Moulinex e 8 janar 2002, paragrafi 141, ku efektiviteti i zgjatjes së angazhimeve mbulonte një periudhë të barabartë me tre ciklesh produktesh; konfirmuar nga gjykimi në rastin T-119/02 *Royal Philips Electronics NV v Commission* [2003] ECR II-1433, paragrafi 112 *et seq.*

## 8. Dispozitat jo-ripërftuese (Mosripërftimi)

Me qëllim që të ruhet efekti strukturor i një mase, angazhimet duhet të parashikojnë që njësia e përqendruar nuk mundet në vijim të përftojë influencë<sup>63</sup> mbi të gjithë ose një pjesë të biznesit të shitur. Angazhimet, normalisht duhet të parashikojnë që nuk do të ketë influencë nga ri-përfitimi të paktën për një periudhë domethënëse, zakonisht 10 vjet. Megjithatë, angazhimet mund të parashikojnë për atë që heq dorë, duke i lejuar Autoritetit që ti çlirojë palët nga ky detyrim, nëse në të ardhmen zbulon se struktura e tregut ka ndryshuar deri në atë masë, që mungesa e influencës mbi biznesin e shitur, nuk është më tej e nevojshme për ta bërë përqendrimin të pajtueshëm me tregun. Edhe në mungesë të një dispozite të qartë, një ri-përfitim i biznesit shkel detyrimin e palëve mbi angazhimet, duke qenë se kjo ndikon në efektivitetin e masave.

## 9. Angazhime alternativë të shitjes : *Crown Jewels*<sup>64</sup> (asetet më te vlefshme)

1. Në disa raste, zbatimi i opsionit të shitjes së pjesës së preferuar të palëve (të një biznesi të suksesshëm që zgjidh shqetësimet e konkurrencës) mund të jetë i pasigurte në këndvështrimin që të zëvendësimin të të drejtave të palëve të treta ose pasiguria lidhur me transferimin e kontratave kyç, të drejtave të pronësisë intelektuale ose pasiguria për të gjetur një blerës të përshtatshëm. Pavarësisht kësaj, palët mund të marrin në konsideratë faktin që ato do të jenë në gjendje të shesin biznesin tek një blerës i përshtatshëm, brenda një periudhe kohore shumë afatshkurtër.
2. Në këto rrethana, Autoriteti nuk mund të rrezikojë se do të cenohet konkurrenca. Komisioni do të pranojë ato angazhime të shitjes, që plotësojnë këto kushte:

(a) në mungesë të pasigurisë, shitja e parë e propozuar në angazhime, është një biznes të suksesshëm; dhe

(b) palët duhet të propozojnë një shitje të dytë alternative, të cilën palët janë të detyruara ta zbatojnë, nëse ato nuk janë në gjendje që të zbatojnë angazhimin e parë, brenda afatit kohor të përcaktuar.<sup>65</sup>

Një angazhim i tillë alternativ normalisht duhet të jetë një ‘*crown jewel*’/aset i vlefshëm<sup>66</sup>, d.m.th duhet të jetë të paktën po aq i mirë sa edhe shitja e parë e propozuar në terma të krijimit të një konkurrenti të suksesshëm sapo të zbatohet, dhe nuk duhet të ketë ndonjë pasiguri në lidhje me zbatimin e tij. Gjithashtu, duhet të jetë në gjendje që të zbatohet sa më shpejt. Angazhimet duhet të kenë kritere të qarta dhe një afat kohor të përcaktuar, lidhur me faktin se: *si* dhe *kur*, detyrimet alternative të shitjes do të bëhen efektive dhe Komisioni kërkon një periudhë kohore më të shkurtër për zbatimin e tyre.

<sup>63</sup> Një influencë nga zotëruesi i mëparshëm i biznesit në sjelljen konkurruese të biznesit të shitur riskon që të pengojë objektivin e masave.

<sup>64</sup> Përkufizimi i ‘Crown Jewels’: Njësia me vlerën më të lartë në një ndërmarrje, duke e përkufizuar nga karakteristikat, vlerën e aseteve dhe perspektiva e të ardhmes. Origjina e këtij termi vjen nga thesari me i vlefshëm dhe i rëndësishëm që posedonin mbretërit (<http://www.investopedia.com/terms/c/crownjewels.asp>)

<sup>65</sup> Shiko gjykimin në rastin T-210/01 *General Electric v Commission* [2005] ECR II-5575, paragrafi 617; COMP/M.1453—AXA/GRE e 8 Prill 1999.

<sup>66</sup> Mënyra alternative mund të konsistojë në një biznes komplet të ndryshëm ose në rastin e pasigurisë për gjetjen e një blerësi të përshtatshëm, të bizneseve shtesë ose aseteve që janë shtuar në paketën fillestare.

3. Nëse ka pasiguri në lidhje me zbatimin e shitjeve për shkak të të drejtave të palëve të treta ose lidhur me gjetjen e një blerësi të përshtatshëm për angazhimet për asetet me vlerë, palët mund të zgjedhin edhe midis blerësve të radhës së parë..

#### **10. Transferimi tek një blerës i përshtatshëm**

Efekti që kërkohet për shitjen do të arrihet vetëm nëse biznesi është transferuar tek një blerës i përshtatshëm, në duart e të cilit do të bëhet një forcë konkurruese aktive në treg. Autoriteti vlerëson mundësinë që ka një biznesi për të tërhequr një blerës të përshtatshëm, lidhur edhe me përshtatshmërinë e angazhimeve të propozuara.<sup>67</sup> Me qëllim që të sigurohemi që biznesi është shitur tek një blerës i përshtatshëm, angazhimet duhet të përfshijnë kritere për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij, të cilat do ta lejojnë Autoritetin që të arrijë në përfundimin se shitja e biznesit tek një blerës i tillë ka të ngjarë të eliminojë shqetësimet e identifikuar të konkurrencës.

##### **(a) Përshtatshmëria e një blerësi**

##### **1. Kërkesat standarde për blerësin janë si më poshtë:**

- a) Blerësit i kërkohet të jetë i pavarur dhe jo i lidhur me palët ,
- b) Blerësi duhet të posedojë burime financiare, ekspertizën përkatëse dhe të ketë nismën dhe mundësinë për të ruajtur dhe zhvilluar biznesin e shitur si të suksesshëm dhe një forcë aktive konkurruese në konkurrencë me palët dhe konkurrentët e tjerë, dhe
- c) Përftimi i biznesit nga blerësi i propozuar nuk duhet të krijojë probleme të reja të konkurrencës apo të sjellë rrezikun që do të vonohet zbatimi i angazhimeve. Prandaj, blerësi i propozuar pritët të marrë të gjitha miratimet e nevojshme nga autoritetet rregullatorë përkatëse për përfkrimin e biznesit që do të shitet.

2. Kërkesat standarde lidhur me blerësin duhet të plotësohen rast pas rasti. Një shembull është kërkesa, kur është e mundur, që blerësi të jetë një blerës industrial sesa blerës financiar.<sup>68</sup> Angazhimet normalisht përmbajnë një dispozitë të tillë kur, për arsye të rrethanave të veçanta të rastit, një blerës financiar nuk do të jetë në gjendje ose nuk ka nismën për të zhvilluar biznesin si një njësi të suksesshme dhe konkurruese në treg, edhe duke konsideruar faktin që mund të ketë ekspertizën e mjaftueshme menaxheriale. (p.sh. duke rekrutuar menaxherë me eksperiencë në sektorin në fjalë) dhe si rrjedhim përfrimi nga një blerës financiar nuk do të eliminojë shqetësimet e konkurrencës .

##### **(b) identifikimi i një blerësi të përshtatshëm**

<sup>67</sup> Rasti IV/M.913—Siemens/Elektrowatt e 18 Nëntor 1997.

<sup>68</sup> Shiko angazhimet në rastin COMP/M.2621 — SEB/Moulinex e 8 Janar 2002, të cilat parashikojnë që personi I pajisur me licencë nevojitet të ketë markën e tij tregtare të përdorur në sektorin në fjalë. Disa tregje mund të kërkojnë një shkallë të mjaftueshme të njohjes së klientëve që një blerës të jetë në gjendje të përkthejë biznesin që do të shitet në një forcë konkurruese në treg.

1. Në përgjithësi, janë tre mënyra për të siguruar që biznesi është transferuar tek një blerës i përshtatshëm. Së pari, biznesi është transferuar brenda afatit kohor të vendosur në vendim tek një blerës, i cili është miratuar nga Komisioni dhe ka plotësuar kërkesat e nevojshme lidhur me blerësin. Së dyti, angazhimet parashikojnë që palët mund të mos plotësojnë transaksionin e njoftuar, para se të kenë hyrë në një marrëveshje detyruese me blerësin për biznesin, e miratuar nga Komisioni (e ashtuquajtur ‘*up-front-buyer*’/blerësi i radhës së parë). Së treti, palët identifikojnë një blerës për biznesin dhe lidhin marrëveshjen detyruese, përgjatë procedurës së Autoritetit<sup>69</sup> (e ashtuquajtura masa ‘*fix-it-first*’/rregulloje menjëherë/ të parën<sup>70</sup>). Ndryshimi kryesor ndërmjet dy opsioneve të fundit është se në rastin e parë, identiteti i blerësit nuk është i njohur për Autoritetin, para vendimit të autorizimit.
2. Zgjedhja e kategorisë, varet nga rreziku rast pas rasti, dhe si rrjedhim nga masat të cilat mundësojnë Autoritetin të përfundojë në shkallën e kërkuar të sigurisë se angazhimet janë zbatuar. Kjo varet nga natyra dhe qëllimi i biznesit që do të shitet, rreziku i degradimit të biznesit në periudhën e ndërmjetme deri në shitje dhe ndonjë pasiguri e pandashme me transferimin dhe zbatimin, në veçanti rreziku i gjetjes së një blerësi të përshtatshëm.

#### **11. Shitja e biznesit brenda një afati kohor të përcaktuar pas marrjes së vendimit**

Në kategorinë e parë, palët mund të procedojnë me shitjen e biznesit bazuar në kërkesat e blerësit, brenda një afati kohor të përcaktuar pas marrjes së vendimit. Kjo procedurë, mund të jetë e përshtatshme në shumicën e rasteve, duke siguruar se një numër blerësish e përballon këtë biznes si të suksesshëm që asnjë arsye nuk do të ndërlikojë ose të pengojë procedurën e shitjes. Kur blerësi duhet të ketë kualifikime të veçanta, kjo procedurë mund të jetë e përshtatshme, nëse ka mjaftueshëm blerës potencial, të interesuar dhe të disponueshëm, të cilët plotësojnë kërkesat e veçanta mbi blerësin, që janë pjesë e angazhimeve në raste të tilla. Në këto rrethana, Autoriteti mund të jetë në gjendje të arrijë në konkluzionin se shitja do të kryhet dhe se nuk ka arsye për pezullimin e zbatimit të njoftimit të përqendrimit pas marrjes së vendimit të Komisionit.

#### **12. Blerësi i radhës së parë /*Up-front buyer***

1. Kategoria e dytë përfshin raste, kur vetëm modeli i propozimit të blerësit të radhës së parë, e lejon Autoritetin që të arrijë në përfundimin mbi shkallën e kërkuar të sigurisë, lidhur me faktin se biznesi do të shitet me efektivitet tek një blerës i përshtatshëm. Si rrjedhojë, “Palët” angazhohen se ato nuk do të përfundojnë transaksionin e njoftuar, përpara se të lidhin marrëveshjen detyruese me blerësin për biznesin që do të shitet, të miratuar nga Komisioni.<sup>71</sup>

<sup>69</sup> Transferimi i biznesit duhet të zbatohet pas vendimit të Komisionit

<sup>70</sup> Kjo terminologji mund të përdoret në mënyra të ndryshme në juridiksione të ndryshme

<sup>71</sup> Rasti COMP/M.3796—Omya/Huber PCC e 19 Korrik 2006; Rasti COMP/M.2972—DSM/Roche Vitamins e 23 Korrik 2003; Rasti COMP/M.2060 — Bosch/Rexroth e 13 Dhjetor 2000; Rasti COMP/M.2337 — Nestlé/Ralston Purina e 27 Korrik 2001; Rasti COMP/M.2544 — Masterfoods/Royal Canin e 15 Shkurt 2002; Rasti COMP/M.2947 — Verbund/Energie Allianz e 11 Qershor 2003.



2. Së pari, kjo ka të bëjë me rastet kur ka pengesa të mjaftueshme për shitjen, të tilla si të drejtat e palëve të treta, ose pasiguri për gjetjen e një blerësi të përshtatshëm.<sup>72</sup> Në këto raste, një blerës i radhës së sipërme do ta lejojë Autoritetin që të arrijë në konkluzionin mbi shkallën e kërkuar të sigurisë dhe që angazhimet do të zbatohen, duke qenë se angazhimi krijon nisma më të mëdha për palët që të përfundojnë procesin e shitjes, me qëllim që të jenë në gjendje të përfundojnë përqendrimin e tyre. Në këto rrethana, palët mund të zgjedhin ndërmjet blerësit të propozuar të radhës së sipërme dhe një angazhimi alternativ tjetër shitjeje.
3. Së dyti, një blerës i radhës së sipërme mund të jetë i nevojshëm në rastet të cilat shkaktojnë rreziqe të konsiderueshme të ruajtjes së konkurrueshmërisë dhe shitshmërinë (të shitet) të biznesit, në periudhën e ndërmjetme deri në shitje. Kjo kategori përfshin rastet kur rreziku i degradimit të një biznesi të shitur, duket se është i lartë, në veçanti për shkak të riskut të humbjes së punonjësve kyç për biznesin, ose kur risqet e ndërmjetme janë rritur duke qenë se palët nuk janë në gjendje të ndërmarrin procesin e *carve out/ndryshimit* në periudhën e ndërmjetme. Procesi i *carve-out/ndryshimit* mundet të kryhet, vetëm kur marrëveshjet e shitjes dhe blerjes me blerësin kanë hyrë në fuqi. Dispozitat mbi blerësin e radhës së sipërme mund të përshpejtojnë transferimin e biznesit që do të shitet— duke marrë në konsideratë nismat në rritje të palëve për të përfunduar shitjen, me qëllim që të jenë në gjendje të përfundojnë përqendrimin e tyre —deri në atë masë që angazhimet lejojnë Autoritetin të arrijë në përfundimin që këto risqe janë të kufizuara dhe se shitja do të zbatohet me efektivitet.<sup>73</sup>

### 13. Masat që rregullohen të parat-menjëherë /*Fix-it-first remedies*

1. Kategoria e tretë përfshin rastet ku palët identifikojnë dhe hyjnë në një marrëveshje ligjore detyruese me blerësin duke nënvizuar faktet kryesore të blerjes përgjatë procedurës së Autoritetit.<sup>74</sup> Komisioni do të jetë në gjendje të vendosë në vendimin përfundimtar, nëse transferimi i biznesit të shitur tek blerësi i identifikuar, eliminon shqetësimet e konkurrencës. Nëse Komisioni autorizon përqendrimin e njoftuar, nuk është i nevojshëm marrja e një vendimi shtesë i Komisionit për miratimin e blerësit dhe për përfundimin e shitjes së biznesit, i cili mund të ndodhë në një kohë të shkurtër më pas.
2. Komisioni mirëpret masat e menjëhershme, në veçanti në rastet ku identiteti i blerësit është i rëndësishëm për efektivitetin e masave të propozuara. Kjo ka të bëjë me rastet kur, duke marrë parasysh rrethanat, vetëm një numër i vogël blerësish të mundshëm mund të konsiderohen si të përshtatshëm, në veçanti sepse biznesi që do të shitet nuk është një biznes i suksesshëm në vetvete, por suksesshmëria e tij do të sigurohet vetëm nga asetet e veçanta të blerësit, ose kur blerësi duhet të ketë karakteristika të veçanta me qëllim që masat të zgjidhin shqetësimet e konkurrencës.<sup>75</sup> Nëse palët zgjedhin që të hyjnë në një

<sup>72</sup> Shiko rastin COMP/M.2060—Bosch/Rexroth e 13 Dhjetor 2000, paragrafi 92.

<sup>73</sup> Shiko rastin COMP/M.2060—Bosch/Rexroth e 13 Dhjetor 2000, paragrafi 95.

<sup>74</sup> Të tilla marrëveshje normalisht janë të kushtëzuara nga vendimi përfundimtar i Komisionit që pranon masat në fjalë.

<sup>75</sup> Shiko rastin COMP/M.3916 —T-Mobile Austria/tele.ring e Prill 2006, shitja e siteve të caktuara të një kompanie celulare dhe frekuencave, që nuk përbëjnë një biznes të suksesshëm, mund të ndodhë vetëm për një konkurrent i cili mund të luajë një rol të

marrëveshje detyruese me një blerës të përshtatshëm, përgjatë procedurës nëpërmjet zgjidhjes së menjëhershme, Autoriteti mundet që në këto rrethana të arrijë në përfundimin se angazhimet do të zbatohen nëpërmjet shitjes tek një blerës i përshtatshëm. Në këto rrethana, një zgjidhje e ‘*upfront buyer*’/blerësit të radhës së parë, që përmban kërkesa të veçanta në lidhje me përshtatshmërinë e blerësit, do të konsiderohet si ekuivalente dhe e pranueshme.

#### 14. Zhvendosja e lidhjeve ndërmjet konkurrentëve

1. Angazhimet e shitjes mundet gjithashtu të përdoren për zhvendosjen e lidhjeve ndërmjet palëve dhe konkurrentëve, në rastet kur këto lidhje çojnë në shqetësime të konkurrencës të krijuara nga përqendrimi. Shitja e aksioneve në minorancë/të pakta në numër në një *joint venture* mund të jetë e nevojshme me qëllim që të shërbejë si një lidhje strukturore me konkurrentin mazhoritar,<sup>76</sup> ose, në mënyrë të ngjashme shitja e aksioneve në minorancë tek një konkurrent.<sup>77</sup>
2. Pavarësisht se shitja e aksioneve të tilla është një zgjidhje e preferuar, Komisioni mundet në raste përjashtimore të pranojë të mos marrë parasysh të drejtat e lidhura me aksionet në minorancë tek një konkurrent kur mund të përjashtojë, ( duke marrë parasysh rrethana të veçanta të rastit), që përfitimet financiare të cilat vijnë nga aksione në minorancë të një konkurrenti, në vetvete sjellin shqetësime të konkurrencës.<sup>78</sup> Në këto rrethana, palët duhet të heqin dorë nga të gjitha të drejtat e lidhura me të tilla aksione, të tilla si përfaqësimi në bord, të drejtat e vetos dhe gjithashtu të drejtat e informimit.<sup>79</sup> Komisioni mundet të jetë në gjendje të pranojë një shërbim të tillë të lidhjeve me një konkurrent, vetëm nëse këto të drejta nuk janë përshtatur në mënyrë domethënëse dhe të përhershme.<sup>80</sup>
3. Kur shqetësimet e konkurrencës vijnë si rezultat i marrëveshjeve me kompanitë që ofrojnë të njëjtin produkt ose të njëjtat shërbime, një masë e përshtatshme mund të jetë përfundimi/arritja e marrëveshjes në fjalë, e tillë si marrëveshja e shpërndarjes me konkurrentët,<sup>81</sup> ose marrëveshjet që çojnë në koordinim të sjelljeve të caktuara tregtare.<sup>82</sup> Megjithatë vetëm arritja e një marrëveshjeje shpërndarjeje, do të eliminojë shqetësimet e konkurrencës, nëse ka siguruar se produkti i konkurrentit, do të shpërndahet gjithashtu në të ardhmen dhe të ushtrojë një presion efektiv konkurrues mbi palët.

---

ngjashëm në treg si telering; Rasti COMP/M.4000 — Inco/Falconbridge e 4 Korrik 2006, shitja e nje biznesi nikeli ndodh vetëm tek ai konkurrent i integruar vertikalisht në ofrimin e nikelit ; Rasti COMP/M.4187 — etso/Aker Kvaerner e 12 Dhjetor 2006, vetëm një blerës ishte i përshtatshëm për përfundimin e biznesit që do të shitet duke qenë se është i vetmi me njohuritë nevojshme know-how dhe prezencën e nevojshme në tregjet fqinje ; rasti COMP/M.3436—Continental/Phoenix e 26 Tetor 2004, vetëm partneri në joint venture të shpërndarjes ishte në gjendje ta kthente biznesin e shitur në të suksesshëm Rasti COMP/M.3136—GE/Agfa e 5 Dhjetor 2003.

<sup>76</sup> Rasti IV/M.942—VEBA/Degussa e 3 Dhjetor 1997.

<sup>77</sup> Rasti COMP/M.3653—Siemens/VATech e 13 Korrik 2005, paragrafi 491, 493 ff.

<sup>78</sup> Shiko rastin COMP/M.3653—Siemens/VA Tech e 13 Korrik 2005, paragrafi 327 ff., ku efektet nga aksionet në minorancë për sa i përket aspektit financiar mund të përjashtohen si një opsion nga shitja e aksioneve që janë ushtruar tashmë më parë.

<sup>79</sup> Rasti COMP/M.4153—Toshiba/Westinghouse e 19 Shator 2006

<sup>80</sup> Shiko rastin COMP/M.3440—ENI/EDP/GDP e 9 Dhjetor 2004, paragrafi 648 f., 672.

<sup>81</sup> Shiko për përfundimin e marrëveshjes së shpërndarjes rastin COMP/M.3779 —Pernod Ricard/Allied Domecq e 24 qershor 2005; Rastin COMP/M.3658—Orkla/Chips e 3 Mars 2005

<sup>82</sup> Shiko veçanërisht në sektorin e transportit detare rasti COMP/M.3829 — Maersk/PONL e 29 Korrik 2005 dhe rasti

COMP/M.3863 —TUI/CP Ships e 12 tetor 2005. Në këto raste, palët angazhohen të heqin dorë nga disa linja dhe konsorciume.

## 15. Masa të tjera

Shitjet ose zhvendosja e lidhjeve me konkurrentët nuk janë të vetmet masa të mundshme për të eliminuar shqetësime të caktuara të konkurrencës. Shitjet janë masat e duhura në terma të efektivitetit dhe efikasitetit. Komisioni mund të pranohet lloje të tjera angazhimesh, por vetëm në rrethana kur, masat e tjera të propozuara, janë të paktën ekuivalente me efektet që sjell shitja.<sup>83</sup>

### *Masa të aksesit*

1. Në disa raste, Komisioni ka pranuar masa që parashikojnë dhënien e aksesit për infrastruktura kryesore, rrjete, teknologji kryesore, përfshirë edhe patentat, know-how ose të drejta të tjera të pronësisë intelektuale. Normalisht, palët i japin akses të tillë palëve të treta mbi baza jo diskriminuese dhe transparente.
2. Angazhimet që garantojnë aksesin në infrastrukturë dhe rrjete, mund të depozitohen me qëllim që të lehtësojnë hyrjen në treg nga konkurrentët. Mund të jetë e pranueshme për Komisionin, në rrethanat kur është e qartë që do të ketë një hyrës aktual të ri, i cili mund të eliminojë çdo pengesë domethënëse të konkurrencës efektive.<sup>84</sup> Shembuj të tjerë të angazhimeve të aksesit, janë angazhimet që garantojnë platformat e pay-TV (televizorit me pagesë/kabllor),<sup>85</sup> dhe për energjinë nëpërmjet programeve të lëshimit të gazit.<sup>86</sup> Shpesh, një zvogëlim i mjaftueshëm i barrierave të hyrjes nuk arrihet nëpërmjet masave individuale, por nëpërmjet një pakete që përfshin një kombinim të masave të shitjes dhe angazhimeve të aksesit ose paketë angazhimesh që synojnë në një lehtësim të përgjithshëm të hyrjes së konkurrentëve në një gamë të gjerë të masave të ndryshme. Nëse këto angazhime, aktualisht e bëjnë hyrjen e konkurrentëve të rinj të mjaftueshëm dhe të mundshëm, ato mund të konsiderohen se kanë shitjet njëjtin efekt ashtu si një shitje. Komisioni e refuzon atë paketë masash, kur nuk është e mundur që të arrihet në përfundim se ulja/zvogëlimi i barrierave të hyrjes si pasojë e propozimit të angazhimeve, çon në hyrjen e konkurrentëve të rinj në treg.<sup>87</sup>
3. Angazhimet që garantojnë akses jo diskriminues në infrastrukturë ose rrjete të palëve që përqendrohen, mundet gjithashtu të paraqiten, me qëllim që të sigurojnë se konkurrenca nuk është penguar si rezultat i përjashtimit. Ka raste kur angazhimet mund të parashikojnë dhënien e aksesit për tubacionet e naftës /naftës-jellës/gazsjellës,<sup>88</sup> dhe për rrjetet e telekomit ose të ngjashme me to.<sup>89</sup>

<sup>83</sup>Rasti COMP/M.3680—Alcatel/Finmeccanica/Alcatel Alenia Space & Telespazio e 28 Prill 2005, ku një shitje ishte e pamundur.

<sup>84</sup>Shiko gjykimin në rastin T-177/04 *easyJet v Commission* [2006] ECR II-1931, paragrafi 197 et seq.

<sup>85</sup>Rasti COMP/M.2876 — Neëscorp/Telepù e 2 Prill 2003, paragrafi 225 et seq., ku paketa e angazhimeve përfshinte aksesin e konkurrentëve në të gjithë elementët thelbësorë të rrjetit të pay-TV të tilla si 1. Aksesit për përmbajtjen e nevojshme; 2. Aksesit për platformën teknike ashtu si dhe 3. Aksesit për shërbimet teknike të nevojshme. Në mënyrë të ngjashme rasti COMP/JV.37 — BskyB/Kirch Pay TV e 21 Mars 2000, konfirmuar nga gjykata në rastin T-158/00 *ARD v Commission* [2003] ECR II-3825, Komisioni pranoi paketën e angazhimeve të cilat i lejuan operatorëve të tjerë akses në tregun e pay-TV.

<sup>86</sup>rasti COMP/M.3696 — E.ON/MOL e 21 Dhjetor 2005; Rasti COMP/M.3868 — DONG/Elsam/Energi E2 e 14 Mars 2006.

<sup>87</sup>Në përqendrimet e transportit ajror, një reduktim i barrierave të hyrjes nga një angazhim i palëve për të ofruar vend parkimi në aeroporte të veçanta mundet të mos jetë gjithmonë i mjaftueshëm për të siguruar hyrjen e konkurrentëve të rinj aty ku ka problem konkurrence dhe e bëjnë masën ekuivalente me efektet e saj si një shitje.

<sup>88</sup>Rasti COMP/M.2533—BP/E.ON e 20 Dhjetor 2001, aksesit për tubacionet e naftës për shitjen e aksioneve në këto kompanitë e tubacione rasti COMP/M.2389—Shell/DEA e 20 Dhjetor 2001, aksesit në një terminal.

<sup>89</sup>Për aksesin në rrjetet e telekomit shiko rastin COMP/M.2803—Telia/Sonera e 10 Korrik 2002; rasti IV/M.1439—elia/Telenor e 13 tetor 1999; Rasti COMP/M.1795 — Vodafone/Mannesmann e 12 Prill 2000. Shiko rastin COMP/M.2903 —

Komisioni do t'i pranojë këto angazhime, vetëm nëse mundet që të arrihet në përfundimin, që këto angazhime do të jenë efektive dhe konkurrentët ka shumë të ngjarë ti përdorin ato dhe që problemet e përjashtimit do të eliminohen. Në raste të veçanta, mund të jetë e përshtatshme të lidhen këto angazhime me dispozitat për blerësin e radhës së parë ose masat e menjëhershme, me qëllim që Autoriteti të arrijë në përfundime të sakta që këto angazhime do të zbatohen.<sup>90</sup>

4. Kontrolli i teknologjisë kyçe ose të drejtave të pronësisë intelektuale mund të çojnë në probleme të përjashtimit të konkurrentëve, kur varen nga teknologjia ose të drejtat e pronësisë intelektuale si një input themelor për aktivitetet në tregun e rrjedhës së poshtme. P.sh shqetësimet në rastet kur probleme të tilla të konkurrencës ngrihen, ndërsa palët mund të refuzojnë informacionin e nevojshëm për ndër-veprueshmërinë e pajisjeve të ndryshme. Në këto raste, angazhimet për ti dhënë akses për informacionin e nevojshëm konkurrentëve, mund të eliminojë shqetësimet e konkurrencës.<sup>91</sup> Në mënyrë të ngjashme në sektorët ku aktorët bashkërisht duhet të bashkëpunojnë, nëpërmjet patentave licencuese me njëri tjetrin, njësia e përqendruar, nuk do të ketë më probleme për të siguruar licencat në të njëjtën masë dhe nën të njëjtave kushte, duke qenë se më parë mund të jenë eliminuar nga angazhimet për të dhënë licencat në të njëjtën bazë gjithashtu në të ardhmen.<sup>92</sup> Në këto raste, angazhimet duhet të parashikojnë licenca jo ekskluzive ose për nxjerrjen e informacionit mbi baza jo-ekskluzive tek palët e treta, të cilat varen nga të drejtat e pronësisë intelektuale ose informacione lidhur me aktivitetin e tyre. Duhet të sigurohet më tej, që afatet dhe kushtet nën të cilat licencat janë dhënë, nuk pengojnë zbatimin efektiv për dhënien e një mase të tillë licence. Nëse nuk ekzistojnë afate dhe kushte të qarta të përcaktuara për dhënien e licencave në treg, afatet dhe kushtet, përfshirë çmimin, duhet të jenë qartësisht të veçuara nga angazhimet (p.sh nëpërmjet formulave të përcaktimit të çmimit). Një zgjidhje alternative mund të jetë mbështetja tek licencat pa pagesë të besnikërisë. Për më tepër, në varësi të rastit, dhënia e licencave, mundet gjithashtu të transmetojë informacion të ndjeshëm tek licencuesi për sjelljen konkurruese të personit të pajisur me licencë, të cilët janë aktive si konkurrentë në tregun e rrjedhës së poshtme, p.sh nëpërmjet transmetimit të numrit të licencave të përdorura në tregun e rrjedhës së poshtme. Në këto raste, me qëllim që masat të jenë të përshtatshme, angazhimet duhet të përjashtojnë probleme të tilla konfidenciale. Në përgjithësi, Autoriteti i pranon këto angazhime vetëm nëse mund të arrijë në konkluzionin që ato do të jenë efektive dhe konkurrentët ka të ngjarë ta përdorin atë.
5. Angazhimet e aksesit kanë natyrë komplekse dhe përfshijnë dispozita të përgjithshme për përcaktimin e afateve dhe kushteve nën të cilat aksesit është dhënë. Me qëllim që ato të bëhen efektive, këto angazhime duhet të përmbajnë dispozita të nevojshme procedurale për monitorimin e tyre, të tilla si kërkesat për llogari të veçantë për infrastrukturën, me qëllim që ti lejojnë atyre një

---

DaimlerChrysler/Deutsche Telekom/JV e 30 Prill 2003, ku Komisioni ka pranuar paketën e angazhimeve që I japin palëve të treta aksesin në rrjetet e telematiks dhe reduktojnë barrierat ehyrjes duke I lejuar ato në përdorin pjesë të këtyre pajisjeve, të ofruara nga palët.

<sup>90</sup> Shiko rastin COMP/M.2903—DaimlerChrysler/Deutsche Telekom/JV e 30 prill 2003, paragrafi 76.

<sup>91</sup> Rasti COMP/M.3083 — GE/Instrumentarium e 2 Shator 2003; Rasti COMP/M.2861 — Siemens/Draegerwerk e 30 Prill 2003

<sup>92</sup> Shiko rastin COMP/M.3998—Axalto/Gemplus e 19 Maj 2006

rishikim të kostove<sup>93</sup>, dhe mjetet e përshtatshme monitoruese. Normalisht të tilla monitorime, duhet të kryhen nga vetë pjesëmarrësit në treg p.sh, nga ato ndërmarrje që duan të përftojnë nga angazhimet. Masat që i lejojnë palëve të treta, që vetë ato të forcojnë angazhimet, japin në veçanti akses në një mekanizëm konfliktual të shpejtë nëpërmjet procedurave arbitrare (së bashku me administratorin)<sup>94</sup> ose nëpërmjet procedurave arbitrare që përfshijnë autoritetet kombëtare rregullatorë, nëse ato ekzistojnë, në tregjet në fjalë.<sup>95</sup> Nëse Autoriteti, arrin në përfundimin se mekanizmat sipas angazhimet do të lejojnë pjesëmarrësit në treg që vetë ata efektivisht ti forcojnë në një kohë të caktuar, nuk kërkohet monitorim i përhershëm i angazhimeve nga Autoriteti. Në këto raste, një ndërhyrje nga Autoriteti do të ishte i nevojshëm vetëm në rastet kur palët nuk bien dakord me zgjidhjet e gjetura nga këto mekanizma.<sup>96</sup> Megjithatë, Autoriteti do të jetë në gjendje vetëm të pranojë këto angazhime kur kompleksiteti nuk çon në një rrezik të këtij efektiviteti dhe kur mjetet monitoruese të propozuara, sigurojnë se angazhimet janë zbatuar efektivisht dhe mekanizmat zbatues do të çojnë në rezultatet e duhura.<sup>97</sup>

### ***Ndryshimi i kontratave ekskluzive afatgjata***

1. Ndryshimi i strukturës së tregut, që rezulton nga një përqendrim i propozuar, mund të çojë në një situatë problematike për konkurrencën efektive. Kjo është në veçanti e vërtetë për marrëveshjet ekskluzive afatgjata të furnizimit, nëse këto marrëveshje përjashtojnë në rrjedhën e sipërme, inputet për konkurrentët ose në rrjedhën e poshtme, aksesin e tyre për klientët. Kur njësia e përqendruar, do të ketë mundësinë dhe nismën të përjashtojë konkurrentët në këtë mënyrë, efektet përjashtuese që rezultojnë nga marrëveshja ekskluzive, mund të çojnë në një pengimin domethënës të konkurrencës efektive.<sup>98</sup>
2. Në këto rrethana, lidhja ose ndryshimi i marrëveshjes ekskluzive, mund të konsiderohet e përshtatshme për eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës.<sup>99</sup> Megjithatë, evidencat e disponueshme, duhet ta lejojnë Autoritetin të përcaktojë qartësisht që nuk do të ruhet eksklusiviteti jo de facto. Të tilla ndryshime të marrëveshjes afatgjatë, normalisht, do të jenë të mjaftueshme, vetëm si pjesë e paketës së masave për eliminimin e shqetësimeve të identifikuar të konkurrencës.

### ***Masa të tjera, lidhur jo me shitjen***

<sup>93</sup> Shiko rastin COMP/M.2803—Telia/Sonera e10 Korrik 2002; Rasti COMP/M.2903—DaimlerChrysler/Deutsche Telekom/JV e 30 Prill 2003.

<sup>94</sup> Për sa i përket efekteve të dispozitave arbitrare shiko rastin T-158/00 *ARD v Commission* [2003] ECR II-3825, paragrafi 212, 295, 352; rasti T-177/04 *easyJet v Commission* [2006] ECR II-1931, paragrafi 186.

<sup>95</sup> Shiko rastin COMP/M.2876—Neëscorp/Telepiù; rasti COMP/M.3916—T-Mobile Austria/tele.ring.

<sup>96</sup> rasti T-158/00 *ARD v Commission* [2003] ECR II-3825, paragrafi 212, 295, 352.

<sup>97</sup> Shiko gjykimin në rastin T-87/05 *EDP v Commission* [2005] ECR II-3745, at paragrafi 102 *et seq.*; dhe rasti T-177/04 *easyJet v Commission* [2006] ECR II-1931, paragrafi 188.

<sup>98</sup> Shiko njoftimin e komisionit për përqendrimet jo-horizontale [...]; rasti IV/M.986 — AGFA Gevaert/DuPont e 11 shkurt 1998

<sup>99</sup> Rasti COMP/M.2876 — Newscorp/Telepiù i 2 Prill 2003, paragrafi 225 *et seq.*, që jep të drejta unilaterale të përfundimit për furnizuesit për përmbajtjen e Tv duke kufizuar qëllimin e dispozitave ekskluzive dhe duke kufizuar zgjatjen e marrëveshjeve të ardhshme në lidhje me furnizimin e përmbajtjes; rasti COMP/M.2822 — ENI/EnBW/GVS e17 Dhjetor 2002, që jep të drejta të hershme të përfundimit të kontratës për të gjithë shpërndarësit lokal të gazit për sa i përket marrëveshjes afatgjatë të furnizimit të gazit. Rasti IV/M.1571 — New Holland e 28 Tetor 1999; Rasti IV/M.1467—Rohm and Haas/Morton e19 Prill 1999

1. Llojet jo strukturore të masave, të tilla si premtime nga palët për të abstenuar nga disa sjellje tregtare (p.sh produktet e lidhura ) normalisht nuk çojnë në eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës që rezultojnë nga mbivendosja horizontale. Në çdo rast, mund të jetë e vështirë që të arrihet shkalla e kërkuar e efektivitetit të këtyre masave, për shkak të mungesës së monitorimit efektiv të zbatimit të tyre<sup>100</sup>. Mund të jetë e pamundur për Autoritetin që të verifikojë nëse angazhimet janë zbatuar ose jo. Edhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut të tillë si konkurrentët, mund të mos jenë në gjendje që të kuptojnë nëse palët plotësojnë kushtet e angazhimeve në praktikë. Gjithashtu, konkurrentët mund të mos kenë nismën që të njoftojnë Autoritetin, duke qenë se ata nuk përftojnë direkt nga këto angazhime. Prandaj, Autoriteti mund të shqyrtojë lloje të tjera të masave që nuk kanë të bëjnë me shitjet, të tilla si premtime sjelljeje, vetëm në raste përjashtimore dhe në rrethana të veçanta, si p.sh në rastet e shqetësimeve të konkurrencës që ngrihen në strukturat konglomerat.<sup>101</sup>

### *Afati kohor për masat jo të shitjes*

Autoriteti mund të pranojë që masat të cilat nuk kanë të bëjnë në shitjen, të kufizohen në kohëzgjatjen e tyre. Pranueshmëria e afatit kohor dhe kohëzgjatja do të varet nga rrethanat rast pas rasti dhe nuk mund të parapërcaktohet në një mënyrë të përgjithshme në këtë udhëzim.

### **16. Klauzola rishikuese**

1. Pavarësisht nga lloji i masave, angazhimet zakonisht do të përfshijnë dispozita rishikuese. Kjo i lejon Komisionit, që bazuar në kërkesën e palëve të cilat tregojnë qëllimin e tyre të mirë, të miratojnë një zgjatje të afatit kohor ose në rrethana të veçanta, të heqin dorë, modifikojnë ose zëvendësojnë angazhimet.
2. Modifikimi i angazhimeve nëpërmjet zgjatjes së afateve kohore, zbatohet për angazhimet e shitjes. Palët duhet të depozitojnë një kërkesë për zgjatje brenda afatit kohor. Kur palët aplikojnë për një zgjatje, për periudhën e parë të shitjes, Komisioni do të pranojë vetëm ato aplikime që tregojnë qëllimin e mirë të palëve, nëse palët nuk janë në gjendje të plotësojnë afatet kohore, për arsye që nuk varen nga ata dhe nëse pritet që palët në vijim të jenë të suksesshëm në shitjen e biznesit brenda një kuadri kohor të shkurtër. Në të kundërt, administratori i shitjes, mund të jetë më mirë të vendoset në mënyrë të tillë që të ndërmarrë shitjen dhe të plotësojë angazhimet e palëve.
3. Komisioni mund tu japë garanci atyre që heqin dorë ose mund të pranojnë modifikimet ose të zëvendësojnë angazhimet vetëm në rrethana të veçanta. megjithatë, kjo ndodh shumë rrallë për rastet e angazhimeve të shitjes. Duke qenë se angazhimet e shitjes duhet të zbatohen brenda një kuadri kohor të shkurtër pas vendimit, është e pamundur, që ndryshimet lidhur me rrethanat në treg të kenë ndodhur në një periudhë të tillë të shkurtër dhe Komisioni

<sup>100</sup> Një shembull i këtyre masave rasti COMP/M.3440 — ENI/EDP/GDP e 9 Dhjetor 2004, paragrafi 663, 719

<sup>101</sup> Shiko në lidhje me efektet konglomerate të përqendrimeve gjykimi i 15 shkurt 2005 në rastin C-12/03 PCommission v Tetra Laval [2005] ECR I-987, paragrafi 85, 89.

normalisht, nuk i pranon ndryshimet. Për raste të veçanta, angazhimet normalisht parashikojnë dispozita rishikuese më të mirëpërcaktuara.<sup>102</sup>

4. Heqja dorë, ndryshimi ose zëvendësimi i angazhimeve mund të jenë më relevante për angazhimet nuk kanë të bëjnë me shitjen, të tilla si angazhimet e aksesit, të cilat mund të jenë vijuese për një numër vitesh dhe jo të gjitha pasiguritë mund të llogariten në kohën e miratimit të vendimit të Komisionit. Raste përjashtimore që justifikojnë heqjen dorë, ndryshimin ose zëvendësimin, mundet së pari të pranohen si angazhime të tilla, nëse palët tregojnë që rrethanat e tregut kanë ndryshuar në mënyrë domethënëse dhe permanente. Për të treguar këtë, kërkohet një periudhë e mjaftueshme afatgjatë, normalisht të paktën disa vjeçare, ndërmjet vendimit të Komisionit dhe një kërkesë nga palët. Së dyti, raste përjashtimore mundet gjithashtu të jenë prezent nëse palët, tregojnë se eksperiencia e përfutur në zbatimin e masave, tregon që objektivi që synohet nga masat e dhëna, do të arrihet më mirë nëse modalitetet e angazhimeve ndryshojnë. Për çdo heqje dorë, ndryshim ose zëvendësim i angazhimeve, Komisioni do të marrë gjithashtu në konsideratë këndvështrimin e palëve të treta dhe ndikimin që mund të ketë ndryshimi për pozicionin e palëve të treta dhe si rrjedhojë në efektivitetin e përgjithshëm të masave. Komisioni gjithashtu merr në konsideratë faktin nëse ndryshimet ndikojnë të drejtën tashmë të përfutur nga palët e treta, pas zbatimit të masave.<sup>103</sup>
5. Nëse në kohën e miratimit të vendimit, Komisioni, për arsye të veçanta, nuk mund të përshpejtojë të gjitha pasiguritë në lidhje me zbatimin e këtyre angazhimeve, është e përshtatshme për palët që të përfshijnë një dispozitë në angazhimet e tyre, që e lejon Komisionin, të ndërmarrë një ndryshim të kufizuar në angazhimeve. Të tilla ndryshime mund të jenë të nevojshme, nëse angazhimet origjinale nuk arrijnë rezultatet e parashikuara, dhe për më tepër nuk eliminojnë shqetësimet e konkurrencës. Proceduralisht, palët mund të jenë të detyruara në këto raste, të propozojnë një ndryshim të angazhimeve, me qëllim që të arrijnë rezultatet e përcaktuara, ose Komisioni mundet vetë, pasi ka dëgjuar palët, të ndryshojë kushtet dhe detyrimet. Kjo lloj dispozite, zbatohet vetëm për rastet, ku modalitete të veçanta rriskojnë zbatimin efektiv të angazhimeve. (Të tilla dispozita janë përdorur, p.sh në lidhje me modalitetet e programeve të lëshimit të gazit.)<sup>104</sup>
6. Komisioni, bazuar në një kërkesë, mund të miratojë një vendim formal për heqjen dorë, ndryshimin ose zëvendësimin e angazhimeve ose vendosin për ndryshimin e masat nga palët, ku ndryshime të tilla përmirësojnë efektivitetin e masave dhe rezultojnë në detyrime ligjore të palëve, p.sh ndryshime kontraktuale. Një ndryshim i angazhimeve normalisht do të jetë efektiv vetëm *ex nunc*<sup>105</sup>. Ndryshimi i angazhimeve, nuk do të shpëtojë ndonjë degë të angazhimeve, të cilat janë zbatuar përpara se të merrej vendimi për ndryshimin.

<sup>102</sup> Siç përmendet në paragrafin 30, Komisioni mund të miratojë një blerës pa disa nga asetet ose personelin e parashikuar, nëse kjo nuk ndikon konkurrueshmërinë dhe suksesin e biznesit të shitur.

Në mënyrë të ngjashme, dispozitat jo kërkuese siç shpjegohen në paragrafin 43, ndalojnë ri përfitim të kontrollit mbi asetet e shitura vetëm nëse Autoriteti nuk ka zbuluar më parë së struktura e tregut ka ndryshuar në atë masë që shitja të mos jetë më tej e nevojshme.

<sup>103</sup> Shiko gjykimin në rastin T-119/02 *Royal Philips Electronics NV v Commission* [2003] ECR II-1433, paragrafi 184.

<sup>104</sup> Rasti COMP/M.3868—DONG/Elsam/Energi E2 of 14 Mars 2006, paragrafi 24 I aneksit.

<sup>105</sup> *Ex nunc* është një frazë latine që do të thotë që tani e ne vijim. Është një term ligjor i përdorur për të thënë se diçka është e vlefshme për të ardhmen dhe jo për të kaluarën. E kundërta është *ex tunc* ([https://en.wikipedia.org/wiki/Ex\\_nunc](https://en.wikipedia.org/wiki/Ex_nunc))

#### IV. Aspekte të procedurës për depozitimim e angazhimeve

##### A. Faza I

1. Autoriteti vendos se një përqendrim është i pajtueshëm me tregun, gjithashtu para fillimit të procedurave, kur është i sigurtë që duke ndjekur ndryshimet, përqendrimi i njoftuar nuk sjell shqetësime serioze për konkurrencën.
2. Palët depozitojnë angazhime për Autoritetin mbi baza informale, edhe përpara njoftimit. Palët duhet të depozitojnë propozimet brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.<sup>106</sup> Autoriteti informon palët për shqetësimet e tij në kohë reale para afatit kohor.<sup>107</sup> Kur palët depozitojnë angazhime, afati kohor për vendimet e Komisionit Përcaktohet në nenin 22 të Rregullores së Përqendrimeve.
3. Propozimet për angazhimet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:
  - a. Ato duhet të specifikojnë angazhimet thelbësore dhe zbatuese;
  - b. Ato duhet të nënshkruhen nga një person i autorizuar për ta bërë këtë;
  - c. Ato duhet të shoqërohen nga informacion mbi angazhimet e ofruara; dhe
  - d. Ato duhet të shoqërohen nga një version jo konfidencial i angazhimeve për qëllime të testimit të tyre në treme palët e treta. Versioni jo konfidencial i angazhimeve, duhet ti lejojë palëve të treta, akses të plotë për operueshmërinë/ushtrimin e aktivitetit dhe efektivitetin e masave të propozuara, me qëllim eliminimin e shqetësimeve të konkurrencës.
4. Propozimet e depozituara nga palët në përputhje me këto kërkesa, do të vlerësohen nga Autoriteti. Autoriteti do të konsultohet, kur e konsideron të përshtatshme, me palët e treta në formën e një testi tregu, duke përfshirë në veçanti ato palë të treta dhe përfaqësuesit e njohur të atyre punonjësve, ku pozicionet janë direkt të ndikuara nga masat e propozuara.
5. Angazhimet në fazën e parë, do të pranohen vetëm kur shqetësimet e konkurrencës janë të identifikueshme dhe mund të riparohen nëpërmjet masave. Shqetësimet e konkurrencës duhet të jenë kaq të lexueshme/qarta dhe masat të përshtatura me to, në mënyrë që mos të ketë nevojë që të hapen hetime të thelluara dhe angazhimet të jenë të mjaftueshme për të qartësuar dyshimet e ngritura.<sup>108</sup> Kur vlerësimi konfirmon se angazhimet e propozuara, eliminojnë dyshimet serioze të ngritura lidhur me shqetësimet e konkurrencës, Komisioni jep autorizimin në fazën e parë.
6. Për shkak të kufizimeve në terma kohorë në fazën e parë, është në veçanti e rëndësishme për palët, të depozitojnë në një kohë të caktuar para Autoritetit,

<sup>106</sup> Neni 19(1) e rregullores zbatuese

<sup>107</sup> Palët njoftuese normalisht do tu ofrohet mundësia për mbajtjen e takimi në këto rrethana, shiko pikën 33 të DG

COMPETITION praktikat më të mira të procedurave të kontrollit të përqendrimeve

<sup>108</sup> Shiko gjykimin në rastin T-119/02 *Royal Philips Electronics NV v Commission* [2003] ECR II-1433, paragrafi 79 et seq.



informacionin e kërkuar,për të vlerësuar saktësisht përmbajtjen, operueshmërinë e angazhimeve dhe përshtatshmërinë e tyre, si dhe për të ruajtur kushtet e konkurrencës efektive në treg. Nëse palët nuk bien dakord me detyrimet e vendosura, Komisioni konkludon se angazhimet e propozuara nuk eliminojnë shqetësimet e konkurrencës.

7. Palët pjesëmarrëse në një përqendrim njoftohen në rastet kur vlerësimi tregon se, angazhimet e ofruara, nuk janë të mjaftueshme për të eliminuar shqetësimet e konkurrencës të krijuara nga përqendrimi. Duke pasur parasysh se në fazën e parë, masat (kushtet dhe detyrimet) janë hartuar/dizenuara për të siguruar një përgjigje të qartë lidhur me shqetësimin e identifikuar të konkurrencës, vetëm disa ndryshime mund ti bëhen angazhimeve të propozuara. Ndryshime të tilla, të paraqitura si një përgjigje e menjëhershme lidhur me rezultatin e konsultimeve, mund të përfshijë sqarime, përmirësime dhe/ose përpunime të tjera të dizenuara për të siguruar Autoritetin që angazhimet janë operative dhe efektive. Megjithatë, të tilla ndryshime mund të pranohen vetëm në rrethanat kur Autoriteti mund të kryejë një vlerësim të përshtatshëm të këtyre angazhimeve.
8. Nëse vlerësimi përfundimtar i Autoritetit për një rast, tregon se nuk ekzistojnë më shqetësime të konkurrencës në një ose më shumë tregje, palët informohen dhe në këtë rast palët mund të tërheqin angazhimet e panevojshme për këto tregje. Nëse palët nuk i tërheqin ato, Komisioni normalisht i injoron ato në vendimin e tij. Në çdo rast, propozimet për këto angazhime, nuk përbëjnë një kusht për dhënien e vendimit të autorizimit.
9. Kur palët janë informuar, që Komisioni ka për qëllim që në vendimin e tij përfundimtar të mbajë qëndrimin se transaksioni ka krijuar shqetësime të konkurrencës në tregje të veçantë, duhet që palët të propozojnë angazhime. Komisioni nuk është në pozita që të vendosë në mënyrë të njëanshme, ndonjë kusht në një vendim autorizimi, por vetëm mbi baza të angazhimeve të palëve.<sup>109</sup> Megjithatë, Autoriteti vlerëson nëse angazhimet e depozituara nga palët, janë të përshtatshme me shqetësimet e konkurrencës, dhe vlerëson nëse duhet t’i bashkëlidhë ato si kushte dhe detyrime tek vendimi përfundimtar.<sup>110</sup> Megjithatë, duhet të theksohet se, në një propozim angazhimesh, janë të nevojshëm të gjitha ato elementë, të cilët janë konsiderohen thelbësorë për të plotësuar kushtet për një qenë një angazhim i pranueshëm. Ky paragraf ashtu si dhe të mëparshmit, gjithashtu zbatohen për angazhimet në fazën e dytë.
10. Nëse Komisioni, arrin në përfundimin se angazhimet e ofruar nga palët, nuk eliminojnë shqetësimet e konkurrencës, me vendim fillon procedurat dhe kalohet në fazën e dytë.

## B. Faza II

1. Komisioni autorizon një përqendrim kur duke ndjekur ndryshimet, një përqendrim i njoftuar nuk pengon konkurrencën efektive.

<sup>109</sup> Shiko paragrafin 6.

<sup>110</sup> Shiko gjykimin e 18 Dhjetor 2007 në rastin C-202/06 P *Cementbouw v Commission* [2007], paragrafi 54.

2. Angazhimet e propozuara duhet të depozitohen pranë Autoritetit brenda 65 ditëve kalendarike, nga dita në të cilën procedurat kanë filluar. Kur afatet kohore për vendimin përfundimtar janë shtyrë sipas rregullores së përqendrimeve, gjithashtu afati kohor për masat automatikisht shtyhet me të njëjtin numër ditësh. Vetëm në rrethana përjashtimore, Autoriteti mund të pranojë që angazhimet janë depozituar për herë të parë pas skadimit të kësaj periudhe. Kërkesa e palëve për shtyrje të afatit kohor, duhet të depozitohet brenda periudhës kohore dhe duhet të marrë parasysh rrethanat e veçanta sipas të cilave palët e justifikojnë atë. Pavarësisht ekzistencës së rrethanave përjashtimore, një shtyrje është e mundur vetëm nëse ka kohë të mjaftueshme për të bërë një vlerësim të përshtatshëm të propozimeve nga Autoriteti dhe të lejojë konsultime të përshtatshme me palët e treta.
3. Çështja nëse depozitimi i masave do të zgjasë afatin kohor për Komisionin që të marrë vendimin përfundimtar, varet nga koha e procedurave në të cilën angazhimet janë depozituar. Kur palët depozitojnë angazhime në më pak se sa 55 ditë kalendarike pas fillimit të procedurave, Komisioni duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda 90 ditëve kalendarike nga data e fillimit të procedurave. Kur palët depozitojnë angazhime në ditën e 55 kalendarike ose edhe më pas (edhe pas ditës së 65 kalendarike, nëse këto angazhime do të pranohen për shkak të rrethanave të veçanta siç përshkruhet në paragrafin me sipër), periudha që Komisioni do të marrë vendimin përfundimtar rritet me 105 ditë kalendarike. Kur palët depozitojnë angazhime brenda 55 ditëve kalendarike, por depozitojnë një version të ndryshuar në ditën e 55 ose më tutje, periudha për të marrë vendimin përfundimtar do të zgjatet deri në 105 ditë kalendarike.
4. Komisioni mund të diskutojë paraprakisht angazhimet para periudhës prej 65 ditësh kalendarike. Palët inkurajohen të depozitojnë draft propozimet, për aspektet substanciale dhe zbatuese, të cilat janë të nevojshme dhe sigurojnë se angazhimet janë plotësisht operative/ që mund të zbatohen. Nëse palët kanë mendimin se nevojitet më tepër kohë për hetimin e shqetësimeve të konkurrencës dhe për dizenjimin/hartimin e angazhimeve korresponduese të përshtatshme, ato mundet gjithashtu ti sugjerojnë Komisionit të zgjasë afatin kohor përfundimtar. Një kërkesë e tillë duhet të bëhet para përfundimit të periudhës prej 65 ditësh kalendarike. Komisioni nuk e zgjat periudhën e marrjes së vendimit përfundimtar, kur kërkesa për zgjatje/shtyrje është paraqitur pas përfundimit të afatit kohor për depozitimin e masave (kushteve dhe detyrimeve), d.m.th pas ditës së 65 kalendarike.<sup>111</sup>
5. Me qëllim nxjerrjen e një vendimi, angazhimet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

<sup>111</sup> Gjykata e shkallës së parë (EU) konfirmoi se rregullorja e përqendrimeve dhe rregullorja zbatuese nuk vendos ndonjë detyrim mbi komisionin që të pranojë angazhimet të cilat janë depozituar pas afatit kohor ligjor, siç parashikohet në paragrafin 94. Shiko rastin e T-87/05 *EDP v Commission* [2005] ECR II-3745, paragrafi 161. Prandaj, Komisioni evropian nuk është i detyruar që të marrë në konsideratë ndonjë masë të cilat janë depozituar nga palët pas afatit kohor për masat, edhe nëse palët kishin rënë dakord për të zgjatur afatin kohor përfundimtar. Për më tepër, kjo nuk korrespondon me qëllimin, siç shpjegohet në pikën 35 të rregullores së përqendrimeve, për zgjatjen sic parashikohet në nenin 10(3). Kjo zgjatje e parashikuar në nenin 10(3), nënparagrafi 1 duhet të lejojë një kohë të mjaftueshme për hetimin e problemeve të konkurrencës duke qenë se është qëllimi i zgjatjes siç parashikohet në nenin 10(3), nënparagrafi 2 për të lejuar kohë të mjaftueshme për analizën dhe testimin e tregut për angazhimet.

- a) Ato duhet të adresojnë të gjitha shqetësimet e konkurrencës, të krijuara nga përqendrimi dhe duhet të sqarojnë plotësisht angazhimet substanciale (thelbësore) dhe zbatuese të marra përsipër nga palët;
  - b) Ato duhet të nënshkruhen nga një person i autorizuar për ta bërë këtë;
  - c) Ato duhet të shoqërohen nga informacioni mbi angazhimet të ofruara; dhe
  - d) Ato duhet të shoqërohen nga një version jo konfidencial i angazhimeve për qëllime të testimit të tregut me palët e treta,
6. Autoriteti vlerëson propozimet e depozituara nga palët, në përputhje me këto kërkesa. Nëse vlerësimi konfirmon se angazhimet e propozuara, eliminojnë shqetësimet e dyshuara të konkurrencës (dhe nëse akoma nuk është nxjerrë raporti i hetimit ) ose shqetësimet e konkurrencës të shprehura në Raportin e Hetimit, Komisioni do të miratojë një vendim autorizimi me kushte.
  7. Palët njoftohen pa vonese në rastet kur vlerësimi çon në përfundimin se angazhimet e propozuara nuk janë të mjaftueshme për të zgjidhur shqetësimet e konkurrencës të krijuara nga përqendrimi.<sup>112</sup>
  8. Autoriteti nuk është i detyruar që të pranojë angazhime pas afatit kohor ligjor për masat (kushtet dhe detyrimet), përveç se kur ai në mënyrë vullnetare ndërmerr vlerësimin e angazhimeve në rrethana të veçanta.<sup>113</sup> Në këtë këndvështrim, kur palët më pas ndryshojnë angazhimet e propozuara pas afatit kohor prej 65 ditësh kalendarike, Autoriteti do të pranojë vetëm ato ndryshime të angazhime kur mundet që të përcaktojë qartësisht (duke vlerësuar informacionin që disponon, përfshirë edhe rezultatet e testimit paraprak të tregut dhe pa qenë nevoja për ndonjë testim tjetër) që këto angazhime, pasi të zbatohen në mënyrë të plotë dhe të qartë, zgjidhin shqetësimet e identifikuara të konkurrencës. Ky proces ndërmerret kur ka kohë të mjaftueshme për të lejuar një vlerësim të përshtatshëm nga Autoriteti dhe konsultim të duhur. Autoriteti normalisht do të refuzojë ndryshime të angazhimeve të cilat nuk përmbushin këto kushte.<sup>114</sup>

## V. Kërkesat për zbatimin e angazhimeve

1. Angazhimet ofrohen si një mjet, nëpërmjet të cilave palët sigurohen se do të merret një vendim, dhe zbatimi i tyre ndodh pas këtij vendimi. Angazhimet kërkojnë një bazë të sigurt për tu zbatuar dhe për të qenë efektive.
2. Më poshtë shpjegohen udhëzime të detajuara mbi zbatimin e angazhimeve të shitjes si angazhimi me tipik. Më pas, janë shpjeguar edhe disa lloje të tjera të angazhimeve.

### 1. Procesi i shitjes

<sup>112</sup> Shiko paragrafin 30 ff. të praktikave më të mira të DG Competition të cilat parashikojnë disa takime ndërmjet Komisionit dhe palëve përgjatë kësaj procedure.

<sup>113</sup> Shiko gjykimin në rastin T-87/05 *EDP v Commission* [2005] ECR II-3745, paragrafi 161 . Shiko gjykimin në rastin T-290/94 *Kaysersberg SA v Commission* [1997] ECR II-2137

<sup>114</sup> Rasti COMP/M.3440—ENI/EDP/GDP e 9 Dhjetor 2004, paragrafi 913.

1. Shitja duhet të përfundojë brenda një periudhe kohore fikse të rënë dakord ndërmjet palëve dhe Autoritetit. Periudha totale kohore është ndarë në periudhën për lidhjen e një marrëveshjeje përfundimtare dhe në një periudhë të mëtejshme për përfundimin, transferimin e titujve ligjorë të transaksionit. Periudha e lidhjes së një marrëveshjeje detyruese, ndahet në periudhën e parë, në të cilën palët mund të kërkojnë për një blerës të përshtatshëm (periudha e parë e shitjes) dhe nëse palët nuk janë të suksesshëm në shitjen e biznesit, një periudhë e dytë në të cilën administratori i shitjes merr të drejtën të shesë biznesin në një çmim minimum (periudha e shitjes nga administratori).
2. Praktika ndërkombëtare ka treguar se, periudhat e shkurtra të shitjes, kontribuojnë në suksesshmërinë e shitjes, ose në të kundërt, biznesi që do të shitet ekspozohet për një periudhë të zgjatur pasigurie. Periudha kohore, duhet të jetë aq e shkurtër në mënyrë që të jetë e realizueshme. Autoriteti, normalisht merr në konsideratë një periudhë prej 6 muajsh për periudhën e parë të shitjes dhe një periudhë shtesë prej 3 muajsh për shitjen nga administratori. Një periudhë shtesë prej 3 muajsh, normalisht parashikohet për përfundimin e transaksionit. Këto periudha, mund të ndryshohen rast pas rasti. Në veçanti, ato mund të shkurtohen, nëse ka një risk të lartë lidhur me suksesshmërinë e biznesit në periudhën e ndërmjetme.
3. Afati kohor për shitjen, normalisht do të fillojë në ditën e marrjes së vendimit nga Komisioni. Përgjatë bëhet për transaksionet nëpërmjet ofertave publike, ku palët angazhohen të shesin biznesin. Në këto rrethana, kur palët nuk mund të përgatiten për shitjen e biznesit, përpara përfundimit të përqendrimit të njoftuar, Komisioni mund të pranojë që periudha për një shitje të tillë, do të fillojë vetëm në datën e përfundimit të transaksionit të njoftuar. Kjo mënyrë përdoret edhe në rastet kur data e përfundimit të përqendrimit, nuk është nën kontrollin e palëve, d.m.th kërkon miratimin e shtetit.<sup>115</sup> Në të kundërt, është e përshtatshme të shkurtohen afatet kohore, me qëllim që të reduktohet koha e pasigurisë për biznesin që do të shitet.
4. Ndërkohë që për blerësit e radhës së sipërme zgjidhjet zbatohen procedurat e përshkruara më sipër, procedurat ndryshojnë për zgjidhjet e menjëhershme/që zgjidhen të parat (*fix-it-first*). Në përgjithësi, një marrëveshje detyruese me blerësin, tashmë do të lidhet përgjatë procedurës, në mënyrë që pas vendimit, të parashikohet vetëm një periudhë e mëtejshme për përfundimin e transaksionit. Nëse para vendimit, ka përfunduar vetëm kuadri i marrëveshjes, periudha e parashikuar për lidhjen e një marrëveshjeje të plotë dhe si rrjedhojë edhe periudha përfunduese, do të vendoset rast pas rasti.<sup>116</sup>

## 2. Miratimi i blerësit dhe i marrëveshjeve të shitjeve dhe të blerjeve

1. Me qëllim që të sigurohet efektiviteti i angazhimeve, shitja tek blerësi i propozuar kërkon miratimin paraprak nga Komisioni. Kur palët (ose administratori për shitjen) kanë arritur një marrëveshje përfundimtare me blerësin, ata duhet të depozitojnë një propozim të arsyetuar dhe të dokumentuar para Autoritetit. Palët ose administratori për shitjen, duhet të

<sup>115</sup> Megjithatë, gjithashtu në këto rrethana dispozita të tjera të angazhimeve në veçanti dispozitat që krijojnë siguri në periudha të ndërmjetme duhet të fillojnë të datën e marrjes së vendimit.

<sup>116</sup> Shiko rastin COMP/M.3916—T-Mobile Austria/telering e 20 Prill 2006

bindin Komision, se blerësi i propozuar plotëson kërkesat blerësin blerjes (kërkesat mbi blerësin) dhe që biznesi është shitur sipas vendimit të Komisionit dhe angazhimeve përkatëse. Kur angazhimet lejojnë që blerës të ndryshëm të propozohen për pjesë të ndryshme të paketës, Autoriteti do të vlerësojë nëse çdo blerës individual i propozuar është i pranueshëm dhe që zgjidhet çdo shqetësim konkurrence.

2. Në vlerësimin e blerësve të propozuar, Autoriteti vlerëson kërkesat për blerësin, duke pasur parasysh qëllimin e angazhimeve, për ruajtjen e një konkurrence efektive në treg, kur janë shfaqur shqetësime të konkurrencës.<sup>117</sup> Në përgjithësi, vlerësimi i Autoritetit lidhur me kërkesat e blerësit, do të jetë depozitimi nga palët, i vlerësimit të monitorimit nga administratori dhe në veçanti diskutimet me blerësit e propozuar dhe planet e tij të biznesit.
3. Blerësi duhet të ketë burimet e nevojshme financiare, dhe duhet të kihet parasysh se si përftimi/blerja është financuar nga blerësi i propozuar. Autoriteti nuk pranon asnjë financim të shitjes nga shitësi, nëse kjo bëhet për të dhënë shitësit në të ardhmen, një pjesë të përfitimeve të biznesit të shitur.
4. Në vlerësimin nëse blerësi i propozuar, rrezikon të krijojë shqetësime të konkurrencës, Autoriteti i konkurrencës vlerëson të gjithë informacionin e disponueshëm në procesin e miratimit të blerësit. Blerësi i propozuar duhet të marrë të gjitha miratimet përkatëse nga autoritetet përkatëse rregullatore. Kur mund të parashikohet (në përputhje me informacionin që disponohet nga Autoriteti) se ka vështirësi të caktuara për marrjen e vendimit të autorizimit për kontrollin e përqendrimeve ose miratime të tjera, të cilat mundet padrejtësisht të vonojnë zbatimin në kohë të angazhimeve, konsiderohet se blerësi i propozuar nuk plotëson kërkesat blerësin duhura.
5. Kërkesat për miratim nga Autoriteti, zakonisht nuk shtrihen vetëm në identifikimin e blerësit, por gjithashtu në marrëveshjen e shitjes dhe blerjes dhe ndonjë lloj tjetër marrëveshjeje të lidhur midis palëve dhe blerësit të propozuar, përfshirë edhe marrëveshjet tranzitore. Autoriteti verifikon nëse shitja sipas marrëveshjes është në përputhje me angazhimet apo jo.<sup>118</sup>
6. Autoriteti i komunikon palëve, këndvështrimet e tij, lidhur me përshtatshmërinë e blerësit të propozuar. Nëse Komisioni arrin në përfundimin, se blerësi i propozuar nuk plotëson kërkesat e blerësit, do të marrë një vendim që blerësi i propozuar nuk është blerësi sipas angazhimeve.<sup>119</sup> Nëse Autoriteti, arrin në përfundimin se marrëveshja e shitjes dhe blerjes nuk parashikon një shitje në përputhje me angazhimet, ia komunikon këtë palëve, pa qenë domosdoshmërisht e nevojshme të refuzojë blerësin. Nëse Autoriteti arrin në përfundimin se blerësi është i përshtatshëm sipas angazhimeve dhe që nga kontrata arrihet në një shitje në përputhje me

<sup>117</sup> Shiko gjykimin në rasti T-342/00 *Petrolesence v Commission* [2003] ECR II-1161.

<sup>118</sup> Siç diskutohet më lart, palët mund të aplikojnë para Autoritetit për të miratuar shitjen e biznesit tek blerësi i propozuar pa një ose më tepër asete ose pjesë të personelit nëse kjo nuk ndikon suksesin dhe konkurrueshmërinë e biznesit të shitur pas shitjes, duke marrë në konsideratë burimet e blerësit të propozuar.

<sup>119</sup> Rasti COMP/M.1628—TotalFina/Elf e 9 shkurt 2000, stacioni I shërbimeve të mjeteve motorike konfirmuar nga gjykimi në rasti T-342/00 *Petrolesence v Commission* [2003] ECR II-1161.

angazhimet, Komisioni miraton shitjen tek blerësi i propozuar.<sup>120</sup> Komisioni nxjerr vendimin e miratimit sa më shpejt të jetë mundur.

### 3. Detyrimi i palëve në periudhën e ndërmjetme.

Palët duhet të përmbushin detyrime të caktuara në periudhën e ndërmjetme. Pikat e mëposhtme do të jenë pjesë e angazhimeve: (i) siguria në ruajtjen e suksesshmërisë së biznesit; (ii) hapat e nevojshme për procesin e ndryshimeve/*carve-out*, dhe (iii) hapat e nevojshëm për të përgatitur shitjen e biznesit.

#### *Ruajtja e përkohshme e biznesit të shitur*

1. Është përgjegjësi e palëve që të zvogëlojnë në minimum rreziqet e mundshme të humbjes së konkurrencës potenciale të biznesit që do të shitet, që vijnë si rezultat i pasigurive që lidhen me transferimin e biznesit. Deri në momentin e transferimit të biznesit tek blerësi, Autoriteti kërkon nga palët, të ofrojnë angazhimet për ruajtjen e pavarësisë, suksesshmërisë ekonomike, tregtueshmërinë dhe konkurrueshmërinë e biznesit. Vetëm këto angazhime bëjnë që Autoriteti të arrijë në përfundime të sigurta se shitja e biznesit do të kryhet ashtu siç është propozuar nga palët në angazhimet e tyre.
2. Angazhimet hartohen në mënyrë të tillë që të jepet siguria se ai është i administruar si një biznes i suksesshëm dhe i shitshëm (me interes të lartë), me synimin për të siguruar suksesshmërinë e tij vijuese ekonomike, tregtueshmërinë dhe pavarësinë e tij.
3. Palëve u kërkohet që të sigurojnë që të gjitha asetet e biznesit janë ruajtur, në përputhje me praktikat më të mira të biznesit dhe që nuk është ndërmarrë ndonjë veprim që mund të ketë një ndikim të kundërt mbi biznesin. Kjo lidhet në veçanti me ruajtjen e aseteve fikse, know-how ose informacioneve tregtare të një natyre konfidenciale ose pronësie, të dhënat mbi klientët dhe aftësitë teknike dhe tregtare të nëpunësve. Për më tepër, palët duhet të ruajnë biznesin në të njëjta kushte si para përqendrimit, në veçanti të sigurojnë burime të mjaftueshme të tilla si kapitale ose linjë kreditosh (mbi bazën dhe vazhdueshmërinë e planeve ekzistuese të biznesit) i njëjti administrim dhe funksione menaxheriale, ose faktorë të tjerë që sigurojnë ruajtjen e konkurrencës në sektorë specifikë. Angazhimet, parashikojnë gjithashtu se palët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme, përfshirë skemat nxitëse të përshtatshme për të inkurajuar të gjithë personelin kryesorë që të qëndrojnë në këtë biznes. Gjithashtu, palët nuk duhet të kërkojnë të lëvizin ndonjë personel tek biznesi i tyre (biznesi që ngelet).
4. Palët duhet të mbajnë biznesin të ndarë nga biznesi i tyre dhe të sigurojnë që personeli kryesorë i biznesit që do të shitet, nuk do të përfshihet me biznesin që ata kanë dhe e kundërta (*vice versa*). Nëse biznesi që do të shitet, është në formën e korporatës dhe është e nevojshme një ndarje strikte e strukturës së korporatës, e drejta e palëve si aksionarë (në veçanti ata që kanë të drejtë vote) duhet të ushtrohet nga administratori monitorues, i cili duhet të ketë të drejtën

<sup>120</sup>Në varësi të rrethanave të shitjes, palët duhet gjithashtu të sigurojnë p.sh se nëpërmjet dispozitave të përshtatshme të marrëveshjes së blerjes, se blerësi do të ruajë biznesin e shitur si një forcë konkurruese në treg dhe nuk do ta shesë biznesin brenda një periudhe të shkurtër kohore.

që të zëvendësojë anëtarët e bordit të zgjedhur nga vetë palët (në emër të palëve). Në çdo rast, duhet të sigurohet se palët nuk ruajnë ndonjë sekret biznesi ose informacion tjetër konfidencial. Çdo dokument ose informacion tjetër konfidencial për biznesin që ruhet nga palët para marrjes të vendimit, duhet të kthehet tek biznesi ose të shkatërrohet.

5. Palëve u kërkohet që të caktojnë një menaxher, me ekspertizën e nevojshme, i cili do të jetë i përgjegjshëm për menaxhimin e biznesit dhe zbatimin e detyrimeve. Menaxheri duhet të veprojë nën mbikëqyrjen e administratorit monitorues, i cili mund të nxjerrë instruksione për menaxherin. Angazhimet duhet të parashikojnë që, caktimi i tyre duhet të ndodhë menjëherë pas marrjes së vendimit dhe para se palët të përfundojnë përqendrimin e njoftuar. Kur palët mund të caktojnë menaxherin nga vetë ata, angazhimet duhet të parashikojnë që administratori monitorues të jetë në gjendje të heqë/pushojë nga puna menaxherin nëse ai/ajo nuk vepron në linjë me angazhimet ose rrezikon zbatimin e përshtatshëm të tyre në kohë. Caktimi i një menaxheri të ri është e drejtë e administratorit monitorues.

#### *Hapat për ndryshimin/carve-out*

1. Autoriteti mund të pranojë në rrethana të caktuara, që shitja e biznesit i cili nevojitet të ndryshohet/*carved out* nga bizneset që palëve mbeten palëve, të mund të konsiderohen si masa të përshtatshme. Shqetësimet e konkurrencës në këtë rast, i eliminon transferimi i biznesit të suksesshëm tek blerësi, i cili mund të ruajë dhe të zhvillojë këtë biznes si një forcë aktive konkurruese. Prandaj palët duhet të angazhohen nëpërmjet një detyrimi të orientuar nga rezultatet, që të ndërmarrin në periudhën e ndërmjetme, një ndryshim/*carve-out* të aseteve, të cilat kontribuojnë në biznesin e shitur. Rezultati duhet të jetë i tillë, që biznesi konkurrues i cili është i suksesshëm dhe që është i ndarë nga bizneset e tjera të palëve, mund të transferohet tek një blerës i përshtatshëm në përfundim të periudhës së përkohshme. Palët duhet të përballojnë kostot dhe riskun e këtij ndryshimi/ *carve-out* në periudhën e ndërmjetme.
2. Ndryshimi/*Carve-out* duhet të ndërmerret nga palët nën mbikëqyrjen e administratorit dhe në bashkëpunim me menaxherin. Së pari, ato dhe ajo pjesë e personelit, të cilat janë ndarë ndërmjet biznesit që do të shitet dhe bizneset që u ngelen palëve, duhet të shpërndahen tek biznesi, në masën që kjo nuk është përjashtuar nga angazhimet.<sup>121</sup> Shpërndarja e aseteve dhe personelit do të monitorohen dhe duhet të miratohen nga administratori monitorues. Së dyti, ky proces mundet që të kërkojë një përsëritje të aseteve që zotërohen ose funksioneve që kryhen nga pjesë të tjera të biznesit të palëve, nëse kjo është e nevojshme për të siguruar suksesshmërinë dhe konkurrueshmërinë e biznesit që do të shitet. Një shembull, është përfundimi i pjesëmarrjes së biznesit, në teknologjinë qendrore të informacionit dhe një instalim i një sistemi të ndarë të teknologjisë së informacionit për biznesin. Në përgjithësi, hapat kryesorë për një proces të tillë dhe funksionet që do të përsëriten duhet të vendosen rast pas rasti dhe të përshkruhen në angazhimet përkatëse.

<sup>121</sup> Shiko paragrafin 26 më sipër për pyetjen se si asetet e ndara duhet të përballen me angazhimet.

3. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet se sukcesi i biznesit që do të shitet nuk është ndikuar nga të tilla masa. Në periudhën e ndërmjetme, palët duhet të ruajnë përdorimin e aseteve, dhe të vazhdojnë të sigurojnë shërbime për biznesin, në të njëjtën masë si në të kaluarën, për sa kohë që biznesi nuk është akoma i suksesshëm mbi baza të vetë-qëndrueshme.

*Detyrime të veçanta të palëve për sa i përket procesit të shitjes.*

Gjatë procesit të shitjes, angazhimet duhet të parashikojnë që blerësi i mundshëm të jetë i kujdesshëm dhe të ruajë, informacion të mjaftueshëm në lidhje me biznesin e shitur. Në këtë mënyrë blerësi ka mundësi të ketë informacion në lidhje me vlerën, qëllimin dhe mundësitë konkurruese të biznesit si dhe të ketë akses të plotë tek personeli. Palët duhet të depozitojnë raporte periodike mbi blerësin e mundshëm dhe zhvillimet e negociatave. Shitja, do të zbatohet vetëm pasi transaksioni të ketë përfunduar, që do të thotë atëherë kur titulli ligjor ka kaluar tek blerësi i miratuar, dhe asetet janë transferuar aktualisht. Në përfundim të procesit, palët duhet të dërgojnë raportin përfundimtar, që konfirmon mbylljen dhe transferimin e aseteve.

**4. Administratori monitorues dhe i shitjes**

*Roli i administratorit monitorues*

1. Duke qenë se Autoriteti, nuk mundet të jetë direkt i përfshirë ditë pas dite në mbikëqyrjen e zbatimit të angazhimeve, palët duhet të propozojnë caktimin e një administratori për të mbikëqyrur zbatimin nga palët të angazhimeve, në veçanti me detyrimet e tyre në periudhën e ndërmjetme dhe procesin e shitjes (i ashtuquajtur “administratori monitorues”). Palët garantojnë efektivitetin e angazhimeve të depozituara nga ato dhe e sigurojnë Autoritetin se ndryshimi (modifikimi) i përqendrimit të njoftuar, ashtu siç është propozuar nga palët, do të ndërmerret në përputhje me shkallën e kërkuar të sigurisë.
2. Administratori monitorues, do të ushtrojë detyrat e tij nën mbikëqyrjen e Autoritetit dhe do të konsiderohet si “syri dhe veshi” i Autoritetit. Do të jetë gardiani që biznesi është menaxhuar dhe është ruajtur mbi baza të vet-qëndrueshme në periudhën e ndërmjetme. Prandaj Autoriteti mund të japë urdhra dhe instruksione për administratorin monitorues me qëllim që të sigurojë përputhshmëri me angazhimet dhe administratori mund të propozojë palëve çdo masë, që e konsideron të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij. Megjithatë, palët nuk mund të instruktojnë administratorin, pa miratimin e Komisionit.
3. Angazhimet përcaktojnë detyrat për administratorin monitorues. Detyrat dhe detyrimet do të specifikohen në detaje në mandatin e administratorit dhe do të konkludohen ndërmjet palëve dhe administratorit, dhe detyrat e tij më pas do të përshkruhen në një plan pune të detajuar. Detyrat e administratorit monitorues, normalisht do të fillojnë menjëherë pas miratimit nga Komisioni të vendimit dhe do të zgjasin deri në transferimin ligjor dhe aktual të biznesit tek blerësi i miratuar. Ndër detyrat kryesore, dallojmë pesë prej tyre (por jo



- vetëm këto) të cilat administratori monitorues duhet t’i ndërmarrë nën mbikëqyrjen e Autoritetit:
- a) së pari, administratori monitorues mbikëqyr sigurinë e biznesit që do të shitet në periudhën e ndërmjetme;
  - b) së dyti, në rastet e ndryshimeve/*carve-out*, administratori monitorues duhet të monitorojë ndarjen e asetëve dhe shpërndarjen e personelit,
  - c) së treti, administratori monitorues duhet të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e përpjekjeve të palëve për të gjetur një blerës të mundshëm për të transferuar biznesin. Në përgjithësi, duhet të rishikojë progresin e procesit të shitjes dhe blerësit e mundshëm të përfshirë në proces. Duhet të verifikojë që blerësit e mundshëm, kanë marrë informacionin e mjaftueshëm lidhur me biznesin- Sapo të jetë propozuar blerësi , administratori monitorues duhet të depozitojë pranë Autoritetit, një opinion të arsyetuar në lidhje me faktin nëse blerësi i propozuar plotëson kërkesat mbi blerësin sipas angazhimeve përkatëse dhe nëse biznesi është shitur sipas angazhimeve. Në fund të procesit, administratori monitorues duhet të mbikëqyrë transferimin ligjor dhe aktual të biznesit tek blerësi dhe të përgatisë një raport përfundimtar që konfirmon transferimin.
  - d) së katërti, administratori monitorues duhet të veprojë si një pikë kontakti për çdo kërkesë nga palët e treta, në veçanti nga blerësit e mundshëm, në lidhje me angazhimet. Palët duhet të informojnë palët e treta të interesuara për identitetin dhe detyrat e administratorit monitorues, përfshirë edhe ndonjë blerës të mundshëm. Në raste mos-marrëveshjesh ndërmjet palëve dhe palëve të treta, në lidhje me çështjet lidhur me angazhimet, administratori monitorues duhet të diskutojë këto çështje me të dyja palët dhe të raportojë para Autoritetit. Me qëllim që ti mundësohet ushtrimi i rolit të tij, administratori monitorues do të ruajë konfidencialitetin për ndonjë sekret biznesi të palëve dhe palëve të treta.
  - e) së pesti, administratori monitorues duhet të raportojë mbi këto çështje para Autoritetit, sipas kërkesës së Autoritetit në raporte periodike dhe duhet të depozitojë raporte shtesë sipas kërkesës së Komisionit.
4. Angazhimet duhet të përcaktojnë shprehimisht nevojat e administratorit monitorues për mbështetje dhe bashkëpunim me palët dhe Autoriteti do të mbikëqyrë lidhjen ndërmjet palëve dhe administratorit, në lidhje me këtë fakt. Me qëllim plotësimin e këtyre detyrave, administratori duhet të ketë akses në librat dhe regjistrat e palëve dhe të biznesit që shitet, për sa kohë dhe deri në atë masë që kjo është e përshtatshme për zbatimin e angazhimeve. Ai gjithashtu mund të kërkojë gjithashtu mbështetje menaxheriale dhe administrative nga palët, duhet të informohet për blerësit e mundshëm dhe të gjitha zhvillimet në procesin e shitjes dhe duhet ti sigurohet i gjithë informacioni, i cili i është depozituar blerësve të mundshëm. Palët duhet të dëmshpërblejnë administratorin dhe ti lejojnë atij të caktojë këshilltarë, nëse është e përshtatshme për plotësimin e detyrave të tij sipas angazhimeve. Angazhimet duhet t’i mundësojnë Autoritetit, që të ndajë informacionin mbi palët me administratorin monitorues, me qëllim që t’i lejojë administratorit

monitorues përmbushjen e detyrave të tij. Administratori monitorues do të jetë i detyruar që të ruajë informacionin konfidencial.

#### *Roli i administratorit shitës*

1. Ashtu si për administratorin monitorues, palët duhet të propozojnë caktimin e një administratori shitjeje (për shitjen), me qëllim që ti bëjnë angazhimet efektive, duke siguruar Autoritetin se do të ndërmerren ndryshimet/modifikimet në përqendrimin e njoftuar, ashtu siç janë propozuar nga ata. Nëse palët, nuk ja arrijnë që të gjejnë një blerë të përshtatshëm brenda periudhës së parë të shitjes, atëherë në periudhën e shitjes së administruar, administratorit për shitjen, do ti jepet një mandat i parevokueshëm dhe ekskluziv për të vendosur mbi biznesin, nën mbikëqyrjen e Autoritetit brenda një afati kohor të veçantë, jo me çmim minimum tek një blerës i përshtatshëm. Angazhimet duhet t’i lejojnë administratorit për shitjen, të përfshijë në marrëveshjen e shitjes dhe blerjes kushte dhe detyrime të tilla, duke i konsideruar të përshtatshme për një shitje të përshtatshme, në veçanti për klientelën, garancitë dhe dëmshpërblimet. Shitja e biznesit nga administratori për shitjen, është në të njëjtën mënyrë subjekt i miratimit paraprak nga Komisioni ashtu si dhe shitja nga palët.
2. Angazhimet do të përcaktojnë se palët duhet të mbështesin dhe informojnë administratorin për shitjen dhe të bashkëpunojnë me administratorin në të njëjtën mënyrë ashtu siç është parashikuar për administratorin monitorues. Për shitjen, palët duhet t’i garantojnë/japin administratorit për shitjen të drejtat e avokatit/përfaqësuesit, përfshirë edhe të gjitha fazat e shitjes.

#### *Miratimi i administratorit dhe mandati i administratorit*

1. Në varësi të angazhimeve, administratori monitorues, mundet ose jo të jetë i njëjti person ose institucion me administratorin për shitjen. Palët duhet të propozojnë një ose disa administratorë potencial para Autoritetit, përfshirë edhe afatet e plota të mandatit dhe të hartojnë një plan pune. Është e rëndësishme që administratori monitorues, të jetë në punë menjëherë pas vendimit të Komisionit. Prandaj palët duhet të propozojnë një administrator të përshtatshëm menjëherë pas vendimit të Komisionit,<sup>122</sup> dhe angazhimet normalisht duhet të parashikojnë që përqendrimi i njoftuar mundet vetëm të zbatohet pasi administratori monitorues të jetë caktuar, pasi është miratuar nga Komisioni.<sup>123</sup> Situata është e ndryshme për administratorin për shitjen, i cili duhet të caktohet shumë përpara përfundimit të periudhës së parë të shitjes,<sup>124</sup> në mënyrë që mandati i tij të fillojë efektet me fillimin e periudhës së administrimit të shitjes.
2. Të dy llojet e administratorëve, do të caktohen nga palët mbi baza të një mandati administratori, të lidhur midis palëve dhe administratorit. Caktimi dhe mandati do të jenë subjekt miratimi nga Komisioni, i cili do të ketë

<sup>122</sup> Normalisht angazhimet duhet të parashikojnë që administratori monitorues të propozohet brenda 2 javësh nga data e vendimit

<sup>123</sup> Rasti COMP/M.4180 — GdF/Suez e14 Nëntor 2006; rasti COMP/M.4187 — Metso/Aker Kvaerner e 12 Dhjetor 2006; rasti COMP/M.3916—T-Mobile/tele.ring e 20 prill 2006.

<sup>124</sup> Komisioni normalisht do të kërkojë caktimin të paktën një muaj para përfundimit të periudhës së parë të shitjes

diskrecionin të zgjedhë administratorin dhe do të vlerësojë nëse kandidatët e propozuar janë të përshtatshëm për detyrat në rastin specifik. Administratori duhet të jetë i pavarur nga palët, të zotërojë kualifikimet e nevojshme për të ushtruar mandatin e tij dhe nuk duhet të jetë ose të ketë konflikt interesi.

3. Komisioni do të vlerësojë kualifikimet e nevojshme rast pas rasti, përfshirë zonën gjeografike dhe sektorin në fjalë. Kompanitë e auditit dhe kompani të tjera konsultuese duhet të jenë veçanërisht të afta që të plotësojnë detyrimet e administratorit monitorues. Individët që kanë punuar në industri specifike mundet gjithashtu të jenë kandidatë të përshtatshëm, për ushtrimin e një roli të tillë nëse ata kanë burimet e nevojshme të disponueshme për t’u marrë me detyra të tilla. Bankat e investimit duket se janë veçanërisht të përshtatshme për rolin e administratorit për shitjen. Pavarësia e administratorit është pikë e rëndësishme me qëllim që ti mundësojë administratorit që të përmbushë në mënyrën e duhur rolin e tij të monitorimit të palëve, siç përcakton Komisioni dhe të sigurojnë kredibilitetin e tij *vis-à-vis*<sup>125</sup> me palët e treta. Në veçanti, Komisioni nuk do të pranojë si administratorë persona ose institucione, të cilët janë në të njëjtën kohë auditorë të palëve ose këshilltarë të investimeve të tyre në shitje. Megjithatë, nuk do të krijohet konflikt interesi nga lidhja e administratorit me palët, nëse këto lidhje nuk dëmtojnë objektivitetin e administratorit dhe pavarësinë e tij në kryerjen e detyrave të tij. Është përgjegjësi e palëve, ti sigurojnë Autoritetit informacionin e duhur, për të verifikuar që administratori përmbush kërkesat. Caktimi i administratorit, pasi është aprovuar edhe nga palët është i përvokueshëm, më përjashtim të rastit kur administratori është zëvendësuar me miratimin dhe më kërkesë nga Komisioni.
4. Mandati i administratorit, duhet të përcaktojë detyrat, ashtu siç përcaktohen në angazhime dhe duhet të përfshijnë të gjitha dispozitat e nevojshme për të mundësuar administratorin që të përmbushë detyrat e tij sipas angazhimeve të pranuar nga Komisioni. Palët janë përgjegjëse për pagesën e administratorit sipas mandatit, dhe struktura e pagesës duhet të jetë e tillë që të mos pengojë pavarësinë e administratorit dhe efektivitetin e tij në përmbushjen e mandatit. Komisioni aprovon administratorin dhe mandatin e tij. Në raste të veçanta, mund të publikojë identitetin e administratorit dhe një përmbledhje të detyrave të tij.
5. Kur angazhimet specifike, me të cilat do të merrej administratori, janë zbatuar, (kur titujt ligjorë të biznesit që do të shitet janë kaluar, asetet janë transferuar tek blerësi dhe çdo marrëveshje e veçantë e cila mund të vazhdonte pas shitjes është përmbushur), mandati i jep të drejtën administratorit, të kërkojë nga komisioni të lirohet nga përgjegjësi të mëtejshme. Edhe pas shkarkimit që i është dhënë, mund të jetë e nevojshme për Komisionin që të kërkojë një ricaktim të administratorit bazuar tek angazhimet, nëse Komisioni vlerëson se angazhimet nuk janë zbatuar plotësisht ose në mënyrën e duhur.

## 5. Detyrimet e palëve që ndjekin zbatimin e shitjes

---

<sup>125</sup> Ballë për ballë

Angazhimet duhet të parashikojnë që për një periudhë prej 10 vjetësh pas miratimit të vendimit që pranon angazhimet, Autoriteti mund të kërkojë informacion nga palët. Kjo i lejon Autoritetit që të monitorojë zbatimin efektiv të masave.

#### 6. Zbatimi i angazhimeve të tjera.

1. Shumë nga parimet e diskutuara më sipër për zbatimin e angazhimeve të shitjes mundet të zbatohen në mënyrë të barabartë për lloje të tjera angazhimesh nëse këto angazhime nevojitet të zbatohen njëkohësisht me vendimin e Komisionit. P.sh nëse është parashikuar që përfutuesi i një licence duhet të miratohet nga Komisioni, vlerësimet lidhur me miratimin e blerësit mundet gjithashtu të zbatohen.
2. Megjithatë, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e gjatë të angazhimeve jo të shitjes dhe kompleksitetin e tyre të shpeshtë, ato shpesh kërkojnë lartët monitorohen për një kohë të gjatë dhe mjete monitoruese specifike me qëllim që t’i lejojnë Autoritetit të arrijë në përfundimin që ato do të zbatohen efektivisht. Prandaj, Autoriteti shpesh do të kërkojë përfshirjen e administratorit për të mbikëqyrur zbatimin e këtyre angazhimeve dhe krijimin e procedurave me qëllim që të sigurojnë një mekanizëm zgjidhjeje dhe ti bëjnë angazhimet të zbatueshme nga vetë pjesëmarrësit në treg. Praktika njeh raste kur është kërkuar caktimi i një administratori .<sup>126</sup> Në këto rrethana, administratori do të mbikëqyrë zbatimin e angazhimeve dhe gjithashtu do të jetë në gjendje të asistojë në procedimet arbitrare me synimin që ato të përfundojnë në një periudhë kohore të shkurtër.

---

<sup>126</sup> Një model i tillë i kombinimit të monitorimit nga arbitrariteti dhe i administratorit monitorues ishte p.sh rasti COMP/M.2803 — Telia/Sonera e 10 Korrik 2002; rasti COMP/M.3083 — GE/Instrumentarium e 2 Shator 2003; dhe rasti COMP/M.3225—Alcan/Pechiney II e 29 Shator 2003.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 375 , datë 08.10.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cogemat S.p.A nga shoqëria SNAI S.p.A”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |              |
|----------------------------|--------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetare     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetare |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar       |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtare      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar;      |

Në mbledhjen e tij të datës 08.10.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cogemat S.p.A nga shoqëria SNAI S.p.A.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Snai S.p.A / Cogemat S.p.A dhe relacionit shoqëruar të Sekretarit të Përgjithshëm,

**V Ë R E N S E:**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi**

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes së investimit” të datës 11 Korrik 2015, e lidhur ndërmjet palëve shoqëria Snai S.p.A (në cilësinë e emetuesit financiar) dhe OI-Games 2 S.A, OI-Games S.A, International Entertainment ( në cilësinë e ortakëve financiarë), aksionerët e shoqërisë Cogemat S.p.A, me objekt përfutimin e kontrollit, nga Snai S.p.A të të gjitha zotërimeve të shoqërive OI Games 2 S.a, OI GAMES S.A International Entertainment S.A dhe rrjedhimisht të gjithë aktivitetit të zhvilluar nga Grupi Cogemat.

Përqendrimi nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë tregun e brendshëm të produktit sa i përket lojërave të fatit, por njoftimi i përqendrimit është bërë për shkak të xhirove të

realizuara në Shqipëri nga shoqëria Hydra Energia S.r.l, e cila është e zotëruar nga shoqëria që kontrollon në mënyrë indirekte shoqërinë Snai S.p.A (‘Palladio Finanziaria’).

Transaksioni përqendrimit me anë të së cilit shoqëria Snai S.p.A përfton kontrollin maxhoritar të shoqërisë Cogemat S.p.A përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndyshuar) dhe plotëson kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe tregun e brendshëm.

## 2. Palët në transaksion

- SNAI S.P.A (‘Snai’), në cilësinë e përfutësit të kontrollit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian, me seli në adresën: Via Luigi Boccherini 39, 55016 Porcari, Itali. Shoqëria nuk ka prezencë në Shqipëri.
- COGEMAT S.p.A (‘Cogemat’), në cilësinë e shoqërisë Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian, me seli në adresën: Piazza della Repubblica 32, 20124 Milano, Itali.  
Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.

## 3. Xhiro për vitin 2014

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar<sup>127</sup> është XXX Lekë.

- SNAI s.p.a.: XXX Euro = XXX Lekë;
- COGEMAT s.p.a. :XXX Euro = XXX Lekë;
- Palladio Finanziara S.p.a. : XXX Euro = XXX Lekë;

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXX Lekë:

- Hydro Energia s.r.l. : XXX Euro = XXX Lekë;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

## 4. Tregu Përkatës:

**Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve.

**Tregu përkatës gjeografik:**Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Përqendrimi i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit nga shoqëria Snai S.p.A, të shoqërisë Cogemat S.p.A duke përfshirë dhe degët e saj. Ky transaksion ndodh në

<sup>127</sup> Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2014, 1 euro = 140 lekë.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

tregun e lojrave të fatit në Itali dhe nuk ka asnjë impakt në tregun e brendshëm përkatës të lojërave të fatit.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkonti Komisionit autorizimin e këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

**VENDOSI:**

3. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cogemat S.p.A nga shoqëria SNAI S.p.A.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**  
**nr.376 , datë 15.10.2015**

**“Për**  
**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me**  
**objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale / horizontale në akset**  
**kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi”, Loti 1 dhe Loti 2”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.10.2014, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i informacionit “Mbi procedurën e prokurimit publik të organizuar nga ARRSH me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale / horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti 1 dhe Loti 2”

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi procedurën e prokurimit publik të organizuar nga ARRSH me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti 1 dhe Loti 2”,

**VËREN SE:**

Nisur nga një artikull në media ku trajtohet një shqetësim mbi mungesën potenciale të konkurrencës në tregun e shërbimit të sinjalistikës rrugore, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr 378 prot, datë 14.09.2015, kërkoi informacion nga “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, lidhur me procedurat e prokurimit të realizuara në datat 07.09.2015 dhe



**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

09.09.2015 me objekt: “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi, Loti 1 dhe Loti 2”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me dy lotet e procedurës së mësipërme rezulton se firmat fituese në të dy lotët kanë qenë shumë pranë fondit limit (96 dhe 97 %) si dhe ka një mundësi të pjesëmarrjes së operatorëve aktivë në tregun përkatës në procedurat e prokurimit në të dyja lotët.

Si përfundim, nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit të dy loteve të procedurës së prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale / horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi”, vërehet se ndërmarjet të cilat kanë fituar këto procedura prokurimi me vlera ofertuese shumë afër fondit limit, nuk kanë konkurruar në të dyja lotët dhe mund të kenë përdorur skemën e rotacionit në ofertave duke ndarë tregun (duke përfutur pjesë përafërsisht të barabarta të fondit limit).

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

**V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti 1 dhe Loti 2, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se 30 ditë nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Eduard YPI</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Servete GRUDA</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Zv/Kryetar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**Nr. 377, datë 22/10/2015**

**“Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive ose të veçanta nëpërmjet kontratave koncesionare”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.10.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi procedurës së miratimit të kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të portit të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”

**Baza ligjore:** Ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), neni 69 dhe neni 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës** pas vlerësimit të Ligjit nr. 104/2015 “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës,

**VËREN SE:**

1. Sipas nenin 2, pika 1 germa c të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) (këtu e në vijim-“Ligji”), ky ligj zbatohet “*për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet që ju janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të veçanta*”.
2. Në nenin 69 pika 1 të Ligjit parashikohet: “*detyrimi për organet qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt që ka të bëjë ndër të tjera me (b) vendosjen e të drejtave*”

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

*ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara”.*

3. Komisioni i Ekonomise dhe i Financave, në rezultatat e vlerësimit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zbatimin e detyrimit ligjor nga ana e institucioneve publike për marrjen e vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës si një instrument i domosdoshëm për rritjen e eficiences se perdorimit të pasurisë publike. Më konkretisht Rezoluta për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, cilëson: *“Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës: -Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit të akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimeve sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.”*
4. Proçedura për dhënien e konçensionit të formës “BOT” (ndërtim,shfrytëzim dhe transferim) në pronësi të shtetit (Built-Operate-Transfer/ BOT) të një Porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto-Romano, Durrës, është në shkelje të nenit 2, pika 1 (germa c) dhe atij 69, pika 1(germa b) të Ligjit, pasi nuk është zbatuar detyrimi ligjor nga Ministria e Transportit dhe Këshilli i Ministrave për të dërguar dhe marrë vlerësimin e Autoritetit Konkurrencës mbi këtë projekt-akt që vendos të drejta ekskluzive dhe/ose të veçanta, në një zonë të caktuar, për ndërmarrjen të cilës i është dhënë ky konçension.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

### **VENDOSI:**

2. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë së Trajtimit të Konçensioneve që:
  - Të zbatojë nenin 2 pika 1 gërma c dhe nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 378 , datë 2.11.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Credins Leasing SHA nga Banka Credins SHA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar;     |

Në mbledhjen e tij të datës 2.11.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Credins Leasing SHA nga Credins Bank SHA.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Banka Credins SHA / Credins Leasing SHA dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

**V Ë R E N S E:**

**1. Transaksioni dhe përqendrimi.**

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për bashkimin me përthithje të shoqërive Banka Credins SHA dhe Credins Leasing SHA”, e cila është nënshkruar ndërmjet palëve më datë 30 Shtator 2015. Objekti i marrëveshjes është transferimi nga Credins Leasing i të gjitha aktiveve dhe pasiveve që zotëron, tek Banka Credins, në këmbim të aksioneve të kësaj të fundit.

Banka Credins do të përthithë në strukturën e saj Credins Leasing, duke ushtruar edhe veprimtarinë e qirasë financiare nga vetë ajo, duke qenë se veprimtaria e qirasë

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

financiare përfshihet në liçencën e ushtrimit të veprimtarisë së lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Pas realizimit të “Marrëveshjes për bashkimin me përthithje të shoqërive Banka Credins SH.A dhe Credins Leasing SH.A”, Banka Credins do të jetë zyrtarisht pronare dhe ushtruese e aktivitetit të qirasë financiare të Credins Leasing me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin prej saj.

Transaksioni, i cili realizohet në formën e bashkimit me përthithje të Credins Leasing SH.A nga Banka Credins SH.A, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) e Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndyshuar) përbën një përqendrim.

### 2. Palët në transaksion

2.1 Banka Credins SH.A: në cilësinë e Ndërmarrjes Përthithëse, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar, Ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me seli në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, nr. 4, Tiranë. Objekti i shoqërisë është veprimtaritë bankare dhe financiare: a) të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore; b) faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare; c) qiranë financiare; d) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit, çeqet bankare dhe kartat e pagesës, etj.

2.2 Credins Leasing SH.A (Credins Leasing): në cilësinë e Ndërmarrjes së Përthithur është një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit bankar të RSh-së, me seli në adresën: Rruga “Nikolla Tupe”, nr.5, Tiranë. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: a) të ushtrojë aktivitetin e qirasë financiare.; b) të japë kredi; c) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve; d) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare; etj.

### 3. Xhiro për vitin 2014

- Xhiro totale në tregun e brendshëm është 5 796 421 000 Lekë:
- Banka Credins SH.A : 5 659 956 000 Lekë;
- Credins Leasing SH.A: 136 465 000 Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”( i ndyshuar).

### 4. Analiza e konkurrencës

- a. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndyshuar), si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- tregu përkatës i produktit, dhe
  - tregu përkatës gjeografik.
- *Tregu përkatës i produktit:* Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘qiraja financiare/ leasing’.
  - *Tregu përkatës gjeografik:* Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

#### 4.2 Struktura e tregut të qirasë financiare

Aktualisht në Republikën e Shqipërisë janë të licencuara për kryerjen e aktivitetit të qirasë financiare jo vetëm subjekte financiare jo banka, ekskluzivisht të përfshira në skemën e këtij aktiviteti, por edhe të gjitha bankat tregtare të cilat operojnë në vend. Në këtë kuptim, tregu i qirasë financiare përbën një treg të hapur me një numër të konsiderueshëm lojtarësh potencialë.

Qiraja financiare ndryshon strukturën e portofolit të saj, në varësi të nevojave të bizneseve pasi pikërisht subjektet aktive në këtë treg fokusohen tek nevojat e këtyre të fundit për financime si në mjete transporti, pajisje, linja prodhimi, makineri bujqësore apo industriale etj.

Përveç subjekteve financiare jobanka, aktivitetin e qirasë financiare për vitin 2014 e kanë ushtruar dhe 3 banka të nivelit të dytë.

Në total, pjesa e kombinuar e tregut të Bankës Credins dhe Credins Leasing pas transaksionit do të arrijë vlerën prej 13.09%. Banka Credins do renditet si subjekti i dytë në treg.

#### 5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura. Bashkimi me përthithje në këtë rast i Credins Leasing nuk e rrit fuqinë e Bankës Credins në mënyrë të tillë që të krijojë një pozitë dominuese. Për më tepër, duke patur parasysh prezencën e një numri të lartë operatorësh të licencuar në këtë treg, ky transaksion nuk pritet të krijojë shqetësime në lidhje me konkurrencën në tregun përkatës.

Ky treg nuk paraqet pengesa domethënëse në hyrje për subjektet e reja si banka, subjekte financiare jobanka, apo qoftë për kompanitë importuese të mjeteve personale apo të punës, të cilat duan të zgjerojnë aktivitetin e tyre edhe në këtë treg.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Tregu i qirasë financiare mbikqyret nga Banka e Shqiperisë, e cila ka autoritetin për të liçencuar dhe mbikqyrur bankat, subjektet financiare jobanka në lidhje me këtë aktivitet.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkonti Komisionit autorizimin e këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”( i ndryshuar).

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” Komisioni i Konkurrencës,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Credins Leassign SH.A nga Banka Credins SH.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 379 , datë 02.11.2015**

**“ Mbi disa rekomandime për projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar
▪ Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.11.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".

**Baza ligjore:** Neni 24, germa f), neni 69 dhe neni 70 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të i projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit",

**VËREN SE:**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Ministria e Financave ka sjellë për mendim projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".
2. Nga vlerësimi i projekt/ligjit rezultoi se është marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me funksionimin e sistemit Bonus-Malus për individualizimin e primit të riskut, nëpërmjet Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës: nr. 247, dt. 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”; nr.325 , dt. 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”; dhe Vendimit nr.324, datë 30.07.2014 “Për vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj shoqërive të sigurimit për rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.

3. Konkretisht nëpërmjet nenit 8 të projektligjit shtohet një nen i ri, neni 10/1, mbi sitemin Bonus-Malus, i cili përfaqëson një sistem eficient tarifimi, që pasqyron profilin e riskut duke individualizuar tarifatat e primeve.
4. Me VKK nr.325, datë, 30.07.2014 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”, pika I.1, i është rekomanduar AMF-së: të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit nga siguruesi i drejtpërdrejtë sipas parashikimeve të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Ky rekomandim nuk është pasqyruar drejtpërdrejtë në projektligj.
5. Bazuar në nenin 11 të Ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", pala e dëmtuar ka të drejtë të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim te siguruesi, përgjegjës i pronarit të mjetit, me të cilin është shkaktuar aksidenti. Kërkesa për dëmshpërblim, që lidhet me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i një mjeti motorik ndaj një mjeti tjetër motorik, mund të trajtohet nga siguruesi i drejtpërdrejtë i pronarit të mjetit motorik të dëmtuar vetëm në rast se shoqëritë e sigurimit lidhin marrëveshje ndërmjet tyre.
6. Trajtimi në çdo rast i kërkesës për dëmshpërblim nga siguruesi i drejtpërdrejtë, do të rriste konkurrencën midis shoqërive të sigurimit në ofrimin e produktit MTPL, duke konkurruar kështu jo vetëm me çmimin e policës së sigurimit, por edhe me cilësinë e shërbimit, shpejtësinë dhe masën e dëmshpërblimit, mënyrën e vlerësimit të dëmit, etj.
7. Për sa më sipër vlerësojmë se projekt-ligji ka reflektuar pjesërisht rekomandimet e dhëna nga AK.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f), nenin 69, pika 1, dhe nenin 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave, që në projekt-ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të reflektohen ndryshimet e nevojshme, referuar neneve 11 dhe 12 të Ligjit, me qëllim që në çdo rast palës së dëmtuar t’i mundësohet trajtimi

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

i kërkesës për dëshmipërblim nga siguruesi i drejtpërdrejtë për të mundësuar rritjen e konkurrencës mes shoqërive të sigurimit dhe përmirësimit e cilësisë së shërbimit për të siguruarit.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi Ministrisë së Financiare dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

nr.380, datë 02/11/2015

**“Për**

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.11.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i informacionit “Mbi procedurën e prokurimit publik të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015” e ndarë në 13 lote.

**Baza ligjore:** Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi procedurën e prokurimit publik të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote.

**VËREN SE:**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 26.10.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 417 prot. na bën me dije se: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote, është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës, 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues, kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë. Nga paraqitja e këtyre ofertave identike, krijohet dyshimi se midis këtyre operatorëve mund të ketë marrëveshje të ndaluar, gjë

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

e cila bie ndesh me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Nga shqyrtimi i mëtejshëm i ofertave të paraqitura nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit të realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt: “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, vërehet se ofertat e paraqitura nga operatorët ofertues për të 13 lotet, janë shumë të njëjta ose shumë afër njëra-tjetrës. Për sa më sipër, në procedurën e prokurimit publik me objekt “Ruajtja e objekteve ku është akomoduar administrata tatimore për vitin 2015” mund të ketë kufizime të mundshme të konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1 dhe nenin 42 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

**V E N D O S I:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;
- II. Periudha e hetimit do të jetë viti 2015.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 18.12.2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Eduard YPI</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Servete GRUDA</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Zv/Kryetar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M  
nr. 381, datë 9.11.2015

“Për  
vleresimin e Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë  
elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |   |         |             |             |
|---|---------|-------------|-------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar     |
| • | Servete | GRUDA       | Zv. Kryetar |
| • | Koço    | BROKA       | Anëtar      |
| • | Iva     | ZAJMI       | Anëtar      |
| • | Eduard  | YPI         | Anëtar      |

Në mbledhjen e tij të datës 9.11.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i vlerësimit të “Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES).

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26, neni 69 dhe neni 70.  
Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të vlerësimit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës të “Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga AAES.

**VËREN SE:**

1. Me anë të shkresës së ERE-s nr. 620 prot., datë 20.10.2015, drejtuar OST, OSHEE, Autoritetit të Konkurrencës dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, jemi informuar se me anë të Vendimit nr. 117, datë 14.10.2015, të bordit të ERE-s, kanë filluar procedurat për shqyrtimin e “Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga AAES. Gjithashtu ERE na fton të shprehim opinionet dhe komentet tona rreth draft marrëveshjes brenda datës 06.11.2015.

2. Për sa më sipër, projekt marrëveshja është e njëjtë me draftin që hartoi dhe dërgoi për mendim shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES).
3. Në mënyrë të përmbledhur në projekt marrëveshje janë përcaktuar:
  - Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike lidhet ndërmjet OSHEE SHA dhe Furnizuesit të energjisë elektrike.
  - Marrëveshja synon sigurimin e shërbimit të shpërndarjes për furnizuesin, duke shpërndarë nga pikat e marrjes deri në pikat e dhënies sasinë e energjisë elektrike që Furnizuesi kërkon të shpërndajë sipas kërkesave të konsumatorëve. Marrëveshja synon gjithashtu edhe rregullimin e marrëdhënieve financiare dhe pagesat midis palëve.
  - Në nenet 3 dhe 4 të marrëveshjes përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e OSHEE SHA dhe Furnizuesit.
  - Në nenin 6 përcaktohen procedurat që ndiqen lidhur me informimin nga ana e OST-operatori tregut të furnizuesit mbi sasinë mujore të konsumuar nga klienti fundor; të drejtën për ankim të Furnizuesit lidhur me saktësinë e të dhënave të përcjella nga OST-operatori tregut; procedurat e dorëzimit nga OSHEE të faturës së shërbimit të kryer dhe shlyerjen e faturës nga Furnizuesi.
  - Në nenin 7 përcaktohen rastet kur OSHEE detyrohet të kompensojë Furnizuesit, konkretisht: në të gjitha rastet e ndërprerjeve; në rastet e pretendimeve të Klientit Fundor për dëme të shkaktuara; në të gjitha rastet e ndërprerjeve të paplanifikuara.
  - Në nenin 10, përveçse në rastet e ndërprerjeve të planifikuara, OSHEE ka të drejtë të bëjë ndërprerje të paplanifikuara në shpërndarjen e energjisë elektrike me qëllim garantimin e sigurisë në punë të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
  - Në draft marrëveshje merren në konsideratë interesat e Klientit Fundor, të cilat duhet të jenë parësore në çdo rast, përveç kompensimit për dëme të shkaktuara Klientit Fundor, në çdo rast duhet të procedohet në interes të Klientit Fundor për një zgjidhje emergjente të situatës.
4. Për gjithë çfarë është trajtuar në projekt/marrëveshje, baza ligjore që i referohet është Ligji i ri nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, njëkohësisht u referohet akteve nënligjore, të cilat janë në zbatim të ligjit të vjetër, i cili nuk është më në fuqi. Në këto rrethana jemi në kushtet kur, në zbatim të Ligjit të ri 43/2015, ende nuk është përfunduar rishikimi i akteve nënligjore si miratimi i modelit të tregut, rregullat e tregut, kodi i shpërndarjes, të cilave AAES u referohet dhe nuk janë në zbatim të ligjit të ri.
5. Pra vlerësojmë që Projekt/Marrëveshja, e cila është ende në fazën e shqyrtimit midis palëve të përfshira, si një projekt i hartuar nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), nuk i referohet bazës nënligjore në zbatim Ligjit të ri nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe duhet rishikuar përsëri me daljen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 69 dhe nenin 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

**V E N D O S I:**

1. “Projekt-Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, Entit Regullator të Energjisë (ERE), ankimuesit dhe subjekteve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**MENDIMI I PAKICËS**

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr 381, datë 9.11.2014 “Për vleresimin e Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” kam mbajtur qëndrimin kundër, me arsyetimin e mëposhtëm :

1. Në pjesën përshkruese të Vendimit, pika 4 dhe 5 trajtohet qartë se Projekt/Marreveshja nuk i referohet bazës nënligjore në zbatim Ligjit të ri nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në kushtet kur “Projekt-Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga AAES, nuk bazohet në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe aktet e tij nënligjore, sidomos Modeli i Tregut, krijon konfuzion në funksionimin e tregut dhe konkurrencës në këtë treg. Sugjeroj që Projekt-Marrëveshja të nënshkruhet pas miratimit të modelit të ri të tregut në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” Mungesa e nje akti ligjor për Modelin e Tregut krijon premisa potenciale për abuzime të mundshme dhe shkeljen e konkurrencës në këtë treg.

Për sa më sipër jap votën time kundër.

Komisioner  
Koço Broka



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 382, datë 17. 11 . 2015**

**“Për**  
**miratimin e “Programit i Lehtësimit nga Gjobat” dhe “Formulari i**  
**Aplikimit për Lehtësimin nga Gjobat””**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |                       |         |
|-----------------------|---------|
| • Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Servete GRUDA       | Anëtar  |
| • Koço BROKA          | Anëtar  |
| • Iva ZAJMI           | Anëtar  |
| • Eduard YPI          | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 17.11.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e “Programi i Lehtësimit nga Gjobat” si dhe “Formulari i Aplikimit për Lehtësimin nga Gjobat”, në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), si dhe të Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”

**Baza ligjore:** Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja d), dh), neni 77, neni 84, si dhe Rregullorja “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: Projekt – Programit të Lehtësimit nga Gjobat; Projekt-Formularit të Aplikimit për Lehtësim nga Gjobat, si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm;

**VENDOSI:**

4. Të miratojë “Programin e Lehtësimit nga Gjobat”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi;
5. Të miratojë “Formularin e Aplikimit të Lehtësimit nga Gjobat”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Komisioni i Konkurrencës**

**Servete Gruda**  
(                    )  
**Zv/Kryetar**

**Koço Broka**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard Ypi**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO(LATI)**

---

**K R Y E T A R**

**Programi i Lehtësimit nga Gjobat**

1. Hyrje

Autoriteti i Konkurrencës është institucioni i cili mbron konkurrencën e lirë dhe efektive në treg në zbatim të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës". Aktiviteti i këtij ligji mbështetet në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: (i) abuzimi me pozitën dominuese; (ii) marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe (iii) bashkimet ose përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullojnë aktivitetin e një institucioni të pavarur në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, me synimin final që tregu të gjenerojë zhvillimin.

Marrëveshjet e ndaluara të njohura ndryshe si karteleva, janë forma më e rënde e shkeljeve të ligjit dhe parimeve të konkurrencës. Ato dëmtojnë konkurrencën dhe sidomos konsumatorin duke rritur çmimet në treg.

Ndërmarrjet e përfshira në këto lloje aktiviteteve ilegale dhe që duan të shpëtohen dhe informojnë Autoritetet e Konkurrencës, nuk duhet të ngurojnë për shkak të gjobave të larta ndaj të cilave janë të ekspozuar. Për këto ndërmarrje parashikohet imunitet i plotë ose i pjesshëm nga gjobat, i parashikuar në Programin e Lehtësimit nga Gjobat.

Qëllimi i Programit të Lehtësimit nga Gjobat, është dhënia e imunitetit ndërmarrjeve bashkëpunuese me Autoritetin e Konkurrencës, duke ndihmuar Autoritetin në

zbulimin dhe shkatërrimin e marrëveshjeve të ndaluara/karteleve, si dhe te ndëshkojnë pjesëmarrësit ne këto kartelev.

Autoriteti e konsideron bashkëpunimin vullnetar, si faktor për zhvillim ekonomik te ndërmarrjeve dhe nga ana tjetër siguron imunitet (të plotë ose të pjesshëm) nga vendosja e sanksioneve të larta për ndërmarrjet.

## 2. Çfarë kuptohet me marrëveshje?

"Marrëveshje" janë marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikatat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale, të tregut.

## 2. Llojet e marrëveshjeve

Marrëveshje horizontale: nënkuptojnë ato marrëveshje që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve konkurrencte (ndërmjet prodhuesve ose tregtarëve me shumicë) që veprojnë në të njëjtin nivel të tregut.

Marrëveshje vertikale: nënkuptojnë ato marrëveshje që lidhen ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në nivele të ndryshme tregu.

## 3. Cilat Marrëveshje ndalohen?

Bazuar në nenin 4 të Ligjit, ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet qe:

- caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi
- kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;
- ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;
- zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
- kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.

## 4. Marrëveshjet e ndaluara/Kartelet- sjellja më e rëndë Anti-konkuruese.

Hetimi dhe ndëshkimi i sjelljeve anti-konkuruese reale ose potenciale, janë prioritete të Autoritetit të Konkurrencës. Shembuj të sjelljeve anti-konkuruese janë fiksimi i çmimit, ose shkëmbimi i informacioneve të rëndësishme tregtare ndërmjet konkurrenteve, diskriminim i çmimit, refuzimi për të negociuar, bid rigging (marrëveshjet në oferta) etj.

Midis shkeljeve të tjera të konkurrencës, Marrëveshjet e ndaluara, të ashtuquajtura Kartel janë shkeljet më të rënda të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Karteli është një marrëveshje ndërmjet konkurrenteve, në radhë të parë e drejtuar në fiksimit e çmimit, ndarjen e klientëve dhe tregut si dhe kufizimit të prodhimit. Kartelet dëmtojnë rëndë konsumatorët duke rritur çmimet dhe duke kufizuar furnizimet, ato i bëjnë produktet dhe shërbimet te pamundura për disa konsumator dhe të shtrenjta për të tjerë.

OECD, ka dalë në përfundimin se çmimet në një industri të kartelizuar janë 10-20% më të larta se sa në rastin kur nuk ka kartel. Në vitet e fundit, një numër i madh Autoritetesh kanë rritur përpjekjet për të zbuluar dhe vendosur gjopa te rënda administrative për shkeljet e ligjit lidhur me marrëveshjet kartel.

## **I. Programi i Lehtësimit nga Gjopa**

### **1. Hyrje**

Marrëveshjet e fshehta (Kartel) janë të vështira për t'u zbuluar dhe për t'u hetuar pa bashkëpunimin e njërit prej pjesëmarrësve në kartel, për vetë natyrën e fshehtë të tyre. Për këtë arsye, një numër i konsiderueshëm Autoritetesh kanë aplikuar programet e lehtësimit nga gjopat për të zbuluar këto sjellje anti-konkurrese. Ky program është zbatuar gjerësisht nga Autoriteti i Konkurrencës Gjerman, Australian, Kanadez, Portugez, Spanjoll si dhe nga pjesa më e madhe e vendeve të Bashkimit Evropian.

Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (Autoriteti) bazuar në Ligjin Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji), vëren se është në interes të konsumatorit shqiptar që të lehtësojë nga gjopa një pjesëmarrës në një marrëveshje të ndaluar kartel, i cili dëshiron t'i jap fund sjelljes anti-konkurrese dhe të bashkëpunojë plotësisht me Autoritetin e Konkurrencës për zbulimin e të gjithë pjesëmarrësve në marrëveshjen e ndaluar kartel duke kontribuar në ndalimin e kësaj sjelljeje antikonkurrese.

Qëllimi i Autoritetit të Konkurrencës për zbulimin dhe ndëshkimin e kartelit, e kalon interesin për ndëshkimin e një ndërmarrjeje ose individi, i cili bëri të mundur identifikimin dhe dënimin e të gjithë kartelit, për vetë faktin se marrëveshjet e ndaluara/kartel janë shkelje serioze të ligjit të konkurrencës. Ato dëmtojnë konsumatorët nëpërmjet politikave të tyre. Në terma afatgjata, ato çojnë në humbje të konkurrueshmërisë dhe zvogëlojnë numrin e mundësive për punësim. Ndërmarrjet e përfshira në këto lloje aktivitetesh, të cilat kanë vullnetin për të mos qenë më pjesë e këtyre marrëveshjeve dhe që informojnë Autoritetin për ekzistencën e aktiviteteve të tilla përftojnë pikërisht nëpërmjet këtij programi të lehtësimit nga gjopa, i cili bazohet në dispozitat ligjore.

Autoriteti, parë në këndvështrimin e ligjit, konsideron se është në interesin publik që të garantojë trajtim të favorshëm për ndërmarrjet të cilat bashkëpunojnë me të. Qëllimi i programit të lehtësimit nuk është vetëm të asistojë Autoritetin në përpjekjen e tij për të luftuar dhe ndaluar marrëveshjet e ndaluara dhe ti dënojnë pjesëmarrësit në to, por gjithashtu është edhe shpërblimi që përftojnë ndërmarrjet si pasojë e bashkëpunimit me Autoritetin.

Programi i Lehtësimit nga Gjoha bazohet në nenin 77 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” si dhe në Kreun III të Rregullores “Për Gjohat dhe Lehtësimin prej Tyre”.

“Lehtësimi” nënkupton imunitetin por edhe reduktimin nga çdo gjohë që do të vendosej për një pjesëmarrës në një marrëveshje të ndaluar, në shkëmbim të zbulimit vullnetar të informacionit për sa i përket kartelit, para ose përgjatë fazës hetimore të një rasti.

Programi vendos një strukturë për vlerësimin e bashkëpunimit të ndërmarrjeve të cilat janë palë në marrëveshje dhe praktika që janë objekti i ligjit.

Programi i lehtësimit nga gjohat është një instrument i rëndësishëm në luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara, duke qenë se ato inkurajojnë ndërmarrjet që të ofrojnë informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me shkeljet e mundshme të konkurrencës. Programi i Lehtësimit nga gjohat, lejon Autoritetin e Konkurrencës që të ofrojë imunitet të plotë ose reduktim nga gjohat, që në të kundërt do të ishin vendosur për një pjesëmarrës në marrëveshje të ndaluar, gjithmonë në shkëmbim të zbulimit të informacionit mbi këtë marrëveshje të ndaluar dhe bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës. Duke pasur parasysh natyrën “sekrete” të marrëveshjeve të ndaluara, kjo politikë e lehtësimit nga gjohat synon në zbulimin e karteleve dhe në forcimin e rregullave të konkurrencës.

## **2. Çfarë përmban programi i lehtësimit nga gjoha për anëtarët e Kartelit?**

Kur një shkelje e ligjit përfshin aktivitetet e Kartelit, gjohat mund të arrijnë deri në 10 % të xhiros vjetore të një ndërmarrje.

Me anë të programit të lehtësimit anëtarët e Kartelit mund t’i pakësojnë pjesërisht gjohat e tyre financiare ose ti shmangin ato tërësisht. Prandaj programi i lehtësimit i jep atyre një stimul real për të dhënë informacion.

Programi i lehtësimit nga gjohat, ka të bëjë me marrëveshjet dhe praktikatat e bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë konkurrentëve, që synojnë të kufizojnë konkurrencën nëpërmjet p.sh fiksimit të blerjeve ose çmimeve të shitjeve, shpërndarjes së produkteve ose kuotave të shitjes apo ndarjes së tregjeve përfshirë edhe bid ridding.

Programi zbatohet ndaj ndërmarrjeve që veprojnë në treg dhe që janë ose kanë qenë pjesë e marrëveshjeve të ndaluara. Me qëllim që të sigurohet se programi i lehtësimit punon me efektivitet, është megjithatë e rëndësishme të mbrohen sa më tepër të jetë e mundur nëpunësit dhe drejtorët e ndërmarrjes duke aplikuar imunitet dhe mbrojtje nga sanksionet individuale.

Programi, gjithashtu ofron mbrojtje të informacionit të dhënë për përftimin e lehtësimit. Me qëllim sigurimin e mekanizmave për bashkëpunim duke inkurajuar aplikuesit për raportim vullnetar në lidhje me marrëveshjet e ndaluara dhe aktivitetet në lidhje me to, është e nevojshme mbrojtja në lidhje me informacionin e dhënë. Informacioni në lidhje me një lehtësim nuk mund të përdoret nga ndonjë autoritet tjetër. Ky informacion mund të shkëmbehet midis institucioneve/Autoriteteve homologe vetëm kur vetë aplikuesi bie dakord për shkëmbimin, ose kur institucioni

marrës ofron një angazhim me shkrim që të mos përdorë informacionin e marrë ose çdo informacion tjetër që mund të marrë pas kësaj date, për të vendosur gjohë/sanksione mbi aplikuesin, pjesët e tij ose nëpunësit.

### **3. Çfarë forme ka lehtësimi nga gjoba?**

Lehtësimi nga gjobat mund të jetë i plotë ose i pjesshëm.

### **4. Çfarë lloj veprimtarie përfshihet?**

Për qëllimet e programit të lehtësimit nga gjobat, termi Kartel ose Veprimtari Karteli përdoret për marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendime të shoqatave të ndërmarrjeve ose praktika bashkërenduese që shkelin Ligjin dhe përfshin:

- (i) Fiksimit e çmimit;
  - (ii) Kufizimi i prodhimit ose vendosja e kuotave;
  - (iii) Ndarjen e tregut
  - (iiii) Bid Rigging (marrëveshjet në oferta)
5. Kushtet për dhënien e lehtësimit nga gjoba

Një ndërmarrje kualifikohet për të përfutur lehtësim nga gjoba, nëse:

1). Përfundon përfshirjen e saj në shkeljen e pretenduar, pas aplikimit të saj, deri në masën që përfshirja e saj në vijim duhet të jetë e arsyeshme, përsa i takon inspektimeve të kryera nga Autoriteti;

2). Bashkëpunon mbi baza të plota dhe të vazhdueshme me Autoritetin e Konkurrencës, nga koha e aplikimit deri në përfundimin e rastit dhe kjo përfshin në veçanti:

Sigurimi pranë Autoritetit i të gjithë informacionit të nevojshëm dhe të dhënave që zotërohen nga aplikuesi ose nën kontrollin e tij;

Qëndrimi në dispozicion të Autoritetit për t’u përgjigjur ndaj çdo lloj kërkesë që, në këndvështrimin e Autoritetit, mund të ndihmojë në krijimin e fakteve domethënëse;

Duke vënë në dispozicion dhe deri në një masë të arsyeshme, punonjësit e mëparshëm dhe drejtorët të gatshëm për t’u intervistuar nga Autoritetit;

Duke mos shkatërruar, falsifikuar apo fshehur informacion të rëndësishëm ose të dhëna; dhe

Duke mos zbuluar fakte ose ndonjë element të aplikimit për lehtësim nga gjoba të paktën para se Autoriteti të ketë njoftuar raportin e hetimit/objeksionet e tij tek palët.

3). Përpara aplikimit për lehtësim nga gjoba nuk duhet të:

Ketë shkatërruar të dhëna, të cilat janë objekt i aplikimit, ose

Ketë zbuluar, direkt ose indirekt, fakte ose ndonjë të dhënë tjetër lidhur me aplikimin që mendon të kryejë tek ndonjë autoritet tjetër konkurrence.

## **II. Lehtësimi i plotë nga gjoba**

### **1. Kushti**

Referuar Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” si dhe Rregullores “Për Gjobat dhe Lehtësimin prej Tyre” për të përfituar lehtësim të plotë nga programi i lehtësimit nga gjobat duhet të plotësohen kriteret e mëposhtme:

Komisioni i Konkurrencës (Komisioni) mund të japë lehtësim të plotë nga çdo gjobë, nëse kjo ndërmarrje është e para që ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së të ndaluar, si dhe/ose në përcaktimin e personave përgjegjës duke siguruar prova dhe të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti, që i mundësojnë këtij të fundit të :

a) të fillojë një hetim në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;

b) të zbulojë një shkelje në bazë të nenit 4 të Ligjit.

**2. Për përfitim nga lehtësimi i plotë i gjobës ndërmarrja duhet:**

a) T’i sigurojë Autoritetit, një kopje ose përshkrim të marrëveshjes së ndaluar, ku përfshihen: qëllimi, veprimtaria, funksionimi, produktet përkatëse, tregu përkatës, zgjatja dhe vlerësimi i volumit të tregut të ndikuar nga marrëveshja e ndaluar, data e lidhjes së marrëveshjes, vendndodhja, përmbajtja dhe pjesëmarrësit në marrëveshje si dhe përshkrime të tjera të cilat ndihmojnë Autoritetin në zbulimin e shkeljes.

b) Të japë emrin dhe adresën e ndërmarrjes që aplikon për lehtësim nga gjoba si dhe emrat dhe adresat e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje.

c) Të japë emrat, pozicionet, vendndodhjet e zyrave dhe kur është e nevojshme, adresat e të gjithë individëve të cilët, për sa ka dijeni ndërmarrja kërkuese, janë ose kanë qenë të përfshirë në marrëveshjen e ndaluar, duke përfshirë të gjithë ata individë të cilët kanë qenë të përfshirë për llogari të kërkuesit.

d) Të informojë Autoritetin, nëse ndërmarrja është tërhequr nga pjesëmarrja në marrëveshjen e ndaluar;

e) Të qëndrojë në dispozicion të Autoritetit, për t’iu përgjigjur kërkesave që mund të kontribuojnë për rastin;

f) Të mos shkatërrojë, falsifikojë ose korrigjojë informacionin përkatës ose të dhënat që lidhen me marrëveshjen e ndaluar;

g) Të japë të dhëna të tjera që lidhen me marrëveshjen e ndaluar.

**3. E Rëndësishme**

Lehtësimi nga gjobat, nuk do të jepet nëse, në kohën e aplikimit, Autoriteti ka pasur të dhëna të mjaftueshme:

a) për të ndërmarrë një hetim, në lidhje me një marrëveshje të ndaluar;

b) ka ndërmarrë një hetim të tillë;



c) Për të marrë një vendim nga Komisioni.

#### **4. Kur përfiton nga lehtësimi**

Lehtësimi nga gjoba, do të jepet në rastin kur Autoriteti në kohën e aplikimit nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të zbuluar një shkelje sipas nenit 4 të Ligjit.

Ndërmarrja, e cila ka ndërmarrë nismën të detyrojë ndërmarrjet e tjera të bashkohen në marrëveshje, ose të qëndrojnë në të, nuk përfiton nga ky lehtësim.

#### **5. Si mund të aplikoj për lehtësim nga gjoba? Procedura për lehtësim të plotë nga gjoba**

Ndërmarrja që kërkon lehtësim të plotë nga gjobat, paraqet pranë Autoritetit një kërkesë për t’u konsideruar e imunizuar plotësisht ose pjesërisht nga gjoba.

Autoriteti nuk pranon kërkesën për lehtësim nga gjobat kur ajo është depozituar pas përfundimit të raportit të hetimit.

Kërkuesi informon Autoritetin për aplikimet për lehtësimet e mëparshme ose që ai ka përfituar.

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar, Komisioni verifikon nëse ky dokumentacion është i mjaftueshëm për të dhënë lehtësimin, dhe vendos për dhënien e lehtësimit të kushtëzuar me shkrim.

Komisioni përcakton afatin kohor, brenda të cilit kërkuesi, duhet të sjellë informacionin dhe të dhënat e kërkuara, me qëllim plotësimin e kriterëve për lehtësim nga gjobat. Në rast të mosrespektimit të kriterëve të mësipërme, kërkuesi nuk përfiton lehtësim nga gjobat.

Nëse ndërmarrja nuk ka plotësuar kriteret dhe afatet e vendosura, Autoriteti informon me shkrim atë. Në një rast të tillë, ndërmarrja mund të tërheqë aplikimin ndaj lehtësimit, ose t’i kërkojë Autoritetit të marrë në konsideratë kërkesën e saj për lehtësim të pjesshëm nga gjobat.

Nëse të dhënat e depozituara nuk konsiderohen të mjaftueshme nga ana e Komisionit, ai njofton me shkrim ndërmarrjen, që aplikimi i saj për lehtësim është refuzuar. Në çdo rast, ndërmarrja mund të kërkojë nga Komisioni, që kërkesa e saj për aplikimin të konsiderohet si aplikim për reduktim nga gjoba (lehtësim i pjesshëm).

Komisioni merr vendimin përfundimtar për të garantuar lehtësim nga gjoba në përfundim të procedurave të tij. Nëse komisioni ka dhënë një lehtësim të kushtëzuar, dhe zbulon se aplikuesi ka vepruar si detyrues për lidhjen e marrëveshjes, ose që aplikuesi nuk ka përmbushur të gjitha kushtet që lidhen me lehtësimin, komisioni informon aplikuesin menjëherë.

Komisioni nuk merr në konsideratë kërkesa të tjera për lehtësim nga gjobat, para se të jetë shprehur për një aplikim ekzistues në lidhje me të njëjtën shkelje.

### **III. Lehtësimi i pjesshëm nga gjoba**

Ndërmarrja, që njofton pjesëmarrjen në një marrëveshje të ndaluar dhe që nuk plotëson kushtet për lehtësim të plotë nga gjoba, mund të aplikojë për të përfituar lehtësim të pjesshëm nga gjoba.

#### **1. Për të përfituar lehtësim të pjesshëm nga gjoba ndërmarrja duhet :**

T’i sigurojë Autoritetit vlera të shtuara në lidhje me marrëveshjen e ndaluar. Në vlerësimin që kryen Autoriteti, merren në konsideratë provat që kanë lidhje me shkeljen dhe kohën kur është kryer ajo. Këto prova kanë më shumë vlerë, sesa provat e krijuara më pas. Në mënyrë të ngjashme, provat e lidhura drejt për drejt me faktet në fjalë, do të konsiderohen me një vlerë më të madhe se sa ato indirekte.

Koncepti i vlerës së shtuar ka të bëjë me faktin nëse provat e dhëna, në varësi të natyrës dhe të detajeve që ato paraqesin, i shtojnë mundësitë Autoritetit që të provojë shkeljen e pretenduar, duke siguruar argumenta shtesë për të provuar këtë shkelje.

#### **2. Sa është masa e lehtësimit të pjesshëm?**

Me qëllim që të përcaktohet niveli i duhur i reduktimit të gjobës, Komisioni merr në konsideratë kohën në të cilën janë depozituar të dhënat (përfshirë edhe faktin nëse aplikuesi është ndërmarrja e parë apo e dyta apo e treta...e kështu me radhë...e cila aplikon). Komisioni në vendimin përfundimtar, vendos për nivelin e lehtësimit të pjesshëm nga gjobat për:

- a) Ndërmarrjen e parë, në masën 30-50%;
- b) Ndërmarrjen e dytë, në masën 20-30%;
- c) Ndërmarrjet vijuese, në masën deri në 20%.

Me qëllim që të përcaktohet niveli i lehtësimit të pjesshëm nga gjoba, Autoriteti merr parasysh kohën në të cilën janë paraqitur provat dhe shkallën në të cilën paraqitet vlera e shtuar. Komisioni mund të marrë parasysh nivelin dhe vijueshmërinë e çdo bashkëpunimi të ofruar nga ndërmarrja.

#### **3. Si mund të aplikoj për lehtësimin e pjesshëm nga gjoba? Procedurat për lehtësimin të pjesshëm nga gjoba.**

Ndërmarrja që kërkon lehtësim të pjesshëm nga gjoba paraqet një kërkesë me shkrim pranë Autoritetit duke sjellë të dhëna të mjaftueshme për marrëveshjen në fjalë. Në kërkesë, duhet të identifikohet qartë koha e paraqitjes së saj.

Me marrjen e kërkesës të ndërmarrjes, Autoriteti i lëshon kësaj te fundit një vërtetim me shkrim duke konfirmuar datën e marrjes së provave në dorëzim.

Nëse Komisioni arrin në përfundimin se provat e paraqitura nga ndërmarrja përbëjnë vlerë të shtuar, atëherë informon ndërmarrjen me shkrim, jo më vonë se sa data në të cilën raporti i hetimit i është dërguar ndërmarrjes, duke e njoftuar atë për përfitimin e

lehtësimi të pjesshëm nga gjoba. Shuma totale e zbritjes nga gjoba duhet të përcaktohet deri në përfundim të hetimit.

Komisioni informon me shkrim ndërmarrjet në rast se arrin në përfundimin se ndërmarrja nuk përfiton nga ky lehtësim.

#### **IV. Pyetje të Përgjithshme**

##### **1. Çfarë janë marrëveshjet Kartel?**

Bazuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasoje pengimin, kufizimin e shtrembërimit e konkurrencës në treg janë të ndaluara.

Marrëveshjet kartel zakonisht përfshijnë: (i) fiksimin e çmimit, ku palët bien dakord në mënyrë direkte ose indirekte në lidhje me çmimet; (ii) vendosin kufizime ku palët bien dakord të kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet; (iii) marrëveshjet në prokurimet publike ku palët bien dakord të koordinojnë ofertat e tyre në këto prokurime; (iv) ndarja e tregut ose të burimeve të furnizimit.

Marrëveshjet Kartel zakonisht kërkojnë fshehtësi dhe dinakëri. Bashkëpunimi në fshehtësi, shpesh i lejon marrëveshjeve kartel të ekzistojnë pa u diktuar nga palët e treta. Në këto rrethana zbulimi i karteleve është më i vështirë se format e tjera të sjelljeve anti-konkurrese. Programi i lehtësimi nga gjobat i lejon Autoritetet të depërtojë perden e fshehtësisë së Karteleve.

##### **2. Si duhet të sillen një ndërmarrje ose një individ nëse është i detyruar nga konkurrentet që të marrë pjesë në një marrëveshje kartel?**

Ndërmarrja ose individi që detyrohet për të marrë pjesë në kartel, duhet ta denoncojë atë pranë Autoritetit të Konkurrencës. Nëse ndërmarrja ose individi ka marrë pjesë në kartel, ai përsëri ka mundësi të aplikojë në Programin e Lehtësimi nga Gjoba dhe në këmbim të lehtësimi të plotë ose të pjesshëm nga gjoba ai duhet bashkëpunojë me Autoritetin për të plotësuar kërkesat e tjera të programit.

##### **3. Kush është “kartel ring-leader”<sup>128</sup> “Nxites i Kartelit”**

Programi i lehtësimi nuk e kualifikon një aplikant, vetëm nëse ai ka një pozicion të qartë si “ring-leader”-“Nxites i Kartelit”- në aktivitetin e kartelit. Në përcaktimin e tij, Komisioni i Konkurrencës do të përqendrohet në rolin që ka pasur secili nga pjesëmarrësit në kartel. Në shumë kartelevë nuk është e qartë dhe nuk mund të gjendet kush është “ring leader”- “Nxites i Kartelit”. Gjithashtu, nuk është e qartë se kush është leader nëse dy ose më shumë pjesëmarrës mund të quhen të njëjtë në marrëveshje. P.sh, nëse në një marrëveshje midis dy ndërmarrjeve secila ndërmarrje luan një rol të njëjtë në kartel, të dyja ndërmarrjet janë të mundshme për të përfituar nga programi i lehtësimi. Përfundimisht, fakti nëse një ndërmarrje është një lider në treg nuk është doemos kusht që ajo të jetë “ring-leader”- “Nxites i Kartelit” në një kartel.

<sup>128</sup> Një ndërmarrje e cila nxit/shtyn një ose disa ndërmarrje për të marrë pjesë në një marrëveshje të ndaluar/kartel ose ka një rol përcaktues në krijimin e kësaj marrëveshjeje. Një person i cili udhëheq të tjerët, veçanërisht në kundërshtim me autoritetet ligjore, etj ( <http://dictionary.reference.com/browse/ringleader>)

#### **4. Çfarë nënkupton “bashkëpunimi i plotë”**

Programi i lehtësimit nënkupton një paraqitje të plotë dhe të sinqertë të fakteve nga ana e aplikantit. Në mënyrë që të përfitojë avantazhe nga Programi i Lehtësimit, aplikantët duhet ti sigurojnë Komisionit të Konkurrencës, të gjitha të dhënat dhe informacionin që posedojnë lidhur me marrëveshjen që shkel konkurrencën. Ata duhet të bashkëpunojnë plotësisht dhe vazhdimisht me Komisionin e Konkurrencës gjatë investigimit dhe në çdo procedim të nevojshëm. Pasi një aplikim për lehtësim është ndërmarrë, Autoriteti i Konkurrencës, do të këshillojë aplikantin për hapat që ai duhet të ndërmarrë, për t’u përshtatur me procedurat dhe me afatet kohore në të cilën hapat duhet të ndiqen. Autoriteti i Konkurrencës gjithmonë do të përpiqet të garantojë që çështja të përparojë në mënyrën dhe kohën më të mirë që është e mundur. Nëse një aplikant i Programit të Lehtësimit, qëllimisht ç’orienton Komisionin e Konkurrencës, paraqet evidenca false, refuzon të japë evidenca të rëndësishme apo i shkatërron apo bashkëpunon në një mënyrë jo të plotë dhe efçente, Komisioni i Konkurrencës do të informojë Aplikantin se nuk po tregon vullnetin e nevojshëm për të përfituar nga programi i lehtësimit dhe imuniteti për të nuk garantohehet.

#### **5. Cili informacion mund të shkëmbehet me shoqatat tregtare?**

Shoqatat e tregtisë dhe të biznesit mund të bëhen pika takimi për pjesëtarët e kartelit. Për këtë arsye është e rëndësishme që të sigurohen, që shoqata e kryen aktivitetin e saj brenda kufijve të ligjit. Informacioni në lidhje me shqetësime të përbashkëta, ose për sigurinë e produkteve ose shërbimeve janë shembuj të informacioneve që mund të shkëmbehen, pa prekur çështje të konkurrencës. Informacion në lidhje me çmimet, kushtet e shitjes dhe klientët, janë informacione tregtare të ndjeshme të cilat nuk është mirë të shkëmbehen pasi mund të dëmtojnë konkurrencën.

Nëse shoqata, një herë në vit konsolidon (update) sektorin e të dhënave, është e rëndësishme që informacioni të mblidhet nga një agjent i cili nuk punon për asnjë nga ndërmarrjet anëtare të shoqatës, në mënyrë që të ruhet konfidentaliteti i të dhënave.

#### **6. A do të zbulohet identiteti im tek anëtarët e tjerë të Kartelit?**

Çdo ndërmarrje e cila dëshiron të përfitojë nga programi i lehtësimit nga gjobat, mund të jetë e shqetësuar që anëtarët e tjerë të kartelit mund të dyshojnë se ajo ka dhënë në mënyrë vullnetare informacion për Autoritetin e Konkurrencës. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës, kur është e mundur do të bëjë përpjekje që të mbajë konfidental identitetin e kësaj ndërmarrje deri në përfundimin e procedurave hetimore.

#### **V. Si të denoncojmë një kartel?**

Informacioni mbi ekzistencën e një karteli mund të dërgohet në:

Autoriteti i Konkurrencës  
Rruga “Sami Frashri” Nr. 4  
Kati 4  
Tiranë, Shqipëri

Aplikimi mund të dërgohet edhe në mënyrë elektronike në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al) ose duke telefonuar në +355 4 22 34 504. (Plotësoni: Formulari i Aplikimit për Lehtësimin nga Gjobat ne faqen zyrtare [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al))



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 383, datë 17.11.2015**

**“Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |            |
|-----------|-------------|------------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar    |
| ▪ Servete | GRUDA       | Zv/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar     |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar     |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar     |

Në mbledhjet e tij të datës 22.10.2015 dhe 17.11.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënia e disa rekomandimeve lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”

**Baza ligjore:** Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), neni 69 dhe neni 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të Ligjit nr. 104/2015 “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”

### **VËREN SE:**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, si Autoriteti Kontraktues, dhe shoqëria koncesionare "Porti MBM (Multy Buoy Mooring)" janë përfshirë në këtë kontratë me qëllim dhënien me Konçesion të formës BOT ("ndërtim-shfrytëzim dhe transferim") në pronësi të shtetit (Built-Operate-Transfer/ BOT) të një porti të llojit MBM (Multi Buoy Mooring), në Porto-Romano, Durrës, që të pranojë ngarkim-shkarkimin e mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20.000 ton dhe me zhytje mbi 8(tetë) metra, për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj.

Kjo kontratë e miratuar me Ligjin nr. 104/2015, date 23.9.2015, “Për miratimin e kontratës së konçesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, i jep koncesionarit të drejtën ekskluzive për përdorimin e portit dhe zotërimin e lirë të zonës.

Procedura e dhënies të këtij konçesioni filloi si rezultat i propozimit të pakërkuar të subjektit “Adriatik Petroleum Platform PTE.LTD” për marrjen në konçesion dhe partneritet publik privat me qëllim menaxhimin dhe zhvillimin teknologjik për ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës

Bazuar në problematikën e funksionimit të koncesioneve me propozim të pakërkuar dhe të tregut të importit të gazit të lëngshëm natyror si treg i varur nga funksionimi i koncesioneve të ngjashme me objektin e kësaj marrëveshje, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se hartimi dhe marrja e opinionit për aktet rregullative të rrjedhura nga kjo marrëveshje koncesionare janë shumë të rëndësishme për shmangien e problemeve potenciale të konkurrencës si pasojë e të drejtës ekskluzive në tregun përkatës dhe në tregjet e lidhura.

Bazuar në nenin 84 "Tarifat portuale" të Ligjit nr.9251, date 8.7.2004 "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), tarifat portuale për shërbimet, që legjislativi në fuqi i cilëson kryesore, përcaktohen nga organet qendrore shtetërore për detarinë dhe financat. Referuar këtij neni, tarifat për shërbimet e portit të ri do të përcaktohen nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave :

- 1.1 Përpara fillimit të zbatimit të projektit të koçensionit të miratojnë metodologjinë e përcaktimi të tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare “porti MBM (Multy Buoy Morning)’
- 1.2 Brenda një periudhe sa me optimale të përcaktoje metodologjinë e përgjithshme të përcaktimit të tarifave për çdo koçesion me procedure të një propozimi të pakërkuar.
- 1.3 Në çdo rast tjetër për koçesionet me procedure të një propozimi të pakërkuar, fillimisht të miratohet metodologjia specifike përkatëse për përcaktimin e tarifave dhe vetëm me pas, Ligjit për miratimin e kontratës koncesionare.

2. Në rregulloren që do të miratohet për funksionimin e Portit MBM (Multy Buoy Mooring), të përcaktohet qartë:

(a) mënyra e operimit të anijeve sipas parimit "*kush hyn i pari, shërbehet i pari*";

(b) detyrimi i ndërmarrja koncesionare "Porti MBM (Multy Buoy Mooring)" për të respektuar të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij porti, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta si dhe

(c) detyrimi i koncesionarit për t’u ofruar shërbimet e saj të gjithë shoqërive me të njëjtat kushte teknike dhe financiare.

3. Në përcaktimin e metodologjisë së tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare "Porti MBM (Multy Buoy Mooring)", të ketë në konsideratë se tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, të bëhen publike dhe transparente.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetare**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**Nr. 384, datë 3.12.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar      |
| ▪                          |             |

Në mbledhjen e tij të datës 3.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,Udhëzimi “Për formën e njoftimit të



## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Messer Hungarogaz Kft. / Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. dhe relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

### V Ë R E N S E :

#### 1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për transferimin e kuotave” të datës 15 Shtator 2015, e lidhur ndërmjet palëve shoqëria Air Liquide Eastern Europe S.A (në cilësinë e aksionarit shitës) dhe Messer Hungarogaz Kft. (në cilësinë e blerësit), me objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Air Liquide Hungari Ipari Gaztermelo Kft (në cilësinë e target-it) të lira nga çdo barrë.

Përqendrimi nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë tregun e brendshëm të produktit sa i përket gazit industrial, por njoftimi i përqendrimit është bërë për shkak të xhirove që realizon Grupi Messer në Shqipëri me anë të degës së tij Messer Albagaz Sh.p.k.

Transaksioni i përqendrimit me anë të të cilit shoqëria Messer Hungarogaz Kft. përfton kontrollin e vetëm dhe ekskluziv të shoqërisë Air Liquide Hungari Ipari Gaztermelo Kft., përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe për pasojë përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe plotëson kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe tregun e brendshëm.

#### 2. Palët në transaksion

- ✚ **MESSER HUNGAROGAZ Kft: (“Messer HU”)** në cilësinë e blerësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Hungarez, me seli në adresën: H\_1044 Budapest, Vatici ut 117, Hungari. Fusha e veprimtarisë së shoqërisë është kryesisht prodhim dhe shpërndarje e gazit industrial, etj.

Shoqëria është prezent në Shqipëri me anë të shoqërisë **Messer Albagaz Sh.p.k.** që prej vitit 2011.

- ✚ **AIR LIQUIDE HUNGARY IPARI GAZTERMELO Kft. (“Air Liquide”)**, në cilësinë e shoqërisë target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit hungarez, me seli në adresën: H-1013 Budapest, Krizstina krt. 39/b.2, Hungari. Objekti i aktivitetit të ndërmarrjes është: (i) krijimi dhe operimi i një apo më shumë njësisive të prodhimit, prodhimi dhe / ose importimi i gazit industrial ose gazit të ajrit në formë të lëngshme apo të gaztë, etj.

Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.

### 3. Xhiro për vitin 2014

**3.1** Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është **2.305.573.888.229,53 ALL**

- Messer Group: 1.047.000.000 € = 146.580.000.000 ALL.
- Messer Hungarogaz Kft: 15.169.337.000 HUF = 6.907.545.330,53 ALL
- Air Liquide Group: 15.358.000.000 € = 2.150.120.000.000 ALL
- Air Liquide Hungary Ipazi – Gaztermelo Kft: 4.318.198.000 HUF = 1.966.344.899 ALL

**3.2** Xhiro totale në tregun e brendshëm është **272.831.000 ALL:**

- Messer Albagaz shpk : 272.831.000 ALL.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

### 4 Tregu përkatës

**4.1 Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘gazet industriale’.

**4.2 Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

#### 4.2 Efektet në treg pas përqendrimit.

Realizimi i këtij transaksioni prek vetëm tregun hungarez. Struktura e tregut të gazeve industrialë në vendin tonë do të mbetet e njëjtë si para transaksionit. Air Liquid Hu nuk ushtron aktivitet në tregun shqiptar dhe si rrjedhojë nuk kemi mbivendosje të aktiviteti të palëve në tregun përkatës së produktit. Pjesët e tregut dhe fuqia e Messer Albagaz pas realizimit të përqendrimit do të mbetet e njëjtë.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimit në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

### VENDOSI:

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 384, datë 3.12.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar      |

Në mbledhjen e tij të datës 3.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft.nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,Udhëzimi “Për formën e njoftimit të

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Messer Hungarogaz Kft. / Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. dhe relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

### V Ë R E N S E :

#### 1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes për transferimin e kuotave” të datës 15 Shtator 2015, e lidhur ndërmjet palëve shoqëria Air Liquide Eastern Europe S.A (në cilësinë e aksionarit shitës) dhe Messer Hungarogaz Kft. (në cilësinë e blerësit), me objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Air Liquide Hungari Ipari Gaztermelo Kft (në cilësinë e target-it) të lira nga çdo barrë.

Përqendrimi nuk prek në mënyrë të drejtpërdrejtë tregun e brendshëm të produktit sa i përket gazit industrial, por njoftimi i përqendrimit është bërë për shkak të xhirove që realizon Grupi Messer në Shqipëri me anë të degës së tij Messer Albagaz Sh.p.k.

Transaksioni i përqendrimit me anë të të cilit shoqëria Messer Hungarogaz Kft. përfton kontrollin e vetëm dhe ekskluziv të shoqërisë Air Liquide Hungari Ipari Gaztermelo Kft., përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe për pasojë përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe plotëson kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe tregun e brendshëm.

#### 2. Palët në transaksion

- ✚ **MESSER HUNGAROGAZ Kft: (“Messer HU”)** në cilësinë e blerësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Hungarez, me seli në adresën: H\_1044 Budapest, Vatici ut 117, Hungari. Fusha e veprimtarisë së shoqërisë është kryesisht prodhim dhe shpërndarje e gazit industrial, etj.

Shoqëria është prezent në Shqipëri me anë të shoqërisë **Messer Albagaz Sh.p.k.** që prej vitit 2011.

- ✚ **AIR LIQUIDE HUNGARY IPARI GAZTERMELO Kft. (“Air Liquide”)**, në cilësinë e shoqërisë target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit hungarez, me seli në adresën: H-1013 Budapest, Krizstina krt. 39/b.2, Hungari. Objekti i aktivitetit të ndërmarrjes është: (i) krijimi dhe operimi i një apo më shumë njësive të prodhimit, prodhimi dhe / ose importimi i gazit industrial ose gazit të ajrit në formë të lëngshme apo të gaztë, etj.

Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.

### 3. Xhiro për vitin 2014

3.1 Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është **2.305.573.888.229,53 ALL**

- Messer Group: 1.047.000.000 € = 146.580.000.000 ALL.
- Messer Hungarogaz Kft: 15.169.337.000 HUF = 6.907.545.330,53 ALL
- Air Liquide Group: 15.358.000.000 € = 2.150.120.000.000 ALL
- Air Liquide Hungary Ipazi – Gaztermelo Kft: 4.318.198.000 HUF = 1.966.344.899 ALL

3.2 Xhiro totale në tregun e brendshëm është **272.831.000 ALL:**

- Messer Albagaz shpk : 272.831.000 ALL.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

### 4. Tregu përkatës

**4.1 Tregu përkatës i produktit:** Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e përqendrimit të ndodhur është konsideruar ‘gazet industriale’.

**4.2 Tregu përkatës gjeografik:** Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

### 4.3 Efektet në treg pas përqendrimit.

Realizimi i këtij transaksioni prek vetëm tregun hungarez. Struktura e tregut të gazeve industriale në vendin tonë do të mbetet e njëjtë si para transaksionit. Air Liquid Hu nuk ushtron aktivitet në tregun shqiptar dhe si rrjedhojë nuk kemi mbivendosje të aktiviteti të palëve në tregun përkatës së produktit. Pjesët e tregut dhe fuqia e Messer Albagaz pas realizimit të përqendrimit do të mbetet e njëjtë.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

## PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

**VENDOSI:**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Iva ZAJMI</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv. Kryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**Nr. 385, datë 3.12.2015**

**Për**

**“Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi zgjidhjen e problematikës së faturimit për klientët e lidhur në tensionin e mesëm dhe faturohen në tensionin e ulët”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |            |
|----------------------------|------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar    |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv/Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar     |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar     |
| ▪ Z. Eduart Ypi            | Anëtar;    |

Në mbledhjen e tij të datës 3.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Për disa rekomandime mbi zgjidhjen e problematikës së faturimit për klientët e lidhur në tensionin e mesëm dhe faturohen në tensionin e ulët.



## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 24 pika d) dhe f) dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me ankesën e ndërmarrjes “FIX PRO” Shpk dhe seancës dëgjimore me palët e prekura:

### **V Ë R E N S E:**

#### **Procedura e ndjekur:**

Ndërmarrja “FIX PRO” Shpk, me anë të shkresës nr. 408 prot., datë 14.10.2015, drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, ankohet ndaj ndërmarrjes “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE), lidhur me faturimin gabim nga ana e kësaj ndërmarrjeje.

Sipas ndërmarrjes “FIX PRO” Shpk, që prej implementimit të Vendimit të Entit Regullator të Energjisë (ERE) nr. 148, datë 07.12.2014, nga ana e OSHEE-së është kategorizuar si klient që furnizohet nga Tensioni i Ulët (TU)pika e matjes, ndërkohë që faktikisht furnizohet nga Tensioni i Mesëm (TM)pika e lidhjes, pasi kabina elektrike është investim i tij.

Në vazhdim të procedurës për shqyrtimin e ankesës së ndërmarrjes “FIX Pro”, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës u kërkua informacion i mëtejshëm për rastin nga OSHEE dhe ERE, si dhe u zhvilluan takime për sqarime teknike rreth rastit, pranë ERE dhe OSHEE.

Ndërmarrja OSHEE më shkresën nr. 19833 prot., datë 02.11.2015, sqaron se objekti për të cilën pretendohet është një kabinë që furnizon dhe dy klientë të tjerë. Aplikimin e tarifës për Tension i Ulët (TU) OSHEE e bazon në Kodin e Matjes, Kodin e Shpërndarjes, Rregulloren e lidhjeve të reja, si dhe në shkresën e ERE-së nr. 508, datë 14.07.2015, sipas së cilës: *“Në lidhje me grupin e konsumatorëve të cilët janë të lidhur në kabina, nga të cilët furnizohen edhe klientë të tjerë, që kanë konsum të ulët dhe që nuk kanë mundësi të spostojnë sistemin e matjes, sepse nuk plotësojnë kushtet teknike, të vazhdohet të faturohen me çmimin e TU”*.

Me anë të shkresës nr. 637/1 prot., datë 11.11.2015, ERE sqaron se e ka trajtuar këtë problem për një grup konsumatorësh, të cilët kanë paraqitur ankesë pranë saj dhe ka shprehur qëndrimin e saj nëpërmjet rekomandimeve dhe udhëzimeve drejtuar kompanisë OSHEE, në shkresën nr. 508, date 14.07.2015 me lëndë: *“Mbi ankimin e konsumatorëve të lidhur në TM për mosaplikimin e tarifave të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e lidhur në TM sipas Vendimit nr. 148, datë 26.12.2014”*. Gjithashtu ERE informon se me anë të shkresës nr. 634 prot., datë 26.10.2015, drejtuar ndërmarrjes OSHEE, ka kërkuar dhe informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve dhe udhëzimeve të shkresës nr. 508, datë 14.07.2015.

Ndërmarrja ankimuese Fix Pro, në vijim të përgjigjes drejtuar OSHEE, na informon dhe pretendon se kabina private është në pronësi të përbashkët të kompanive Fix Pro sh.p.k dhe VANEST sh.p.k, pasi Kompania Fix Pro sh.p.k ka qenë pjesë e "VANEST" sh.p.k deri në vitin 2008, kohë ne te cilën kompania ndau aktivitetet, u vendosën dy matësa me dy kontrata në kabinë.

Për qartësimin e situatës u ftuan në seancë dëgjimore pranë Autoritetit të Konkurrencës OSHEE, ERE dhe ankimesi, ndërmarrja FIX PRO, të cilët dhanë shpjegime në lidhje me objektin e ankesës.

### **Vlerësimi i rastit bazuar në kuadrin ligjor rregullator**

Marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe vendosjen e rregullave lidhur me hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike, rregullohen dhe janë objekt i Ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ERE është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike.

Referuar nenit 18 të Ligjit të mësipërm, ndër objektivat e ERE-s në kryerjen e funksioneve rregullatorë të përcaktuara në ligj janë dhe:

- angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, efikasiteti së energjisë elektrike, si dhe integrimi në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme;
- sigurimi i përfitimit të klientëve prej funksionimit të tregut të brendshëm, duke promovuar konkurrencën dhe mbrojtjen e klientëve;
- garantimi i standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 43/2015, ERE ndër të tjera, ka të drejtat e mëposhtme:

- a) merr vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike;
- b) monitoron dhe kontrollon funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe detyron të licencuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut;
- c) kërkon informacion prej të licencuarve, në kuadër të realizimit të detyrave të tyre;
- d) vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve;
- e) zgjidh mosmarrëveshjet, në lidhje me ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të këtij ligji;

Referuar nenit 68 të Ligjit nr. 43/2015, shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i cili ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientë, duke ofruar pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore dhe duke respektuar treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka për detyrë të lidhë në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, si dhe të sigurojë akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Operatori i sistemit të shpërndarjes

është përgjegjës për veprimtarinë matëse dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjet, në përputhje me Kodin e Matjes.

Referuar pikave (III.3.1) dhe (III.3.2) të Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike, të miratuar me anë të Vendimit nr. 101 të ERE-s, datë 26.08. 2008, pikat e matjes do të vendosen në kufijtë e pronësisë së klientit, apo përdoruesit, ose mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura midis palëve. Pika e lidhjes mund të jetë e ndryshme nga pika e matjes dhe ky fakt është objekt aprovimi i palëve në marrëveshje. Në këto raste, kërkesat e saktësisë për matjen do të zbatohen në pikën e matjes.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 43/2015, çdo palë e interesuar që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t’i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s, e cila merr vendim brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e ankesës.

Referuar nenit 107 të Ligjit nr. 43/2015, moszbatimi i vendimeve të ERE-s, moszbatimi i detyrimeve lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave dhe moszbatimi i vendimeve të ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nga ana e të licencuarve, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen nga ERE me gjobë nga 0,1 % deri në 3 % e të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit.

Referuar ankesës së ndërmarrjes FIX PRO, shkresës së ERE-s nr. 508, datë 14.07.2015, me lëndë: *“Mbi ankimitimin e konsumatorëve të lidhur në TM për mosaplikimin e tarifave të shijes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e lidhur në TM sipas Vendimit nr. 148, datë 26.12.2014”*, dhe informacionit të depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ana e ERE-s dhe OSHEE-së në formë shkresore dhe gjatë seancave dëgjimore, rezulton se problematika e ngritur nga ankuesi është edhe për shumë klientëve të tjerë, gjë e cila mund të çojë në diskriminim e tyre.

Për sa më sipër trajtuar konkludojmë:

- Ankimesi nuk ka paraqitur kërkesë zyrtare pranë ERE-s, por është bazuar në ankesën e shoqatës.
- ERE pretendon se operatori OSHEE duhet të bëjë faturimet sipas Tensionit të Mesëm, dhe më pas të kompesohen humbjet që do të rrezultojnë nga përlllogaritjet përkatëse.
- ERE pretendon se ka marrë ankesa edhe nga shoqata të tjera për të njëjtin problem dhe do të gjejnë zgjidhje me zbatimin e ligjit të ri “Per sektorin e energjisë” dhe modelit të ri të tregut, i cili parashikon që një “furnizues universal” dhe faturimet do të kryhen në bazë të tensionit real të konsumuar.
- OSHEE pretendon se faturimi është kryer në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke zbatuar kodin e matjes dhe udhëzimet e ERE-s të paraqitura nëpërmjet shkresës së saj Nr. 508 prot, datë 14.07.2015.
- OSHEE pretendon se në rast se biznesi do të faturohet me tarifat e TU duhet të kryejë investimet përkatëse për të transferuar piken e matjes.

**PËR KËTO ARSYE :**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Në zbatim të nenit 24, shkronja (d) dhe (f) dhe nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës

**V E N D O S I :**

I- T’i rekomandojë Enti Rregullator të Energjisë si vijon:

- *Zgjidhjen përfundimtare për klientët e lidhur në Tension të Mesëm duke miratuar nje tarifë të posaçme sipas kategorisë se klientëve, me qëllim vendosjen në kushte jo diskriminuese dhe të njetja konkurrence;*
- *Vlerësimin e tarifës së zbatuar nga OSHEE nëse përbën një tarifë mbi tarifat e miratuara dhe kompesimin përkatës të klientëve në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi.”*

II- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij Vendimi palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete Gruda**  
(\_\_\_\_\_)

**Zv.Kryetar**

**Koço Broka**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 386 , datë 14.12. 2015**

**“Për**

**hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, loti I dhe loti II”

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), veçanërisht neni 24 pika d, neni 43, pika 1 dhe 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, loti I dhe loti II”:

### VËREN SE:

#### **Procedura e ndjekur:**

Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 376, datë 15.10.2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti I dhe Loti II”, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka ndjekur procedurat e hetimit paraprak në tregun përkatës.

Metodologjia që është përdorur gjatë hetimit është Udhëzuesi “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta ne prokurimet publike” përshtatur sipas metodologjisë që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike, si dhe rekomandimet e UNCTAD-it.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 409, datë 15.10.2015 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në treg, konkretisht pranë ndërmarrjeve: “R.S & M” sh.p.k; “I.D.K - Konstruksion” sh.p.k; dhe “Jubica” sh.p.k.

Gjatë inspektimeve janë mbajtur procesverbalet përkatëse “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, si dhe “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.

#### **Vlerësimi ligjor**

Bazuar dhe në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), procedura e hetimit të thelluar fillohet kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës.

Shenjat kryesore të kufizimit të konkurrencës të evidentuara në raportin e hetimit paraprak janë si vijon:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me dy lotet e procedurave të mësipërme rezulton se ndërmarrjet fituese në të dy lotet kanë qenë shumë pranë fondit limit (ofertat fituese 97% të fondit limit) si dhe ka një mungesë të pjesëmarrjes së operatorëve aktivë në tregun përkatës në procedurat e prokurimit në të dyja lotet”.

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

2. Ndonëse bashkimi i operatoreve ne lotin e parë ka fituar 63,42% dhe lotin e dytë 36.5%, sipas operatoreve qe do te realizojnë te dy lotet kjo ndarje eshte 38% R.S&M, 24% Jubica dhe 25% IDK dhe Madekonst 13%.”. Pra, kjo është ndarje e tregut, pasi fituesit e prokurimit publik nuk kanë konkurruar për asnjë moment me njëri-tjetrin.
3. Raporti evidenton ndarje të tregut edhe nga pikpamja gjeografike. Zhvillimi i procedurave të prokurimit për të njëjtin treg përkatës në dy zona të ndryshuara gjeografike ku dy konkurrentë kanë krijuar një joint venture për një zonë gjeografike dhe konkurrenti tjetër ka marrë pjesë dhe është shpallur fitues në një tjetër zonë gjeografike.
4. Sipas raportit “ndermarrja RSM Company Sh.p.k ka diferenca të ndjeshme në çmimin e ofertave”, por është përjashtuar në të dyja procedurat e prokurimit. Konkluzioni është se kjo kompani ose ka paraqitur ofertë mbuluese, ose është përjashtuar për të konkretizuar rezultatin e paracaktuar.

Si konkluzion, nga procedura e hetimit paraprak rezulton se vihen re shenja të kufuzimit të konkurrencës në formën e një marrëveshje të ndaluar në prokurimet publike sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121, datë “28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), si dhe udhëzimit “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta ne prokurimet publike”.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Në zbatim të nenit 24, shkronja (d) dhe (f) dhe nenit 43 pika1,2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

### **V E N D O S I :**

1. Të fillojë procedurën e hetimit të thelluar për tregun e prokurimit publik të shërbimeve të përmirësimit dhe rifreskimit të sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare për të vlerësuar nëse konkurrenca është penguar, kufizuar apo shtrembëruar.
2. Realizimi i procedurës hetimore do të përfshijë përveç procedurave të prokurimit “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, loti I dhe loti II” edhe procedura të tjera të ngjashme në akset rrugore kombëtare të zhvilluara gjatë viteve të fundit.
3. Ndërmarrjet nën hetim janë: (i) “R.S & M” sh.p.k; (ii) “I.D.K -Konstruksion” sh.p.k; (iii) “Jubica” sh.p.k dhe (iv) “RSM Company” sh.p.k. dhe ndermarrjet e tjera qe mund te rezultojne gjate periudhes se hetimit te thelluar.
4. Procedurat hetimore duhet të përfundojnë jo më vonë se 3 muaj nga data e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete Gruda**  
( )

**Zv.Kryetar**

**Koço Broka**  
( )

**Anëtar**

**Iva Zajmi**  
( )

**Anëtar**

**Eduard YPI**  
( )

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**nr.387, datë 14.12.2015**

**“Për disa rekomandimet në tregun e shërbimit të pajisjeve fiskale”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të monitorimit të tregun të shërbimit të pajisjeve fiskale.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24 shkronja d, dhe neni 26.  
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”



Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të monitorimit të tregun të shërbimit të pajisjeve fiskale të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

## **KONSTATOI:**

### **I. PROCEDURA E NDJEKUR:**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës me anë të Urdhrit të Brendshëm nr. 57, datë 03.09.2015 ngriti Grupin e Punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit të kasave fiskale”.
2. Periudha e monitorimit e përcaktuar nga Sekretariati është Janar 2014 – Shtator 2015.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me monitorimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe nga të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari të tregtimit të pajisjeve fiskale.

### **II. Tregu përkatës**

4. Shërbimi i pajisjeve (kasave) fiskale, ofrohet vetëm nga ndërmarrjet e autorizuar për furnizimin e pajisjeve (kasave) fiskale, si dhe të autorizuar për mirëmbajtjen e tyre. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose i huaj, që kërkon të pajiset me autorizimin “Shoqëri e autorizuar” për furnizimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, duhet të aplikojë pranë Ministrisë së Financave, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar. Gjithashtu, tatimpaguesit duhet të përdorin vetëm pajisjet fiskale të cilat janë sipas standardeve dhe kushteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe që tregtohen vetëm nga ndërmarrjet e autorizuar nga Ministria e Financave.
5. Pra, referuar sa më sipër, tregu i shërbimit të pajisjeve (kasave) fiskale, përbëhet nga 2 (dy) nëntregje, përkatësisht:
  - a- *Nëntregu i shitjes (furnizimit) së pajisjeve (kasave) fiskale;*
  - b- *Nëntregu i shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve (kasave) fiskale.*
6. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efektet që shkakton sjellja e tyre në treg, treg produkti do të konsiderojmë tregun e shërbimit të pajisjeve (kasave) fiskale të ndarë në 2 (dy) nëntregje, përkatësisht : nëntregun e shitjes së pajisjeve (kasave) fiskale dhe nëntregun e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve (kasave) fiskale.
7. **Tregu përkatës gjeografik** përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallit/shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Zona gjeografike e shitjes së pajisjeve fiskale si dhe e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale është territori i Republikës së

Shqipërisë. Në bazë të autorizimeve individuale, të lëshuara nga Ministria e Financave, ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, ato ofrojnë pajisje fiskale dhe shërbimin e mirëmbajtjes së tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Struktura e tregut**

8. Siç jemi shprehur edhe më sipër, nga Ministria e Financave janë autorizuar pesë (5) ndërmarrje për të furnizuar dhe mirëmbajtur pajisje fiskale, të cilat sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore kanë paraqitur pajisjet fiskale për t’u certifikuar pranë komisionit të ngritur në Ministrinë e Financave për të verifikuar përputhshmërinë e pajisjes që do të hedhin në treg me kërkesat ligjore të kërkuara nga këto pajisje.
9. Referuar të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se ndërmarrjet e autorizuar kanë certifikuar 24 (njëzet e katër) pajisje fiskale, të cilat po i paraqesim në tabelën e mëposhtme.

### **III. RREGULLIMI I TREGUT**

10. Referuar nenit 55 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, tatimpaguesit që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.
11. Në bazë të nenit të mësipërm, i është dhënë e drejta Këshillit të Ministrave për miratimin e karakteristikave teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së autorizimit për këto shoqëri.
12. Referuar pikës 55 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin dhe personat e tatueshëm, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, janë të detyruar të pajisen, të përdorin dhe mirëmbajnë pajisjet fiskale në përputhje me dispozitat e VKM nr. 781, date 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.
13. Referuar ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë tregun e shërbimit të pajisjeve fiskale, rezulton se nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore për të hyrë në

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

këtë treg, pasi çdo ndërmarrje e interesuar mund të aplikojë pranë Ministrisë së Financave për t’u pajisur me autorizimin përkatës për të ushtruar veprimtari tregtimin e kasave fiskale dhe ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së tyre, pasi plotësohen kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar në Kreun II, “Procedura e aplikimit dhe e autorizimit të shoqërive të autorizuar”, të VKM nr. 781, datë 14.11.2007.

14. Referuar kritereve të kërkuara për të aplikuar për t’u pajisur me autorizim, në bazë të Kreut II, pika 1/f, kërkohet që ndërmarrja të ketë një qarkullimin vjetor për 3 (tri) vitet e fundit në total, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 10 milionë euro ose ekuivalente. Gjithashtu, për t’u pajisur me autorizim, ndërmarrjes i kërkohet të depozitojnë një garanci bankare, në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë) \$, në llogari të Ministrisë së Financave.
15. Pra në tregun përkatës, nuk ka pengesa ligjore për hyrjen në treg, pasi ndërmarrjet të cilat përmbushin kriteret e nevojshme dhe zotërojnë kapitalin e nevojshëm janë të lira të hyjnë në treg, por kemi pengesa ekonomike që kanë të bëjnë me qarkullimin vjetor të kërkuar prej 10 milionë euro në 3 (tre) vitet e fundit, si dhe garancia bankare prej 500 000 (pesëqind mijë) \$.
16. Pra, kërkesat ekonomike që u kërkohen ndërmarrje për të hyrë dhe ushtruar veprimtarinë në këtë treg, përbëjnë barriera domethënëse hyrëse. Eliminimi i këtyre barrierave do të rriste konkurrencës midis ndërmarrjeve.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 24 shkronja d) dhe nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

- I. Ti rekomandojë Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave që:

*“Në VKM. nr. 781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionit për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”(i ndryshuar), të rishikohen barrierat ekonomike përsa i përket qarkullimit vjetor prej 10 milionë EURO për 3 (tre) vjet dhe garancisë bankare prej 500 000 (pesëqind mijë) \$”.*

- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Eduard YPI

( )  
Zv/Kryetar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**nr.388, datë 14.12.2015**

**“Për**

**mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në “Tregun e blerjes së energjisë  
elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” dhe disa  
rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë dhe Operatorin e Shpërndarjes  
së Energjisë Elektrike.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e raportit të hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”.

**Baza ligjore:** Nenet 24 (shkronja d); neni 26 i Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (ketu e me poshtë ligjit), neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të

Konkurrencës” dhe neni 5 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.

Ligji nr.8485 datë 11.11.1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin e thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

## **KONSTATOI:**

### **I. PROCEDURA E NDJEKUR:**

1. Bazuar në ankesën e vazhdueshme të shoqërisë GEN-I, në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, Autoriteti i Konkurrencës ka kryer disa monitorime në periudha kohore të ndryshme për këtë treg. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e monitorimit të tregut, në situatën aktuale të tregut dhe pas seancave konsultative me ERE-n, me qëllim mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike, dhe rritjen e konkurrencës në këtë segment tregu, u shpreh me anë të Vendimit nr. 334, datë 31.10.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes”.<sup>129</sup>
2. Por, tregu vazhdonte të kishte përsëri shqetësime, madje ankimuesi pretendoi për marrëveshje midis operatorëve pjesëmarrës në procedura dhe më pas për marrëveshje ndërmjet OSHEE dhe shoqërive pjesëmarrëse të tregut, duke informuar kompanitë pjesëmarrëse për çmimet e paraqitura nga ankimuesi, me qëllim nxjerrjen nga tregu të shoqërisë ankimuese. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 326, datë 08.09.2014, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” për të evidentuar kufizimet e mundshme të konkurrencës, nga sjellja e pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga ana e OSHEE-së, të cilat mund të çojnë në pengimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në treg, në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar).
3. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak në lidhje me procedurat e tenderimeve të kryera nga CEZ shpërndarje/(ndryshuar më pas në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike-OSHEE) dhe sjelljes së operatoreve pjesëmarrës u zhvilluan seanca degjimore me perfaqësues të shoqërisë GEN-I grup dhe OSHEE.
4. Gjithashtu, nga Sekretariti i Komunitetit të Energjisë, më anë të letrës së datës 18 Shkurt 2015, njoftohemi se pranë Sekretariatit është depozituar një ankesë, nga burime anonime, ku flitet për marrëveshje të ndaluar ndërmjet OSHEE dhe

<sup>129</sup> Autoriteti i Konkurrencës, është shprehur më heret me anë të korespondencës shkresore në lidhje me shqetësimet e vazhdueshme të këtij segmenti tregu

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

tregtarëve të energjisë, në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Sekretaritati sugjeron që rasti të kalojë në hetim të thelluar duke shprehur gadishmërinë për të asistuar duke bashkëpunuar në nivel ekspertësh, gjate procedurës së hetimit të thelluar.

5. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në konkluzionet e raportit të hetimit paraprak, në sugjerimet e Sekretariatit të Energjisë dhe në pretendimet e GEN-I për një marreveshje të mundshme vertikale ndërmjet OSHEE dhe shoqërive pjesëmarrëse në tender, me anë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 355, datë 20.03.2015, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar.
6. Periudha e hetimit të thelluar e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin e mësipërm është Janar-Dhjetor 2014.
7. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës kërkoi të dhëna dhe informacion nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), GSA dhe EFT AL.
8. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 374, datë 11.09.2014 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime pranë ndërmarrjeve GSA dhe EFT AL, ku u mbajtën dhe procesverbalet “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, dhe “Mbi inspektimin në ndërmarrje”. Më pas në korrik 2015, me sugjerimin e Sekretarit të Energjisë, u administruan informacionet të cilat ndodheshin në kompjuterat dhe në posten elektronike të anetareve të komisionit të blerjes, pranë OSHEE-së.
9. Procedura hetimore është fokusuar në sjelljen e ndërmarrjeve apo bashkëpunimin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedura tenderimi dhe në bashkëpunimin me OSHEE duke dhënë informacione për çmimet e konkurrentëve. Pra, hetimi i thelluar u fokusua në mundësinë e ekzistencës së marreveshjes në drejtim vertikal dhe në drejtim horizontal.
10. Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 dhe 29 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 355, datë 20.03.2015 “Per hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”, me anë të Urdhrit nr. 21, datë 01.04.2015 “Për ngritjen e Grupit të Punës mbi fillimin e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të hetimit të thelluar.

## II. NDËRMARJET NËN HETIM

11. Në procedurën e hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, u hetuan ndërmarrjet dhe sjellja e tyre:
  - 5- GSA
  - 6- EFT
  - 7- GEN-I Tirana sh.p.k dhe GEN-I Beograd
  - 8- OSHEE
12. Gjate procedurës së hetimit u kryen inspektime të njëkohshme pranë ndermarrjeve GSA dhe EFT, ku u mbajtën procesverbalet përkatëse të inspektimit me qëllim evidentimin e shenjave apo evidencave direkte të bashkëpunimit.  
*Në përfundim të procedurave të inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte që të provonin ekzistencën e bashkëpunimit ose marrëveshjeve të ndaluara midis këtyre ndërmarrjeve.*
13. Për mbledhjen e evidencave dhe fakteve të mëtejshme, u administruan pranë OSHEE-së informacione të postës elektronike në lidhje me procedurat e kryera për periudhën Janar – Dhjetor 2015.
14. Të gjitha informacionet e administruara u perpunuan më tej, me qëllim sigurimin e evidencave dhe provave indirekte për vërtetimin e bashkëpunimit në dy drejtime : horizontal (midis ndërmarrjeve pjesëmarrëse) dhe vertikal (midis ndërmarrjeve dhe OSHEE-së).

### **III. ANALIZA E KONKURENCËS**

#### **III.1.Tregu përkatës**

17. Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence<sup>130</sup>. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
  - a) Tregu përkatës i produktit
  - b) Tregu përkatës gjeografik

#### **III.1.a Tregu përkatës i produktit**

18. Tregu përkatës i produktit është tregu i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga OSHEE (ish Cez shpërndarje).
19. Bazuar në Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike dhe në Deklaratën Rregullatore, blerja e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve kryhet nga OSHEE. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është i vetmi operator, me pozicion monopol natyror, në dy segmente të tregut të energjisë elektrike. Ai vepron i vetëm në segmentin e tregut të shpërndarjes dhe në segmentin e furnizimit me pakicë të publikut.

<sup>130</sup> L I G JI 9121 datë 28.7.2003 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS dhe Udhëzimi i Komisionit të Konkurrencës nr 76, datë 07.04.2008.

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

20. Për shkak të humbjeve teknike dhe jo teknike të rrjetit të shpërndarjes, dhe për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, është vetëm OSHEE operatori që kryen blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Pra, në këtë segment tregu OSHEE vepron i vetëm. Si rrjedhim tregu është inelastik dhe i pazëvendësueshëm nga ana e kërkesës.
21. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, në këtë treg janë të licensuar 66 operatorë për tregtim të energjisë elektrike, por kompania OSHEE e dërgon ftesën për ofertë në 22 operatore dhe paraqiten si pjesëmarrës në procedura vetëm 4-5 operatorë. Pra, oferta është inelastike.
22. Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, është inelastike pasi OSHEE është i vetmi operator që kryen blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

**III.1.a Tregu përkatës gjeografik.**

3. Tregu gjeografik përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë pasi energjia elektrike që blihet për mbulimin e humbjeve në rrjet, përdoret për sigurinë e rrjetit të brendshëm me energji elektrike të vazhdueshme, si edhe të gjitha transaksionet për blerjen e energjisë elektrike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**III.2 Analiza e tregut**

23. Nga informacioni i administruar u analizuan pjesët e tregut për kompanite pjesëmarrëse dhe fituese të tenderave sipas muajve. Pjesët e tregut janë evidentuar në tabelën e mëposhtme.

Pjesët e tregut për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve, viti 2014 (%)

Nr.	Shoqëritë	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	GSA	14	30	31	23	7	16	17	30	20	16	21	29
2	EFT*AG	63	46	68	37	52	84	60	42	80	42	45	44
3	GEN-I*SB	23						15	7		14	9	11
4	GEN-I Tirana		23	1	38	41		8	19		23	12	9
5	GEN-I Athens											9	6
6	AXPO		1		2				2		5	4	1
		100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Tabela nr.1

24. Analiza u krye për çdo muaj, pasi procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të kryera nga OSHEE janë procedura mujore. Referuar të dhënave të tabeles nr.1, operatori EFT AG, ka pjesën më të madhe të tregut për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve për çdo muaj nga Janari deri në Dhjetor 2014.

**III.3 Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në treg**



25. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg është hetuar dhe analizuar gjithë dokumentacioni i administruar dhe grumbulluar gjatë procedurës së hetimit për çdo muaj, duke marrë në konsideratë edhe informacionin e ankimesit.
26. Kompania CEZ shperndarje/OSHEE, gjatë periudhës Janar – Shkurt 2014 ka kryer blerjen/importin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve bazuar në vendimin e bordit të ERE-s, nr. 42, datë 25.05.2009, mbi “Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH SH.A.
27. Më pas, CEZ shperndarje/OSHEE për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve bazuar në vendimin e ERE-s, nr. 9, datë 06.02.2014 pika 2, për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, ka zbatuar “Rregulloren e procedurave të blerjes nga KESH SH.A (KESH Gen/FPSH) të energjisë elektrike, nga tregtarët vendas dhe të huaj, të miratuar me Vendimin e ERE nr. 30, datë 23.03.2011.
28. Cez shperndarje/OSHEE, për periudhën Mars – Dhjetor 2014 ka aplikuar këtë rregullore për blerjen e energjisë elektrike. Sipas nenit 9, pika 2, “Autoriteti Blerës duhet të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit çdo ftesë për blerje të energjisë elektrike në të njëjtën ditë që fton kompanitë e listuara prej tij, për të marrë pjesë në procesin e blerjes së energjisë elektrike”. Detyrimi për publikim përfordhet edhe në nenin 19 të Rregullores.
29. Bazuar në nenin 13/3 të kësaj Rregulloreje, Cez shperndarje SH.A duhet të lexojë në prani të ofertuesve sasi dhe çmimet për gjithë ofertuesit, por kompania OSHEE/Cez shperndarje<sup>131</sup> lexon vetëm emrat dhe çmimet e ofertuesve. Por, në fakt, gjatë periudhës së hetimit kjo pikë e rregullores nuk është zbatuar.
30. Për të vlerësuar sjelljen e operatorëve është analizuar kërkesa dhe oferta për produktin për çdo muaj, pasi raporti kërkesë-ofertë është një element shumë i rëndësishëm për të përcaktuar çmimin e blerjes.

Tabelë e kërkesë-ofertës së prokurimeve të energjisë të kryera nga Cez shper/OSHEE, viti 2014

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Kerkese	500	480	385	260	220	250	260	270	225	252	317	330
Oferte (I)	441	410	482	391	209	298	260	246	235	200	240	170

Tabela nr. 2

30. Nga tabela duket që për muaj të veçantë, janar, shkurt, maj, gusht, tetor, nëntor dhe dhjetor, sasia e këkuar është më e madhe se sasia e ofertuar në fazën e parë të negociimit, për këtë arsye Cez shperndarje/OSHEE pretendon se nëse do të behen publike sasi dhe çmimet e ofruara nga ofertuesit gjatë procedurës së prokurimit/fazave të negociimit, ofertuesit (tregtarët) nuk do të ulin çmimin e shitjes së energjisë.

<sup>131</sup> Referuar shkresës së CEZ shperndarje nr.189/1, datë 21.04.2014

31. Gjatë procedurës së hetimit, bazuar në dokumentacionin e siguruar gjatë inspektimeve dhe dokumentacionin e administruar nga OSHEE, me qëllim vërtetimin në se pjesëmarrësit kanë komunikuar apo kanë bashkepunuar me OSHEE-ne duke nxjerrë informacion rreth ofertave të dërguara nga operatori GEN-I, u krahasuan dhe u hetuan oraret e ofertave të dërguara gjatë procedurës.

**32. Procedurat e tenderimit të energjisë muaj pas muaji për vitin 2014.**

- Gjatë analizës së fakteve dhe evidencave të prodhuara nga procedura e hetimit të thelluar konstatohet se nuk u vërejtën prova të mjaftueshme direkte dhe indirekte që të provonin ekzistencën e marrëveshjeve të ndaluara horizontale mes shoqërive EFT dhe GSA dhe ndonjë marrëveshje vertikale mes OSHEE-së në anën e kërkesës dhe EFT dhe GSA në anën e ofertës.

- **Në prokurimin e muajit Janar 2014** fitues janë EFT AG për sasinë 294 MW me çmim 69.75Euro/MWh dhe GSA për sasinë 55 MW me çmimin 64.57Euro/MWh çmim i cili është më i lartë se çmimi ofertës së parë në raundin e tretë(64.25 64.57Euro/MWh), por më i ulët se çmimi i ponderuar për të dy ofertat(64.25 dhe 66.75) pasi shpallja fitues është bërë për sasinë kumulative të dy ofertave. GEN-I është përjashtuar nga procedura pasi nuk ka pranuar të heqë kushtet e vendosura për afatin e pagesave të faturave (brenda 30 diteve) dhe pagesen e faturave të prapambetura nga periudhat e mëparshme (nëntor-dhjetor 2013) të cilat nuk ia kishte njohur administrimi i CEZ Çek.

Nëse analizohet çmimet nga pikpamja e një marrëveshje të mundshme mes ofertuesve, rezulton se ofertat dhe çmimet e shpallura fituese janë me diferencë domethënëse me njëra tjetrën me rreth 5 euro për MWh (megavatorë) pavarësisht se janë vetëm dy operatorë të shpallur fitues.

Mundësia e rrjedhjes së informacionit nga OSHEE për konkurrentët e ankimuesit nuk përjashtohet, por kjo hipotezë përveç se duhet të provohet dhe për të cilën ankimuesi nuk ka sjellë asnjë provë dhe nga inspektimet dhe verifikimet e dokumentacionit nuk është mundur të provohet, mbetet gjithësesi jashtë objektit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), por mund të jetë objekt i shqyrtimit nga organet e auditit të brendshëm të OSHEE dhe KLSH, për të parë nëse nga këto veprime i është shkaktuar dëm shtetit që është pronari i 100 % të aksioneve të OSHEE-së.

Por, elementët e dyshuar të rrjedhjes së informacionit siç pretendon ankimuesi nuk mundin të provohen ndër të tjera edhe për shkak të faktit se ankimuesi e ndryshoi pretendimin e tij nga mundësia e ekzistencës së koordinimit të ofertave mes konkurrentëve të tij të mundësia e një marrëveshje vertikale mes OSHEE dhe ofruesve të tjerë të energjisë.

- **Në prokurimin e muajit shkurt 2014**, nga analiza e orareve të ofertave të dërguara me faks vihet re se ofertat e konkurrentëve të ankimuesit janë dërguar më vonë se oferta e GEN-I.

Sa i përket pretendimit të ankimuesit se “çmimet e konkurrentëve janë disa cent më të ulëta se ato të GEN-I, duke bërë të mundur eliminimin e operatorëve të tjerë të tregut” nga analiza e rezultateve të ankandit rezulton se janë shpallur fitues të gjithë konkurrentët dhe çmimet variojnë nga 70.5 euro/MWh deri në 63.55 euro/MWh me ndryshime të rëndësishme nga një ofertues te tjetri dhe asnjëri nga konkurrentët nuk ka çmim me cent më të ulët se Gen-I.

Ne muajin shkurt operatori GEN-I, ka hequr kushtet e vendosura (me afatin e pageses se faturave). Operatori GSA ka paraqitur dy oferta dhe eshte shpallur fitues me dy oferta.

Nga dokumentacioni i administruar, për procedurën e prokurimit të muajit Shkurt 2014, nuk u evidentuan shenja të ngjashme ose evidenca të cilat provojnë bashkëpunimin e operatorëve dhe OSHEE gjatë hartimit të ofertave.

- **Në prokurimin e muajit Mars 2014**, duket sikur provohet hipoteza e Gen-I se “nëpërmjet paraqitjes së ofertave përfundimtare me çmime të cilat janë disa cent më të ulëta se ato të GEN-I, duke bërë të mundur eliminimin e operatorëve të tjerë të tregut” pasi diferenca mes tre fituesve është 0.05 euro/MWh. Fituesit e muajit Mars 2014 janë: GEN-I Tirana Sh.p.k për sasinë 5 MW me çmim 55.90Euro/MWh; GSA për sasinë 120 MW me çmim 55.80 Euro/MWh dhe EFT AG për sasinë 260 MW me çmim 55.85Euro/MWh.

Por hipoteza se çmimet e konkurrentëve janë disa cent diferencë nga Gen-I pasi ka patur rrjedhje informacioni nga OSHEE për konkurrentët, në këtë ankaud nuk provohen pasi oraret e dërgimit të ofertave rrezojnë pretendimin se OSHEE mund të ketë informuar konkurrentët për çmimet e GEN-I.

Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit përkatës, nuk u evidentuan shenja ose evidenca të cilat provojnë bashkëpunimin e operatorëve gjatë hartimit dhe shqyrtimit të ofertave për prokurimin e muajit Mars 2014.

- **Në prokurimin e muajit Prill 2014**, nuk u evidentuan shenja të ngjashme ose evidenca të tjera të cilat provojnë bashkëpunimin apo koordinim të sjelljes së operatorëve gjatë hartimit dhe shqyrtimit të ofertave për prokurimin e muajit Prill 2014.

- **Në prokurimin e muajit Maj 2014** nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, evidentohet se ofertat e shpallura fituese mes EFT dhe GSA ndryshojnë vetëm me 0.1 euro, por ky fakt nuk është i pamjaftueshëm për të provuar bashkëpunimin mes operatorëve konkurrues(marrëveshje horizontale) dhe ndërmjet OSHEE dhe operatorëve(marrëveshje vertikale) gjatë shqyrtimit oraret e dërgimit të ofertave dhe analiza e korespondences elektronike të ofertave për prokurimin e muajit Maj 2014.

Pretendimi se OSHEE mund të ketë njoftuar pjesëmarrësit e tjerë në procedurë për ofertën e Gen-I, nuk provohet pasi nga procesverbalet perkatëse vihet re se ora e dërgimit të ofertave përfundimtare të GEN-I Tirana është me vonë se oraret e ofertave të dërguara nga shoqëritë e tjera konkurrencte.

- **Në prokurimin e muajit Qershor 2014**. Referuar ofertave fituese, vihet re se çmimet përfundimtare të ndërmarrjes EFT dhe GSA për muajin Qershor 2014 ndryshojnë me vetëm 0.04 Euro, ndërsa ofertat fillestare ndryshojnë më shume.

Gjithashtu, ofertat përfundimtare të EFT dhe GSA për të cilat pretendohet për marrëveshje vertikale me OSHEE-në janë dërguar rreth 60 dhe 40 minuta pas ofertës së GEN-I. Afersia kaq e dukshme e çmimeve mes operatorëve të shpallur fitues dhe diferenca me vetëm 0.1 euro me Kurum dhe 0.6 euro me Gen-I të bëjnë të dyshosh mbi aplikimin e një “teorie loje” me informacion asimetric mes konkurrentëve në treg, por që në mungesë të evidencave direkte të komunikimit horizontal(EFT-GSA) dhe vertikal(OSHEE me EFT dhe GSA) mbetet hipotezë e arsyeshme, por e paprovueshme me faktet dhe provat që disponohen.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vihet re se jane paraqitur oferta nga ndërmarrjet GEN-I Tirana Sh.p.k dhe GEN-I Beograd, të cilat janë pjesë e të njëjtit grup. Në këtë rast ku numri i operatorëve me të cilet vazhdojnë negociatat është i kufizuar (vetem 5 operatore) ndersa dy operatore janë të të njëjtit grup, rrezikon të ketë konkurrencë.

- **Në prokurimin e muajit Korrik 2014**, janë verifikuar oraret e dërgimit të ofertave dhe vihet re se oraret e dërgimit të ofertave perfundimtare nga shoqerite e GEN-I Grup jane paraqitur me vonë se oraret e ofertave të ofertuesve të tjerë. Pra, oraret e dërgimit të ofertave e rrezojnë pretendimin se OSHEE mund të ketë bashkepunuar duke informuar konkurrentët për çmimet e GEN-I.  
Gjithashtu afërsia e ofertave fituese lë dyshime për një “teorie loje” me shkëmbim informacioni mes konkurrentëve në treg, por oraret më të hershme të dërgimit të ofertave nga këto dy konkurrentë krahasuar me Gen-I, nuk e provojnë marrëveshjen vertikale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mes OSHEE-së nga ana e kërkesës dhe kompanive ofertuese nga ana e ofertës.  
Në këtë procedure ofertat e paraqitura nga ndërmarrjet e grupit GEN-I ( GEN-I Tirana Sh.p.k dhe GEN-I Serbia), janë pjesë e të njëjtit grup dhe janë të nënshkruara nga i njëjti person, paraqiten me oferta dhe konkurojnë si dy shoqëri të pavarura.
- **Në prokurimin e muajit Gusht 2014**. Afërsia e ofertave fituese lë dyshime për një “teorie loje” me shkëmbim informacioni mes konkurrentëve në treg, por oraret më të hershme të dërgimit të ofertave nga kompanite fituese krahasuar me Gen-I Grup e bëjnë të të paprovueshme marrëveshjen vertikale, apo shkëmbimin e informacionit mes OSHEE-së nga ana e kërkesës dhe kompanive ofertuese nga ana e ofertës.  
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, oraret e dërgimit të ofertave dhe analiza e korrespondences elektronike e-maileve, nuk u verejten shenja te koordinimit te sjelljes apo te bashkepunimit ndermjet OSHEE, EFT dhe GSA. Por, vihet re se ofertat e paraqituara nga ndërmarrjet GEN-I Tirana SHPK dhe GEN-I SB, konkurojne me oferta të veçanta sikur janë shoqëri te pavarura.
- **Në prokurimin e muajit Shtator 2014**. Afërsia e ofertave fituese të EFT dhe GSA të lë dyshime për një “teorie loje” me shkëmbim informacioni mes konkurrentëve në treg por oraret më të hershme të dërgimit të ofertave nga këto dy konkurrentë krahasuar me Gen-I e bëjnë të paprovueshme marrëveshjen vertikale nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mes OSHEE-së nga ana e kërkesës dhe EFT e GSA-së nga ana e ofertës.  
Shoqerite e GEN-I Grup i kane paraqitur ofertat me vone se GSA, ndersa EFT e ka paraqitur oferten e fundit nje min para GEN-I Tirana dhe nje min pas GEN-SB.  
Keshtu, oraret e dërgimit të ofertave e rrezojnë pretendimin se OSHEE mund te ketë bashkepunuar me EFT dhe GSA duke informuar per çmimet e GEN-I.  
Pra, nuk ekzistojnë prova të mjaftueshmë në dokumentacionin e procedures dhe korespodences elektronike, e-maileve, për të provuar marrëveshjen e bashkepunimit ndermjet OSHEE, EFT dhe GSA.
- **Në prokurimin e muajit Tetor 2014**. Nga dokumentacioni perkates vihet re se shoqerite e GEN-I Grup, i kane paraqitur ofertat me vone se GSA dhe EFT.

Keshtu, oraret e dërgimit të ofertave e rrezojnë pretendimin se OSHEE mund të ketë bashkepunuar me EFT dhe GSA duke informuar për çmimet e GEN-I. Çmimet nga oferta e pare deri në ofertën perfundimtare janë ulur. Pra nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme në dokumentacionin e procedurës dhe korespondencës elektronike e-maileve, për të provuar marrëveshjen e bashkepunimit ndërmjet OSHEE, EFT dhe GSA. Në procedurën e muajit tetor sasia e energjisë së kontraktuar është me e madhe sa energjia e kërkuar për mbulimin e humbjeve.

- **Në prokurimin e muajit Nentor 2014.** Nga dokumentacioni përketes vihet re se oraret e dërgimit të ofertave perfundimtare të GEN-I Tirana, GEN-I SB dhe GEN-I Athens janë në orën 17.59, ndërsa EFT ora 18.05, AXPO është ora 17.41 dhe GSA është ora 17.56. Në këtë rast EFT e ka dërguar ofertën 6 min më pas se GEN-I Grup, ndërsa GSA e ka dërguar ofertën më pare se GEN-I Grup. Në procedurën e prokurimit të muajit nëntor 2014, GEN-I Grup paraqitet me tre oferta të ndryshme, ndërkohe që konkurojnë gjithsej 6 shoqëri. Pra nga 6 shoqëri që futen në procesin e konkurimit tre i perkasin grupit GEN-I, dhe të tre janë shpallur fitues. Edhe në këtë rast nuk mund të vertetohet bashkepunimi vertikal. Në procedurën e muajit nëntor sasia e energjisë së kontraktuar është me e madhe se energjia e kërkuar për mbulimin e humbjeve.
  - **Në prokurimin e muajit Dhjetor 2014.** Nga dokumentacioni konstatohet se ofertat e grupit GEN-I janë dërguar më vonë se ofertat e shoqërive të tjera. Pra, nuk provohen shenja komunikimi apo bashkërendimi ndërmjet shoqërive pjesëmarrëse (EFT dhe GSA) dhe OSHEE për të informuar në lidhje me ofertën e GEN-I. Në procedurën e prokurimit të muajit dhjetor 2014, GEN-I Grup paraqitet me tre oferta të ndryshme në një procedurë që konkurojnë gjithsej 7 shoqëri. Pra nga 7 shoqëri që futen në procesin e konkurimit, tre i perkasin të njëjtit grup GEN-I, dhe të tre janë shpallur fitues. Gjithashtu edhe shoqëria EFT Grup paraqitet me dy shoqëri EFT AG dhe EFT Albania duke paraqitur ofertat përkatëse dhe duke dale fituese me të dyja shoqëritë. Në procedurën e muajit dhjetor sasia e energjisë së kontraktuar është me e madhe se energjia e kërkuar për mbulimin e humbjeve
33. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, oraret e dërgimit të ofertave dhe analiza e korespondencës elektronike e-maileve, nuk iu verejten shenja të koordinimit të sjelljes apo të bashkepunimit ndërmjet OSHEE, EFT dhe GSA. Gjithashtu nga analiza e orareve të dërgimit të ofertave nuk vertetohet dyshimi se konkurentët kanë informacion paraprak për çmimin e ankimuesit, për ta nxjerrë nga tregu, pasi ofertat e konkurrenteve janë dërguar pothuajse më vonë se ofertat e kompanisë GEN-I.
34. Nga shqyrtimi i ankesave bazuar në hipotezat e pretenduara nuk ka përputhje midis skemave të paraqitura, madje ankimuesi nuk e ka mbështetur hetimin me argumenta të qarta për të vertetuar pretendimin e marrëveshjes në drejtim vertikal apo horizontal.
35. Tregu i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është treg i derregulluar, për

sa i përket çmimit, ndersa procedura e prokurimit të energjise elektrike është e përjashtuar nga rregullat e Ligjit “Për prokurimin publik” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

36. Dinamika e çmimeve ndryshon në disa raunde negociatash, që OSHEE i kryen për të optimizuar portofolin ekonomik të blerjes, por procesi në vetvete, ka ngritur hipoteza mbi mungesën e transparencës, pasi në tre raundet e para publikohet vetëm çmimi dhe jo sasia e ofruar që sipas OSHEE-së bëhet për të siguruar sasisë e energjisë së kërkuar dhe uljen e çmimeve të ofruara. Në përgjithësi janë zhvilluar 4 faza negocimi gjate të cilave ofertuesit kanë paraqitur ofertat e tyre.
37. Nga analiza e të dhënave të administruara vihet re se në muajt ku kërkesa për energji elektrike është më e vogël se oferta e paraqitur, çmimi fitues me të cilin është lidhur kontrata përfundimtare është më i ulët, pra është rritur konkurrenca ndermjet shoqerive pjesemarrëse ne procedure.
38. Ndërsa në muajt janar, shkurt, maj, gusht, tetor, nëntor të vitit 2014, kërkesa për energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes është më e madhe se oferta fillestare e operatorëve që marrin pjesë në procedurën e prokurimit duke zbehur konkurrencën mes operatorëve që ofrojnë produktin energji elektrike për tregun përkatës.
39. Gjate muajve tetor, nëntor, dhjetor 2014, nga ana e OSHEE është blere me shume energji elektrike se sasia e kerkuar. Gjate periudhes janar, shkurt 2014, sasia e kontraktuar/blere është më e vogël se sasia e kërkuar.
40. Referuar te dhënave për çdo muaj (të cilët konsiderohen si tregje përkatëse të veçanta) operatori EFT AG, ka pjesën më të madhe të tregut që varion nga 42% - 80% per çdo muaj (Janari - Dhjetor 2014).
41. Numri i kompanive pjesëmarrje në procedure dhe që OSHEE/Cez SH.A ka lidhur kontrata furnizimi është i kufizuar. Janë pothuajse të njëjtat kompani që marrin pjesë dhe shpallen fituese pas katër proceseve negocimi, pra katër ose pese kompani, e cila ka çuar ne ulje të konkurrencës ndermjet pjesemarrësve.
42. Gjate procedurave të prokurimit ndërmarrjet të cilat i përkasin të njëjtit grup sic jane ndërmarrjet e grupit GEN-I, në shtate muaj kanë paraqitur dhe kane dale fitues me oferta të veçanta. Kjo ka çuar në ulje të konkurrencës pasi nuk mund te konkurrojnë me njëra tjetren ndërmarrje të të njëjtit grup. Pra, tregu perveç se ka numër të kufizuar pjesëmarrësish, ka edhe pjesëmarrje të të njëjtit grup qe paraqiten me oferta të veçanta. Gjithashtu, në muajin dhjetor 2014 edhe EFT është paraqitur dhe ka dalë fituese me dy oferta te EFT AG dhe EFT Albania.
43. Baza ligjore rregullatore që zbatohet për blerjen e energjisë elektrike per mbulimin e humbjeve dhe menyra se si ajo zbatohet, e kufizon numrin e pjesëmarrësve ne procedure, e ben procesin jotransparent dhe te besueshem për shoqërite pjesëmarrëse dhe si rrjedhim e ben tregun me inelastik, nga ana e ofertës, duke e çuar ne tkurtje te numrit të ofertuesve, duke ndikuar negativisht për konkurrencën në treg, dhe në rritjen e kostove përfundimtare të produktit energji elektrike.

44. Ofertat që kompanite dergojne me poste elektronike prane CEZ/OSHEE, dërgohen në posten elektrokniqe zyrtare të personave pergjegjes per procesin e prokurimit, pra jo nepermjet nje adrese te posacme per prokurimet, e cila te hapet dhe lexohet ne prani te pjesemarrësve, kjo e ben procesin jo te besueshem dhe transparent.
41. Për sa më sipër, referuar sjelljes së ndërmarrjeve gjatë procedurave të prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, rezulton se nuk gjenden shenja komunikimi direkte të cilat mund të kufizojnë konkurrencën në bazë të nenit 4, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar).
42. Por gjithsesi është baza ligjore dhe rregullatore e cila krijon deformime dhe shqetësime për konkurrencën në treg nëpërmjet:
- (i) tkurrjes së numrit të ofertuesve,
  - (ii) humbjes së besimit të operatorëve në procesin e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve,
  - (iii) faktin që në shume raste kërkesa është më e madhe se oferta, si dhe kufizimit të numrit te operatoreve qe do te futen në procedurat e mëtejshme të negociimit bën që operatorët e të njëjtit grup, për të zënë vende për procedurat e mëtejshme të hyjnë si operatorë të veçantë,
  - (iv) negociatat dypalëshe që kryhen ndërmjet OSHEE-së dhe ofertuesve e bën procesin dyshues.
43. Ndërkohë që kishin përfunduar procedurat hetimore dhe Komisioni i Konkurrencës ishte para marrjes së vendimit përfundimtar, nga OSHEE vihemi në dijeni se gjatë periudhës janar-shtator 2015 edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar audit pranë OSHEE-së ndër të tjera edhe lidhur me procedurat e blerjes së energjisë elektrike.
44. OSHEE SH.A me nr.19157 prot, datë 21.10.2015, na njofton se nga audit i Kontrollit të Lartë të Shtetit u konstatuan parregullesi në zbatimin e procedurave të blerjes se energjise per mbulimin e humbjeve të energjise në sistemin e shpërndarjes, pasi kompanitë e të njëjtit grup kanë realizuar marrëveshje të ndaluara në procedurat e blerjes së energjisë elektrike, kanë fshehur pozicionin e tyre të dyfishte dhe kane kryer tregti direkt të fshehtë, duke krijuar avantazh të paligjshem, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës.
45. Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr 418/1, datë 29/10/2015 kërkoi nga KLSH të vendosë në dispozicion të Autoritetit çdo evidencë apo provë që të vërtetojë bashkëpunimin ndërmjet pjesëmarrësve në procedurë.
46. Kontrolli i Lartë i Shtetit me anë të shkresës nr. 90/3 prot të datës 08.11.2015 dergoi raportin e auditimit në të cilin Autoriteti i Konkurrencës nuk gjeti prova dhe evidenca të cilat të vërtetonin bashkëpunimin e pjesëmarrësve.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 4, nenit 24 shkronja d), nenit 43 pika 5, dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e të Autoritetit të Konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, ndaj ndërmarrjeve GSA, EFT, ndërmarrjeve të grupit GEN-I, OSHEE, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve në treg.
2. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës si dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike(OSHEE):
  - a- *Gjatë procedurave të plotësimit të kuadrit nënligjor sipas parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për energjinë elektrike” lidhur me Modelin e Tregut dhe rregulloret e posaçme për blerjen e energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve, të mbahen parasysh rekomandimet e përsëritura të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me parimet e garës dhe transparencës së procedurave dhe zbatimin e rregullave të ankandit sipas praktikave më të mira të ofruara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe vendet antare;*
  - b- *Të ndalojë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të lidhura që i përkasin te njejtë grup, apo kanë lidhje aksionerësh, të paraqiten me oferta të veçanta në procedurat e prokurimit apo te blerjes së energjisë elektrike.*
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi për palët nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

**Koço BROKA**

**Iva ZAJMI**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)

**Zv/Kryetar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 389, datë 14.12.2015**

**“Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës për projekt/ligjit ““Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar””.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |            |
|-----------|-------------|------------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar    |
| ▪ Servete | GRUDA       | Zv/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar     |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar     |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 14.12.2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i projekt/ligjit ““Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar””.

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja f), neni 69 dhe neni 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës** pas vlerësimit të projekt/ligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar””,

### **VËREN SE:**

1. Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nëpërmjet neneve të tij 69 dhe 70, përcakton shumë qartë rolin e Autoritetit të Konkurrencës në vlerësimin e shkallës së kufizimit apo pengimit të konkurrencës dhe barrierave rregulluese të konkurrencës. Në zbatim dhe respektim të këtij Ligji, për një vlerësim sa më të drejtë dhe specifik të pasojave që mund të vijnë mbi konkurrencën në rastin e dhënies së një ndihme shtetërore, do të ishte i nevojshëm mendimi i Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni kompetent në këtë fushë.
2. Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave, në rezolutat e vlerësimit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar zbatimin e detyrimit ligjor nga ana e institucioneve publike për marrjen e vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës si një instrument i domosdoshëm për rritjen e eficiencës së përdorimit të pasurisë publike. Më konkretisht Rezoluta për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, cilëson: “Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës: -Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit të akteve që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimeve sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.”
3. Sipas legjislacionit të BE-së, kontrolli i ndihmës shtetërore është pjesë e politikës së konkurrencës. Për këtë qëllim UNCTAD (United Nations Conference on Trade and Development) në Raportin e tij “Voluntary peer review of the Albanian Competition Law and Policy” ka dhënë rekomandimet përkatëse lidhur me krijimin e kapaciteteve institucionale për kontrollin efektiv të ndihmës shtetërore.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

### **VENDOSI:**

1. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë:

Të zbatojë nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

( \_\_\_\_\_ )

**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

**Eduard YPI**

( \_\_\_\_\_ )

**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**VENDIM**

**nr. 390 , datë 22.12.2015**

**Për**

**“Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.12.2015, trajtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës”.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d) dhe f); neni 26 dhe neni 70, pika 2.  
Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës” dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

## **VËREN SE:**

### **I. PROCEDURA**

1. Bazuar në konkluzionet e monitorimit të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4 dhe 9, neni 24 (shkronja d) dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; neni 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”; neni 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Vendimit nr. 360, datë 04.05.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së, për periudhën kohore 2012- Prill 2015.
2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
3. Në bazë të nenit 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 233, datë 05.05.2015 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

### **II. NDËRMARRJET NËN HETIM**

4. Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 360, datë 04.05.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës”, ndërmarrjet nën hetim të cilat operojnë në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës, janë:
  - Ndërmarrja "A&V GAZ" SHA, me NIPT: K92223503O, me seli në: Porto Romano, Durrës;
  - Ndërmarrja "KEVIN GAZ" SHA, me NIPT: K68411501Ë, me seli në: FSHAti Ishull - Lezhë;
  - Ndërmarrja "PRIMAGAS ALBANIA" SHA, me NIPT: K62818402N, me seli ne adresën: Durrës, Porto – Romano, 500 m në veri të hidrovorit.

- Ndërmarrja "KASTRATI" S.H.A, me NIPT K43823006A, me seli në: Lagjia nr.14, Rruga Tiranë-Durrës, Shkozet;
- Ndërmarrja "KASTRIOT & PETROL" SHA, me NIPT: L11718501C, me seli në: Durrës - Xhafzotaj - Pejzë;
- Ndërmarrja "GLOBAL GAZ" SHA, me NIPT: K12516401E, me seli në: Portëz - Fier;
- Ndërmarrja "DUA GAZ" SHA, me NIPT: J62314006I, me seli në: Autostradën Tiranë-Vorë Km.14;
- Ndërmarrja "AV GAZ DISTRIBUTION" SHA, me NIPT: L11409508E, me seli në: Porto Romano, Durrës;
- Ndërmarrja "ROYAL GAZ" SHA, me NIPT: K11316501C, me seli në: Durrës-Shijak-Pjezë;
- Ndërmarrja "MEGA GAZ" SHA, me NIPT: K22826401S, me seli në: Qender-Fier, Lagjia: "Zhupan", Rr. "Kadri Hoxha";
- Ndërmarrja "PETROL GAZ" SHA, me NIPT: J83113625U, me seli në: Gjirokastër-Dropull-Jorgucat, Rruga Nacionale Gjirokastër-Kakavi;
- Ndërmarrja "KORÇA GAZ" SHA, me NIPT: K63813001E, me seli në: Drenovë -Korçë;
- Ndërmarrja "IB GAZ" SHA, me NIPT: K12915201Ë, me seli në: Elbasan FSHAti Bradashesh, km 3 i Autostradës Elbasan - Metalurgjik;
- Ndërmarrja "ANDKRI" Sh.p.k, me NIPT: K63521606T, me seli në: Gjirokastër - Dropull - Jorgucat;
- Ndërmarrja "ALFAGAS SHA", me NIPT: L41909003V, me seli në: Tiranë, Prezë, Ahmetaq; pranë Rinasit, Rr. "Vasil Miho";
- Ndërmarrja "MARE OIL" SHA, me NIPT: K21922802I, me seli në: Tiranë, Prezë, Ahmetaq;

### III. ANALIZA E KONKURRENCËS

5. Në zbatim të Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, miratuar me Vendimin nr. 76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës, tregu përkatës përfshin tregun e produkteve dhe tregun gjeografik.
  - a. **Tregu përkatës i produktit** në këtë procedurë hetimore përfshin importin, shitjen me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës.
  - b. **Tregu përkatës gjeografik** është territori i Republikës së Shqipërisë.
6. Kërkesat për gazin e lëngshëm të naftës sigurohen nga importi, kryesisht në rrugë detare. Ndërmarrjet e importit të GLN ushtrojnë njëkohësisht edhe veprimtarinë e tregtimit me shumicë të GLN-së. Në nivelin e sipërm të tregtimit të GLN (import dhe shitje me shumicë) operojnë një numër i konsiderueshëm ndërmarrjesh.
7. Ndërmarrjet e tregtimit me shumicë të GLN e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar. Këto ndërmarrje themelohen në formën e shoqërive anonime, si dhe kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëri të tregtimit me pakicë të GLN, si stacione të shitjes së karburanteve apo njësi të lëndëve djegëse. Ndërmarrjet e tregtimit me shumicë kanë të drejtë të furnizojnë: rafineritë e naftës; impiantet e përpunimit; shoqëritë e tregtimit me pakicë; mjetet detare dhe ajrore; si dhe konsumatorët e mëdhenj.

8. Nga analiza që i është bërë tregut të shitjes rezulton se ndërmarrjet që kanë objekt të tyre veprimtarinë e shitjes me shumicë të GLN-së operojnë edhe në tregun e pakicës, duke tregtuar GLN-në edhe në tregun e shitjes me pakicë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.
9. Në tregun e shitjes me pakicë të GLN-së nuk operojnë vetëm shoqëritë e tregtimit me pakicë të GLN-së, por edhe shoqëritë e tregtimit me shumicë, duke thyer në këtë mënyrë segmentet e tregtimit në kundërshtim me Ligjin.
10. Sipas Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, veprimtaria e tregtimit me pakicë të GLN-së kryhet nga:
  - a) Stacionet e shitjes së karburanteve (tregtim me pakicë i gazit të lëngshëm për automjete);
  - b) Njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës (tregtimi me pakicë i gazit të lëngshëm për ngrohje dhe gatim për konsumatorët).
11. Gjatë procedurave hetimore u konstatua se ekziston edhe një kategori tjetër e njësisive të shitjes me pakicë të GLN-së të cilët kryejnë aktivitet të shitjes me pakicë dhe furnizohen nga ndërmarrjet e tjera të shitjes me pakicë, në kundërshtim me Ligjin nr. 8450 për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre. Në këtë mënyrë ndërmarrjet që kanë objekt të tyre shitjen me pakicë të GLN-së, tregtojnë produktin GLN edhe drejt klientëve të tjerë me qëllim rishitjen, duke krijuar kështu një hallkë të tretë vertikale të zinxhirit të shitjeve të GLN-së.
12. Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, me specifikimet dhe përcaktimet që i ka bërë niveleve të shitjeve, nuk lejon që të ketë një hallkë të tretë shitje me pakicë e cila furnizohet sërish nga ndërmarrje që kanë licencë për shitje me pakicë të GLN-së. Ligji nr. 8450 përcakton qartë se në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së ekzistojnë dy kategori:
  - a) Shitës me shumicë (SHA) të cilët kryejnë aktivitetin e importit dhe shitjes me shumicë konform lejeve dhe legjislacionit në fuqi;
  - b) Shitës me pakicë të cilët tregtojnë GLN vetëm për konsumatorë fundorë.

### **III. 1. Sjellja e ndërmarrjeve në treg**

13. Gjatë inspektimeve të kryera në ndërmarrjet nën hetim nuk u gjet asnjë provë apo evidencë direkte apo indirekte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kundërshtim me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
14. Mungesa e elementëve të ekzistencës së një marrëveshje të mundshme ka përqëndruar realizimin e analizës së konkurrencës në vlerësimin e elementëve të nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), për të parë nëse ka apo jo shenja të abuzimit me pozitën dominuese.

#### **III.1.1 Vlerësimi i pozitës dominuese**

Referuar nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), klasifikimi i një ndërmarrje me pozitë dominuese në treg kërkon analizën e disa elementeve të tregut si më poshtë.

##### **A. Pjesët e tregut**

15. Struktura e tregut të importit të gazit tregon se ndërmarrja A&V Gas SHA ka një pjesë tregu mbi 50% gjatë viteve 2012-2014. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave konstatohet se gjatë periudhës Janar – Prill 2015 pjesa e tregut e ndërmarrjes A&V GAZ SHA ka rënë duke zënë rreth 45% të volumit në tregun e importit. Konkurrenti më i afërt i kësaj ndërmarrje Kevin Gaz SHA zotëron një pjesë tregu 18.5% të tregut në vitin 2014, ndërsa për periudhën Janar – Prill 2015 pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje shkon në 27.2%. Ndërmarrja Kastrioti & Petrol SHA, e cila furnizohet nga Kastrati SHA (ndërmarrje me të njëjtët aksionerë), ka rritur ndjeshëm pjesën e tregut gjatë periudhës Janar – Prill 2015 në 17.4% nga 4.3% që ishte ky tregues në vitin 2014.
16. Duke ju referuar treguesve sasiore të strukturës së tregut sipas ndërmarrjeve, vihet re se ndërmarrja A&V Gas SHA, e cila është importuesja më e madhe gjatë vitit 2014, ka rritur sasinë e importeve në tregun e brendshëm me rreth 15.3% krahasuar me vitin e kaluar, situatë kjo e shoqëruar më daljen nga tregu të ndërmarrjes Prima Gaz dhe Mare Oil. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 kemi një rritje të prezencës në treg të ndërmarrjeve Kevin Gaz SHA dhe Kastrioti & Petrol SHA të cilat operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë. Këto ndërmarrjes kanë rritur prezencën e tyre në tregun e importit dhe shitjes me shumicë edhe gjatë periudhës Janar-Prill 2015.
17. Treguesit e përqendrimit bëjnë që indeksi i përqendrimit HHI të jetë i lartë duke i dhënë tregut karakteristikat e një tregu shumë të përqendruar, me një strukturë oligopolistike. Nga të dhënat konstatohet se kemi një rënie të përqendrimit në treg gjatë katër-mujorit të parë të vitit 2014.
18. Në përfundim të analizës së pjesëve të tregut, bazuar në udhëzimin mbi pozitën dominuese të ndërmarrjeve në treg dhe praktikave më të mira të Komisionit Europian mund të themi se pavarësisht rënies në katër-mujorin e parë të vitit 2015 në 45% të tregut të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së, ndërmarrja A&V GAZ SHA plotëson kriterin e pjesës së tregut për tu vlerësuar si ndërmarrje me pozitë dominuese në treg.

#### **B. Barrierat ligjore dhe ekonomike**

19. Në legjislacionin shqiptar, tregu i gazit rregullohet dhe funksionon në bazë të Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre”. Bazuar edhe në analizat e mëparshme të realizuara gjatë procedurave të hetimit në tregun respektiv, është konstatuar se nuk ka asnjë kufizim apo barrierë administrative të parashikuar nga legjislacioni shqiptar për hyrjen në treg të operatorëve të rinj gjë e cila mund të ishte barrierë për krijimin e një monopoli.
20. Duke qenë se Shqipëria nuk është e lidhur në ndonjë rrjet tubacioni të transportit të GLN, thuajse gjithë importimi i GLN realizohet nëpërmjet rrugëve detare, e cila ofron avantazhe të ndjeshme në kosto, krahasuar me transportin rrugor.
21. Investimet e konsiderueshme në sistemin e magazinimit dhe transportit të produktit kërkojnë gjithashtu kapitale të konsiderueshme të cilat vështirësojnë hyrjet e reja në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN. Për shkak të avantazheve që ka transporti i GLN në rrugë detare, ndërmarrjet janë të detyruara të realizojnë investime në infrastrukturën magazinuese në portin “Romano Port”, ose duhet të marrin me qira nga porti, në rastin e portit “Vlora 1”, depozitat e gazit.
22. Kostot fillestare në këtë treg janë të larta jo vetëm për shkak të investimeve në aktive të qëndrueshme, por kërkon gjithashtu qarkullim të madh të vlerave monetare gjatë transaksioneve të blerjes dhe shitjes së GLN.

23. Ndërmarrja A&V Gas SHA nuk zotëron në pronësi kapacitete depozitimi pranë portit “Romano Port” SHA, por operon nëpërmjet kontratave të qirasë me ndërmarrjen “Intergas Albania” Sh.a me të cilën kanë aksionerë të përbashkët. Ndërmarrja Prima Gas SHA ka realizuar investime dhe zotëron kapacitetet e veta depozituese në port por nga sa jemi në dijeni, kjo ndërmarrje i ka dhënë në përdorim tek ndërmarrja Kastrati SHA nëpërmjet kontratës së qirasë.
24. Pozita e konsoliduar e ndërmarrjes A&V Gas SH.a në treg, qëndrueshmëria e pjesëve të tregut në vite, përbëjnë barriera hyrëse për konkurrentë të tjerë ku eksperiencia apo reputacioni janë të nevojshme për të konkurruar efektivisht. Gjithashtu, aksioneri i vetëm i ndërmarrjes “A&V Gas” SHA zotëron 50% të aksioneve në ndërmarrjen “Intergas” SHA që zotëron depozitat ku ushtron aktivitetin A&V GAZ SHA. Gjithashtu, ndërmarrja A&V GAZ SHA është e integruar me ndërmarrjen “Romano Port” SHA.
25. Të gjithë këta faktorë e bëjnë të vështirë hyrjen në treg sikurse tepër të kushtueshme daljen nga tregu.

### **C. Konkurrenca potenciale**

26. Konkurrenca potenciale në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së, referuar edhe monitorimeve të mëparshme, reflekton një treg eficient ku ndërmarrjet ndjekin bursat dhe nuk aplikojnë çmime “excessive”. Ndërmarrjet në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së konkurrojnë me njëra-tjetrën duke aplikuar çmime me diferenca të ulëta dhe në ndjekje të vazhdueshme të njëra-tjetrës. Edhe investimet kapitale në teknologji të këtyre ndërmarrjeve gjatë viteve të fundit pranë Portit “Romano Port” SHA tregojnë për një nivel të lartë konkurrence.
27. Ndërmarrjet Kevin Gaz SHA dhe KASTRIOT & PETROL SHA kanë rritur pjesën e tregut gjatë vitit 2014 dhe katërmujorit të parë të vitit 2015. Konkurrenca potenciale ka bërë që ndërmarrja A&V GAZ SHA të ketë rënie të ndjeshme për sa i përket pjesës së tregut që zotëron në katërmujorin e parë të vitit 2015, duke shkuar në 45% të tregut të importit të GLN-së nga 58% që zotëronte kjo ndërmarrje në vitin 2014.
28. Ndërmarrja Kevin Gaz SHA ka filluar aktivitetin në vitin 2012 dhe rezulton në vitin 2014 me një pjesë tregu prej 18.5% në rritje të vazhdueshme duke mbërritur në 27.2 në katërmujorin e parë të vitit 2015 .
29. Ndërmarrja KASTRIOT & PETROL SHA ka një rritje të pjesës së tregut dhe mund të vlerësohet si një konkurrent potencial për ndërmarrjen me pozitë dominuese A&V Gas SHA. Pjesa e tregut të kësaj ndërmarrje ka shkuar në 17.4% në katërmujorin e parë të vitit 2015 nga 4.3% që ishte pjesa e tregut të kësaj ndërmarrjeje në vitin 2014. Ndërmarrja Kastrioti&Petrol SHA vlerësohet si një konkurrent i rëndësishëm i ndërmarrjes A&V GAZ SHA për shkak të ndërmarrjes së lidhur me të Kastrati SHA e cila ka një rrjet të ngritur të shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së.
30. Ndërmarrja Kastrati SHA, integruar vertikalisht me ndërmarrjen Kastrioti&Petrol SHA mbetet konkurrenti potencial më i madh në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së për ndërmarrjen A&V GAZ SHA. Konkurrenca potenciale drejt ndërmarrjes A&V GAZ SHA, nga ndërmarrja Kastrati SHA vjen për shkak edhe të pozicionit lider që kjo ndërmarrje ka në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, treg i lidhur me atë të importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së.



#### **D. Fuqia kundërvepruese e blerësve**

31. Për të analizuar fuqinë kundërvepruese të blerësve analiza realizohet në nivelin e tregtimit me shumicë, pasi ndërmarrjet importuese nuk tregtojnë GLN në tregun me pakicë në mënyrë direkte. Për shkak të mungesës së kontratave afatgjata si dhe numrit shumë të madh të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shumicës, lehtësitë me të cilën mund të ndryshojnë burimin e furnizimit shitësit me pakicë të GLN-së, fuqia kundërvepruese e blerësve mbetet e lartë. Pra një ndërmarrje që tregon GLN në nivelin e tregtimit me pakicë, devijon në një periudhë afatshkurtër furnizimet e saj drejt një ndërmarrjeje tjetër, nëse kushtet e tregtimit të GLN-së ndryshojnë. Pra ndërmarrja A&V Gas SHA si edhe ndërmarrjet e tjera që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së përballen me një fuqi të lartë kundërvepruese të blerësve, sjellje e cila reflekton edhe marzhet e ulëta të fitimit bruto të kompanive importuese.
32. Fuqia kundërvepruese e blerësve reflektohet edhe në ndryshimin e strukturës së tregut të shitjes me shumicë të GLN-së gjatë katërmujorit të parë të vitit 2015, ku një pjesë e madhe e shitësve në nivelin e tregtimit me pakicë kanë ndryshuar furnitorë duke bërë që ndërmarrja AV GAZ SHA të humbasë rreth 13% të tregut në import dhe shitje me shumicë.

Duke vlerësuar: strukturën e tregut të importit të GLN, pjesën e tregut të ndërmarrjes AV GAS SHA, barrierat ligjore dhe ekonomike, nivelin e konkurrencës potenciale, fuqinë kundërvepruese të blerësve në një treg me kërkesë jo elastike, produktin homogjen dhe tregun transparent, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja A&V Gas SHA ka pozitë dominuese në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të GLN.

#### **III.2 Sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese**


33. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, GP i është referuar nenit 9 të Ligjit dhe udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121, datë 23.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
34. Tregu i importit të GLN, pas ndryshimit strukturor në infrastrukturën portuale në vitin 2009 dhe nisjes së operimit të porteve të hidrokarbureve “Vlora 1” në Vlorë dhe “Romano Port” SHA, në Durrës, u karakterizua nga përqendrimi në treg, dalje të konkurrenteve nga tregu i importit dhe aktivizimi i tyre në nivelet e tjera të tregtimit, investimeve strukturore dhe magazinuese nga ndërmarrjet importuese.
35. Referuar nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 27.07.2003 dhe udhëzimit “Mbi pozitën dominuese dhe abuzimin me të”, format abuzive të ndërmarrjes me pozitë dominuese në treg i specifikojmë në dy drejtime:
  - Abuzimi në lidhje me çmimin
  - Abuzimi në oferta

##### **III.2.1 Sjellja në lidhje me çmimin**

36. Referuar të dhënave rezulton se ndërmarrja A&V Gas SHA gjatë 4 viteve të fundit ka realizuar tregtimin e gazit në nivelet e tjera të tregtimit brenda territorit të Shqipërisë si dhe eksportin në vendet e rajonit si Kosovë dhe Maqedoni.
37. Grafiku më poshtë paraqet sasinë totale të shitjes së gazit (ton) e krahasuar me koston e blerjes së mallit (çmimi i blerjes dhe shpenzimet e përmendura më sipër), me çmimin e shitjes në tregun vendas dhe në tregun rajonal.

38. Përsa i përket çmimit të shitjes, vihet re se çmimi në tregun vendas, kryesisht në periudhën e verës, është më i ulët se çmimi i shitjes në tregun rajonal duke ndjekur trendin e çmimit të blerjes.

Grafiku nr. 3: Grafiku i volumeve të importit dhe çmimet e shitjes të A&V Gas SHA




Burimi: Ndërmarrja A&V Gas SHA, shkresa nr. 253/4 prot., datë 16.06.2015 dërguar nga ndërmarrja “AV GAZ SHA”; Përpunimi grupi i punës (sasia e shprehur në ton, çmimi në lekë/kg)

#### A. Çmimet grabitqare (Predatory Prices)

39. Kjo analizë merr në shqyrtim aktivitetin e ndërmarrjes në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së, pra në tregun ku ndërmarrja A&V Gas SHA ka pozitë dominuese dhe ku sjellje të tilla abuzive nxjerrin nga tregu ose dobësojnë aktivitetin e konkurrenteve të drejtpërdrejtë me ndërmarrjen me pozitë dominuese.
40. Referuar praktikave në të mira të KE dhe OECD, analiza e “predatory price” vlerësohet në të njëjtin nivel tregtimit dhe mbështetet në analizën e çmimit të shitjes më koston mesatare të ndryshueshme (AVC<sup>132</sup>) për sasinë kryesore të produktit të shitur ose gjithë produktin nga një ndërmarrje me pozitë dominuese. Kjo sjellje mund të shkaktoj kushte për përjashtimin të konkurrentëve në treg në periudhë afatshkurtër.

Grafiku nr. 1: Krahasimi i çmimit efektiv të shitjes me ATC dhe AVC



Burimi: Shkresa nr. 253/4 prot., datë 16.06.2015 dërguar nga ndërmarrja “AV GAZ SHA”; Përpunuar nga GP.

41. Referuar të dhënave të pasqyruara në grafikun e mësipërm, konstatohet se në muajt të veçantë (korrik-shtator 2012, korrik-gusht 2013) dhe në muajin mars 2015,

<sup>132</sup> AVC= CIF(çmimi i blerjes së mallit + kostot e transportit)+ Kostot e shkarkimit + siguracion malli + pagesat e Inspektoriatit Qendror Teknik

$LRAIC^{133} = ATC > \text{çmimi efektiv i shitjes} > AVC$ , kurse në periudhat e tjera çmimi është më i lartë se  $LRAIC = ATC^{134}$ . Por, edhe në këto tre periudha afatshkurtra, çmimi efektiv i shitjes  $> AVC$  duke mos qënë një provë e mjaftueshme për çmime grabitqare.

42. Bazuar në analizën në këtë seksion rezulton se çmimi i shitjes së aplikuar nga ana e ndërmarrjes A&V Gas SHA gjatë periudhës 2010-Prill 2015 rezulton se është mbi koston LRAIC, niveli më i lartë i kostove dhe njëkohësisht më i përdorur në analizat e çmimeve grabitqare në analizat e KE dhe OECD. Periudhat mujore në të cilat rezulton se çmimi i shitjes së GLN-së është nën koston LRAIC por sipër AVC, hasen në pak raste gjatë kësaj periudhe dhe rezultati i këtyre shitjeve nuk rezulton në humbje kontabël për ndërmarrjen ose me ulje të shitjeve dhe si i tillë nuk mund të vlerësohet i mjaftushëm si evidencë për të provuar sjellje grabitqare të ndërmarrjes.

### B. Çmime të larta (Excessive Price)

43. Ndërmarrja A&V Gas SHA reflekton lëvizjet në çmimet e bursës (çmimi CIF) ku lëvizjet e çmimeve të shitjes së ndërmarrjes janë simetrike<sup>135</sup>. Rënia e çmimeve gjatë fundit të vitit 2014 dhe pjesës së parë të vitit 2015 ka qënë në përputhje me bursën ndërkombëtare, duke treguar se tregu është në kushte konkurrenciale dhe përfitimet nga rënia e çmimit të GLN-së transferohen tek konsumatori fundor.

### C. Ngjeshja e çmimit (margine squeeze)

44. Situata e njohur si “margin squeeze”, ngjeshje e çmimeve, aplikohet kur ndërmarrja me pozitë dominuese në tregun e sipërm (në këtë rast ndërmarrja A&V Gas SHA), ndjek një strategji duke aplikuar çmime shitje (shitje me shumicë) tek klientët e paintegruar, ku diferenca me çmimet që aplikon ndërmarrja e integruar AV Distribution në nivelin tjetër të tregtimit, me çmimin që A&V Gas SHA u shet klientëve të tjerë është negative ose zero. Pra, ndërmarrja me pozitë dominuese mund të transferojë fitimet për një periudhë afatshkurtër, nga një nivel tregimi në tjetrin (nga tregu poshtë në atë lart), duke përjashtuar konkurrentet në nivelin e poshtëm. Në rastet e tjera, diferenca duhet të krahasohet më kostot e konkurrentëve të tjerë në nivelin tjetër të tregtimit<sup>136</sup>.
45. Për sa më sipër, konkludojmë se gjatë muajve të caktuar në raste të caktuara haset fenomeni i ngjeshjes së çmimit ku rezulton se kostoja totale mesatare LRAIC që operojnë shitësit në nivelin tjetër të tregtimit është më e lartë se çmimi që shet ndërmarrja AV GAS DISTRIBUTION e integruar vertikalisht. Nga analizimi i të dhënave sasiore, rezultateve financiare dhe procesverbaleve të mbajtur gjatë inspektimeve nuk konstatohet që ndërmarrjet të jenë detyruar të dalin nga tregu apo të përballen me humbje financiare si pasojë e drejtëpërdrejtë e sjelljes diskriminuese të ndërmarrjes AV GAS SHA dhe AV GAS DISTRIBUTION SHA, integruar me të. Rezultati i sjelljes së ndërmarrjes AV GAS DISTRIBUTION vërtetohet edhe në pjesët e tregut që ajo zotëron në periudhën

<sup>133</sup> LRAIC është mesatarja e të gjitha kostove (fikse dhe të ndryshueshme) që kompanisë I nevojiten për të prodhuar një njësi të veçantë produkti. LRAIC (Long Run Average Incremental Cost), dhe kosto mesatare totale (ATC) janë zëvendësuese të mira për njëra tjetrën dhe janë të njëjta në rastin e një produkti të vetëm të ndërmarrjes, siç është edhe rasti në tregun e GLN.

<sup>134</sup>  $LRAIC = ATC = AVC + \text{Kosto indirekte vjetore (shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit + shpenzime personeli + Amortizim/zhvlerësim sipas PASH të bilanceve 2012-2013-2014)}$ . Për periudhën Janar – Prill 2015 duke qënë se mungojnë të dhënat e një bilanci financiar të certifikuar janë marrë shpenzime mujore përkatësisht: shpenzime qira, mirembajtje, sigurime, tarifa shkarkimi, reklama, shpenzime postare, shërbime bankare, shpenzime personeli, shpenzime interesa).

<sup>135</sup> Në rastet e dyshimeve të abuzimit me pozitën dominuese nga ana e një ndërmarrjeje me pozitë dominuese është i hasur dendur fenomeni raketë dhe pupël (rocket and feathers), ku ndërmarrjet për shkak të fuqisë kalojnë përfitimet vetëm në drejtimin e tyre në kushtet e rënies së kostove të prodhimit, në këtë rast çmimit të blerjes së GLN në bursa.

<sup>136</sup> LECG Europe (2004): “The Economics of Margin Squeeze A short history of nearly everything”


2012-Prill 2015 ku pjesa e saj e tregut në nivelin tjetër të tregtimit ka mbetur rreth 10%, thuajse e pandryshuar. Në pjesën më të madhe të rasteve mujore të hasuara na Tabelat në Aneks të një ngjeshje të çmimit, rezultati negativ vjen kryesisht për shkak të kostove indirekte të cilat nuk arrijnë të mbulojnë nga çmimi me të cilin tregtohet produkti GLN nga ana e ndërmarrjes së integruar me ndërmarrjen me pozitë dominuese.

46. Si konkluzion të analizës së margin squeeze mund të themi se në kushtet kur ndërmarrja e integruar AV GAS DISTRIBUTION blen nga ndërmarrja me pozitë dominuese AV GAS SHA me një çmim më të lartë GLN dhe shet sërish me çmim më të lartë se ndërmarrjet e tjera për periudha relativisht afatmesme, nuk mund të jemi para rastit të abuzimit me ngjeshje të çmimit (margin squeeze).
47. Gjatë procedurës së hetimit paraprak nuk janë konstatuar praktika të cilat mund të konsiderohen si refuzim për të ofruar nga ana e ndërmarrjes A&V Gas SHA. Nga inspektimet e realizuara pranë ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë, procesverbaleve të mbajtura, përfaqësuesit e këtyre ndërmarrjeve kanë deklaruar se kanë qënë të lirë në furnizimin me produkt nga ana e kësaj ndërmarrjeje. Gjithashtu, një pjesë e klientëve të ndërmarrjes me pozitë dominuese AV GAS SHA kanë ndryshuar burimin e furnizimit drejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë.
48. Pjesa e tregut që ndërmarrja e integruar zotëron në nivelin tjetër të tregtimit varion nga 10-12% (viti 2012-2014), tregues ky i moderuar krahasuar me pjesën e tregut që kanë ndërmarrjet e tjera si dhe numrin e madh të klientëve të ndërmarrjes A&V Gas SHA.

#### IV. Reflektimi i çmimit të importit në tregun vendas

49. Analiza në këtë pjesë i referohet çmimeve të blerjes dhe shitjes së ndërmarrjeve në hetim, duke marrë si pikë referimi çmimin e importit i cili është edhe çmimi në këtë rast i bursës ndërkombëtare të GLN-së që i referohet edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave gjatë procedurës së zhdoganimit të GLN-së.
50. Siç u konkludua edhe më sipër në kreun III, ndërmarrjet e marra nën hetim në këtë procedurë paraprake janë grupuar në dy kategori shitësish: i) Importues dhe shitës me shumicë; ii) niveli tjetër i tregtimit
51. Bazuar në këto dy nivele është realizuar edhe analiza e çmimit të shitjes së këtyre ndërmarrjeve sipas grupeve përkatëse:

Grafiku nr. 6: Cmimi i shitjes me shumicë sipas importuesve Janar 2012 – Prill 2015




Burimi: Te dhëna nga A&V Gas, prima Gas, Kevin gas; Përpunimi Gp

52. Nga grafiku sa më sipër konkludohet se ndërmarrja AV GAS SHA për periudhën Janar 2014 – 30 Prill 2015 ka ulur çmimin e GLN-së nga 110 lek/Kg në 60. 3 lek/Kg duke reflektuar konjunkturën e çmimit të blerjes. Rënia e çmimit rezulton me 45.5% për këtë periudhë. E njëjta sjellje refruar grafikut më sipër konstatohet

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

edhe me ndërmarrjen e dytë për sa i përket madhësisë së importit dhe shitjes me shumicë Kevin Gas SHA e cila rezulton me një çmim shitje 104.5 lek/Kg në janar 2014 dhe në muajin Prill 2015 çmimi i shitjes është 65.6 lek.kg. Rënia e çmimit është 37.2%

Grafiku nr. 7: Cmimi i shitjes në nivelin tjetër Janar 2014 – Prill 2015



Burimi: Të dhëna nga IB Gas SHA, ALFA Gas SHA, Andkri gas shpk, AV Gas Distribution sh.a

53. Për sa i përket nivelit tjetër të tregtimit, ndërmarrjet që realizojnë sipas faturave faktike shitje me shumicë dhe pakicë, rezulton se kemi një reflektim të uljes së çmimit që vjen si rezultat i konjunkturës së importit dhe nivelit të sipërm të tregtimit. Kështu, referuar grafikut më sipër rezulton se ndërmarrja IB Gaz SHA në muajin Janar 2014 ka tregtuar me një çmim prej 124.5 Lek/Kg ndërsa në muajin Prill 2015 çmimi i shitjes nga faturat rezulton 83.2 lek/Kg. Rënia e çmimit të shitjes është 33.2%. Ndërmarrja Andkri Gas Shpk në muajin Janar 2014 ka tregtuar me një çmim prej 114.6 Lek/Kg ndërsa në muajin Prill 2015 çmimi i shitjes është 78.4 Lek.Kg. Rënia e çmimit për këtë ndërmarrje në këtë periudhë rezulton 31.6%.
54. Ndërmarrja AV Gaz Distribution SHA ka tregtuar në muajin Janar 2014 me një çmim prej 122 lek/Kg dhe në muajin Prill 2015 çmimi i shitjes së GLN-së rezulton 85 Lek/Kg. Rënia e çmimit për këtë ndërmarrje rezulton me 30.4%.
55. Si konkluzion, nga analiza sa më sipër rezulton se në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN-së ka një reflektim të plotë të çmimit të blerjes dhe atij të shitjes. Në nivelin tjetër të tregtimit (ndërmarrje që tregtojnë GLN me shumicë dhe pakicë), reflektohet konjuktura e çmimit të blerjes. Rënia e çmimit të shitjes për këto ndërmarrje rezulton me më shumë se 30% për periudhën Janar 2014 – 30 Prill 2015.
56. Për sa më sipër, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës, rezulton se nuk ka shkelje të Ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe f), nenit 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar,

### V E N D O S I:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës, pasi në përfundim të kësaj

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg bazuar në nenin 4 dhe 9 të Ligjit për periudhën në hetim.

- II. T’ i rekomandojë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave:
- a) Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mirëfunksionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së në përputhje me nenet 14, 15 dhe 16 të Ligjit nr. 8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.
  - b) Të ndalojë ndërmarrjet e shitjes me shumicë të GLN-së të shesin me pakicë tek klientët fundorë të cilët nuk janë të përfshirë në nenin 14 të Ligjit nr. 8450, date 24.2.1999.
  - c) Të ndalohen ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN-së që të tregtojnë produkt për njësi të tjera që kanë si objekt rishitjen e këtij produkti siç parashikohet në nenin 16 të Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999. Njësitë e shitjes me pakicë të GLN-së duhet të tregtojnë produkt vetëm për konsumatorët fundorë.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi të gjithë palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<b>Servete Gruda</b>	<b>Koço Broka</b>	<b>Iva Zajmi</b>	<b>Eduard YPI</b>
(_____)	(_____)	(_____)	(_____)
<b>Zv.Kryetare</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtare</b>	<b>Anëtar</b>

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 391, datë 24/12/2015**

**“Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |           |
|-----------|-------------|-----------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar   |
| ▪ Servete | GRUDA       | Z/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar    |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar    |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar    |

Në mbledhjet e tij të datës 21 dhe 24/12/2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Dhënia e disa rekomandimeve lidhur me amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK ("Amendamenti")

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 2 germa c, neni 24, shkronjat d dhe f), 69 dhe 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të Amendamentit të Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me datë 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Airport SHPK ("Amendamenti") dhe pas dëgjimit të përfaqësuesve të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës në datën 23.12.2015 në mbledhjet e datës 21 dhe 24 dhjetor 2015,

### VËREN SE:

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës së bashku me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes në rolin e Organit Shtetëror të Autorizuar me shkresën e protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës nr 469 prot., të datës 14.12.2015 kanë kërkuar dhënien e mendimit të Autoritetit lidhur me dokumentin ndryshues të kontratës koncesionare të aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”.

Në zbatim të nenit 7 të Ligjit 9312, datë 11.11.2004 "Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "Tirana Airport Partners", Shpk, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar "Nene Tereza", Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljve kësaj shoqërie koncesionare", dy ministrinë në cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar, kanë zhvilluar procedurat e negociimit e disa termave të kontratës koncesionare, **me qëllim mundësimin e operimit të aeroporteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.**

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson nismën e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për të marrë mendimin e Autoritetit të Konkurrencës për draft-marrëveshjen sipas nenit 2 germa c, neni 24, shkronjat d dhe f), 69 dhe 70, pika 2 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson hapat e Organit Shtetëror të Autorizuar (Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes) drejt liberalizimit dhe rritjes së konkurrencës në shërbimet aeroportuale në Republikën e Shqipërisë.

#### I. Afati i koncesionit

Sipas draft marrëveshjes, kompania, në varësi të përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve specifike nga Qeveria e Shqipërisë të përcaktuara në këtë Amendament, ka vullnetin të heqë dorë, në masën e përcaktuar në këtë Amendament, nga e drejta e eskuzivitetit për fluturimet ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjere).

Në këmbim të heqjes dorë nga eskuziviteti, palët bien dakord se Klauzola 2.2 (Afati) paragrafi (a), fjalia e parë përkatëse, e Marrëveshjes së Koncesionit do të amendohet dhe do të lexohet si me poshtë: "(a) Koncesioni jepet për një afat kohor prej 22 (njëzet e dy) vitesh duke filluar nga Data e Fillimit ("Afati / Koncesionit"). Në rast se ndonjë aeroport apo aeroporte, përveç Aeroport/t të Kukësit "Zayed Bin Sultan Al-Nahyan", i



cili përjashtohet nga ky kusht, fillon operimin ne Republikën e Shqipërisë deri me date 23 Prill 2025, Afati i Koncesionit do të zgjatet me tej përkatësisht sipas datës së operimit të një aeroporti tjetër por afati shtyrjes eskuzivitetit fillon nga 2 vite dhe në total nuk do te tejkalojë 5 (pese) vite.

## **II. Eskluzivitetit**

Sipas projekt marrëveshjes, TIA heq dorë nga eskuziviteti kombëtar për gjithë territorin kombëtar të Republikës së Shqipërisë por jo nga eskuziviteti në zonën gjeografike pasi palët sipas draft-marrëveshjes bien dakord: se Klauzola 2.3. (Ekskluziviteti) paragrafi (c), I Marrëveshjes së Koncesionit do të amendohet dhe do të lexohet si me poshtë:

"(c) Qeveria e Shqipërisë do të sigurojë se gjate Afatit të Koncesionit nuk do të licencohet, autorizohet dhe as operohet aeroport tjetër, per fluturime ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjere), ne një rreze prej 100km (ajrore) nga Tirana Internacional Airport "Nënë Tereza" me përjashtim të uljeve emergjente. Aeroporti / Kukësit "Zayed Bin Sultan Al-Nahyan" dhe një aeroport në Vlore brenda një rrezeje prej 20km (ajrore) nga qendra e qytetit te Vlorës janë të përjashtuar nga ky kusht. Asnjë kusht i kësaj kontrate nuk do të kufizojë përdorimin e ndonjë aeroporti në Republikën e Shqipërisë për qëllime te ndihmave humanitare ose te ndihmave emergjente ne kohe katastrofash ose emergjencash civile ne Republikën e Shqipërisë ose në territoret fqinje."

## **III. Vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës**

### ***III.a. Për draft-marrëveshjen në parim***

Ligji nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar në nenin 2 përcakton se në fushën e zbatimit të ligjit janë edhe (gërma c) ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet, të cilave ju janë dhënë nga shteti të drejta eskuzive ose të drejta të veçanta.

Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës duhet të shprehet në lidhje me të drejtat eskuzive të shërbimit të transportit ajror ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve sa i përket draft-marrëveshjes së propozuar e cila ka si pasojë ndryshimin e zonës gjeografike të eskuzivitetit të operimit të fluturimeve ajrore ndërkombëtare tregtare(kargo dhe pasagjerë).

Sipas relacionit të OSHA-së nga pikëpamja e numrit të konkurrentëve që do të ofrojnë shërbimin e operimit të fluturimeve ajrore ndërkombëtare tregtare (kargo dhe pasagjerë) kjo draft-marrëveshje synon hapjen e tregut edhe për të paktën dy aeroporte të tjera, një në Kukës dhe në zonën gjeografike 20 km larg Vlorës duke e ngushtuar tregun gjeografik të eskuzivitetit të Aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” në një rreze prej 100 km. Këto dy aeroporte: aeroporti i Kukësit "Zayed Bin Sultan Al-Nahyan" dhe nje aeroport në Vlore brenda nje rrezeje prej 20km (ajrore) nga qendra e qytetit te Vlorës janë të përjashtuar nga ky kusht.

Ngushtimi i rrezes së tregut gjeografik për eskuzivitetin e fluturimeve ndërkombëtare ka qenë një nga rekomandimet e vazhdueshme të Autoritetit të Konkurrencës gjatë

vlerësimin të së drejtës ekskluzive të fluturimeve ndërkombëtare mbështetur në praktikën e bashkimit Evropian mbi tregun përkatës dhe tregun gjeografik të shërbimit të transportit ndërkombëtar me natyrë tregtare (pasagjerë dhe kargo).

Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës është shprehur në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me çështjet e konkurrencës dhe funksionimit të aeroportit të vetëm ndërkombëtar të Shqipërisë, lidhur me rishikimin e tarifave të shërbimeve si dhe mbi përfundimin e ekskluzivitetit të furnizimit me karburant në aeroport

### **III.b Për draft-marrëveshjen nen për nen**

#### ***1- Përcaktimi përkufizimit mbi datën e operimit***

Sipas draft-marrëveshjes (neni 3) “palët bien dakord se Kompania do të gëzojë të drejtën t’i bëjë të ditur, nëpërmjet një njoftimi në formë të shkruar Organit Shtetëror të Autorizuar në një formë të pranueshme për Kompaninë, zgjatjen e Afatit të Marrëveshjes së Koncesionit në rast të vënies në punë/operim të një aeroporti tjetër siç është përshkruar në këtë Klauzole 2.2 (a). Njoftimi i bere nga Kompania do të jete detyrues dhe i zbatueshëm dhe Palët nuk do të ndërmarrin asnjë veprim tjetër”.

#### ***2- Mbi zgjatjen e afatit të ekskluzivitetit***

Në nenin 3 të Amendamentit parashikohet zgjatja e afatit të ekskluzivitetit të operimit të aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” të paktën me dy vite (pavarësisht nëse do të operojë ose jo ndonjë aeroport tjetër në territorin e Shqipërisë) dhe në varësi të datës së operimit zgjatjen e afatit sipas tabelës me minimalisht 0.5 vite nëse një aeroport tjetër fillon në vitin 2024 dhe maksimalisht 5 vite nëse ndonjë aeroport tjetër fillon të operojë që këtë vit.

Autoriteti i Konkurrencës rekomandon hapjen e tregut dhe të shërbimeve aeroportuale në mënyrë të veçantë nga hyrja e mundshme e kompanive ajrore me kosto të ulët (low cost) por thekson se gjatë negociimit të rishikimit të marrëveshjes duhet marrë në konsideratë:

- 1- Performanca financiare e “Tirana International Aeroport” gjatë viteve të operimit;
- 2- Stanjacionin e tretut sa i përket numrit të pasagjerëve (rreth 1.81 milionë në vit për 2013 dhe 2014) duke humbur avantazhet e rritjes së shpejtë të tregjeve në rajon dhe vendet e Bashkimit Evropian nga operimi kompanive me kosto të ulët;
- 3- Metodologjinë e përdorur për zgjatjen e afatit të paktën me dy vjet pa vendosur kusht operimin e aeroporteve të tjera;
- 4- Bazën e informacionit të vënë në dispozicion nga OSHA nëpërmjet një Memo të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe informacionin shtesë në seancën dëgjimore të datës 23.12.2015;

### **PËR KËTO ARSYE**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (f), nenin 69, pika 1, neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

**VENDOSI:**

- I. Të mos zgjatet afati i ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare pavarësisht kushteve të vendosura nga koncensionari për rishikimin e marrëveshjes;
- II. Të liberalizohen shërbimet( ground handling) sipas anekseve të kontratës koncensionare: (i) Pagesës së Shërbimit në Tokë dhe e Uljes dhe e Ngritjes, (ii) Pagesës për Pasagjerët, (iii) Pagesës së Kargos, (iv) Pagesës së Parkimit të Avionëve dhe (v) Pagesës së ndriçimit të aerodromit.
- III. Të zbatohet vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 308, datë 21.02.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës ne tregun e shërbimit të transportit ajror”, në mënyrë të veçantë: *“Për shkak të pozicionit të kompanisë koncensionari si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifat të jenë të orientuara drejt kostos”*.

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**  
**nr. 392, datë 29/12/2015**

**Për një ndryshim në vendimin nr 391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- |           |             |           |
|-----------|-------------|-----------|
| ▪ Lindita | MILO (LATI) | Kryetar   |
| ▪ Servete | GRUDA       | Z/Kryetar |
| ▪ Koço    | BROKA       | Anëtar    |
| ▪ Iva     | ZAJMI       | Anëtar    |
| ▪ Eduard  | YPI         | Anëtar    |

Në mbledhjet e tij të datës 29/12/2015, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Sqarimin e vendimit 391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet

## **“Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015**

Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional  
Aeroport SHPK”

**Baza ligjore:** Kodi Procedurës Administrative, neni 120

**Komisioni i Konkurrencës** pas sinjalizimit nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës mbi paqartësinë e dispozitivit 1 të Vendimit nr 391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK”,

### **VËREN SE:**

Me vendimin nr 391 datë 24.12.2015 Komisioni i Konkurrencës është shprehur “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK” dhe në pikën 1 të dispozitivit:

- *“Të mos zgjatet afati i ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare pavarësisht kushteve të vendosura nga koncensionari për rishikimin e marrëveshjes”;*

Për të sqaruar më sipër në pjesën arsyetuese të Vendimit nr 391 datë 24.12.2015 Komisioni është shprehur:

- Autoriteti i Konkurrencës vlerëson nismën e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës për të marrë mendimin e Autoritetit të Konkurrencës për draft-marrëveshjen sipas nenit 2 germa c, nenit 24, shkronjat d dhe f), 69 dhe 70, pika 2 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
- Autoriteti i Konkurrencës vlerëson hapat e Organit Shtetëror të Autorizuar (Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes) drejt liberalizimit dhe rritjes së konkurrencës në shërbimet aeroportuale në Republikën e Shqipërisë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, d të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe nenit 120 të Kodit të Procedurës Administrative:

### **VENDOSI:**

Pika I e Vendimit nr.391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK”, të ndryshohet si vijon:

Ishte:

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

*“Të mos zgjatet afati i ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare pavarësisht kushteve të vendosura nga konkensionari për rishikimin e marrëveshjes”;*

Bëhet:

*“Të liberalizohet tregu i shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve dhe kargos pa u zgjatur afati i ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare pavarësisht kushteve të vendosura nga konkensionari për rishikimin e marrëveshjes”;*

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Vendimit Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Zv/Kryetar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Eduard YPI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

---

**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

**V E N D I M**

**nr. 393, datë 29.12.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Costa Edutainment S.p.A nga Venice European Investment S.p.A dhe Piora S.r.l”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |             |
|----------------------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetar |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar      |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar      |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar;     |

Në mbledhjen e tij të datës 29.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

## “Buletini Zyrtar” Nr. 11/2015

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nepermjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Costa Edutainment S.p.A nga Venice European Investment S.p.A dhe Piora S.r.l .

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Venice European Investment S.p.A / Costa Edutainment S.p.A dhe relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

### V Ë R E N S E:

#### 1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes së Investimit” të datës 2 Tetor 2015, e lidhur ndërmjet palëve: shoqëria Venice European Investments Capital S.p.A (në cilësinë e emetuesit financiar) dhe Piora 11 S.r.l , Poggio 13 S.r.l, Depositi Poeruali S.p.A, Giuseppe Costa, Nicola Costa, Giovanni Battista Costa, Andrea Costa, Paolo Maria Marsano (në cilësinë e ortakëve maxhoritarë të shoqërisë Costa Edutainment S.p.A), dhe shoqëria Costa Edutainment S.p.A (në cilësinë e Targetit).

Përqendrimi konsiston në përfitim nga shoqëria VEI të afërsisht 16.45% të kapitalit aksionar të Costa-s (dhe shoqëritë e zotëruara prej saj) dhe të një mjeti financiar të konvertueshëm së bashku me të drejtat e vetos, të cilat do të rezultojnë në ndryshimin faktik të kontrollit të shoqërisë Target.

Transaksioni përqendrimit me anë të së cilit shoqëria VEI S.p.A hyn si aksioner i ri kontrollues në shoqërinë Costa Edutainment S.p.A përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndyshuar.

#### 2. Palët në transaksion

- Venice European Investments Capital S.p.A: është një shoqëri aktive në fushën e investimeve private dhe investimeve në infrastrukturë, etj. Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.
- Costa Edutainment S.p.A: është aktive në menaxhimin e siteve dhe strukturave që i dedikohen kohës së lirë aktiviteteve kulturore dhe edukuese dhe kërkimit shkencor, etj. Shoqëria nuk është prezente në Shqipëri.

#### 3. Xhiro për vitin 2014

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX Lekë.
  - Palladio Finanziara s.p.a. : XXX Euro = XXXX Lekë



- Priora 11 s.r.l. : X Euro = X Lekë;
  - Costa Edutainment s.p.a. : XXX Euro = XXX Lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXX Lekë:
- Hydro Energia s.r.l. : XXX Euro = XXX Lekë;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

#### **4. Tregu Përkatës:**

##### *C. Tregu përkatës i produktit:*

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve.

##### *D. Tregu përkatës gjeografik:*

Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

#### **5. Efektet në treg pas përqendrimit**

Përqendrimi nuk ka asnjë impakt në tregun e brendshëm pasi ndodh në tregun e menaxhimit të siteve dhe strukturave për qëllime aktivitetesh zbavitjeje, kulturore dhe edukuese si dhe kërkim shkencor në Itali.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar:

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Costa Edutainment S.p.A nga Venice European Investment S.p.A dhe Priora S.r.l.
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

<b>Servete GRUDA</b> ( <u>                    </u> ) <b>Zv. Kryetar</b>	<b>Koço BROKA</b> ( <u>                    </u> ) <b>Anëtar</b>	<b>Iva ZAJMI</b> ( <u>                    </u> ) <b>Anëtar</b>	<b>Eduard YPI</b> ( <u>                    </u> ) <b>Anëtar</b>
---	---	--	---

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**V E N D I M**

**nr. 394, datë 29.12.2015**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Kastrati Sh.a të Auto Star Albania Sh.a”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |              |
|----------------------------|--------------|
| ▪ Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetare     |
| ▪ Znj. Servete Gruda       | Zv. Kryetare |
| ▪ Z. Koço Broka            | Anëtar       |
| ▪ Znj. Iva Zajmi           | Anëtar       |
| ▪ Z. Eduard Ypi            | Anëtar;      |

Në mbledhjen e tij të datës 29.12.2015, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Kastrati Sh.a të Auto Star Albania Sh.a.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet, 10-12, dhe neni 13, në

veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Plotë “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Kastrati Sh.a / Auto Star Albania Sh.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

## **V Ë R E N S E:**

### **1. Transaksioni dhe përqendrimi**

“Kontrata Shitje Aksionesh” është nënshkruar ndërmjet palëve Kastrati Sh.a në cilësinë e Blerësit dhe z. Basri Rruka në cilësinë e aksionerit të vetëm (Shitësit) të Auto Star Albania Sh.a, më datë 17 Gusht 2015.

Më anë të kësaj Kontrate, Shitësi dëshiron t’i shesë, transferojë dhe çedojë të 75% të aksioneve, të lira nga çdo barrë, të shoqërisë Auto Star Albania Sh.a tek Blerësi.

Me realizimin e “Kontratë Shitje Aksionesh” ndërmarrja Kastrati Sh.a do të bëhet aksioner maxhoritar dhe pronar i ligjshëm në shoqërinë Auto Star Albania dhe si rrjedhojë do të përftojë edhe kontrollin në këtë të fundit.

Operacioni i transferimit të 75% të aksioneve të Auto Star tek Kastrati Sh.a, në formën e hyrjes së aksionerit të ri kontrollues përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) dhe 10.2) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

### **2. Palët në transaksion**

- Kastrati Sh.a : në cilësinë e Blerësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Lagjia 14, Rr. e Tiranës, Ura e Dajlanit, Durrës. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj me objekt: (i) krijimin, instalimin dhe vënien në shfrytëzim të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit; (ii) import eksport, dhe tregti me shumicë të naftës e gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transporti kombëtar dhe ndërkombëtar i tyre; (iii) import eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të teknologjisë dhe pjesëve të këmbimit për ushtrimin e veprimtarisë hidrokarbure, të automjeteve të transportit hidrokarbur, të kokave dhe çisternave bote për to dhe për depozita stacionare të bombolave me apo pa mbushje gazi si dhe dhënien e asistencës teknike për to, etj.
- Auto Star Albania Sh.a (Auto Star): në cilësinë e Shitësit është një shoqëri e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, me seli në adresën: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 7. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj me objekt (i) importin, eksportin dhe tregtimin me shumicë të të gjitha llojeve të mjeteve motorike duke përfshirë importin e autoveturave, mjeteve të transportit të pasagjerëve, kamionëve dhe transportierëve të tij; (ii) importin, eksportin, si dhe tregtimin me shumicë apo me pakicë të pjesëve të këmbimit, aksesoreve, agregatëve për të gjitha llojet e mjeteve motorike, duke përfshirë pjesët e këmbimit për të gjitha llojet e autoveturave, mjeteve motorike për transportin e pasagjerëve kamionëve dhe transportierëve të çdo lloji; (iii)

kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit (servisit) për të gjitha llojet e mjeteve motorike, duke përfshirë kryerjen e këtij shërbimi për autoveturat, mjetet e transportit të pasagjerëve, kamionëve dhe transportierëve të çdo lloji. Riparimin dhe kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes për motorët e mjeteve lundruese (anijeve); (iv) importimin dhe përdorimin nga shoqëria dhe për tregtimin në tregun e brendshëm të vajrave lubrifikantë dhe nënprodukteve të tyre, etj.

### **3. Xhiro për vitin 2014.**

➤ Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX Lekë:

- Kastrati sh.a. = XXXX Lekë;
- Auto Star Albania sh.a. = XXXX Lekë;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

### **4. Tregu përkatës**

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu me shumicë dhe pakicë i tregimit të mjeteve motorike (autovetura, mjete transporti për pasagjerë, kamionë) dhe i pjesëve të këmbimit.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

### **5. Efektet në treg pas përqendrimit**

Përfitimi i kontrollit të 75% të aksioneve të Auto Star Albania sh.a. nga Kastrati sh.a. nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun përkatës të produktit duke qënë se të dy ndërmarrjet pjesmarrëse në këtë transaksion operojnë në tregje të ndryshëm produkti.

Fuqia ekonomike e Kastrati sh.a. do të ndikojë në performancën dhe investimet në të ardhmen në ndërmarrjen Auto Star Albania sh.a., duke rritur volumin e automjeteve të importuara, përmirësime në infrastrukturë, rritje të kapaciteteve të shërbimeve në servis dhe tregtisë së pjesëve të këmbimit.

Ky transaksion nuk sjell mbivendosje horizontale të aktiviteteve të palëve pjesmarrëse duke mos sjellë asnjë ndryshim në pjesët e tregut të secilës ndërmarrje. Pozicioni i tyre në treg do të mbetet i njëjtë si para ashtu edhe pas realizimit të këtij transaksioni.

Për sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

### **VENDOSI:**

**“Buletini Zyrtar”** Nr. 11/2015

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga Kastrati Sh.a të Auto Star Albania Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**  
(                    )  
**Zv. Kryetar**

**Koço BROKA**  
(                    )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Eduard YPI**  
(                    )  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**